

UNICEF

**Modulet e Trajnimit të Trajnuesve për
Arsimin Gjithëpërfshirës**

Lidhja e teorisë me praktikën

Moduli Prezantues

Bazuar në modulet e përgatitura nga zyra rajonale Unicef dhe Universiteti i Edukimit të Zyrhut

Ky botim është rezultat i një procesi bashkëpunues mes Zyrës Rajonale të UNICEF-it për CEE/CIS, Zyrën e UNICEF-it në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Universitetit të Edukimit të Zyrh. Zyra e Unicef në Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Institutin e Zhvillimit të Arsimit dhe Institutin për Studime të Opinioneve Publike mundësoi përgatitjen e këtij botimi në kontekstin shqiptar në kuadër të projektit “Adresimi i sfidave të Arsimit Gjithpërfshirës në Shqipëri”.

Grupi i punës i cili përgatiti modulin e trajnimit:

Judith Hollenweger

Paula F. Hunt

Nora Sabani

Grupi i punës i cili përshtati modulin e trajnimit në kontekstin shqiptar:

Albana Markja

Dr. Marina Ndrio

Prof. Dr. Edmond Dragoti

Prof. Asoc. Irida Agolli



Përmbajtje

Hyrje	5
Sfondi dhe Shpjegimi.....	5
Parimet bazë të moduleve mbi arsimin gjithëpërfshirës.....	9
Organizimi i parimeve dhe modeleve përgjatë moduleve.....	13
Përdorimi i moduleve	24
Vështrim i përgjithshëm mbi të tre modulet	29
Moduli 1: Arsimi gjithëpërfshirës – Vizioni, Teoria, Konceptet.....	29
Moduli 3: Ofrimi i mjediseve për mësim të personalizuar	31
Modulet ToT për arsimin gjithëpërfshirës.....	32
MODULI 1:	
Arsimi Gjithëpërfshirës – Vizioni, Teoria dhe Konceptet.....	32
Hyrje	33
Tema 1.1:	
Hyrje në Arsimin Gjithëpërfshirës	36
Aktiviteti 1.1.1: Lumi i Jetës – Të sjellim mendimet e pjesëmarrësve në trajnim.	36
Aktiviteti 1.1.2: Perspektiva e sistemit dhe e individit dhe zbatimi i të drejtave të njeriut	38
Aktiviteti 1.1.3: Ciklet e përfshirjes për të reflektuar situatën e fëmijës.....	40
Aktiviteti 1.1.4: Përfshirja dhe Përrjashtimi në institucione për të reflektuar situatën në shkolla.	42
Aktiviteti 1.1.5: Reflektimi mbi Ndikimin e Mësuesit (çon në temën 2)	43
Tema 1.2:	
Zhvillimi Profesional Personal	45
Aktiviteti 1.2.1: Përtej veprimeve të mësuesit.	45
Aktiviteti 1.2.2: Eksperienca dhe reflektimi mbi paragjykimet.	47
Aktiviteti 1.2.3: Trajektorja e qasjes së ciklit të jetës profesionale	49
Tema 1.3:	
Vlerësimi i diversitetit të nxënësve.	52
Aktiviteti 1.3.1: Kuptimi i identiteteve sociale	52
Aktiviteti 1.3.2: Reflektim mbi ciklin e nënshtrimit.	54
Aktiviteti 1.3.3.: Reflektimi mbi pasojat e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut.	55
Tema 1.4:	
Mbështetje për të Gjithë Nxënësit.... ..	57
Aktiviteti 1.4.1: Mendoni më mirë për aktivitete sesa detyra.	57
Aktiviteti 1.4.2: Zhvillimi i një kuptimi më të thellë të pjesëmarrjes.....	59
Aktiviteti 1.4.3: Zhvillimi i një kuptimi më të thellë të mjediseve mësimore. ...	61
Aktiviteti 1.4.4: Reflektim i mbështetjes për të gjithë nxënësit në shkollat e pjesëmarrësve....	63
Tema 1.5:	
Puna me të tjerët.....	64
Aktiviteti 1.5.1: Puna me familjet dhe komunitetin.	64
Aktiviteti 1.5.2: Punojmë së bashku në shkolla.	65
Aktiviteti 1.5.3: Krijimi i një vizioni të përbashkët “Arsimi gjithëpërfshirës në shkollat tuaja”	66
MODULI 2	
Punojmë së bashku për të krijuar shkolla gjithëpërfshirëse	68
Hyrje	69

Tema 2.1:	
Përdorimi i komunikimit për të vendosur marrëdhënie pune.	72
Aktiviteti 2.1.1: Ushtrimi “Më dëgjo mua”	72
Aktiviteti 2.1.2: Rast studimor “Sibora dhe prindërit e saj”	74
Aktiviteti 2.1.3: Harta e bashkëpunimit	75
Aktiviteti 2.1.4: Analiza e marrëdhënieve	77
Aktiviteti 2.1.5: Bashkëpunimi për pjesëmarrjen (çon te Tema2)	79
Tema 2.2:	
Kuptimi i kufizimeve të pjesëmarrjes	81
Aktiviteti 2.2.1: Analizoni kufizimet e pjesëmarrjes.	81
Aktiviteti 2.2.2: Eksplorimi i kufizimeve të pjesëmarrjes.	83
Aktiviteti 2.2.3: Ndarja e njohurive dhe të mësuarit nga njeri-tjetri	85
Tema 2.3:	
Bashkëpunimi për të kapërcyer kufizimet në pjesëmarrje	87
Aktiviteti 2.3.1: Përshkruani diversitetin në kontekstin e shëndetit	87
Aktiviteti 2.3.2: Të njohim ICF-në si kornizë të përbashkët	89
Aktiviteti 2.3.3: Zgjidh problemin tim, të lutem!	91
Tema 2.4:	
Ndërtimi i skuadrave dhe koalicioneve për gjithëpërfshirje	93
Aktiviteti 2.4.1: Së bashku zgjidhim probleme më të mëdha	93
Aktiviteti 2.4.2: Reflektimi i roleve dhe detyrave të një ekipi gjithëpërfshirës	95
Aktiviteti 2.4.3: Reflektim mbi marrëdhëniet duke përdorur hartën e bashkëpunimit	97
Aktiviteti 2.4.4: Idetë dhe vizionet për të përmirësuar marrëdhëniet për gjithëpërfshirje	98
MODULI 3:	
Krijimi i mjediseve për të nxënëit e personalizuar	99
Hyrje	100
Tema 3.1:	
Analizimi i situatës të të nxënëit për fëmijët dhe të rinjtë	104
Aktiviteti 3.1.1: Nxemja: Ndërgjegjësimi për situatën.	104
Aktiviteti 3.1.2: Studim rasti “Qengji dhe ujku”	106
Aktiviteti 3.1.3: Kuptimi i ndërgjegjësimit për situatën te fëmijët.	108
Aktiviteti 3.1.4: Testi Marshmallow i rivizituar.	110
Aktiviteti 3.1.5: Aplikimi i modelit të Sarah dhe kolegët e saj	112
Tema 3.2:	
Zhvillimi i qëllimeve efektive	114
Aktiviteti 3.2.1: Arritja e qëllimit të vetë-përcaktuar.	114
Aktiviteti 3.2.2: Qasja e ciklit jetësor dhe përcaktimi i qëllimit.	117
Aktiviteti 3.2.3: Qëllimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.	119
Aktiviteti 3.2.4: Përdorimi i formulimeve të qëllimit për reagim	121
Aktiviteti 3.2.5: Qëllimet konfliktuese	123
Tema 3.3:	
Përshtatja e situatave për kërkesat e nxënësit.	126
Aktiviteti 3.3.1: Një histori, shumë mësim për t’u nxënë.	126
Aktiviteti 3.3.2: Krijoni mundësi për të nxënë!	127
Aktiviteti 3.3.3: Harmonizimi i qëllimeve me mundësitë!	128
Aktiviteti 3.3.4: Përshtatni mjediset për të nxënëit	129
Aktiviteti 3.3.5: Kompetencat për gjithëpërfshirjen.	131
Tema 3.4:	
Zhvillimi i praktikave për t’i mbështetur të gjithë nxënësit.	133
Aktiviteti 3.4.1: Sillini të gjitha bashkë - World Café.	133
Aktiviteti 3.4.2: Proveni një ide!	135
Aktiviteti 3.4.3: Rishikimi dhe planifikimi për të ardhmen	137

Hyrje

Sfondi dhe Shpjegimi

Arsimi gjithëpërfshirës në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe rajonit të Shteteve të Pavarura të Komonuelthit CEE/CIS

Besimi se çdo fëmijë ka të drejtën e një edukimi cilësor që respekton dhe promovon dinjitetin e tij/saj dhe zhvillimi optimal është në themel të qasjes së të drejtave të njeriut të UNICEF-it ndaj edukimit.

Edukimi cilësor është një e drejtë për çdo fëmijë. Të dyja, **Konventa e të Drejtave të Fëmijëve (KDF)** dhe **Konventa e të Drejtave e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK)**, shprehin qartë synimin për të garantuar edukim cilësor për të gjithë dhe rëndësinë e ofrimit të mbështetjes së kërkuar gjithëpërfshirëse për të zhvilluar potencialin e çdo fëmije. Edukimi cilësor mund të arrihet kur çdo dhe secili fëmijë, duke përfshirë fëmijët e përjashtuar dhe më të marginalizuar, janë në shkollë dhe marrin edukim cilësor gjithëpërfshirës që u ofron atyre dijet që kërkohen në jetë.

Pavarësisht përpjekjeve të UNICEF-it dhe organizatave të tjera e progresit në lidhje me Edukimin Global, diferencat në të mësuar midis nxënësve në vende me të ardhura të ulëta/mesme dhe atyre në vende me të ardhura të larta vazhdojnë të jenë prezente, ndërkohë që shumë fëmijë nuk janë në gjendje të lexojnë kur mbarojnë klasën e dytë, duke e braktisur shkollën në fund të ciklit fillor ose mbas përfundimit duke ngelur analfabetë. Një nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm është arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës dhe e drejta e njerëzve për të mësuar gjatë gjithë jetës. Në fakt, një vlerësim i situatës globale në 2007 i *Child Friendly Schools (CFS)* (*Shkollave Miqësore për Fëmijët*) tregoi se një numër vendesh po përfshinin parimet e CFS-së në përpjekjet e tyre reformuese, por pabarazitë ndërmjet fëmijëve më të disavantazhuar ishin prezente ose vazhdonin të rriteshin. Për më tepër, studentët nga vendet e CEE/CIS filluan të merrnin pjesë në provimet ndërkombëtare ku doli në pah cilësia tepër e ulët e arsimimit.

Në vendet e CEE/CIS, shqetësimi në rritje përsa i përket cilësisë së edukimit dhe pabarazisë në rritje e shtyu UNICEF-in të shikonte për pengesat që ekzistonin pavarësisht përthithjes së suksesshme të parimeve të CFS. Shume sfida ngelen në rajon, ndërmjet tyre: 1) sigurimi i aksesit dhe barazisë; 2) përmirësimi i rezultateve në të mësuar; 3) parandalimi i ndikimit të emergjencave në aksesin e fëmijëve në arsim; dhe 4) përmirësimi i efektivitetit të financimit dhe qeverisjes.

Në rajon, pavarësisht përpjekjeve të ndryshme dhe universalitetit progresiv të edukimit, fëmijë nga minoritete etnike dhe gjuhësore, fëmijë me aftësi të

kufizuara, adoleshentë, fëmijë ndërmjet moshave 3-6 vjeç, dhe disa vajza, vazhduan të jenë të marginalizuar, të përjashtuar nga sistemet arsimore, dhe shpesh edhe të pallogaritur dhe rrjedhimisht të padukshëm.

Në dekadat e fundit ka patur një transformim rrënjësor të sjelljeve dhe paradigmave konceptuale në themel të përfshirjes së njerëzve me aftësi të kufizuara duke kaluar nga një model mbrojtës dhe mjekësor drejt një modeli social dhe gjithëpërfshirës duke u fokusuar në të drejtat, mundësitë e barabarta, dhe pjesëmarrjen e plotë të njerëzve me aftësi të kufizuara në jetën sociale dhe ekonomike të shoqërisë. Në vitin 2008, OKB-ja miratoi Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK), dhe shumë vende të Rajonit e kanë nënshkruar dhe/ose ratifikuar dhe sipas së cilës çdo vend njih të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për një jetë familjare, edukim, kujdes shëndetësor, rehabilitim, punë dhe punësim, mbrojtje sociale, pjesëmarrje në jetën kulturore, veprimtari sportive dhe zbatimëse.

Vendet në rajon sa vjen e po ndërmarrin akoma më shumë reforma në sistem të lidhura me arsimin gjithëpërfshirës, dhe edukimi i mësuesve ka dalë në pah si një nga prioritetet më urgjente. Ish Republika Maqedonase e Jugosllavisë ishte një nga vendet e para që filloi procesin e zhvillimit të trajnimit të mësuesve me synimin për të sistematizuar edukimin gjithëpërfshirës. Procesi përfshinte zhvillimin e 5 moduleve për trajnimin e mësuesve. Trajnimi i Mësuesve u ofrohet tani të gjitha Zyrave të Vendeve nga rajoni me synimin për t'i përfshirë në përpjekjet përgatitore të mësuesve në një mënyrë sistematike dhe të qëndrueshme (njëkohësisht në formimin fillestar dhe në punë).

Arsimi Gjithëpërfshirës në Shqipëri

Edhe në Shqipëri, arsimi gjithëpërfshirës konsiderohet si një nga kushtet e domosdoshëm në përmbushjen e gamës së kërkesave për realizimin efektiv të reformave në arsim. Mësuesi gjithëpërfshirës vlerësohet si aktor i rëndësishëm që garanton cilësinë e edukimit.

Qeveria Shqiptare në bashkëpunim me organizatat jo-fitimprurëse, ka pranuar që të garantoj të drejtën për pjesëmarrje dhe cilësi edukimi për çdo fëmijë, duke e konsideruar këtë premtim si kyç në kornizën e zhvillimit të edukimit. Artikulli 18, paragrafi 2 i Kushtetutës së Shqipërisë thotë: "Askush nuk mund të diskriminohet për arsye që lidhen me gjininë, racën, fenë, etnin, gjuhën, besimet politike fetare apo filozofike, kushtet ekonomike, edukimin, statusin social ose origjinën." Disa tregues pozitivë të zhvillimit të arsimit gjithëpërfshirës në Shqipëri janë aprovimi i Ligjit për Arsimin Parauniversitarë, Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitarë (e MAS), Dispozitave Normative Strategjise për Arsimin Gjithëpërfshirës për Fëmijët me AK.

Arsimi gjithëpërfshirës në kontekstin e UNICEF-it

Arsimi gjithëpërfshirës është një koncept i gjerë që përfshin të gjitha grupet e fëmijëve. Programi edukativ i UNICEF-it përfshin të gjitha grupet e fëmijëve duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve që rrezikojnë të ngelen jashtë edukimit.

Lajmi i mirë është që ka mënyra efektive për të ndërtuar shoqëri gjithëpërfshirëse ku në të cilat fëmijët me aftësi të kufizuara mund të gëzojnë të drejtat e tyre, duke përfshirë këtu të drejtën për një edukim cilësor, njësoj si fëmijët që nuk

kanë aftësi të kufizuara. Disa nga mënyrat do të shqyrtohen në këtë trajnim dhe shumë të tjera do të diskutohen në të ardhmen, por është tepër e domosdoshme që pengesat fizike, të sjelljes dhe politike, duke përfshirë edhe stigmat negative dhe diskriminimin, do të trajtohen dhe të ç'rrenjosen.

Në përputhje me KDF dhe KDPK dhe misionin e UNICEF-it, arsimit gjithëpërfshirës është qasja që UNICEF-i përdor për t'u siguruar se çdo fëmijë do të marrë edukim cilësor. Edukimi cilësor, ashtu siç përcaktohet në Deklaratën Salamankës, promovon "njohjen e nevojës për të punuar dhe ecur drejt 'shkollës për të gjithë' –institucione që përkrahin ndryshimet, mbështesin të mësuarit dhe i përgjigjen nevojave individuale" (fq.2). Arsimit gjithëpërfshirës është një proces që vlerëson mirëqenien e të gjithë nxënësve dhe nuk është fundi në vetvete.

Sipas qasjes së bazuar mbi të drejtat e njeriut, TË GJITHË fëmijët kanë të drejtën e arsimit gjithëpërfshirës. Të gjithë fëmijët kanë të drejtën për arsim gjithëpërfshirës. Në përputhje me KDF, KDPK dhe misionin e UNICEF-it, si dhe të organizatave të përkushtuara ndaj barazisë, UNICEF-i advokon për fuqizimin e sistemeve edukative në mënyrë që të sigurojnë se çdo fëmijë merr edukim cilësor. UNICEF-i shpesh punon me qeveritë, donatorët, dhe organizatat e shoqërisë civile për të siguruar realizimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe mjedisin për një edukim sa më gjithëpërfshirës. Masat efektive ofrohen për të ndërtuar shoqëri gjithëpërfshirëse ku fëmijët me dhe pa aftësi të kufizuara gëzojnë të drejta të barabarta, duke përfshirë edhe të drejtën për edukim gjithëpërfshirës. Për më shumë informacion mbi qasjen e UNICEF-it bazuar mbi të drejtat e njeriut, shiko, Publikimin 1 të serisë së UNICEF-it [A Rights-Based Approach to Inclusive Education for Children with Disabilities](#).

Qëllimi i zhvillimit të moduleve

Qëllimi i moduleve është të ofroj një bazë për trajnimin mbi arsimin gjithëpërfshirës i cili buron nga qasja e bazuar mbi të drejtat e njeriut. Mësuesit janë agjentët më të rëndësishëm të ndryshimit për përfshirjen sociale dhe promovimin e pjesëmarrjes dhe mësimit për të gjithë fëmijët. Modulet janë të bazuar në parimin që, kur është e nevojshme, duhet të përdoren sa më shumë informacion, mjete dhe udhëzime.

Nuk është mungesa e informacionit ajo që i pengon shkollat dhe sistemet edukative por, mungesa e ekspertizës për ta vënë këtë njohuri në zbatim. Modulet janë hartuar që t'i përshtaten çdo lloj mjedisi trajnimi në momente të caktuara të karrierës profesionale të mësuesit. Përmbajtja dhe veprimtaritë janë tepër fleksibël mjaftueshëm për të përshtatur modulet që do të përdoren nga studentët mësues dhe mësuesit në punë gjatë zhvillimit profesional dhe për trajnimin e trajnerëve, mësuesve dhe mentorëve.

Për t'u bërë agjentë të ndryshimit dhe promotorë të përfshirjes sociale, mësuesit duhet të ngrenë kapacitetet e tyre dhe të shkollave për të punuar me popullata të ndryshme nxënësish, për të siguruar pjesëmarrjen dhe promovuar të nxënit. Është fare e lehtë ta humbësh fillin me gjithë këto publikime, udhëzime, shembuj të praktikave të mira, dhe mjeteve që ofrohen për të promovuar arsimin gjithëpërfshirës. Qëllimi kryesor i këtyre moduleve të trajnimit nuk është që të ofrojë më shumë informacion por të ndihmojë pjesëmarrësit të zhvillojnë një 'hartë të vetën' për t'i udhëzuar ata drejt arsimit gjithëpërfshirës. Pjesëmarrësit duhet të bëhen kompetentë në të kuptuarit e situatave të tyre dhe të lokalizimit të problemeve të identifikuara brenda kontekstit të arsimit gjithëpërfshirës.

Synimi është që ata të jenë në gjendje të orientohen vetë duke patur një pikë më të mirë fillestare për të iniciuar ndryshime që do të çojnë në arritjen e rezultateve të synuara pa pasoja anësore negative.

Modulet janë zhvilluar duke përdorur një set parimesh bazë, që janë të rëndësishme për arsimin gjithëpërfshirës. Këto premisa bazë janë aplikuar në module sa herë që është e mundur duke patur parasysh kohën e kufizuar të dhënë, setin e kufizuar të metodave, dhe një kontekst pothuajse të personalizuar trajnues. Për shembull, modulet dhe temat janë të organizuara si paketë veprimtarish për të theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes aktive. Ato ofrojnë njohurinë pothuajse të gatshme dhe lehtësojnë të nxënit në bashkëpunim me kolegët. Njohuria kuptohet jo vetëm si një përmbledhje teorish të ndryshme, konceptesh dhe metodash por, si diçka që ka nevojë të pasurohet, ndahet, dhe ndërlihet. Si rrjedhim, modulet theksojnë prezantimin e aplikimit të parimeve bazë, modeleve bazë dhe procedurave që mund të përdoren në mjedise të ndryshme. Ato janë fleksibël për t'u përshtatur me nevojat lokale por edhe të qëndrueshme për të ruajtur një identitet të njëjtë në të gjitha vendet.

Modulet përqipen t'u adresohen **pjesëmarrësve si nxënës**, si praktikues dhe si bartës të njohurisë dhe ekspertizës nga e cila mund të përfitojnë – **pjesëmarrësit si mësues**. Në varësi të pjesëmarrësve, ose të nxënit, në themel të përpjekjeve bashkëpunuese mund të jenë ndarja e eksperiencave apo edhe zhvillimi në bashkëpunim i njohurive të reja. Në varësi të qëllimeve specifike, trajnuesit do t'i duhet të pasurojë modulet duke krijuar mjedise dhe mundësi të përshtatshme.

Modulet nuk ofrojnë një plan fiks apo afat kohor për temat dhe aktivitetet. Trajnuesi duhet të bëjë një gjykim për sa i përket kohës që duhet të shpenzohet me çdo aktivitet. Duke ofruar materiale leximi, raste studimore, duke sjellë eksperiencë dhe praktikë të pjesëmarrësve në mënyrë aktive në trajnim dhe duke pasuruar modelet me informacion konceptual, eksperiencë e të mësuarit mund të shtrihet konsiderueshëm për çdo aktivitet. Është në varësi të trajnuesit për të vendosur se çfarë tjetër duhet të përfshihet në çdo veprimtari dhe se për çfarë synimi në rastet kur referencat bëhen për materiale dhe mjete të tjera mësimi.

Terminologjia

Në module përdoren koncepte dhe terminologji që përdoret gjerësisht nga UNICEF-i dhe partnerët e tjerë për ta bërë përmbajtjen sa më të aksesueshme që të jetë e mundur. Kjo shprehet gjithashtu edhe në parimet bazë të prezantuara në këtë seksion.

Modulet i referohen *trajnuesve* dhe *pjesëmarrësve* për të sqaruar rolet e tyre specifike në veprimtaritë e parashtruara, meqenëse, edhe trajnuesit edhe pjesëmarrësit mund të jenë mësues që punojnë në mjedise të ndryshme (dhe/ose kapacitete të ndryshme). Edukimi i mësuesve përdoret si një term i përgjithshëm për të gjitha veprimtaritë përgjatë jetës profesionale të mësuesve. *Trajnimiti* si rrjedhojë i referohet moduleve dhe duhet parë si pjesë e të mësuarit të gjithanshëm që nevojitet për t'u bërë një praktikues gjithëpërfshirës.

Parimet bazë të moduleve mbi arsimin gjithëpërfshirës

Parimet e mëposhtme duhet të prezantohen meqenëse, ato do të hasen në të tri modulet, duke përfshirë sesi duhet të përdoren dhe se çfarë tjetër duhet bërë për të mbështetur arsimin gjithëpërfshirës.

Qasja e bazuar mbi të drejtat e njeriut

E drejta për akses, pjesëmarrje dhe arritje

Modulet janë bazuar në qasjen e bazuar mbi të drejtat e njeriut. Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të kenë akses, të marrin pjesë, dhe përfitojnë nga edukimi cilësor që është i personalizuar duke marrë parasysh situatat në jetën e tyre, interesat, dhe aspiratat.

Akcesi dhe *pjesëmarrja* reflektojnë të drejtën e pranimit dhe të drejtën për t'u përfshirë në edukim cilësor. *Arritja* ose marrja e edukimit reflekton të drejtën për një të ardhme të hapur dhe realizimin e potencialit të secilit ose zhvillimin e kapaciteteve. Marrja e edukimit dhe kalimi i suksesshëm në moshë madhore janë rezultate të sinergjive ndërmjet respektit për të drejta individuale dhe realizimit progresiv.

Respektimi i të drejtave dhe realizimi progresiv

Filozofia e moduleve dhe përmbajtja janë të bazuara në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve (KDF) dhe Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar (KDKPAK). Të dyja konventat nënvizojnë rëndësinë e pjesëmarrjes dhe fuqizimit si edhe rëndësinë e të krijuarit mjedise ofruese.

Për të realizuar të drejtat individuale për të gjithë fëmijët, të drejtat e tyre duhet të respektohen nga personat në përgjegjësi dhe të realizohen në mënyrë progresive nëpërmjet investimeve në politika, strategji, struktura dhe procese. Kjo reflektohet në idenë e të *drejtave individuale* dhe *realizimit progresiv*. Realizimi progresiv kërkon fillimin e proceseve të ndryshimit. Modulet mbi arsimin gjithëpërfshirës duhet të kuptohen si një mjet midis të tjerave për realizimin progresiv. Përgatitja dhe fuqizimi i mësuesve për edukimin gjithëpërfshirës është shumë i rëndësishëm por, gjithashtu duhet të iniciohen edhe veprime të tjera që synojnë proceset ndryshuese në shkolla dhe komunitete.

Informacioni mbi qasjen e bazuar te të drejtat

Informacioni mbi qasjen e bazuar në të drejta të edukimit gjendet lehtësisht. (shiko prezantimin e këtij publikimi) I një rëndësie të veçantë është edhe publikimi i UNICEF-it *The Right of Children with Disabilities to Education: A Rights-Based Approach to Inclusive Education* dhe Publikimi 1 i Serisë së UNICEF-it *A Rights-Based Approach to Inclusive Education for Children with Disabilities*.

Të mësuarit si proces social

Të nxënit është rezultati i ndërveprimeve me të tjerët dhe botën

Të nxënit nuk është diçka që ndodh në mendjet e izoluar; të nxënit është gjithmonë rezultat i ndërveprimit me botën, veçanërisht me botën sociale rreth nesh. Të nxënit është një proces aktiv; nuk është thjesht marrje pasive e informacionit. Fëmijët e vegjël mësojnë nëpërmjet përfshirjes direkte në veprimtari për të fituar aftësi, siç është ecja për shembull; synimi i veprimtarisë së tyre është që të mësojnë të ecin dhe të kënaqen ndërkohë. Ndërkohë që fëmijët rriten, ata përballen me situata të të nxënit ku kryerja e veprimtarive nuk ofron kënaqësi të menjëhershme por ato ndihmojnë në arritjen e objektivave më pak të prekshëm dhe më abstrakt siç janë leximi, përlllogaritjet dhe vetë-kontrolli. Këto objektiva janë në vetvete mjete që synojnë një rezultat; p.sh, të jesh në

gjendje të shkosh në shollë, të gjesh një punë, të shijosh poezinë. Të nxënit e qëllimtë kërkon një motivim ose një shtysë, aftësinë për vetë-rrregullim dhe lidhjen me të tjerët. Në proces, fëmijët jo vetëm që aftësohen por edhe mësojnë për veten e tyre dhe të tjerët. Sesi fëmijët nxënë dhe ku nxënë ata, është njësoj e rëndësishme sa ajo se çfarë ata po mësojnë. Për më shumë informacion mbi të mësuarit si proces social, shiko Publikimin 12 të Serisë së UNICEF-it *A Rights-Based Approach to Inclusive Education for Children with Disabilities*.

Të nxënit do të thotë të marrësh pjesë në komunitet

Të nxënit nënkupton thithjen e njohurive por edhe pjesëmarrjen në një komunitet që mëson dhe krijimin e njohurive të reja duke përdorur kreativitetin dhe potencialin për inovacion. Mësuesit duhet të krijojnë mjedise të nxëni që inkurajojnë të tilla procese. Një pjesë e madhe varet nga të kuptuarit e mësuesit të procesit të të nxënit meqenëse kjo do të reflektohet në situatat që ata do të krijojnë gjatë mësimit. A janë ata nxënës të veçuar apo lehtësojnë të nxënit në bashkëpunim? A besojnë ata se të nxënit është aftësia për të riprodhuar njohurinë saktësisht ashtu siç u është mësuar? A e kuptojnë njohurinë si diçka që mund të shkruhet apo si diçka që duhet të zbatohet? Prandaj është e rëndësishme të zhvillohet një kuptim i të nxënit që është në përputhje me objektivat e qasjes bazuar mbi të drejtat e njeriut për arsimin gjithëpërfshirës.

Njerëzit mësojnë më shumë nga njerëzit me interesa të njëjta

Modulet bazohen në parimin që *ne mësojmë më mirë nga njerëzit që janë ndryshe nga ne por janë të përfshirë në të njëjta veprimtari* dhe kanë të njëjta interesa ose përipiqen të zgjidhin probleme të ngjashme. Prandaj, grupe të ndryshme nxënësish kanë një potencial të madh për të përfituar nga eksperiencia dhe njohuria e njëri-tjetrit nëse ekziston një objektiv i përbashkët. Ky është edhe argumenti më i fortë për arsimin gjithëpërfshirës; potencialisht pasuron eksperiencat për të gjithë nxënësit. Të paturit e një objektivit të përbashkët, dhe përfshirja në të njëjtën fushë është një përbërës kyç në krijimin e komunitetit të nxënësve. Një përbërës tjetër është *besimi* ndërmjet nxënësve se së bashku mund të krijojnë diçka. Parakushti i tretë është lejimi i grupit të nxënësve për të qenë një komunitet dhe kjo kërkon përfshirje të ndërsjellë – me fjalë të tjera, nëpërmjet bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes së përbashkët. Arsimi gjithëpërfshirës ka të bëjë me lehtësimin e procesit të të nxënit dhe pjesëmarrjes në krijimin e mjediseve ofrues. Prandaj është tepër e rëndësishme që mësuesit të jenë në gjendje të mbështesin nxënësit të bëhen një komunitet.

Kompetencat

Të nxënit bëhet i dukshëm përmes veprimit

Nëse të nxënit bëhet i qartë nëpërmjet veprimeve dhe reflektohet në ndryshime të sjelljes (më shumë sesa në riprodhim njohurie, përgjigje të memorizuara dhe aplikim algoritmash), mësuesit duhet të përdorin strategji të ndryshme për të lehtësuar të nxënit dhe të matur rezultatet e të nxënit. Arsimi gjithëpërfshirës ka të bëjë me krijimin e situatave të të nxënit ku të gjithë fëmijët mund të mësojnë diçka të përshtatshme për jetën e tyre. Kurrikulat tradicionale janë të organizuara në lëndë shkollore dhe u tregojnë mësuesve se cilat tema duhet të mësohen. Kjo qasje është e rrënjësuar në besimin se vetëm disa fëmijë do të jenë në gjendje të mësojnë shumë mirë dhe të ecin përpara duke u shndërruar në elitë për vendin. Edukimi përdoret si një proces përzgjedhës dhe asgjë nuk bëhet për të menduar se çfarë ndodh me fëmijët që dështojnë me kurrikulën e dhënë. Kjo qasje edukuese nuk është në përputhje me qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut.

Zhvillimi i kompetencave kyçe për jetën

Drejtësi sociale në edukim do të thotë se fëmija është në qendër të procesit mësimor dhe jo kurrikula. Edukimi duhet t'u ofroj mundësi dhe të fuqizojë fëmijët për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm, dhe jo të krijojë një elitë të vogël dhe një grup të madh të nxënësve të dështuar. Një qasje e të mësuarit gjatë gjithë jetës ndihmon në të kuptuarit se çfarë fëmijët duhet të mësojnë që t'ia dalin në jetë në moshë madhore. Qartësisht, lëndët në shkolla luajnë një rol të vogël në jetën e shumë të rriturve dhe kontribuojnë pak në zgjidhjen e problemeve në jetë. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme një qasje e bazuar në kompetenca. *Kompetenca* është aftësia për të zhvilluar veprimtari në mënyrë efektive. Kompetencat shfaqen në situata ose kontekste të ndryshme, duke përfshirë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që duhet për të ndërmarrë veprimet e duhura. Kompetencat janë zbatim njohurish, aftësish dhe qëndrimesh që shfaqen në situata specifike. Kompetencat janë rezultat i strategjive për zgjidhjen e problemeve që aplikohen në situata të ndryshme në jetë.

Qasja për modulet e bazuar në kompetenca

Arsimi gjithëpërfshirës kërkon një qasje të bazuar në kompetenca dhe pjesëmarrje. Shkollat dhe sistemet arsimore duhet të ofrojnë udhëzime duke përcaktuar kompetencat kyçe. Ato mund të transformohen në plane mësimore të personalizuar sipas nevojave të të gjithë fëmijëve. Modulet përdorin një qasje të bazuar në kompetenca për mësimin e nxënësve dhe mësuesve. Një qasje që zgjat gjithë jetën përdoret për mësuesit dhe fëmijët. Modulet mund të përdoren përgjatë zhvillimit profesional të mësuesve duke i bërë ata të përshtaten me kërkesat specifike të të nxënësve të pjesëmarrësve. Përcaktimi i kompetencave të mësuesit ofrohet në modulin e 1-rë për të reflektuar në zhvillimin profesional të mësuesve. Trajnuesi duhet t'i referohet dhe "Profilit të mësuesit gjithëpërfshirës" dokument i cili ka si qëllim evidentimin e aftësive thelbësore, dijeve, qëndrimeve dhe vlerave që duhet të ketë gjithsecili mësues, pavarësisht nga lënda që jep, specializimi apo grupmosha ku jep mësim.

Qasja bazuar në situata të ndryshme reale

Veprimet kompetente që shfaqen sipas situatave


Kompetencat reflektojnë të nxënësve dhe shfaqen në situata dhe kontekste të ndryshme. Të nxënësve në vetvete ndodh në situata që janë gjithmonë të përfshira në kontekste më të gjëra sociale. Fëmijët sjellin në shkollë situata nga jeta e tyre; kur situatat nga jeta personale e fëmijëve përplasen me situatat e krijuar në shkollë atëherë ka një rrezik të madh përjashtimi. Veprimet ndodhin në situata dhe duhet t'u përshtaten situatave. Të kuptuarit e natyrës së situatave dhe krijimi i situatave që lehtësojnë të nxënësve, është jetësore për arsimin gjithëpërfshirës. Si rrjedhojë, modulet marrin një qasje situacionale dhe kërkojnë të ndërtojë pjesëmarrësit dhe trajnuesit më shumë të marrin në shqyrtim situata ku detyrat janë zbatuar sesa të fokusohen në një detyrë të vetme. Kjo reflektohet në strukturën bazë dhe organizimin e moduleve që është i ndërtuar rreth veprimtarive që i shërbejnë një qëllimi të caktuar dhe krijojnë situata të caktuara ku pjesëmarrësve u kërkohet që të reflektojnë, ndërveprojnë dhe të parashikojnë.

Modeli i teorisë së veprimtarisë për të analizuar situata

Si model për të analizuar veprimtaritë e kryera në kontekste apo situata specifike, në modulin 1 është përdorur një *model teorik veprimtarish* i thjeshtuar. Modeli mund të përdoret për të përshkruar veprimtari në situata të ndryshme; funksionon për të analizuar hapa të thjeshtë të ndërmarrë brenda pesë minutave, por gjithashtu funksionon edhe për të analizuar situata të fëmijëve në shkollë. Përcaktimet dhe shpjegime të mëtejshme ofrohen në kapitullin tjetër (modeli aktivitetit) dhe në modulin e 1-rë.

Modulet përdorin një qasje bazuar në situatata

Një qasje bazuar në situata reflektohet në mënyrën sesi janë organizuar modulet. Veprimtaritë krijojnë situata, dhe për secilën veprimtari është formuluar një qëllim për të ndihmuar trajnuesin dhe pjesëmarrësit të orientohen në hapat e tyre për zhvillimin e veprimtarisë. Modulet përdorin një model të thjeshtë të veprimtarive, me qëllim për të ndihmuar në fokusimin në situata konkrete të ndryshme nga jeta e fëmijëve. Qasja bazuar në situata është një **parim organizues** që përdoret për t'u dhënë pjesëmarrësve mundësi të shumta për të zhvilluar situata të orientuara drejt mënyrës së të menduarit. Nëse mësuesit do të krijojnë mjedise ofruese, ata duhet të jenë në gjendje të analizojnë situata të të nxënit dhe t'i përshtatin ato sipas kërkesave të nxënësve të tyre. Kjo kërkon vëmendje ndaj situatave dhe aftësi në zgjidhjen e problemeve.



Të nxënit në shkolla


Ta shohësh edukimin përmes syve të fëmijëve

Arsimi gjithëpërfshirës do të thotë ta shikosh shkollën me sytë e fëmijëve, duke vënë në rradhë të parë interesat e tyre, duke siguruar pjesëmarrjen dhe të nxënit. Por shkollat janë institucione me funksione sociale konfliktuese: duke ofruar edukimin më të mundshëm për të gjithë, duke rikrijuar struktura fuqizuese në një shoqëri, duke dhënë shanse të ndryshme në jetë dhe duke përzgjedhur. Mësuesit vetë përballen me pritshmëri dhe motivime konfliktuese që shpesh krijojnë dilema. Këto dilema ndihen më shumë me fëmijët që perceptohen të kenë probleme në të nxënë dhe pjesëmarrje. Këto dilema duhet të merren seriozisht dhe sa herë të dalin në pah gjatë ndërveprimit, u duhet dhënë koha e mjaftueshme për diskutim. Një mësues gjithëpërfshirës është në gjendje të balancojë objektivat në konflikt, duke i nxjerrë në pah dhe prioritetuar ato brenda një konteksti të një vizioni më të madh ose qëllimi të përgjithshëm. Parimet organizuese të prezantuara në këto module dhe veprimtaritë që fokusohen në ndërtimin e vizionit duhet të ndihmojnë në zhvillimin e kompetencave që nevojiten këtu.

Shkollat si organizata të nxëni

Arsimi gjithëpërfshirës nuk ka të bëjë vetëm me mësuesin si individ; ka të bëjë gjithashtu me shkollat si organizata dhe komunitetet. Për të ngritur kapacitetet e shkollave për të përdorur objektivat konfliktues në mënyrë krijuese kërkohen profesionistë të cilët janë në gjendje t'i mendojnë shkollat si institucione të nxëni dhe shikojnë veten si agjentë të ndryshimit dhe zhvillimit. Modulet janë të organizuar në një mënyrë që lehtësojnë arritjen e kompetencave përkatëse dhe ofrojnë për shkollat mjetet për t'u futur në këtë proces. Të kthehesh në një institucion të nxëni kërkon zotërimin e pesë disiplinave të të nxënit: (1) aftësinë për të zhvilluar një vizion të përbashkët; (2) përdorimin efektiv të modeleve të përbashkëta mendore; (3) vetë ndërgjegjësimi i të gjithë atyre që janë të përfshirë; (4) kapacitetin për të nxënë në skuadër dhe zgjidhje problemesh; si edhe (5) sistemet e të menduarit ose kuptuarit të situatave komplekse. Modulet kërkojnë të adresojnë këto kapacitete dhe të ofrojnë mundësi për t'i zhvilluar ato.

Këto pesë disiplina mund të prezantohen në modelin e aktiviteteve:



Organizimi i parimeve dhe modeleve përgjatë moduleve

Cikli i jetës


Edukimi për jetën

Qasja e *edukimit për jetën* reflekton ndërveprimin e sotëm dhe veprimtarinë në kontekstin e zhvillimit të një personi përgjatë jetës. Ajo promovon idenë e të nxënit gjatë gjithë jetës jo vetëm si domosdoshmëri por edhe si një trajektore për të cilën shkollat duhet të kontribuojnë në mënyrë domethënëse. Qasja e *edukimit për jetën* ka të bëjë me trajektorët zhvilluese dhe kërkon t'i influencojë ato në mënyrë pozitive për të siguruar qëndrueshmërinë dhe rezultatet afatgjata pozitive. Të marrësh në konsideratë ciklin e jetës së një nxënësi apo ciklin e jetës profesionale të një mësuesi kërkon aftësi për të lidhur veprimet e tanishme me rezultatet që janë larg në kohë (në të ardhmen) dhe hapësirën (hapësirat sociale ose fushat e jetës jashtë shkollës). Fokusimi në kompetencat kyçe që mund të merren në një mjedis dhe të aplikohen në mjedise të tjera sociale ndihmon në arritjen e tyre.

Të veprësh tani me të ardhmen në mendje

Shkollat gjithëpërfshirëse duhet të zhvillojnë të kuptuarit sesi vendimet që merren "tani e tutje" mund të kenë pasoja afatgjata në jetët e fëmijëve dhe të rinjve. Mësuesit duhet të jenë të vëmendshëm për këtë, në mënyrë që të jenë në gjendje të reflektojnë mbi pasojat e mundshme të veprimeve të tyre dhe aty ku është e mundur, të zhvillojnë alternativa të tjera.


Është përgjegjësia e tyre të mbajnë të hapur të ardhmen e fëmijëve (shiko qasjen



bazuar mbi të drejtat) dhe jo të kufizojnë aftësitë e tyre të ardhme duke limituar pjesëmarrjen e tyre. Synimi i arsimit gjithëpërfshirës është që të lejoj fëmijët të arrijnë maksimumin e potencialeve të tyre. Meqenëse asnjë mësues nuk e di që një pjesëmarrje e plotë dhe efektive do të kërkohet në të ardhmen e largët, këto objektiva dhe synime afatgjata të edukimit duhet të ndahen në objektiva afat-mesëm dhe afat-shkurtër.


Zgjerimi i të menduarit përgjatë kohës dhe hapësirës sociale

Pjesa “tani e tutje” është e kufizuar në kohë dhe hapësirë. Por mund të shtrihet në situata të tjera ose hapësira sociale dhe mund të shtrihet përgjatë kohës në të ardhmen. Shkollat gjithëpërfshirëse dhe mësuesit gjithëpërfshirës janë në gjendje t’i konsiderojnë të dyja, rëndësinë e veprimeve të tanishme dhe veprimtaritë për fusha të tjera sociale (transferimin dhe aplikimin e kompetencave) dhe rëndësinë për të ardhmen (zhvillimin e kompetencave) Kjo është një çështje që mësuesit përballen në planet e tyre edukativë por edhe kur zhvillojnë shkollat e tyre për t’i bërë gjithëpërfshirëse:



Grafiku i mëposhtëm tregon lidhjet midis të tashmes dhe të ardhmes së largët dhe ofron një model mendor për të menduar për mjedise të ndryshme sociale. Kjo ide është marrë edhe në modelin e kompetencave të mësuesit të paraqitur në module. Për më tepër, ai ofron pika fokale për të identifikuar nivelet në të cilat situatat mund të analizohen duke përdorur modelin e aktiviteteve:

E tashmja dhe e ardhmja e largët



Qasje të reja për kohën dhe hapësirën


Shkollat tradicionale kanë një qasje të standardizuar ndaj kohës dhe hapësirës; koha ndahet në pjesë 45 minutëshe dhe hapësira ndahet në klasa me madhësi të barabartë dhe banka të organizuara radhë-radhë. Shkollat gjithëpërfshirëse duhet t'i shqyrtojnë të tilla elementë dhe të reflektojnë në hartimin e situatave të nxënit që mund të lehtësojnë eksperiencën të ndryshme në të nxënë për të përfshirë të gjithë fëmijët dhe të rinjtë.

Zgjidhja e problemit

Të krijosh një shkollë gjithëpërfshirëse kërkon zgjidhjen e një sërë problemesh dhe tejkalimin e pengesave dhe vështirësive duke gjetur zgjidhje të reja. Të nxënit është thelbësor, zgjidhje problemesh dhe marrja e informacionit është hapi i parë në këtë proces.

Të nxënit është zgjidhje problemesh

Meqenëse zgjidhja e problemeve është një veprimtari e rëndësishme, këtu paraqitet një model i përbashkët për t'u përdorur përgjatë moduleve. Së pari, duhet kuptuar situata ose duhet identifikuar problemi (situata, problemi). Kjo ndiqet përgjithësisht nga një sekuencë në të cilën kërkohen informacione shtesë, mblidhen pikëpamje të ndryshme ose opinionet e personave të ndryshëm (matja, mbledhja). Pastaj, ky informacion ka nevojë të analizohet dhe kuptohet. Duhet të ketë një sekuencë që u jep kuptim ngjarjeve duke integruar informacionin dhe mundësisht të zhvillohet një kuptueshmëri më e mirë e problemit (analizimi, kuptimi). Si një hap tjetër, zhvillohen zgjidhje të ndryshme dhe skenarë për të adresuar problemin (planifikimi, vendimi), dhe së fundmi një prej tyre përzgjidhet dhe vihet në zbatim (veprimi, zbatimi). Si fazë finale të ciklit të zgjidhjes së problemit, vlerësohen rezultatet përkundrejt objektivave dhe rezultateve të planifikuara (kontrolli dhe vlerësimi).



Të nxënit e zgjeruar

Të nxënit e zgjeruar nuk është asgjë tjetër veçse përdorimi i aftësive për zgjidhjen e problemeve për të qenë efektiv dhe i kompletuar në jetë.

Fatkeqësisht, shumë studentë harxhojnë shumë kohë me të nxënit vetëm për vete, duke ndërtuar mekanizma mbrojtës dhe duke mësuar si të shmangin sfidat për të ruajtur karakterin ose një sens identiteti. Kjo i çon studentët në rrethin vicioz të të nxënit të padobishëm ose ndërveprimit negativ me mësuesit dhe shokët.

Zgjidhja e problemit si një parim i moduleve


Cikli i zgjidhjes së problemeve përdoret përgjatë tre moduleve për të ndihmuar strukturën dhe planifikimin e proceseve të të nxënit (cikli i të nxënit). Kjo mund të aplikohet në mësimin e nxënësve dhe zgjidhjes së problemeve. Të nxënit duhet të kuptohet si procesi i plotë i zgjidhjes së problemeve; mund të lidhet gjithashtu me pesë "E-të" e parimeve të nxënit:

Përfshirja (*Engage* - bëje problemin ose sfidën të dukshme), eksploro (*Explore* - eksploro problemin, vëzhgo ose merr më shumë informacion, krijo njohuri të reja), shpjego (*Explain* - siguro gjithëpërfshirjen dhe kuptimin), zgjero (*Extend* - apliko atë çfarë u mësua në situata) dhe vlerëso (*Evaluate* - vlerëso të nxënit). Cikli i zgjidhjes së problemit mund të lidhet me "Taksonominë e Blumit" dhe cikle të ndryshme të veprimeve që janë aplikuar në zhvillimin e politikave.

Koncepti i "përgjigjes për ndërhyrje"**Modeli me tre nivele i sistemeve mbështetëse**

Sistemet e arsimit gjithëpërfshirës sigurojnë udhëzime të standardeve të larta për të gjithë fëmijët por, bëjnë parashikime për grupe të caktuara fëmijësh që kërkojnë ndërhyrje apo mbështetje të caktuar si edhe për fëmijët të cilët kanë nevojë për ndërhyrje intensive ose mbështetje për pjesëmarrjen dhe të nxënit.

Brenda konceptit të "përgjigjes për ndërhyrje", është zhvilluar një grafik i dobishëm ("trekëndëshi i ndërhyrjes") për të vizualizuar këto tre grupe në një model:

**Gjuha e përbashkët**

"Trekëndëshi i ndërhyrjes" ndihmon për të folur për grupe të ndryshme fëmijësh, nevojat e tyre për mbështetje specifike, përqindjen e fëmijëve të identifikuar (nevojat për edukim special dhe/ose fëmijët me aftësi të kufizuara) që priten të

jenë në çdo sistem edukativ si edhe mjediset që shkollat duhet të krijojnë në mënyrë që të jenë mikpritëse për të gjithë fëmijët. Modeli mund të ndihmojë shkollat të vlerësojnë sistemet e tyre mbështetëse dhe të shikojnë nëse ato kanë akses për mbështetje që i lejon të përfshijnë të gjithë fëmijët dhe të rinjtë.

Flisni për ndryshimet midis shteteve dhe mjediseve arsimore

Grupet e fëmijëve që futen në nivelin e dytë ("Ndërhyrje në grupe të vecanta") mund të ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin. Disavantazhet që duhen trajtuar mund të lindin nga mos përdorimi i gjuhës së udhëzimeve, përkatësia në një grup të marginalizuar ose të qenit një nxënës i ngadaltë.

Fëmijët që futen në nivelin e tretë ("Ndërhyrje intensive") janë përgjithësisht fëmijë me aftësi të kufizuara që kërkojnë ndihmë intensive, pajisje të veçanta, ndihmë nga eksperti ose masa të tjera për të siguruar pjesëmarrjen e tyre në mjedise gjithëpërfshirëse.

Kompetencat e mësuesit

Katër fushat e kompetencës së mësuesit

Një tjetër parim organizimi, që është pjesë e të tre moduleve, është koncepti i kompetencave të mësuesit. Katër fushat e kompetencave të mësuesit janë përdorur për të nënvizuar profilin e mësuesve gjithëpërfshirës (shikoni "Profili i Mësuesit Gjithëpërfshirës"): 1) Vlerësimi i diversitetit të nxënësit; 2) mbështetja e të gjithë nxënësve; 3) puna me të tjerët; dhe 4) vazhdimësia e zhvillimit profesional individual. Edhe pse është e dobishme të diskutohen degëzimet e kompetencave, ai nuk ofron shumë orientime për mënyrën se si këto kompetenca mund të krijohen me kalimin e kohës dhe përgjatë karrierës profesionale.

Mënyrat e njohjes për të orientuar veprimin

Për të folur dhe për të ndarë ide sesi zgjidhja e problemeve dhe formimi profesional ndihmon drejt ndërtimit të kompetencave të mësuesit dhe rritjes së kapaciteteve të tyre për të krijuar klasa gjithëpërfshirëse në shkolla kërkohet një model i ri.

Zgjidhja e problemeve në "tani e tutje" ndodh përgjithësisht sipas modelit të njohjes, pasuar nga reagimi i menjëhershëm nëpërmjet veprimeve rutinë dhe e monitoruar nga një vëmendje sipas situatës (veprimet si përshtatja e volumit të zërit me nivelin e zhurmës në klasë). Nëse problemet vazhdojnë, merret parasysh një perspektivë më e gjerë për të kuptuar situatën dhe për të marrë masat e duhura (veprime si: p.sh ti thuhet një nxënësi të mos bëj zhurmë). Nëse problemet nuk mund të zgjidhen duke përdorur veprimet e ndërmarra në atë situatë, situata duhet të adresohet në një drejtim tjetër (si p.sh, përmirësimi i ndërveprimit me shokët). Këto mënyra të ndryshme njohjeje dhe praktike paraqiten në tabelën (Eraut 2009, e përshtatur që nga 2007):

Llojet e procesit	Mënyra e njohjes		
	E çastit/ refleksive	E shpejtë/intuitive	Diskutuese/analitike
Vlerësimi i situatës	Njohja e veçorive	Diskriminimi Interpretimi i shpejtë	Diagnozë e tejzgjatur Konsultim, diskutim dhe analizë
Vendimmarrja	Përgjigja refleksive	Njohja fillestare ose përgjigja intuitive	Analizë dhe bisedë diskutuese
Veprimet e hapura	Veprime rutinë	Rutina të ndërprera nga vendime të shpejta	Veprime të planifikuara me rishikime periodike të ecurisë
Angazhimi meta-konjitiv	Ndërgjegjësimi për situatën	Monitorimi i nënkuptuar Reflektime të shkurtëra dhe reaguese	Monitorimi i mendimit dhe aktivitetit, të nxënësve reflektues Vlerësimi në grup

Aftësia për t'i lidhur efektivisht tre mënyrat

Mësuesit efektiv janë në gjendje të mbështeten në modelin e tyre të njohjes të menjëhershëm dhe në një përgjigje pothuajse automatike për të mbajtur një atmosferë në klasë që mbështet të nxënit. Por, nëse hasen vështirësi, mësuesit duhet të jetë në gjendje të ndërpresin veprimet e tyre rutinë, të marrin vendime të shpejta dhe të përshtatin sjelljet e tyre.

Kjo mund të mos jetë e mjaftueshme për të adresuar problemet që duhen trajtuar për një periudhë më të gjatë kohe, mundësisht duke përfshirë disa persona në procesin e zgjidhjes së problemit.

Lëvizjet, veçoritë dhe abstraksionet

Sipas idesë së qasjes së ciklit të jetës, mësuesit duhet të jenë në gjendje të lidhin veprimet e tyre të menjëhershme apo "veprimet" për të krijuar situata të nxëni ose të vendosin "modele" që ndihmojnë nxënësit të jenë pjesëmarrës efektiv në situata specifike jetësore.

Por, që të planifikojnë për një pjesëmarrje të vazhdueshme në shoqëri, mësuesit duhet të kenë parasysh tërë panoramën e madhe dhe të punojnë me "abstraksione" të cilat nevojiten për të lidhur situata të ndryshme të të nxënit me situatat e përgjithshme të jetës së fëmijës. Saphier, Haley-Speca dhe Goëer (2008) kanë organizuar respektivisht njohuritë dhe aftësitë e mësuesit. Shumë shpesh kjo reflektohet në progresionin e njohurive dhe aftësive të fituara përgjatë ciklit të jetës profesionale të mësuesve:

Llojet e procesit	veprimet	Modele	Abstraksionet
Menaxhimi	Vëmendja Momenti Disiplina	Hapësira Koha Rutinat	
Mësimdhënia	Qartësia Parimet e të nxënit	Modelet e mësimdhënies	
Motivimi	Pritshmëritë Forcimi i marrëdhënies personale	Klima në klasë	
Kurrikula			Hartimi i kurrikulës Objektivat Planifikimi Përvojat e të nxënit Vlerësimi Objektivat gjithëpërfshirëse

Pjesëmarrja

Pjesëmarrja si një koncept kyç

Një përcaktim i pjesëmarrjes dhe një model bazë për të kuptuar kufizimet e pjesëmarrjes, paraqitet në modulën 1 dhe përdoret përsëri në modulet 2 dhe 3. "Pjesëmarrja" i referohet komponentit të procesit të edukimit gjithëpërfshirës, ndërsa "aksesi" fokusohet në kontributet dhe "arritjet" në rezultatet e edukimit. Pjesëmarrja është gjithashtu një term kyç për qasjen bazuar mbi të drejtat. *Pjesëmarrja e sotme është një parashikim i fortë për pjesëmarrjen në të ardhmen: nëse fëmijët nuk janë në gjendje të marrin pjesë në të gjitha situatat jetësore sot, do të ketë pak gjasa që ata ta bëjnë këtë në të ardhmen, ose vetëm nëse ofrohet mbështetje e mjaftueshme ose situata ndryshohet për ta bërë sa më pjesëmarrëse.*

Përkufizimi i pjesëmarrjes

Pjesëmarrja është të qenit i përfshirë ...si "përfshirja e sjelljes" (veprim pozitiv, përfshirje në detyrat akademike dhe për të nxënit, pjesëmarrje në veprimtaritë shkollore). Pjesëmarrja është njohja dhe të ushtruarit e


kompetencës (p.sh, njohëse, komunikuese, manuale, emocionale, etj.). *Pjesëmarrja është "përfshirje mendore"* (vetë-rregullim, fleksibilitet në zgjidhjen e problemeve, kopjimi strategjive); *njohja dhe ushtrimi i autonomisë* (p.sh, tërheqja e vëmendjes, sjellje vetë-rregulluese për të kryer detyra komplekse, marrja e vendimeve për jetën, vetë-vendosja); "përfshirje emocionale" (reagime afektive si interesi, lumturia, identifikimi me mësuesin dhe shokët); *njohja dhe ushtrimi i përkatësisë* (p.sh, të tregosh interes të tjerët, të jesh i motivuar për të marr në konsideratë sugjerimet e të tjerëve, të ndjehesh i pranuar dhe i mirëpritur) *në rutina tipike në kushte tipike që janë të orientuara drejt objektivave domethënëse personale ose sociale.*

Të gjithë fëmijët mund të mësojnë dhe të marrin pjesë

Parimi bazë i arsimit gjithëpërfshirës është se të gjithë fëmijët mund të mësojnë, prandaj, të gjithë duhet të marrin pjesë në mësim. Është përgjegjësia e shkollave të sigurojnë që nxënësit mësojnë gjëra të dobishme për veten e tyre dhe shoqërinë. Meqenëse pjesëmarrja sigurohet më shumë në situata konkrete, është e nevojshme të zhvillohet tek fëmijët një kuptueshmëri e situatave dhe të ofrohen mjete për të analizuar ato (shiko "Modelin e Aktiviteteve"). Pjesëmarrja mund të analizohet përgjatë të gjitha fushave të jetës së një fëmije (p.sh, edukimi, jeta shkollore, jeta familjare, argëtim).

Katër perspektivat e pjesëmarrjes


Nëse pjesëmarrja është një koncept kyç për arsimin gjithëpërfshirës, duhet ofruar një model për të kuptuar kufizimet në pjesëmarrje. Në modulën 1, katër perspektiva janë paraqitur për këtë qëllim: "perspektiva zhvillimore" (qasja e ciklit të jetës); "perspektiva e marrëdhënieve" (qasja ndaj personit dhe sistemit), "perspektiva kurikulare" (qasja e kompetencave); dhe "perspektiva shëndetësore" (qasja e shëndetit dhe mirëqenies).



Perspektiva shëndetësore ka qenë dominuese

Sistemet edukative tradicionalisht kanë sisteme mbështetëse për kufizimet në pjesëmarrje që dalin në pah në kontekstin e shëndetit dhe mirëqenies. Arsimi gjithëpërfshirës ka ardhur si pasojë e përpjekjeve për të siguruar pjesëmarrjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe probleme shëndetësore.

Kjo është arsyeja pse sisteme të veçanta mbështetëse kanë një traditë të gjatë në shumë vende, sa që në disa rrethana ka çuar në një mbipërfaqësim të fëmijëve në mjedise të veçanta edukimi (p.sh. me fëmijë nga familje imigrantësh ose minoritetesh etnike/gjuhësore). Modeli mjekësor që qëndron mbrapa këtyre mjediseve të veçanta të ndara është kritikuar në 10 vitet e fundit dhe një model i ri, për të kuptuar kufizimet në pjesëmarrje, ka dalë në pah.



Perspektiva zhvillimore

Një traditë tjetër në pjesën më të madhe të sistemeve edukuese është që t'i grupojë arritjet e fëmijëve sipas moshës. Pritshmëria e mësuesve është që, në një pikë të caktuar të zhvillimit të tyre, të gjithë fëmijët të kenë arritur të njëjtin zhvillim në të gjitha fushat. Duke patur parasysh këto pritshmëri, diversiteti përta i përket zhvillimit mund të çojë në kufizime të pjesëmarrjes së nxënësve të cilët zhvillohen në një mënyrë "atipike". Për shkak të rrethanave në jetë por edhe përzgjedhjes gjenetike, trajektoret zhvillimore janë të ndryshme edhe midis fëmijëve të të njëjtit grup-moshë (dhe shpesh nga i njëjti gjenom). Duke marrë parasysh pikëpamjen e ciklit të jetës, kjo mund të ndihmojë në të kuptuarit e trajektoreve zhvillimore dhe t'u përgjigjet ndryshimeve në zhvillim.

Perspektiva e marrëdhënieve

Pjesa më e madhe e vendeve, në të shkuarën, kishin në sistemet e tyre grupe kulturore homogjene fëmijësh. Perceptimet për grupet homogjene e bënë ndërveprimin më të lehtë meqenëse prindërit kishin të njëjtat pritshmëri, besime, dhe sisteme vlerash ashtu si dhe mësuesit. Modelet e marrëdhënieve nuk ishin vënë në pikëpyetje dhe fëmijët pritëshin që t'i nënshtroheshin autoritetit të të rriturve. Për të kuptuar kufizimet në pjesëmarrje të shkaktuar nga mungesa e ushqimit të marrëdhënieve mbështetëse (shiko seksionet mbi "të mësuarit si proces social"). Një model ose qasje nevojitet që të ndihmojë shkollat të kuptojnë situatat personale të fëmijëve dhe të analizoj situatat sociale të krijuara në shkolla. Në modulin 1 paraqitet një model për të parë sistemet dhe sesi marrëdhëniet që krijojnë influencojnë pjesëmarrjen e fëmijëve. Modeli shpjegohet në seksionin tjetër dhe duhet të përdoret për të kuptuar kufizimet në pjesëmarrje që vijnë për shkak të mungesës së ushqyerjes së marrëdhënieve (shiko seksionin mbi Sistemet dhe Personat).

Perspektiva kurrikulare

E fundit por jo nga rëndësia, fëmijët mund të kufizohen në pjesëmarrje sepse ata akoma nuk kanë patur mundësinë të fitojnë kompetencat që nga mësuesi ose shkolla janë caktuar si parakusht për pjesëmarrjen. Shumë vende, si dhe

në Shqipëri, kanë akoma kurrikula jo shumë fleksible, ndonjëherë edhe duke theksuar se çfarë duhet të mësohet në një javë të caktuar të vitit shkollor. Duke u fokusuar në kompetenca të gjera (shiko seksionin mbi kompetencat) mund të ndihmojë në ndërtimin e planeve mësimorë të personalizuar.


Sistemet dhe personat

Bashkimi i sistemeve dhe personave

Arsimi gjithëpërfshirës ka të bëjë me të bërit bashkë të sistemeve dhe njerëzve në mënyrë që të promovojë pjesëmarrjen për të gjithë. Tradicionalisht, fokusi ishte te nxënësi si individ dhe te fakti sesi ata mund të përshtaten në edukim. Që në fillim të debatit të gjithëpërfshirjes, kjo logjike u kthye në anën tjetër: fokusi u vendos në sistemet arsimore dhe në faktin sesi ato mund të bëheshin të përshtatshme për nevojat e të gjithë fëmijëve. Në realitet, nuk është kurrë vetëm njëri apo tjetri prej tyre dhe kontributi i njerëzve apo sistemeve për gjithëpërfshirje apo përjashtim mund të ndryshojë nga një situatë në tjetrën. Prandaj është e rëndësishme që të ofrohen mjete dhe modele për të bërë bashkë pjesëmarrjen e personave dhe gjithëpërfshirjen e sistemeve arsimore.

Kuptimi i sistemeve sociale

Kërkesa për të menduar sipas perspektivës së personit dhe sistemit reflektohet në qasjen e bazuar te të drejtat e njeriut (shikoni seksionin e perspektivës). Ajo ka të bëjë gjithmonë me respektimin e të drejtave të individit, dhe realizmin progresiv përmes zhvillimit të sistemeve dhe organizatave. Prandaj, mësuesit dhe shkollat kanë nevojë për mjete që të mendojnë për sistemet (shikoni gjithashtu seksionin e të nxënies në shkolla). Modeli i prezantuar këtu për të kuptuar marrëdhëniet dhe sistemet që ato krijojnë është krijuar nga Uri Bronfenbrenner:



Ka shumë qasje për të përshkruar sistemet sociale prandaj mund të përzgjidhet një tjetër sipas preferencës së trajnuesit. Modeli duhet të jetë në gjendje të vendosë individin në qendër të sistemit, i rrethuar nga rrathë të marrëdhënieve të krijuara në shoqëri. Modeli prezantohet në modulën 1 dhe përdoret përsëri më vonë për të treguar kompleksitetin e situatave në jetën e një fëmije.

Njerëzit si pjesë e institucioneve

Ndihma nënkupton mënyrën se si sistemet dhe personat mund të mblihen së bashku brenda kontekstit të sistemit edukues dhe përdoret një matricë për të bërë bashkë të dyja pikëpamjet (person/sistem), nivelet e sistemit edukues dhe proceset e tij (kontribut, proces, rezultat). Ky model është i dobishëm për të identifikuar praktikatat në sistemet edukuese (nivele klase, shkollë, politikash) dhe sesi të ndryshohen ato për të mbështetur shkollat gjithëpërfshirëse.

		Prespektiva kronologjike				
Prespektiva e sistemeve	Shkolla si...	Matje Mbledhje	Analizë Kuptim	Planifikim Vendimmarrje	Veprim Zbatim	Kontroll Vlerësim
	Politikat					
	Shkollat					
	Klasa					
Marrëdhëniet pjesëmarrëse lidhin mjediset/sistemet me personin						
Pjesëmarrja e personit (fëmijët, mësuesit, prindërit)						

Shigjetat tregojnë dy pika hyrëse për të promovuar të drejtat për edukim: person – sistem dhe sistem – person. Në situatat reale në jetë, zbatimi i të drejtave kërkon marrëveshje ndërmjet personave dhe sistemeve. Ky model ndihmon për të shqyrtuar pikat e ndryshme hyrëse dhe se ku të drejtat mund të realizohen.


Zgjidhja e problemit në institucione

Matrica, gjithashtu integron ciklin e zgjidhjes së problemeve që u prezantua më parë. Kjo do të ndihmojë për të integruar procedurat të zhvilluara për të zgjidhur probleme specifike (p.sh, krijimi i planeve të personalizuara të edukimit) me proceset e përgjithshme të punës në shkollë. Gjithëpërfshirja nuk ka të bëjë me zbatimin e metodave të caktuara apo mjeteve dhe materialeve; por ka të bëjë me zhvillimin e një sistemi që t'i përgjigjet nevojave të të gjithë njerëzve të përfshirë. Prandaj shkollat duhet të fuqizohen të mendojnë në sisteme.

Modeli i teorisë së aktivitetit

Nevoja për veprime të koordinuara

Për ta bërë arsimin gjithëpërfshirës realitet do të thotë se të gjithë aktorët duhet të koordinojnë veprimet e tyre me vizionin e përbashkët për të krijuar shkollat gjithëpërfshirëse dhe klasa gjithëpërfshirëse. Gjithëpërfshirja dhe përjashtimi janë rezultat i veprimeve njerëzore, si e veprimeve në ndërveprimin e drejtpërdrejtë me fëmijët ashtu dhe veprimeve indirekte që krijojnë pengesa për pjesëmarrjen. Modeli i teorisë së aktivitetit prezantohet në modul 1 dhe përdoret sa herë që pjesëmarrësve u kërkohet të eksplorojnë, reflektojnë ose kundërshtojnë aktivitetet (zgjidhja e problemeve dhe të nxënimit). Modeli është zhvilluar nga Yrjö Engeström, një mësues finlandez bazuar në punën e Vygotsky dhe Leontiev. Nisur nga qëllimi i këtyre moduleve, koncepti i "rregullave", "komunitet", dhe "ndarja e punës" që përdoren për të përshkruar kontekstin e një aktiviteti janë bërë bashkë me kuptimin e ri "kontekst":



Përkufizimet e elementeve

Në diagramën e mësipërme, fjala "*Subjekt*" i referohet personit ose personave që është/janë duke zbatuar një veprimtari. Veprimtaria kuptohet dhe analizohet nga pikëpamja e tij/saj (p.sh, mësuesi). Fjala "*Objekt*" i referohet pikës fokale të veprimtarisë dhe përcakton se në çfarë drejtimi është vendosur kjo veprimtari. Ky mund të jetë një person tjetër, problem, temë, ose ndonjë objekt. Objekti ndërtohet nga subjekti dhe fokusohet në aspekte që janë të përshtatshme për të zbatuar veprimtarinë (p.sh, matematikë, sjellje e nxënësit). "*Rezultat*" i referohet të gjithë rezultateve të pritshme apo jo të pritshme ose ndikimeve që vijnë si rrjedhojë e zbatimit të veprimtarisë (p.sh, arritjet, zhgënjimet). "*Mjete dhe objekte*" janë mjete fizike dhe njohëse që përdoren për të zbatuar veprimtarinë (p.sh, libri, strategjitë e të mësuarit, gjuha). "*Konteksti*" i referohet karakteristikave të mjedisit social në të cilën zhvillohet veprimtaria. Kjo mund t'i referohet vlerave sociale, besimeve, normave ose rregullave por gjithashtu edhe klimës në klasë dhe mbështetjes së ofruar nga shokët.

Aplikimi në situata të ndryshme sociale


Modeli duket i paplotë kur e mendon në terma abstrakt, por bëhet konkret dhe i strukturuar kur aplikohet në veprimtari konkrete. Komponentët mund të kenë kuptime të ndryshme kur aplikohen në mjedise të ndryshme, por struktura është e fortë mjaftueshëm për ta bërë të dallueshëm.

Modeli ofron një mënyrë të menduarit të veprimtarive për të patur një objektiv specifik ose për përdorimin e mjeteve të caktuara në kontekste të veçanta. Për shembull, një djalë mund të dështojë në zgjidhjen e një problemi matematikor sepse ai akoma nuk e ka zotëruar algoritmin (mjetin mendor), sepse ai ka frikë nga dështimi (rezultati) dhe prandaj nuk përfshihet në veprimtari (objekti), ose sepse ai tallet nga shokët e vetë (konteksti). Dështimi i një mësuesi për të zbatuar praktika gjithëpërfshirëse mund të vij për shkak të besimeve të tij/saj (subjekti), mungesa e metodave efektive dhe të materialeve të mjaftueshme (mjetet dhe objekte), mungesa e të kuptuarit të arsimit gjithëpërfshirës (objekti), një mungesë e motivacionit ose synimit për të mbështetur të gjithë nxënësit (qëllimi), ose mungesë e mbështetjes nga drejtori, inspektori, ose përgjegjësi (konteksti).

Komunitetet e praktikës

Realizimi i arsimit gjithëpërfshirës kërkon veprimtaritë koordinuara nga shumë njerëz përgjatë kohës dhe situatave. Shkollat gjithëpërfshirëse dhe sistemet arsimore gjithëpërfshirëse nuk krijohen njëherë e përgjithmonë; ato duhet të zhvillohen dhe mirëmbahen si një proces në vazhdimësi.

Për të kuptuar shkollën si komunitete të nxënësve ose si komunitete praktike me një vizion të arsimit gjithëpërfshirës që realizohet nëpërmjet sigurimit të pjesëmarrjes së të gjithëve, mund të përdoren përshtatjet apo interpretimet e modelit në vijim:



Përdorimi i moduleve

Çfarë duhet të marrin parasysh trajnuesit

Mësimi i të rriturve

Modulet mbi arsimin gjithëpërfshirës janë për t'u mësuar nga të rriturit për të rriturit dhe në shumicën e rasteve nga mësuesit ose profesionistët e tjerë të cilët punojnë në mjedise edukative. Modulet e trajnimit mund të përshtaten sipas mjediseve dhe audiencave të ndryshme. Trajnuesit dhe pjesëmarrësit duhet të sjellin eksperiencat e tyre specifike të mësimdhënies dhe nxënies për trajnimin. Kur përdoren në mënyrë pozitive këto eksperiencat mund të pasurojnë eksperiencën e të mësuarit për çdo person të përfshirë.

Mësuesit janë punonjës të njohurive

Mësuesit janë "punonjës të njohurive". Atyre iu ë njohuritë dhe u pëlqen të mësojnë gjëra të reja që sjellin përfitime në punë. Pjesëmarrësit në veprimtari kanë shumë gjasa të udhëhiqen nga rezultatet dhe duan të mësojnë diçka të dobishme.

Është e rëndësishme të diskutohet dhe qartësohet qëllimi dhe përshtatshmëria e moduleve dhe veprimtarive ku pjesëmarrësit janë të përfshirë. Prandaj, të gjitha modulet, temat dhe veprimtaritë individuale theksojnë qëllimin për të ndihmuar trajnerin dhe pjesëmarrësit të jenë të vetë-drejtuar në veprimet e tyre dhe të mundësojnë diskutimet mbi këto çështje.

Mësuesit janë autonomë

Ndërkohë që punonjësit e njohurisë pëlqejnë të marrin njohuri të reja, gjithashtu synojnë të jenë mbrojtës ndaj njohurive të tyre, që janë edhe kapitali i tyre profesional. Meqenëse mësuesit identifikohen më shumë me atë që dinë, ata mund të jenë të ndjeshëm ndaj "kritikave" ose ndaj asaj që ata e perceptojnë si "sulm" ndaj autonomisë së tyre në klasë.

Shumë mësues janë mësuar të punojnë të izoluar; ata nuk e vlerësojnë praktikën dhe bashkëpunimin e tyre që kërkohet në kontekstin e arsimit gjithëpërfshirës. Prandaj është e rëndësishme që të sjellin njohuritë e tyre në trajnim. Kjo mund të bëhet nëpërmjet detyrave praktike që reflektojnë interesat personal dhe t'i shërbejnë një synimi të menjëhershëm për të rritur praktikën e tyre. Detyra të tilla mund të planifikohen paralel me modulet.

Konteksti kuptimplotë për modulin

Pjesëmarrësit duhet të jenë të motivuar të pranojnë modulet si pjesë e një përpjekje më të madhe. Kjo mund të jetë, p.sh, një projekt reformash më i madh për ta bërë shkollën apo komunitetin e tyre më gjithëpërfshirës.

Një kontekst i tillë ofron udhëzime për veprimtaritë e tyre dhe krijon skenën për aktivitetet. Trajnuesi duhet të jetë i vetëdijshëm për kontekstin më të madh brenda të cilit futen modulet dhe të punojnë si ofrues për t'i lejuar pjesëmarrësit

Arsimi gjithëpërfshirës për orientimin e trajnimit

të mësojnë, eksplorojnë problemet, dhe të punojnë drejt objektivave të tyre. Kjo arrihet më mirë duke aplikuar një qasje pjesëmarrëse që respekton njohurinë, llojet e të mësuarit, dhe preferencat mësimorë të pjesëmarrësve, dhe adreson problemet që pjesëmarrësit kuptojnë dhe janë të motivuar për të punuar.

Në përmbledhje, mund të thuhet se filozofia dhe parimet e artikuluar në këto module duhet të udhëheqin praktikën e vetë trajnerit. Kjo ndihmon pjesëmarrësit të mësojnë për këto nëse atyre u jepet një mundësi për t'i eksperimentuar ato. Trajnerët duhet të jenë mësues kompetent gjithëpërfshirës, dhe si rrjedhojë të mundësojnë akses, pjesëmarrje dhe rezultate për të gjithë pjesëmarrësit. Ju lutemi referojuni parimeve organizuese të përshkruara në këto botim.

Krijimi i mjediseve mundësuese

Trajnuesit duhet të japin mendime sesi të krijohet një mjedis mundësues. Ata duhet të marrin parasysh kontekstin në të cilin zhvillohet trajnimi dhe të sigurohen që ky kontekst mundëson motiv për të gjithë pjesëmarrësit.

Ka një sërë faktorësh që kontribuojnë në krijimin e një mjedisi mundësues:

- Qëllimi i modulit reflekton nevojën e pjesëmarrësve;
- Arritjet e pritshme dhe veprimet e synuara drejt krijimit të më shumë shkollave gjithëpërfshirëse janë mbështetur dhe vlerësuar nga shkollat, autoritetet lokale dhe politikë bërësit.;
- Komuniteti më i gjerë i prekur nga ndryshimet drejt arsimit gjithëpërfshirës është mjaftueshëm i përfshirë (p.sh, përfaqësuesit e prindërve ose inspektorët marrin pjesë në trajnime dhe informojnë kolegët e tyre);
- Mjedisi i krijuar për trajnimin, mundëson të mësuarit me pjesëmarrje (p.sh, rregullimi i klasës, materialet e përdorura, atmosfera e krijuar, marrëdhënia trajner-pjesëmarrës).

Për më shumë informacion mbi mësimin e të rriturve dhe një vështrim të përgjithshëm mbi metodat e mësimin, shiko disa nga informacionet që ofrohen në site si Wikipedia.

http://en.wikipedia.org/wiki/Category:Learning_methods.

Këtu ju do të drejtoheni në informacion të detajuar mbi disa nga metodat e referuara në module, si:

- Hartëzimi i mendjes: http://en.wikipedia.org/wiki/Mind_map
- Hartëzimi i koncepteve: http://en.wikipedia.org/wiki/Concept_map
- Edukimi i të rriturve: http://en.wikipedia.org/wiki/Adult_education
- Mësimi në bashkëpunim: http://en.wikipedia.org/wiki/Collaborative_learning
- World Café: [http://en.wikipedia.org/wiki/World_Café_\(conversational_process\)](http://en.wikipedia.org/wiki/World_Café_(conversational_process))
- Metoda me copëza: [http://en.wikipedia.org/wiki/Jigsaw_\(teaching_technique\)](http://en.wikipedia.org/wiki/Jigsaw_(teaching_technique))
- Loja e vendimit: http://en.wikipedia.org/wiki/Decision_Game

Metodologjia e moduleve

Promovimi i të nxënësve dhe pjesëmarrjes

Modulët reflektojnë parimet dhe filozofinë e arsimit gjithëpërfshirës dhe duhet të përdoren në këtë frymë. Arsimit gjithëpërfshirës kuptohet si proces për të promovuar të nxënësve dhe pjesëmarrjen për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, për të mundësuar akses, pjesëmarrje, dhe arritjen e rezultateve pozitive. Për ta bërë të mundur këtë, pyetjet në vijim duhen bërë në secilin fazë planifikimi:

Pyetje planifikuese kyçe për përdorimin e moduleve, temave dhe veprimtarive:

Çfarë? Çfarë duhet mësuar? (Objektiva)

Pse? Pse duhet mësuar? (Qëllimi, Vlerat)


Kush? Kush duhet përfshirë? (Angazhimi)

Si? Si duhet mësuar? (Mjetet, Strategjitë)

Ku? Ku duhet mësuar? (Krijimi i Mjedisve)

Kur? Kur duhet mësuar? (Planifikimi i veprimeve të koordinuara në situata)

Duke përdorur Modelin e Teorisë së Aktivitetit, këto pyetje mund të bëhen dhe diskutohen me pjesëmarrësit e tjerë për të siguruar motivimin, dhe kjo ndihmon në veprimtari të drejtpërdrejta dhe arritjen e rezultateve domethënëse:



Trajnuesi duhet të qartësojë pikat e mëposhtme:

Modulet janë të organizuara për të ndihmuar qartësimin e këtyre pikave sa herë që është e mundur. Për shkak të kontekstit specifik në të cilën modulet do të përdoren nuk mund të para-caktohen. Trajnerit do t'i duhet të sqarojë këto pyetje në lidhje me situatën specifike në të cilat modulet përdoren:

- Mbi çfarë duhet të punojnë, fokusohen apo mësojnë pjesëmarrësit? (Veprimtari të nxëni);
- Pse duhet që ata të përfshihen në këtë veprimtari? (Qëllimi i përfshirjes në veprimtari);
- Kush duhet të përfshihet dhe si duhet të mundësohet përfshirja? (Parakushtet për të mësuar);
- Si duhet të nxënë pjesëmarrësit? (Mjetet, strategjitë, metodat për të mundësuar të mësuarit);
- Ku duhet të nxënë pjesëmarrësit? (mundësimi i mjedisve dhe komuniteti);
- Kur duhet të nxënë pjesëmarrësit? (Pjesët e mësimit, krijimi i sinergjive për të promovuar mësimin).

Nxirra në pah e veprimtarisë duke përdorur modelin e aktivitetit

Nëse këto pika do të adresohen gjatë diskutimeve mbi rishikimin e moduleve dhe veprimtarive, do të ndihmojnë pjesëmarrësit të optimizojnë eksperiencat e tyre të të nxënit si edhe për konsiderimin e mënyrave në të cilat çfarë është nxënë mund të përdoret në praktikën e tyre. Të nxënit nuk ka të bëjë vetëm me shtimin e informacionit për t'u mbajtur mend; mësimi ka të bëjë me krijimin e një kuptueshmërie më të mirë të botës dhe vetes, në mënyrë që të bëhet një mësues efektiv dhe kompetent. Mësimi është bërë i dukshëm në ndryshime të sjelljes, vlerave, besimeve, dhe kuptueshmërisë.

Aplikoni organizimin e parimeve

Parimet organizuese dhe modelet e përshkruara në hyrje mund të aplikohen të dyja për trajnimin në vetvete dhe praktikën e mësuesve që marrin pjesë në trajnim. Ato bëhen përfaqësues të përbashkët që mund të përdoren në mjedise të ndryshme sociale.

Ato mund të marrin kuptime të ndryshme në vende të ndryshme, por struktura është e përbashkët, mjaftueshëm për t'i bërë ato të kuptueshme. Ndarja e të tilla modeleve të përbashkëta dhe parimet janë kyç për bashkëpunimin midis mjediseve sociale. Për shembull, *Modeli i Teorisë së Aktivitetit* mund të përdoret në mjedise për të analizuar dhe përshkruar veprimtaritë. Mësuesit mund të përdorin modelin për të menduar për veprimtaritë e tyre në klasa ose mund ta përdorin atë për të folur me nxënësit rreth të njëjtës veprimtari por nga pikëpamja e këtyre të fundit. Drejtuesit mund ta përdorin për të menduar në veprimtaritë në shkollat e tyre. Trajnuesit dhe pjesëmarrësit mund ta përdorin për të sqaruar pritshmëritë e tyre dhe të vlerësojnë veprimtaritë trajnuese.

Qasja e pjesëmarrjes

Kyçi për të lejuar qasjen me pjesëmarrje është fokusimi mbi përfshirjen e pjesëmarrësve. Për të mundësuar një orientim të tillë modulet janë bazuar më tepër në veprimtaritë rreth arsimit gjithëpërfshirës sesa rreth përbajtjes. Parimet dhe qëllimi i veprimtarive është bërë aq i qartë sa është e mundur për të lehtësuar përshtatshmërinë pa humbur idetë bazë dhe qëllimin e aktiviteteve. Metodologjia e moderimit është bërë e thjeshtë aq sa është e mundur për të siguruar aplikimin e thjeshtë të moduleve. Metodatat e përshkruara në veprimtari mund të shtrihen dhe ndryshohen sipas preferencave të trajnuesit dhe pjesëmarrësve.

Nevoja për më shumë mundësi të nxëni

Modulet ofrojnë një eksperiencë themelore të të mësuarit për pjesëmarrësit. Përdorimi i materialeve të tjera, shumë prej të cilave janë zhvilluar nga UNICEF-i dhe partnerët e tyre, mund ta shtrijnë më tej këtë eksperiencë të të mësuarit. Atje ku është e mundur janë përdorur referenca për leximet kyçe që mund të gjenden në këtë publikim.

Leximet/referencat kryesore mund të gjenden në:

- Portali Rajonal mbi Arsimin gjithëpërfshirës i CEE/CIS: <http://www.inclusive-education.org/>
- UNICEF's E-Learning Platform Agora: <https://agora.unicef.org/>

Struktura e aktiviteteve

Të gjitha veprimtaritë janë paraqitur duke përdorur të njëjtën strukturë për të mundësuar orientimin për trajnerin. E para, ofrohet një vështrim i përgjithshëm duke përdorur Modelin e Teorisë së Aktivitetit:

- Qëllimi (Pse?): Jep objektivat e aktivitetit, dhe cakton rezultatet e pritshme;
- Fokusi i Aktivitetit (Çfarë?): Sqaron se për çfarë është aktiviteti, cilat janë çështjet që kërkon të adresojë, ose çfarë është e rëndësishme për përbajtjen e aktivitetit. Kërkon të përshkruajë problemin e hapësirës ku duhet të punojë;
- Materialet dhe Metodatat (Sa): Ofron informacion mbi mjetet ose strategjinë e punës;
- Informacion shtesë/alternativa: Ofron informacion shtesë mbi veprimtaritë ose alternativat e aktiviteteve.

Struktura pason Modelin e Teorisë së Aktivitetit

Pyetjet rreth pjesëmarrësve (Kush) dhe rreth kontekstit të të mësuarit (Ku?) duhet të adresohen për të gjithë modulën dhe jo për veprimtari individuale. Pjesëmarrësit duhet të qëndrojnë dhe marrin pjesë në të gjitha veprimtaritë dhe me shumë gjasa, konteksti nuk mund të ndryshohet nga një veprimtari në tjetrin.

Kush dhe ku sqarohesh për modulën

Informacion bazë për trajnuesin

Sidoqoftë, pyetjet rreth “Kush” dhe “Ku” mund të jenë akoma të rëndësishme për të siguruar motivimin në nivele më të larta për përfshirjen e të gjithë pjesëmarrësve. Si pjesë e rubrikës, “metodat” informacioni mbi mënyrat e ndërveprimit apo të mësuarit në bashkëpunim, mjediset e propozuara sociale duhet të përshtaten me preferencat e pjesëmarrësve.

Çdo veprimtari ofron gjithashtu informacion mbi historikun e trajnuesit. Ky seksion duhet të ndihmoj trajnerin të lidhë veprimtari specifike me modulën e përgjithshëm dhe të ndihmojë orientimin. Informacioni jepet mbi arsyet pse një veprimtari u përzgjedh dhe kur shihet e nevojshme ofron informacion mbi historikun teorik ose parimet që parashtrohen. Rrjedhimisht, sekuenca e aktivitetit përshkruhet në detaje.

Për të mundësuar orientimin mbi këto mënyra të të mësuarit, janë përdorur piktogramet në vijim:



Plenare – ose prezantuese ose raportim;



Grupe të mëdha pune;



Punë individuale me theks mbi reflektimin;



Punë në partneritet;



Punë individuale me shkrim.

Prezantime PowerPoint

Paralel me përshkrimin e sekuencave të aktivitetit, slajdi respektiv nga prezantimi shoqëruet në PowerPoint. Prezantimi jepet për orientim. Trajnuesi duhet të kalojë nëpër slajde me kujdes për t'u siguruar se përmbajta është kuptuar.

Disa slajde tregojnë zgjidhjen ose rezultatin e punës individuale dhe në grup: këto slajde duhet të përfshihen vetëm në versionin e prezantimit, por nuk do të jepet një version në dorë për pjesëmarrësit.

Përshtatja e Moduleve sipas Kontekstit të Vendit

Ky seksion do të plotësohet mbas konsultimeve me përfaqësuesit e delegacioneve të vendeve gjatë seminarit dhe do të përfshijë informacion mbi çështjet në vijim:

- Informacion mbi formatin e kursit – çfarë është e mundur, çfarë është efektive?
- Shembuj të aplikimit (p.sh, me skedën, programin, veprimtaritë shtesë, etj);
- Modele të zbatimit (p.sh, modeli me zbritje);
- Mjetet për të ndihmuar një plan kombëtar që përfshin veprimtaritë përtej moduleve;
- Përshtatja e ndryshimeve kulturore;
- Përshtatja për audiencë të ndryshme.

Vështrim i përgjithshëm mbi të tre modulet

Moduli 1: Arsimi gjithëpërfshirës – Vizioni, Teoria, Konceptet

Tema 1.1: Hyrje në Arsimin gjithëpërfshirës

Qëllimi i temës:

- Zhvillimi i një komuniteti që mëson, gjithëpërfshirës brenda hapësirës trajnuese;
- Zhvillimi i analizave të situatave të përbashkëta: nga vini ju;
- Qartësimi i pritshmërive (ku doni të shkoni) dhe ofroni motivacion;
- Qartësimi i të kuptuarit dhe zhvillimi i një përcaktimi paraprak për "arsimin gjithëpërfshirës";
- Kuptimi i rolit të mësuesit si agjent ndryshimi.

Tema 1.2: Zhvillimi Personal Profesional

Qëllimi i temës:

- Kuptimi i rëndësisë së zhvillimit profesional për Arsimin gjithëpërfshirës;
- Njohja e përcaktimit të kompetencave për gjithëpërfshirje të mësuesit;
- Vetëdija e paragjytimeve që influencojnë veprimet tona;
- Njohja e disa ndryshimeve ndërmjet "Mësuesve fillestarë, atyre me përvojë dhe atyre ekspertë";
- Zhvillimi i vizionit për një mësues gjithëpërfshirës.

Tema 1.3: Vlerësimi i Diversitetit të Nxënësve

Qëllimi i temës:

- Kuptimi i gjytimeve brenda dhe jashtë grupit (favorizimi brenda në grup) dhe si lidhet me emërtimin;
- Njohja e dimensioneve më të rëndësishëm të diversitetit;
- Kuptimi i ciklit të shtypjes dhe hartimi ciklit tuaj të fuqizimit;
- Konsiderimi i rëndësisë së të Drejtave të Njeriut për vlerësimin e diversitetit të nxënësve;
- Mendoni për mënyrat kjo njohuri mund të jetë e përshtatshme për shkollat tuaja.

Tema 1.4: Mbështetje për të Gjithë Nxënësit

Qëllimi i temës:

- Konsideroni mënyrat tuaja të të menduarit rreth mësimit dhe arritjeve;
- Mësoni një model që mund të ndihmojë në të kuptuarit e situatave të mësim nxënies;
- Konsideroni të mësuarit si rezultat i pjesëmarrjes (jo vetëm si arritje);

- Kuptoni dhe organizoni mjedise të ndryshme/organizimin e ofrimit;
- Mendoni për mënyrat sesi kjo njohuri mund të jetë e përshtatshme për shkollën tuaj.

Tema 1.5. Puna me të tjerët

Qëllimi i temës:

- Konsideroni gjithëpërfshirjen e komunitetit dhe shkollës tuaj dhe përdoreni këtë informacion për të marrë në konsideratë veprime;
- Ndërto një vizion të arsimit gjithëpërfshirës – kështu që mund të planifikoni veprimet me kolegët, nxënësit, prindërit, dhe komunitetin tuaj;
- Rishikoni përmbajtjet e modulit;
- Identifikoni nevojat për më shumë informacion dhe sqarime.

Moduli 2: Punojmë së Bashku për të Krijuar Shkolla Gjithëpërfshirëse

Tema 2.1: Komunikimi për të ndërtuar marrëdhënie

Qëllimi i temës:

- Reflektimi mbi rëndësinë e komunikimit për marrëdhëniet njerëzore;
- Zhvillimi i një harte të marrëdhënieve tuaja ekzistuese profesionale;
- Kuptimi i komunikimit si një veprimtari e përbashkët;
- Fokusimi mbi bashkëpunimin për pjesëmarrjen.

Tema 2.2: Kuptimi i kufizimeve të pjesëmarrjes

Qëllimi i temës:

- Zhvillimi i një të kuptuari më të thellë mbi kufizimet në pjesëmarrje;
- Përdorimi i pikëpamjeve të ndryshme për të analizuar kufizimet në pjesëmarrje;
- Zhvillimi i strategjive që mund të përdoren për të ekzaminuar kufizimet në pjesëmarrje.

Tema 2.3: Bashkëpunimi për të tejkaluar kufizimet në pjesëmarrje

Qëllimi i temës:

- Njohja e ICF si një kornizë e përbashkët për bashkëpunim (konteksti i shëndetit dhe mirëqenies);
- Zhvillimi i strategjive për bashkëpunim përgjatë ciklit të zgjidhjes së problemeve;
- Njohja dhe zhvillimi i mjeteve që ju ndihmojnë për të zbatuar këto strategji.

Tema 2.4: Ndërtimi i skuadrave dhe koalicioneve për gjithëpërfshirje

Qëllimi i temës:

- Kuptimi i qëllimit dhe veprimtarive për një skuadër gjithëpërfshirëse;
- Rishikimi i gjërave të mësuara deri në këtë pikë dhe sesi ju ndihmon për të ndërtuar një skuadër gjithëpërfshirëse;
- Zhvillimi i strategjive për të ndërtuar koalicione në komunitetin tuaj;
- Mendoni për gjërat që ju do të donit të mësoni.

Moduli 3: Ofrimi i mjediseve për mësim të personalizuar

Tema 3.1: Analizimi i situatave mësimore të fëmijëve dhe të rinjve

Qëllimi i temës:

- Aplikoni atë se çfarë keni mësuar deri tani për të analizuar situatat mësimore;
- Mësoni të analizoni një situatë nga pikëpamja e mësuesit dhe pikëpamja e nxënësve;
- Praktikimi për t'u fokusuar mbi situatën sesa karakteristikat e nxënësit.

Tema 3.2: Zhvillimi i objektivave efektive

Qëllimi i temës:

- Aplikimi i qasjes së ciklit të jetës ndaj caktimit të objektivave;
- Ndërtimi i kapaciteteve për të zhvilluar objektiva afat gjatë, mesëm, shkurtër.
- Përdorimi i deklaratave të objektivave, qëllimeve, për të ofruar informacion kuptimplotë.

Tema 3.3: Përshtatja e situatave ndaj kërkesave të nxënësit

Qëllimi i temës:

- Të mësuarit e lidhjes së objektivave me situatat e mësimit;
- Njohja e mënyrave në të cilat pjesëmarrja mund të përmirësohet në klasë;
- Aplikimi i asaj që është mësuar për të zhvilluar plane mësimore të personalizuara.

Tema 3.4: Zhvillimi i praktikës për të mbështetur të gjithë nxënësit

Qëllimi i temës:

- Zhvillimi i një strategjie bashkëpunimi për t'u zbatuar në shkollën tuaj;
- Zhvillimi i mjeteve dhe metodave që ju mund të zbatoni në shkollën tuaj;
- Zhvillimi i strategjive për të ecur drejt arritjes së arsimit gjithëpërfshirës.

Modulet ToT për arsimin gjithëpërfshirës

Moduli 1:

Arsimi Gjithëpërfshirës – Vizioni, Teoria dhe Konceptet

Hyrje

Deklaratë mbi qëllimin

Moduli 1-rë synon të ofrojë një këndvështrim më të gjerë mbi konceptet kryesore të arsimit gjithëpërfshirës. Kjo kërkon një qasje të bazuar në aktivitete të orientuara edhe nga premiset e pjesëmarrësve. Përfshirja aktive e pjesëmarrësve bën që ata "të mësojnë". E rëndësishme nuk është vetëm të mësoarit e parimeve të arsimit gjithëpërfshirës por gjithashtu dhe ndjeka dhe zbatimi i këtyre parimeve.

Pjesëmarrësit jo vetëm që duhet të marrin njohuri por gjithashtu duhet të prezantohen me koncepte dhe modele që mund t'i përdorin në punën e tyre të përditshme.

Moduli synon të ofrojë mundësi për reflektim mbi praktikën e punës së gjithë secilit, njohuri, besime, dhe qëndrime. Këto janë bazat e kompetencave të mësuesit. Kompetencat përkatëse të arsimit gjithëpërfshirës do të paraqiten dhe përdoren si struktura themelore e modulit.

Vështrim

Modul i 1-rë ofron një pamje të përgjithshme të procesit të arsimit gjithëpërfshirës me fokus te mësuesit dhe profesionistët e tjerë që punojnë në mjedise arsimore formale (p.sh, shkolla, kopshte). Moduli shqyrton impaktin e punonjësve dhe sistemeve në procesin e gjithëpërfshirjes, si dhe ndikimin e përjashtimit, duke pasur në fokus qasjen mbi të drejtat.

Arsimi gjithëpërfshirës kuptohet si një proces që siguron pjesëmarrjen dhe mësimin e të gjithë nxënësve. Koncepti paraqitet duke përdorur qasjen bazuar mbi të drejtat. Realizimi i të drejtave ka të bëjë me respektimin e të drejtave personale dhe zbatimin në vazhdimësi të qasjes së bazuar mbi të drejtat në institucione dhe organizata. Mësuesit duhet të jenë në gjendje të sigurojnë të drejtat përmes të dyja qasjeve: duke respektuar të drejtat e çdo fëmije dhe duke e bërë klasën dhe shkollën e tyre më gjithëpërfshirëse. Këto parime paraqiten në modulën që ju jeni duke u prezantuar dhe trajtohen më tej në modulet 2 dhe 3. Për të mësuar më shumë rreth kornizës konceptuale të UNICEF-it për arsimin gjithëpërfshirës shikoni publikimin *The Right of Children with Disabilities to Education: A Rights-Based Approach to Inclusive Education*.

Të punuar me të dy perspektivat, atë të individit dhe atë të sistemitëshhtë e rëndësishme të kuptohet perspektiva e sistemeve në përgjithësi, në shoqëri dhe në mënyrë të veçantë në institucione. Pjesëmarrësit duhet të zhvillojnë aftësi bazike për ti parë, menduar dhe konsideruar sistemet nga një perspektivë e tillë, që i lejon ata të shndërrohen në agjentë të arsimit gjithëpërfshirës në mjediset e tyre të punës. Përgjatë modulit shpesh janë prezantuar modele, që ndihmojnë për të kuptuar përfshirjen sociale të fëmijës (familje, komunitet, shoqëri) dhe institucionet gjithëpërfshirëse (klasë, shkollë, sistem arsimor).

Nëse mësuesit do të bëhen agjentë ndryshimi për arsimin gjithëpërfshirës ata duhet të kenë dëshirë të zhvillojnë jo vetëm njohuritë e tyre por edhe aftësitë dhe qëndrimet. Moduli i 1-rë nënvizon rëndësinë e mësuesve, njohuritë, aftësitë, dhe qëndrimet e tyre në realizimin e këtij procesi. Duke përdorur profilin e një mësuesi gjithëpërfshirës të zhvilluar nga Agjencia Evropiane për Nevojat e Veçanta dhe Arsimin Gjithëpërfshirës kërkohet të ilustron dhe nënvizohen kompetencat e përfshira në këtë dokument. Në modul janë paraqitur katërfusha (zhvillimi profesional personal, vlerësimi i diversitetit të nxënësve, mbështetje për të gjithë nxënësit, dhe puna me të tjerët).

Moduli i 1-rë gjithashtu paraqet disa nga parimet organizuese dhe disa modele që do t'ju shërbejnë pjesëmarrësve si mjete në praktikë:

- Perspektiva
- Qasja e sistemit nga Uri Bronfenbrenner me fokus në sistemet mikro, mezo, dhe makro.
- Matrica që përfaqëson nivelet (klasë, shkollë, politika) dhe procesin e edukimit (kontribut, proces, rezultat).
- Profili i Mësuesit Gjithëpërfshirës
- Cikli i veprimeve dhe cikli i zgjidhjes së problemeve
- Modeli i aktiviteteve
- Koncepti i Pjesëmarrjes

Pjesëmarrësit

Trajnimi do të jetë i suksesshëm vetëm nëse arrin të prekënjohurinë, eksperiencat, dhe besimet që pjesëmarrësit sjellin në trajnim. Moduli duhet t'i lejojë pjesëmarrësit të bëhen agentë ndryshimi për gjithëpërfshirjen në punën e tyre. Kjo kërkon krijimin e mundësive për të reflektuar mbi situatën e tyre dhe lidhjen e moduleve me aktivitetin dhe veprimet e tyre.

Trajnuesi duhet të dijë sa më shumë që të jetë e mundur rreth situatës së pjesëmarrësve përpara se të fillojë modulin. Kjo do të bëjë ndryshimin e asaj ku ata ndodhen përta i përket zhvillimit të tyre profesional: a janë ata mësues nxënës, a janë mësues të rinj apo me eksperiencë? Diversiteti i pjesëmarrësve mund të përdoret në mënyrë të përshtatshme, duke lejuar mësimin ndërmjet pjesëmarrësve. Kjo krijon një mundësi për të zbatuar parimet e arsimit gjithëpërfshirës.

Mund të mendohet edhe për mënyrat sipas të cilave pjesëmarrësit mund të mbështeten në mësimin individual. Ka mjete të ndryshme që mund të përdoren për ta bërë mësimin të dukshëm p.sh, zhvillimi i një portofoli ose mbajtja e ditarëve.

Mjedisi Mundësues

Situata e krijuar gjatë trajnimit duhet të mundësojë shkëmbimin, diskutimet, dhe dokumentimin e mendimeve, pritshmëritë, dhe idetë. Ajo duhet të promovojë idetë dhe parimet e arsimit gjithëpërfshirës duke vlerësuar eksperiencat e ndryshme që pjesëmarrësit sjellin në trajnim duke lejuar mësimin individual dhe duke krijuar një atmosferë bashkëpunuese.

Modulet janë të bazuar në aktivitete dhe kërkojnë të mbështesin trajnuesin në krijimin e mundësive të pjesëmarrësve për të mësuar. Pjesëmarrësit kanë nevojë të jenë kontribues në këtë proces, në mënyrë që njohuritë që kanë dhe ato që marrin të mbështeten në një trup të përbashkët. Kështu ata kanë mundësi të marrin pjesë dhe të bashkëpunojnë. Trajnuesi duhet të krijojë një mjedis qënxit të mësuarit aktiv dhe jo thjeshtë të përcjellë informacion që mund të gjendet lehtësisht diku tjetër.

Një pjesë e rëndësishme e të qenit një mundësues i të mësuarit është që trajnuesi të sigurohet se të mësuarit është diçka e dukshme. Moduli ofron sugjerime sesi kjo mund të realizohet për aktivitetet individuale por trajnuesi duhet të japë gjithashtu disa mendime për të dokumentuar atë që mësohet nga pjesëmarrësit. Ai duhet të mbaj shënime të rezultateve të rëndësishme që dalin nga diskutimet ose puna individuale, dhe të mundësoj mjedis pune për pjesëmarrësit.

Trajnimi do të jetë më efektiv nëse krijohen lidhje midis mjedisit ku zhvillohet trajnimi, kontekstit të situatave të tij dhe mjediseve të punës së përditshme, situatave reale me të cilat përballen pjesëmarrësit. Kjo mund të arrihet ose duke e përfshirë projektin në tërësi ose vetëm atë aktivitet që promovon arsimin gjithëpërfshirës në shkolla ose komunitet. Nëse modulet e trajnimit kombinohen me punë zhvillimore, atëherë praktika mund të rrisë të mësuarit e moduleve. Aktiviteti i ofruar në këtë modul mund të përfshihet edhe në punë praktike në shkolla.

Si ti përqasemi modulit

Nëse trajnuesi ka qenë i përfshirë më parë si nxënës, në përvetësimin e modulit, apo nëse është i familjarizuar me përmbajtjen dhe konceptet e tij, kjo do të ndihmonte në mbarëvajtjen e trajnimit. Trajnuesi është i lirë të aplikojë apo zhvillojë aktivitete të tjera alternative, të ndryshme nga ato që janë përfshirë në modul, nëse gjykon se ato i shërbejnë të njëjtit qëllim ose qëllimeve të ngjashme.

Konceptet e paraqitura në këto module nuk janë thjesht ide apo nocione për t'u mësuar por për t'u aplikuar në punën e përditshme. Kuptimi konceptual do të thellohet nëpërmjet aplikimit të këtyre koncepteve në problemet në praktikë. Konceptet duhen parë si mjete për të shndërruar mendimet në veprimet dhe jo si një pjesë njohurie që vetëm përvetësohet, por nuk aplikohet. Prandaj, paraqitja teorike e koncepteve duhet të zërë një pjesë të vogël, në mënyrë që të sigurohen mundësi të mjaftueshme për mendim aktiv dhe zgjidhje problemesh.

Për të ndihmuar pjesëmarrësit të orientohen me modulin, është e rëndësishme të ofrohet një vështrim i përgjithshëm i moduleve dhe temave, si dhe mundësi për rishikimin e tyre. Edhe pse ky aktivitet nuk është i planifikuar, ai duhet të jetë fokusi i parë i trajnimit. Kjo do të lejoj pjesëmarrësit të orientohen vetë gjë që është e domosdoshme për çdo nxënës aktiv. Qëllimet e listuara për çdo temë do të ndahet me pjesëmarrësit. Ato mund të përdoren për të krijuar një ide të përgjithshme dhe për të rishikuar temat dhe modulet.

Produktet e zhvilluara nga pjesëmarrësit duhet të jenë kuptimplota meqenëse ato mund të përdoren përgjatë trajnimit. Meqenëse dobishmëria e këtyre produkteve do të varet nga cilësia, është trajnuesi ai që duhet të vendosi sesi t'i përdore ato.

Tema 1.1: Hyrje në Arsimin Gjithëpërfshirës

Vështrim i përgjithshëm i Temës 1.1

Qëllimi i temës

- Zhvillimi i një komuniteti të të mësuarit gjithëpërfshirës brenda hapësirës trajnuese
- Zhvillimi i një analize situatë të përbashkët: nga vini ju
- Qartësimi i pritshmërive (ku doni të arrini) dhe prezantimi i motivimit
- Qartësimi i të kuptuarit dhe zhvillimi i një përcaktimi paraprak për Arsimin gjithëpërfshirës
- Kuptimi i rolit të mësuesit si agjent ndryshimi

Trajnuesit mund të mos paraqitin vetëm objektivat dhe synimet e temës, por edhe mund t'ju kërkojnë pjesëmarrësve të shkruajnë pyetjet që ata kanë në lidhje me përmbajtjen dhe objektivat e temës. Këto pyetje mund të përdoren nga pjesëmarrësit të cilët mund të pyesin kur këto çështje do të adresohen përgjatë trajnimit. Në fund të çdo teme, trajnuesi mund të pyesë nëse të gjitha pyetjet u adresuan.

Vështrim i përgjithshëm. Aktivitete

Aktiviteti 1.1.1: Lumi i Jetës – Të sjellim mendimet e pjesëmarrësve në trajnim

Aktiviteti 1.1.2: Perspektiva e sistemit dhe individit dhe zbatimi i të drejtave të njeriut

Aktiviteti 1.1.3: Ciklet e përfshirjes për të reflektuar situatën e fëmijës

Aktiviteti 1.1.5: Reflektim mbi influencën e mësuesit (të çon në Temën 2)

Aktiviteti 1.1.1: Lumi i Jetës – Të sjellim mendimet e pjesëmarrësve në trajnim.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Të njohim njëri-tjetrin dhe të bëhemi gati.
- Pjesëmarrësit të reflektojnë mbi eksperiencat dhe njohurinë që lidhet me trajnimin, në të kaluarën e tyre.
- Pjesëmarrësit të mendojnë çfarë duan të mësojnë dhe të imagjinojnë ndikimin që kjo mund të ketë në punën e tyre në praktikë.
- Trajnuesi të marrë informacione fillestare në lidhje me atë se çfarë kanë kuptuar pjesëmarrësit.

Fokusi i Aktivitetit:

Eksperiencat në të shkuarën të lidhura me arsimin gjithëpërfshirës për t'u ndarë me të tjerët. Pritshmëritë individuale dhe në grup të lidhura me rezultatet e trajnimit dhe eksperiencat vetjake. Kuptimi i arsimit gjithëpërfshirës.

Materialet dhe Metodot:

Flipchart, Stilolapsa, Letra ngjithëse, introspeksion, diskutime

Informacion / alternativa shitesë:

<http://www.kstoolkit.org/River+of+Life>
http://www.click4it.org/index.php/River_of_Life_Method
http://www.click4it.org/images/2/2c/100_ëays_to_energize.pdf

Informacion për trajnuesin






Është e rëndësishme që moduli të nisë me një aktivitet që i ndihmon pjesëmarrësit të fokusohen në përmbajtjen e modulit, qartësoni pozicionin e tyre, duke mbajtur në vëmendje rezultatet. Ajo çka është përfunduar përgjatë këtij procesi mund të përdoret më vonë për të rivlerësuar suksesin e modulit dhe për të reflektuar ndryshime në perceptimet dhe mendimet e pjesëmarrësve.




Nëse pjesëmarrësit shprehin qartë pritshmëritë në lidhje me rezultatet e pritshme dhe ato përfundimtare, procesi i punës gjatë trajnimit zhvillohet me intensitet të lartë. Kërkimi i një produkti (rezultati përfundimtar) (p.sh, pika të shkruara në flipchart) ndihmojnë pjesëmarrësit të fokusohen në diskutimet e tyre. Për më tepër, nëse grupit i kërkohet të zgjedhë një pjesëmarrës që i përcjell diskutimet e tyre, kjo do të rrisë angazhimin për të raportuar serish në seanca plenare dhe do të krijojë një produkt të dobishëm në përfundim të trajnimit.

Zhvillimi i një vizioni për gjithëpërfshirjen mund të bëhet në disa mënyra: si një ushtrim i shkurtër i pastrukturuar për të përmbledhur rezultatet ose konkluzionin e çdo pjesëmarrësi ose më tepër si përpunim i zhvillimit të një vizioni.

Rezultatet e këtij aktiviteti mund të përdoren përsëri në temën 3 dhe të lidhet me modulet 1 dhe 2.

Sekuena e Aktivitetit

<p><i>Hyrje në Ushtrime (plenare)</i></p> <p><i>Jepni një arsyetim dhe shpjegoni simbolikën e "Lumit të Jetës" duke u fokusuar në "Arsimin gjithëpërfshirës".</i></p> <p><i>"Lumi përfaqëson atë se çfarë pjesëmarrësi ka provuar dhe mësuar mbi "Gjithëpërfshirjen" në shkollën e tij – në të shkuarën, tashmen (moduli aktual), dhe në të ardhmen."</i></p>	<p style="text-align: center;">Lumi i jetës</p>  <p>Lumi përfaqëson atë që ju përjetoni dhe mësoni "Përfshirjen" në shkollën tuaj — në të shkuarën, në të tashmen (moduli ynë) dhe në të ardhmen.</p>
<p> Bërja e Ushtrimit (plenare, individuale dhe grup) Udhëzimet në slajd duhet të lexohen dhe shpjegohen.</p> <p> Punë individuale</p> <p> Punë në grup për të shkëmbyer mendime</p> <p> Çdo grup duhet të raportojë në sesion plenar</p>	<p style="text-align: center;">Lumi i jetës - Udhëzime</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Jeni ulur në një tavolinë me kolegë që nuk i njihni (që nuk janë nga shkolla juaj). 2. Skica e një lumi është vizatuar përgjatë letrës në tavolinën tuaj. Një e katërta përfaqëson të shkuarën (ajo çfarë ju sillni në trajnim), dy të katërtat përfaqësojnë të tashmen (aty ku jemi tani), dhe një e katërta përfaqëson të ardhmen (çfarë do të mësojmë gjatë trajnimit dhe çfarë shpresojmë të marrim me vete): 3. Të gjithë pjesëmarrësit vizatojnë piktura që përfaqësojnë përvojat e tyre të shkuara që lidhen me «Arsimin gjithëpërfshirës». 4. Të gjithë pjesëmarrësit ndajnë imazhet e tyre me grupin si një mënyrë për t'u prezantuar dhe për t'u njohur me njëri-tjetrin. 5. Të gjithë pjesëmarrësit shkruajnë 3 rezultate që ata do të dëshironin të arrinin ose pyetje të ndryshme që do të donin t'iu jepnin përgjigje gjatë këtij moduli trajnimi (çereku i dytë dhe i tretë). 6. Të gjithë pjesëmarrësit përmendin 3 gjëra për të cilat duan të mësojnë në këtë trajnim në mënyrë që të forcojnë kapacitetet e tyre për të promovuar gjithëpërfshirjen (çereku i katërt).

<p>Zhvillimi i një vizioni për arsimin gjithpërfshirës (plenare, individuale dhe grup)</p> <p> Udhëzimet në slajd duhen lexuar dhe shpjeguar.</p> <p> Pjesëmarrësit thonë rezultatet e tyre të pritshme</p> <p> Secili zhvillon një vizion të arsimit gjithpërfshirës.</p>	<p>A keni një vizion për arsimin gjithpërfshirës?</p> <p>Arsimi gjithpërfshirës është një proces që synon të kapërcejë barrierat e të nxëniet dhe pjesëmarrjes.</p> <p>Arsimi gjithpërfshirës i përgjigjet diversitetit duke krijuar situata ku të gjithë fëmijët dhe të rinjtë mund të mësojnë dhe provojnë kompetencë, autonomi dhe përkatësi.</p> <p>Arsimi gjithpërfshirës ndërtohet mbi përvojën dhe njohuritë e çdokujt të përfshirë në këtë proces, dhe në këtë mënyrë mundëson zgjerimin e përvojave dhe njohurive të gjithkujt.</p> <p>Cili është vizioni juaj për arsimin gjithpërfshirës?</p> <p>Të gjithë pjesëmarrësit përmendin 3 rezultate afatgjata që ata duan t'i arrijnë në shkollën e tyre (çereku i katërt i «Lumit të jetës»).</p> <p>Të gjithë pjesëmarrësit zhvillojnë përkufizimin e tyre paraprak për arsimin gjithpërfshirës.</p>
---	--

Aktiviteti 1.1.2: Perspektiva e sistemit dhe e individit dhe zbatimi i të drejtave të njeriut

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Të paraqes dy perspektiva bazë për zbatimin e qasjes bazuar mbi të drejtat.
- Pjesëmarrësit mësojnë të mendojnë rreth të drejtave gjithmonë me fokusin mbi sistemin dhe individin.
- Pjesëmarrësit eksplorojnë se çfarë do të thotë të përfshihesh në komunitete dhe në arsimin formal.
- Pjesëmarrësit prezantohen fillimisht me idenë se “përfshirja” nuk ka të bëjë vetëm me aksesin por edhe me pjesëmarrjen dhe arritjet.

Fokusi i Aktivitetit:

Studimi i rasteve për të treguar nevojën për të zhvilluar sisteme dhe individë. Arsimi si akses (kontribut), pjesëmarrje (proces), arritje (rezultat). Rrathët e përfshirjes në komunitet (shoqëri). Niveli sistemeve të përfshirjes në arsimin formal (institucione).

Materialet dhe Metodrat:

Letër dhe lapës për të punuar mbi rastin studimor (opsionale: “flipchart” ose slajde për t’u paraqitur në seancë plenare) Vizioni i arsimit gjithpërfshirës (Produkt i Aktivitetit 1.1.1)
Punë individuale, diskutime në grup.

Informacion / alternativa shtesë:






Informacion për trajnuesin:

Puna me rastin studimor duhet t’i ndihmojë pjesëmarrësit të fokusohen në të dyja sistemet: atë se çfarë ndodh në shkolla dhe në komunitet. Kjo do t’i përgatisë pjesëmarrësit për të reflektuar mbi përfshirjen në shoqëri dhe shkolla. (Aktivitetet 1.1.3 dhe 1.1.4) shqyrtojnë përgjegjësinë e shkollave për të siguruar të drejtat e arsimit për të gjithë fëmijët. Për më shumë informacion mbi legjislacionin dhe politikën për arsimin gjithpërfshirës shiko Publikimin 3 të Serisë së UNICEF-it *A Rights-Based Approach to Inclusive Education for Children with Disabilities*.

Ky aktivitet synon të paraqesë “qasjen ndaj sistemit dhe individit” për të zbatuar të drejtat e njeriut: kjo ka të bëjë me mjediset mundësues (sistemet) dhe fuqizimin e individëve (personave).

Termtat “Akses”, “Pjesëmarrje” dhe “Arritje” nënvizojnë nevojën për të parë kontributet, procesin, dhe rezultatet e arsimimit. Termtat mund të lidhen gjithashtu me “Të gjithë fëmijët janë të përfshirë”, “Të gjithë fëmijët kanë sfida” dhe “Të gjithë fëmijët janë të suksesshëm”.

Sekuena e aktivitetit

 <p><i>Puna me rastin studimor (individuale dhe grupe të vogla pune):</i></p>  <p>Leximi i rastit individualisht dhe mbajtja e shënimeve. Diskutimi me pjesëmarrës(it)</p>  <p>Paraqitja në seancë plenare</p>  <p>Diskutoni mundësuesitë dhe pengesat dhe se si mund të hiqen ato. Përgjegjësia e shkollës?</p>	<h3>Studim rasti: Qasja e sistemit dhe individit</h3> <p>Shkolla jonë ka punuar shumë për të qenë gjithëpërfshirëse. Mësuesit janë trajnuar si duhet dhe janë të përqendruar te fëmija, mjedisi është i aksesueshëm dhe mikpritës, kurrikula është fleksibël, higjiena dhe pastërtia janë në rregull, dhe vetë fëmijët marrin pjesë në mënyrë aktive duke e bërë shkollën një mjedis të gëzueshëm, miqësor dhe produktiv.</p> <p>Megjithatë, është e qartë se ka akoma fëmijë në komunitetin tonë që nuk e ndjekin shkollën.</p> <p>Një prej tyre është një fëmijë që vjen nga zonat e marxhinalizuara, që nuk ka qenë kurrë në shkollë, vjen nga një familje shumë e varfër dhe flet një gjuhë që nuk është gjuha kryesore e mësimdhënies në shkollë.</p> <p>Një tjetër fëmijë është prekur nga poliomeli, ka vështirësi në lëvizje, ai nuk ka qenë kurrë në shkollë dhe rri ulur në shtëpi duke mos bërë asgjë, i frikësuar të dalë jashtë se të tjerët mund të tallen me të.</p> <p>Shkruani të gjitha çështjet që sipas pikëpamjes suaj janë të rëndësishme për t’u marrë parasysh në vizionin e «Arsimit gjithëpërfshirës».</p>
 <p><i>Paraqitja e perspektives së Sistemit dhe individit (Plenare)</i></p> <p>Trajneri prezanton konceptet e “Aksesit, Pjesëmarrjes, dhe Arritjes” si edhe “perspektiven e Sistemit dhe Personit”. Mund të lidhet me proceset “Lartë-Poshtë” dhe “Poshtë-Lartë”: - Mund të lidhet me idenë e “Të drejta individuale” dhe “Zbatimin e të drejtave në mënyrë të vazhdueshme Mund të lidhet me “Kontribut – Proces – Rezultat”. - Mund të lidhet me përcaktimin fillestar të pjesëmarrësve mbi arsimin gjithëpërfshirës: Ku është fokusi këtu?</p>	<h3>Aksesi — Pjesëmarrja — Arritja</h3> <p>Arsimi gjithëpërfshirës ka të bëjë me sigurimin e aksesit, pjesëmarrjes dhe arritjes për të gjithë nxënësit.</p> <p>Qasja e individit dhe sistemit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fokusi te nxënësit që janë vulnerabël për t’u përjashtuar. • Fokusi te sistemi — identifikoni dhe përpunoni të kapërceni barrierat për gjithëpërfshirjen. <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div data-bbox="778 1458 1042 1653" style="border: 1px solid black; padding: 5px;"> <p>Fokusi te sistemi: Mjediset e të nxënësit, qëndrimet dhe metodat i përgjigjen diversitetit dhe promovojnë gjithëpërfshirjen. Kapërcimi i barrierave</p> </div> <div data-bbox="1114 1458 1377 1653" style="border: 1px solid black; padding: 5px;"> <p>Fokusi te nxënësi: Respektimi i pikëpamjeve të tyre dhe ofrimi i mbështetjes së përshtatshme si garantues të të drejtave. Fuqizimi</p> </div> </div> <div data-bbox="813 1697 1361 1803" style="border: 1px solid black; padding: 5px; margin-top: 10px;"> <p>Arsimi gjithëpërfshirës. Përgjigja ndaj diversitetit. Krijimi i situatave dhe sistemeve sociale pjesëmarrëse.</p> </div>

Aktiviteti 1.1.3: Ciklet e përfshirjes për të reflektuar situatën e fëmijës.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Reflektimi mbi situatat jetësore të fëmijës, në komunitetin ku ai jeton
- Fillimi i të menduarit në tre nivele ku ndryshimet drejt arsimit gjithëpërfshirës mund të iniciohen.
- Kontekstualizimi i mendimeve dhe ideve abstrakte sipas kontekstit të tyre.

Fokusi i aktivitetit:

Përfshirja si “të qenit pjesë” ose “përkatësi” në nivel ndërpersonal, komunitar, dhe shoqëror (arsimi informal)

Përfshirja si “të qenit pjesë” ose “përkatësi” në nivel klase, shkolle, dhe politikash (arsimi formal).

Proceset në shoqëri dhe institucionet që kontribuojnë në përfshirjen dhe përjashtimin.

MaterialedheMetoda:

“Flipchart”, stilolapsa

Gjenerim idesh, diskutime në grupe të vogla dhe diskutime në tërësi

Informacion shtesë/ alternativa:

Shembuj të aplikimit të “cikleve të mbështetjes”:

http://www.inclusion-europe.com/topside/en/site_content/81-person-centred-planning-tools-eg-passion-audit-relationship-map/244-circles-of-support

Informacion për trajnuesin:


Pjesëmarrësve fillimisht u kërkohet të fokusohen në atë sesi marrëdhëniet ndërmjet individëve, familjeve, dhe komuniteteve formojnë shoqërinë. Përfaqësimi në formë rrrathësh koncentrik (rrathët e përfshirjes, por potencialisht edhe rrrathët e përjashtimit) ndihmon në reflektimin e situatave jetësore të familjeve dhe fëmijëve të ndryshëm në komunitet dhe në shoqëri. Kjo ide do të përdoret përsëri në aktivitetin 1.3.1 kur pjesëmarrësit të reflektojnë në marrëdhëniet në grup dhe jashtë grupit dhe në aktivitetin 1.5.1 kur pjesëmarrësit të diskutojnë punën me familjet dhe komunitetet. Për më shumë informacion mbi prindërit, familjet, dhe pjesëmarrjen e komunitetit shikoni Publikimin 13 të Serisë së UNICEF-it *ARights-Based Approach to Inclusive Education for Children with Disabilities*.

Fëmijët kanë nevojë për marrëdhënie për të qenë qenie njerëzore dhe për të kuptuar botën. Marrëdhëniet mund të kontribuojnë në proceset përjashtuese kur ato nuk janë ushqyese dhe mbështetëse. Ky mund të jetë rasti në nivelin e marrëdhënieve personale në nivel marrëdhëniesh (fëmijët e përjashtuar (në nevojë)), në komunitet (p.sh, familjet e përjashtuara (në nevojë), ose në nivel shoqëror (grupet e përjashtuara në nevojë)).

Produkti ose rezultatet nga ky aktivitet do të përdoren në temën 5, aktiviteti 1.5.2 (Puna me familjet dhe komunitetet).

Sekuenca e Aktivitetit

“Përfshirja në shoqëri dhe komunitet” (plenare)

 Prajneri shpjegon nivelet e ndryshme të përfshirjes Duke përdorur një ose të dyja përfaqësimet.


Udhëzimet për ushtrimin (shiko PPT shtesë)
Zhvilloni ide mbi çështjet në vijim.


- Çfarë e bën shoqërinë gjithpërfshirëse?
- Çfarë e bën komunitetin gjithpërfshirës?
- Çfarë e bën marrëdhënien gjithpërfshirëse?

Mendoni për fëmijë në nevojë që ju njihni dhe merrni shembullin e rastit studimor:

- Cilat procese mund të ndihmojnë për ta bërë shoqërinë gjithpërfshirëse?
- Cilat procese mund të kontribuojnë në përjashtim?


Mendoni për komunitetin/bashkinë në të cilën ju jetoni dhe shqyrtoni aplikimin e reagimit tuaj.

 Pjesëmarrësit zhvillojnë ide ose në grupe të vogla ose plenare.

 Pjesëmarrësit ndajnë ide nëse puna u bë në grupe të vogla. Rezultatet do të përdoren përsëri në Temën 5 për të shqyrtuar bashkëpunimin me Familjet dhe komunitetet. Një shembull aplikimi është paraqitja grafike e ofruar

(Rrathët e mbështetjes, përfshirja Europe)

Gjithëpërfshirja në shoqëri dhe komunitet



Mikrosistemi: Grupe ose institucione që kanë një ndikim direkt mbi individin, ndikimi është i drejt për drejtë përmes marrëdhënieve.

Mezosistemi: Ndërveprime midis mikrosistemeve (p.sh. midis familjes dhe shkollës).


Ekosistemi: Mikrosisteme jo në kontakt të drejtpërdrejtë, por me ndikim nga të tjerët.

Makrosistemi: Kultura në të cilën individët jetojnë.

Kronosistemi: Veçoritë që zhvillohen në një mjedis individual dhe situatë jetësore përgjatë kohës.

Uri Bronfenbrenner: Teoria e sistemeve ekologjike.

Rrathët e gjithëpërfshirjes



Shoqësia

Komuniteti

Marrëdhëniet

Shkollat si komunitete

Aktiviteti 1.1.4: Përfshirja dhe Përfshirja në institucione për të reflektuar situatën në shkolla.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Reflektimi i shkollave si institucione dhe impakti i tyre mbi individët
- Bërja e matricës për të bërë bashkë të tre nivelet e sistemit dhe procesit.
- Paraqitja e koncepteve "Akses", "Pjesëmarrje" dhe "Arritje" për të treguar rëndësinë e shqyrtimit të treguesve të kontributeve, procesit, dhe rezultateve të arsimit gjithpërfshirës

Fokusi i Aktivitetit:

- Fokusi në sistemet arsimore si institucione
- Fokusi në proceset që zhvillohen në sistemet arsimore
- Fokusi tek fëmijët në nevojë (p.sh, nga rastet studimore, aktiviteti 1.1.2) për të reflektuar ndikimin e shkollave në gjithpërfshirje.

Materiale dhe Metoda:

"Flipcharts", stilolapsa (opsionale për raportim), për udhëzime shiko slajdin shtesë në prezantim
Zhvillimi i ideve për të gjeneruar treguesit përkatës dhe aplikimin e treguesve në mjediset e tyre


Informacion/alternativa shtesë:



Informacionpërtajnuesin:

Në këtë aktivitet, pjesëmarrësit aplikojnë qasjen e niveleve mikro, mezo, dhe makro ndaj sistemeve arsimore. Për të përshtatur më mirë konceptet e "aksesit" (kontributit), "pjesëmarrjes" (proces) dhe "arritje" (rezultat), është parë si me e përshtatshme prezantimi përmes matricave dhe jo nëpërmjet rratheve. (shikoni publikimin prezantues). Niveli në klasë përfaqëson nivelin mikro ku sistemet arsimore kanë një ndikim të drejtpërdrejtë mbi fëmijët nëpërmjet marrëdhënieve me mësuesin dhe shokëve. Në nivel shkolle, (niveli mezo/ i mesëm), ndërlihdhet krijohen nga mësuesit, familjet, ose aktorë të tjerë. Në nivel politikash (niveli makro), përcaktohen rregullat dhe rregulloret, parimet bazë, dhe krijohen udhëzues.

Individët vihen në kontakt me institucionet nëpërmjet marrëdhënieve dhe kjo mund të lehtësojë ose pengojë aksesin e tyre, pjesëmarrjen ose arritjet. Matrica mund të përdoret për të lokalizuar praktika të ndryshme, rregulla, dhe rregullore, dhe për të treguar sesi ato ndikojnë te individi. Trajnuesi duhet të zhvillojë disa shembuj ose të përpiqet të japë ilustrime që lidhen me pjesëmarrësit.

Sekuena e Aktivitetit

<p>"Gjithpërfshirja në shkolla si institucione publike" (Plenare dhe zhvillim idesh nga pjesëmarrësit)</p>  <p>Trajneri shpjegon nivelet e ndryshme të përfshirjes në matricë (duke lidhur nivelet e gjithpërfshirjes dhe procesit). Trajnuesi ofron përcaktime për Aksesin, Pjesëmarrjen, dhe Arritjen.</p> <p>Udhëzime për ushtrimin (shiko PPT shtesë) Zhvillo ide mbi çështjet në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Çfarë e bën sistemin e arsimit gjithpërfshirës? ▪ Çfarë e bën një shkollë gjithpërfshirëse? ▪ Çfarë e bën një klasë gjithpërfshirëse? 		<h4>Shkollat si institucione publike dhe fusha politikash</h4>																						
		<p>Perspektiva kronologjike</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Aksesi</th> <th>Pjesëmarrja</th> <th>Arritja</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="3">Perspektiva e sistemeve</td> <td>Politikat</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Shkolla</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Klasa</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td colspan="4" style="text-align: center;">Marrëdhëniet lidhin sistemet me individët</td> </tr> <tr> <td>Individi</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>				Aksesi	Pjesëmarrja	Arritja	Perspektiva e sistemeve	Politikat			Shkolla			Klasa			Marrëdhëniet lidhin sistemet me individët				Individi	
	Aksesi	Pjesëmarrja	Arritja																					
Perspektiva e sistemeve	Politikat																							
	Shkolla																							
	Klasa																							
Marrëdhëniet lidhin sistemet me individët																								
Individi																								

<p>Mendoni për fëmijë në nevojë që mund të merren si shembull rasti studimor:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Çfarë procesesh mund të ndihmojnë për të realizuar arsimin gjithpërfshirës? ▪ Çfarë procesesh kontribuojnë në përjashtim? <p>Mendoni për shkollën ku ju punoni dhe shqyrtoni mënyrën e reagimit tuaj.</p> <p> Pjesëmarrësit zhvillojnë ide ose në grupe të vogla pune ose në plenare</p> <p> Pjesëmarrësit ndajnë ide nëse puna u bë në grupe të vogla</p>	<p>Përkufizimet për aksesin, pjesëmarrjen dhe arritjen</p> <p>Aksesi: I referohet faktorëve të cilët kanë lidhje me shkollën dhe që lehtësojnë ose pengojnë aksesin e fëmijëve vulnerabël dhe ndikojnë në faktin nëse një fëmijë është i pranishëm në klasë apo jo. Kjo përfshin edhe aksesin në sistemet e mbështetjes së nevojshme dhe në kurrikulën e përgjithshme.</p> <p>Pjesëmarrja: I referohet faktorëve të procesit që kanë lidhje me shkollën dhe që lehtësojnë ose pengojnë sensin e përkatësisë, kompetencës dhe sensin e autonomisë së fëmijës. Pjesëmarrja kuptimplotë ndahet me shokët e të njëjtës grupmoshë dhe orientohet drejt qëllimeve që janë në të njëjtën linjë me shoqërinë dhe individin.</p> <p>Arritja: I referohet efekteve të shkollës të fëmijët dhe të rinjtë: Çfarë ka arritur fëmija si rezultat i pjesëmarrjes në arsim? Çfarë përfiton ai pasi ka ndjekur shkollën?</p> <p>Aksesi: E drejta për arsimim Pjesëmarrja: Te drejtat për arsimim Arritja: Të drejtat përmes arsimimit</p>
---	---

Aktiviteti 1.1.5: Reflektimi mbi Ndikimin e Mësuesit (çon në temën 2)

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Reflekimi në lidhje me ndikimin që kanë faktorët në familje dhe shkollë mbi arritjet e nxënësit (arritjet)
- T'i përballë pjesëmarrësit mebesimin e tyre mbi atë se çfarë ndikon në arritjet e nxënësit.
- Të paraqesë dimensionet e kompetencave nga "profili i një mësuesi gjithpërfshirës" si një organizator për modulet e mbetura

Fokusi i Aktivitetit:

Besimet e pjesëmarrësve mbi ndikimin e familjes, shkollës, dhe mësuesit në arritjet e nxënësit. Evidenca mbi efektivitetin dhe masat më pak efektive për të mbështetur arritjet e nxënësit

MaterialedheMetoda:

Nuk nevojiten materiale të tjera përveç slajdeve. Shikoni slajdet me vëmendje por rezultatet nuk do t'ju jepen në letër. Reflektoni mbi besimet tuaja dhe diskutoni

Informacion shtesë / alternativa:

Hattie, J. (2009). Mësimi i dukshëm. Një sintezë e 800 meta-analizave në lidhje me arritjet. Routledge. Agjencia Evropiane për Nevojat e Veçanta dhe Arsimin Gjithpërfshirës: Projekt informacion mbi "Rritja e rezultateve për të gjithë nxënësit" (shikowww.european-agency.org)

Informacion për trajnuesin:

Përmbajtja e këtij aktiviteti është bazuar në analizën e 800 rasteve (nxënësve), të bërë nga John Hattie në lidhje me arritjet e nxënësve dhe faktorët që ndikojnë në kwtto arritje. Rezultatet e dhëna bien ndonjëherë ndesh me mitet krijuara dhe që gati janë të përbashkëta, përse i përket ndikimit që kanë sistemet arsimore efektive dhe praktikat në klasa në arritjet e nxënësve. Duke dashur të vlerësohet niveli i ndikimit, pjesëmarrësit mund të mbështeten në besimin e tyre se ata mund të sfidohen nga të dhënat e paraqitura. Besimet janë pjesërisht të influencuara nga sistemi arsimor i përgjithshëm dhe rregullat dhe rregulloret e tij (p.sh, ngelja) dhe pjesërisht të influencuara nga eksperiencat personale të pjesëmarrësve. Varet nga trajnuesi sesa të dukshme/eksplicite duhen bërë besimet e pjesëmarrësve dhe deri në ç'pikë duhet të

arrijnë diskutimet mbi këto. Në çdo rast, ekziston një mundësi për të ngritur pyetje për praktikat ekzistuese dhe për të marrë në konsideratë alternativa.

Sekuenca e aktivitetit

<p><i>Fokusi mbi Faktorët i lidhur me mjedisin e shtëpisë (plenare) (individuale dhe punë në grupe të vogla):</i></p> <p> Prezantimi i faktorëve të lidhur me mjedisin familjen mbi arritjet (e marr nga Hattie 2009). Diskutim në grup mbi mundësuesit dhe barrierat dhe si mund të lëviznin ato?</p> <p> Diskutim në grup mbi çështjen nëse shkollat dhe mësuesit kanë një ndikim më të madh në arritjet sesa faktorët të lidhur me mjedisin familjar.</p>	<h4>Mjedisi familjar ndikon mbi arritjet e nxënësit</h4> <p>Efektet e disa faktorëve që lidhen me mjedisin familjar. A kanë shkollat në përgjithësi dhe mësuesit në veçanti më shumë ndikim tek arritjet e nxënësve apo janë faktorët që lidhen me mjedisin familjar që ndikojnë më shumë?</p>
<p><i>Fokusi në Faktorët të lidhur me mjedisin shkollor (plenare individuale dhe punë në grupe të vogla):</i></p> <p> Prezantimi i efektit të shkollës në arritjet (marr nga Hattie 2009).</p> <p> Pjesëmarrësit gjykojnë individualisht nëse faktorët kanë ndikim të lartë, të ulët, apo të vogël në arritjet e nxënësit.</p> <p> Prezantimi i rezultateve (shiko slajdin shtesë me rezultatet)</p> <p><i>Diskutime mbi ndryshimet ndërmjet besimeve dhe të dhënave /evidencave të pjesëmarrësve.</i></p>	<h4>Efektet e shkollës mbi arritjet</h4> <p>Çfarë kontributi mendoni se kanë faktorët e mëposhtëm mbi arritjet e nxënësit? «Kontribut të madh», «Kontribut mesatar» ose «Kontribut të vogël»?</p> <p>Ofrimi i vlerësimit formues për mësuesit; Marrëdhënia mësues-nxënës; Reduktimi i numrit të nxënësve në klasë; Kontrolli i nxënësit mbi të nxënit; Mënyra për të ndaluar etiketimin e nxënësve; Mësimdhënie e individualizuar; Aftësia për të grupuar; Si të zhvilloni pritshmëri të larta për secilin nxënës; Mësimdhënie përmes kompjuterit; Mbetja në klasë</p>
<p><i>Fokusi në Faktorët të lidhur me mjedisin shkollor (plenare individuale dhe punë në grupe të vogla):</i></p> <p> Prezantimi i ndikimit që ka mësuesi në arritjet (marr nga Hattie 2009).</p> <p> Pjesëmarrësit gjykojnë individualisht nëse faktorët kanë ndikim të lartë, të ulët, apo të vogël në arritjet e nxënësit.</p> <p> Prezantimi i rezultateve (shiko slajdin shtesë me rezultatet)</p> <p><i>Diskutime mbi ndryshimet ndërmjet besimeve dhe evidencave të pjesëmarrësve.</i></p>	<h4>Ndikrimi i faktorve të ndryshëm të mësuesit mbi arritjet</h4> <p>Cilët faktor të mësimit mendoni se kanë një ndikim të madh, mesatar ose të ulët mbi arritjet e nxënësit?</p> <p>Cilësia e mësimdhënies; Njohuritë e mësuesit për lëndën; Mikro-mësimdhënia; Trajnimi i mësuesit; Qartësia e mësuesit; Mos-etiketimi i nxënësve; Zhvillimi profesional; Efektet e mësuesit; Pritshmëria.</p>
<p>Projekti i Agjencisë Evropiane (Plenary)</p> <p> Prezantimi i kompetencave të zhvilluara në "Profilin e Mësuesve Gjithpërfshirës" të agjencisë Evropiane dhe standardeve të mësuesit gjithpërfshirës në Shqipëri.</p> <p><i>Këto katër fusha të kompetencave të mësuesit për arsimin gjithpërfshirës do të ndihmojnë në organizimin e temave të mbetura të këtij moduli.</i></p>	<h4>Projekti i Agjencisë Evropiane mbi «Mësuesit për gjithpërfshirjen»</h4> <p>«Zhvillimi profesional personal» (Tema 2) «Vlerësimi i diversitetit të nxënësit» (Tema 3) «Mbështetja për të gjithë nxënësit» (Tema 4) «Puna me të tjerët» (Tema 5)</p>

Tema 1.2: Zhvillimi Profesional Personal

Vështrim i përgjithshëm i Temës 1.2

Qëllimi i Temës

- Kuptimi i rëndësisë së zhvillimit profesional për Arsimin Gjithëpërfshirës.
- Njohja e një përcaktimi për gjithëpërfshirjen.
- Të bëhemi të vetëdijshëm për paragjykimet që ndikojnë në veprimet tona.
- Njohja e disa ndryshimeve midis mësuesve inovative, me eksperiencë, dhe ekspert.
- Zhvilloni vizionin tuaj të mësuesit gjithëpërfshirës.

Trajnuesi mund të mos paraqesë objektivat apo synimet e temës, por mund të pyesë pjesëmarrësit, të mbajë shënim ndonjë pyetje që ata kanë në lidhje me përmbajtjen dhe objektivat e temës. Këto pyetje mund të bëhen më vonë kur çështja të adresohet në trajnim. Në fund të çdo teme, trajnuesi mund të pyesë nëse të gjitha pyetjet kanë marrë ose jo përgjigje.

Vështrim mbi aktivitetet

Aktiviteti 1.2.1: Përtej veprimeve të mësuesit

Aktiviteti 1.2.2: Të provosh dhe reflektosh paragjykimin

Aktiviteti 1.2.3: Trajektorja e qasjes së ciklit të jetës profesionale

Aktiviteti 1.2.1:Përtej veprimeve të mësuesit.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Filloni të mendoni rreth veprimeve tuaja dhe zgjidhjes së problemit
- Prezantim me ciklin e zgjidhjes së problemit që ndihmon lidhjen e hapave të ndryshme.
- Përgjegjshmëria e pjesëmarrësve për faktin se të gjitha perceptimet janë të kufizuara dhe duhet të jenë subjekt i reflektimit.

Fokusi i Aktivitetit:

Kompetencat e mësuesit për diversitetin

Cikli i zgjidhjes së problemit: kompetencat dalin në pah gjatë veprimeve, paragjykimet bëhen të dukshme gjatë veprimeve.

Shembuj personal të keq-gjykimeve

Materialet dhe Metodrat:

Nuk nevojiten materiale të tjera përveç slajdeve.

Reflektim mbi veprimet e gjithsecilit dhe sesi para-gjykimet ndikojnë në këto veprime.

Informacion /alternativa shtesë:




Shiko referencat e dhëna në slajd.

Informacion për trajnuesin:


Tema e 2-të fillon me një prezantim të parë të kompetencave të mësuesit duke ofruar një përcaktim të gjerë. Përshkrime të detajuara të kompetencave të mësuesit për arsimin gjithëpërfshirës gjenden në Agjencinë Evropiane "Profili i Mësuesve Gjithëpërfshirës" dhe standardeve të mësuesit gjithëpërfshirës në Shqipëri. Qëndrimet përfaqësojnë besimet, vlerat dhe përvojat në të shkuarën të një mësuesi. Qëndrimet dalin në pah gjatë veprimeve dhe prandaj duhet të diskutohen në kontekstin e aktiviteteve të mësuesit. Prandaj, ky model i paraqitur këtu, ndihmon në reflektimin mbi veprimet dhe faktorët që ndikojnë në veprime (shiko gjithashtu publikimin prezantues).


Modeli i zgjedhur këtu thekson faktin që veprimet e synuara njerëzore janë gjithmonë për zgjidhjen e problemit. Cikle të ngjashme veprimi gjenden në internet. Nëse trajnuesi konsideron përdorimin e një modeli alternativ këtu, modeli duhet përdorur përgjatë modulit për të ruajtur vazhdimësinë dhe që të mos ngatërrojë pjesëmarrësit.

Sekuena e aktivitetit


<p><i>Kompetencat e mësuesit për diversitetin (Plenare)</i></p>  <p>Plenare: Ofroni përcaktimet me informacion shtesë dhe shembuj.</p> <p>Nënvizoni faktin që kompetencat mund t'u atribuohen individëve, grupeve sociale dhe institucioneve. Mund të lidhet me Temën 1.1 nëse doni.</p> <p>Tregoni "njohuritë", aftësitë dhe qëndrimet. Mund të pyesni për shembuj nga pjesëmarrësit.</p> <p>Çfarë; "sa" dhe "pse": të gjitha duhen për zgjidhjen e suksesshme të problemeve.</p>	<p>Kompetencat e mësuesit për diversitetin</p> <p>Kompetenca mund t'i atribuohet individëve, grupeve sociale ose institucioneve „kur ata zotërojnë ose sigurojnë kushtet për arritjen e qëllimeve zhvillimore specifike dhe për përmbushjen e kërkesave të paraqitura nga mjedisi i jashtëm“.</p> <p>Kompetenca përfshin një set njohurish, aftësish dhe qëndrimesh që i mundësojnë një personi kryerjen e një pune të caktuar në mënyrë efektive dhe funksionimin në atë mënyrë që të përmbushë ose kapërcejë standardet që priten në një profesion ose mjedis pune të veçantë.</p> <p>Kompetenca e mësuesit për të mësuar nxënësve diversitetin socio-kulturor ka të bëjë me "çfarë", "si" dhe "pse"; i përdor njohuritë dhe veprimet në një kontekst të caktuar duke mobilizuar gjithë burimet për të sjellë vlera të shtuara.</p> <p>Kuadri i Kompetencës së Këshillit të Evropës «Kompetenca kyçe për diversitetin».</p> <p>Shikoni gjithashtu Përkufizimet e Kompetencave për Punësim të UNICEF-it:</p> <p>http://www.unicef.org/about/employifiles/UNICEF_Compencies.pdf</p>
<p><i>Cikli i zgjidhjes së problemit (Plenare)</i></p>  <p>Plenare: Jepni një prezantim të parë ciklit të zgjidhjes së problemit.</p> <p>Tregoni se në çdo hap, u aplikuan përvojat vetjake, besimet, mënyrat e perceptimit dhe gjykimin të ngarjeve dhe njerëzve të tjerë.</p> <p>Ju lutemi referojuni publikimit prezantues për më shumë detaje. Ju mund të doni të zhvilloni një shembull për të ilustruar hapat e ndryshëm.</p>	<p>«Cikli i veprimit» ose «Cikli i zgjidhjes së problemit»</p>  <pre> graph TD A([situata, problemi]) --> B([matja, mbledhja]) B --> C([kontrolli, vlerësimi]) C --> D([veprimi, zbatimi]) D --> E([planifikimi, vendimmarrja]) E --> F([analizi, kuptimi]) F --> B </pre>

Cikli i zgjidhjes së problemit: Influencat dhe paragjykimet personale (Plenare)

 Plenare: Ky është një seksion më i gjatë ku grupi udhëhiqet nëpërmjet ciklit të zgjidhjes së problemit për të konsideruar dhe reflektuar mbi paragjykimet personale. Ky slajd ofron një vështrim të përgjithshëm.

 Pjesëmarrësit mund të ftohen të japin shembuj personal të keq-gjykit, paragjytimeve dhe besimeve që kufizojnë ose janë të gabuara në lidhje me nxënësit e tyre.

Veprimet tona janë subjekt i anshmërisë



```

graph TD
    A[Gjendja e mjedisit] --> B[Perceptimi]
    B --> C[Kuptimi]
    C --> D[Projeksioni për të ardhmen / vendimmarrja]
    D --> E[Performanca e veprimit]
    E --> F[Reagimi]
    F --> B
  
```

Aktiviteti 1.2.2: Eksperienca dhe reflektimi mbi paragjykimet.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Përdorimi i ciklit të zgjidhjes së problemit për të treguar burimet e paragjykit në secilën fazë të procesit.
- Mundësimi i eksperiencave personale dhe reflektimi mbi paragjykimet në veprimet njerëzore
- Ofrimi i shembujve që ndihmojnë në kuptimin e ndikimit të besimeve, vlerave, dhe qëndrimeve.

Fokusi i Aktivitetit:

Perceptimet e vetë pjesëmarrësve, kuptimi, synimet, veprimet, dhe reflektimet.

Materialet dhe Metodadat:

Asnjë material nuk nevojitet përveç slajdeve.

Eksperienca e burimeve të ndryshme të paragjykit dhe reflektimi.

Informacion shtesë/alternativa:

Ushtrime alternative, (fenomene ose eksperimente të marra nga psikologjia sociale dhe kuptimore) mund të përdoren dhe citohen.

Informacion për trajnuesin:

Ky aktivitet ndihmon pjesëmarrësit të provojnë dhe kuptojnë më mirë sesi perceptimet, gjithëpërfshirja, synimet, veprimet, dhe reflektimet ndikohen dhe janë të hapura ndaj paragjytimeve. Këto fenomene të përgjithshme u tregojnë pjesëmarrësve se të jesh paragjykes është pjesë e mendjes njerëzore dhe nuk është diçka që duhet të vij turp. Ajo që është e rëndësishme për mësuesit është të bëhen të vetëdijshëm që të jenë në gjendje të kuptojnë paragjykimet e tyre në veprimet e tyre dhe të tjerëve.

Psikologjia sociale dhe kulturore ofron një mori ushtrimesh, eksperimentesh, dhe përshkrimesh të këtyre fenomeneve. Trajnuesit mbase duan të gjejnë shembujt e tyre ose të ftojnë pjesëmarrësit të mbledhin shembuj që mund të përdoren në mjedise të tjera (p.sh, gjithashtu me fëmijët).

Sekuena e aktivitetit

Perceptimi



Sa mirë po vëzhgojmë?


Loja e basketbollit

Ju lutemi, numëroni sa herë ia pasojnë topin njëri-tjetrit lojtarët me bluzën e bardhë.

Gjendet në internet:

<http://www.youtube.com/watch?v=vJG698U2Mvo>

Kuptimi



Gjykimi dhe interpretimi janë personalë

Pyetja e perspektivës:

<https://www.youtube.com/watch?v=M3bfO1rE7Yg>

Konteksti ndikon mbi interpretimin tonë:

A B C
12 13 14



Aktor-Vëzhgues-i anshëm: Ne kemi prirjen të atribuojmë sjelljen e të tjerëve faktorëve personalë ose të brendshëm, por sjelljen tonë ne ua atribuojmë faktorëve të jashtëm (situatave).

Projeksioni për të ardhmen dhe vendimmarrja

Nëse bëhesh pis,
do të jesh në
telashe!

Ma jep dorën dhe
gjithçka do jetë
në rregull.

Vetëm mbahu,
mund t'ia dalësh
edhe vetëm!



Vlerësimi dhe reflektimi

Anshmëri e konfirmuar;
Profeci vetë-përmbushëse;
Efekti Placebo;
Kujtesa përzgjedhëse.

Këto janë disa veçori nga fenomeni i njohur si anshmëritë konjitive http://en.wikipedia.org/wiki/List_of_cognitive_biases.

Të jesh i anshëm është njerëzore, por mësuesit duhet të jenë të ndërgjegjshëm ndaj këtyre anshmërive nëse duan t'i mbështesin të gjithë nxënësit në një shoqëri diverse.

Aktiviteti 1.2.3: Trajektorja e qasjes së ciklit të jetës profesionale

Vështrim i përgjithshëm:

Qëllimi:

- Paraqitni një gjuhë të përbashkët për të folur rreth punës dhe programeve këshilluese.
- Kuptoni se arsimi gjithëpërfshirës kërkon një qasje të të mësuarit për gjithë jetën.
- Adresoni pika specifike të të mësuarit në çdo fazë të zhvillimit profesional.
- Zhvilloni një vizion të asaj se çfarë mësuesit duhet të arrijnë në secilën fazë të zhvillimit profesional.

Fokusi i Aktivitetit:

Mësuesit dhe ajo se çfarë kanë nevojë të mësojnë në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre profesional.

Materialet dhe Metodat:

"Flipcharts", stilolapsa (opsionale për raportim të diskutimeve në grup) Përvoja e burimeve të ndryshme të paragjykitimit dhe reflektimi

Informacion/alternativa shtesë:

Informacion për trajnerin:

Pjesëmarrësit duhet të konsiderojnë eksperiencat e tyre të të mësuarit në këtë modul si pjesë e zhvillimit të tyre profesional. Arsimi gjithëpërfshirës nuk është diçka që ti e mëson dhe pastaj ja u tregon nxënësve, kërkon të mësuar që ndikon në kompetencat, besimet, dhe aftësitë e tua. Materiali prezantues ofron informacion mbi "mësuesit e aftësuar" që duhet lexuar përpara se të bëhet ky aktivitet. Pikat në slajde mund të lidhen me modelin e ofruar këtu. Mësuesit e rinj mund të jenë të preokupuar që ti bëjnë "gjërat drejt"; mësuesit me përvojë e menaxhojnë këtë pjesë, por kanë vështirësi në caktimin e "modeleve" që mbështesin arsimin gjithëpërfshirës. Përgjithësisht, për të krijuar në mënyrë të përshtatshme që lejojnë drejtimin e praktikës, kjo është diçka që mësuesit e arrijnë vetëm nëpërmjet reflektimit e bërjes bashkë të njohurive të lëndës, njohurive pedagogjike dhe atyre që ju ofron institucioni.

Ky aktivitet nuk futet në këto lloje detajesh dhe nivelesh dhe kërkon vetëm të propozojë një pikë orientuese dhe ndihmon në të kuptuarit se mësuesit gjithëpërfshirës kanë nevojë të mësojnë gjatë gjithë karrierës së tyre. Ky nuk është një mendim që mbështetet nga mësuesit që besojnë se menjëherë mbas certifikimit ata s'kanë nevojë të mësojnë gjëra të tjera. Nëse e keni këtë besim, ai duhet trajtuar këtu. Ushtrimi fokusohet në pozicionin e tyre në trajektoren e praktikës që ndihmon në adresimin e çështjeve përkatëse.

Sekuena e aktivitetit

Sqarimi i detyrave kryesore zhvillimore dhe profesionale në ciklin e jetës profesionale të mësuesit (Plenare)



Prezantimi i tre slajdeve. Trajneri duhet të lexojë informacion mbi aftësitë e mësuesit përpara prezantimit të koncepteve të mësuesve të rinj, me përvojë, dhe mësuesve ekspert.

Mësuesit fillestar — lënia pas dore e nxënësve

Nga nxënësi te mësuesi fillestar:

- Krijoni një identitet si mësues;
- Shikojeni klasën më shumë nëpërmjet syve të një mësuesi sesa të një nxënësi;
- Lëndët shkollore janë më shumë sesa fakte dhe rregulla;
- Mësimdhënia është një aktivitet i ndërlikuar dhe me dy kuptueshmëri;
- Ka konceptualizime të shumta të mësimdhënies që ata mund të mos i kenë provuar si nxënës;
- Dëshira e madhe për të kontrolluar sjelljen e nxënësit nuk është një ide e mirë.



Mësuesi me përvojë — merret me situata të ndërlikuara

Nga mësuesi fillestar te ai me përvojë:

- Shikojeni të nxënit nëpërmjet syve të nxënësve;
- Reflektoni sistematikisht mbi praktikën personale;
- Bashkëpunimi dhe mbështetja e shokëve bëhet pjesë e praktikës së përditshme;
- Zhvilloni një kuptueshmëri për situatën e të nxënit sesa të përqendrohni te atributet e nxënësit;
- Zhvilloni një sens vetë-efikasiteti dhe kompetence në menaxhimin e qëllimeve konfliktuese.



Mësuesi mentor – ekspertizë në formë rrjeti**Nga mësuesi me përvojë te mësuesi mentor:**

- Të qenit i aftë për të identifikuar përfaqësimin thelbësor të lëndës ose fushës së njohurisë së një personi;
- Orientoheni sistematikisht të nxëniet nëpërmjet ndërveprimeve në klasë pa i kontrolluar nxënësit;
- Monitorimi i aktiviteteve të të nxëniet në mënyrën e duhur sjell reagime për të nxëniet dhe krijon identitete pozitive;
- Mësoni t'i ndihmoni nxënësit vetë-sistemohen dhe të ndjekin attribute emocionale;
- Ndikoni efektivisht për rezultate pozitive të nxënësit.

**Zhvillimi i një vizioni për mësuesit përgjatë ciklit të jetës profesionale**

Prezantimi i citimeve (citime alternative mund të përdoren).



Punë me partner ose individuale për të zhvilluar vizionin e asaj që një mësues i ri, me përvojë, dhe ekspert është në gjendje të bëjë.



Pjesëmarrësit duhet të përdorin informacionet dhe konceptet e diskutuara (p.sh, fushat e kompetencës së mësuesit, çfarë duhet për pjesëmarrjen e mësuesit). Diskutimet në grup ose prezantimet në seancë plenare janë opsionale.

Cili është vizioni juaj dhe çfarë kërkon të arrini?

Citate që reflektojnë kuptueshmërinë që ne kërkojmë të arrijmë:

«Të japësh mësim do të thotë të mësosh dy herë» (Joseph Joubert)

«Ne mund të dimë nëpërmjet të nxëniet nga dikush tjetër: por mund të jemi të mençur vetëm përmes mençurisë sonë» (Michel de Montaigne)

Trajtojini njerëzit sikur të ishin ata që duhej të ishin, dhe ndihmojini ata të bëhen ata që mund të jenë të aftë të bëhen» (Johann Wolfgang von Goethe)

«Autoriteti i atyre që japin mësim është shpesh një pengesë për ata që duan të mësojnë» (Cicero)

Cili është vizioni juaj për një mësues fillestar, me përvojë dhe një mësues mentor/edukator?

Ku jeni tashmë në ciklin jetësor profesional?

Tema 1.3: Vlerësimi i diversitetit të nxënësve.

Vështrim i përgjithshëm i Temës 1.3:

Qëllimi i Temës

- Kuptimi i paragjykimit në grup dhe jo në grup (favorizimi në grup), si lidhet me emërtimin
- Njohja e dimensioneve më të rëndësishme të diversitetit
- Kuptoni ciklin e shtypjes dhe hartoni ciklin tuaj të fuqizimit
- Shqyrtoni rëndësinë e të Drejtave të Njeriut për vlerësimin e diversitetit të nxënësve
- Mendoni për mënyrat sesi kjo njohuri mund të jetë e përshtatshme për shkollën tuaj

Trajnuesi mund të mos paraqesë vetëm objektivat dhe synimet e temës, por edhe t'ju kërkojë pjesëmarrësve të shkruajnë pyetjet që ata kanë në lidhje me përmbajtjen dhe objektivat e temës. Këto pyetje mund të përdoren nga pjesëmarrësit të pyesin kur këto çështje do të adresohen në trajnim. Në fund të çdo teme, trajnuesi mund të pyesë nëse të gjitha pyetjet u adresuan.

Vështrim i përgjithshëm i Aktiviteteve

Aktiviteti 1.3.1: Kuptimi i identiteteve sociale

Aktiviteti 1.3.2: Reflektim mbi ciklin e shtypjes

Aktiviteti 1.3.3: Reflektim mbi pasojat e qasjes bazuar në të drejtat e njeriut

Aktiviteti 1.3.1: Kuptimi i identiteteve sociale

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Shqyrtimi i identiteteve sociale të pjesëmarrësve
- Pranimi se paragjykimet sociale janë të ndërruara në marrëdhëniet njerëzore.
- Provimi i ndikimit të identiteteve sociale në proceset në grup.

Fokusi i Aktiviteteve:

Identiteti social i pjesëmarrësve

Proceset në grup të lidhura me identitetet sociale dhe dinamika brenda dhe jashtë grupit

Materialet dhe Metodadat:

Pyetësor "Kuptimi i identitetit social të tyre", udhëzime dhe deklarata për ushtrimin "Power Walk", reflektim dhe eksperiencë personale

Informacion /alternativa shtesë:


Informacion për trajnuesin:


Për të kuptuar identitetet sociale të fëmijëve dhe sa të ndryshme mund të jenë ato kërkon reflektim mbi identitetin social të vetë-vetes. Është e rëndësishme të kuptojmë se jo të gjitha dimensionet mund të jenë njësoj të rëndësishme për njerëz të ndryshëm dhe e kundërta të çon në diskriminim. Për shembull, shumë njerëz i përkasin ose të paktën janë rritur sipas feve dhe traditave të ndryshme. Për shumë individë,


feja luan një rol kyç në jetët e tyre prandaj ky është një dimension i rëndësishëm për të përcaktuar identitetet e tyre, ndërsa për të tjerët feja është më pak e rëndësishme. Paragjykimi në grup ose jashtë grupit është një fakt themelor i të qenit njeri: ne nuk mund të kemi marrëdhënie të ngushta me çdo njeri. Dhe duke u përkushtuar në disa marrëdhënie, ne distancohemi nga të tjerët. Është pjesë e detyrave profesionale të mësuesit të reflektojnë në këto procese në lidhje me praktikat e tyre sociale dhe të njohin dinamikat në grup dhe jashtë grupit në klasën e tyre.

Sekuena e aktivitetit

Plotësoni pyetësonin (punë individuale)

 Një prezantim i shkurtër për të shpjeguar detyrën.

 Pjesëmarrësit plotësojnë pyetësonin e identiteteve sociale. Disa nga informacionet janë private, prandaj pjesëmarrësit nuk duhen detyruar t'i ndajnë me të tjerët.

 Pyetjet në slajd mund të përdoren për të reflektuar ose diskutuar situatat në grup.

Pyetësoni "Kuptimi i identiteteve tona sociale"

Understanding Our Social Identities

Identity (Specify in each category how you identify yourself—for example, under "Sexual Identity," heterosexual, homosexual, etc.)	How important is this identity to you? (1-10, ten is high)	How apparent is this identity to someone who only sees you or does not know you well? (1-10, ten is high)	How highly regarded is this identity by society as a whole? (1-10, ten is high)	Ways in which this identity is positively viewed by society/aspects of society?	Ways in which this identity is negatively viewed by society/aspects of society?
Race:					
Ethnicity:					
Social class:					
Gender:					
Sexual identity:					
Ability/Disability (able-bodied, with cerebral palsy, etc.):					
Spirituality/Religion, Membership in faith community:					
Occupation/Proposed occupation:					
Membership in social organization:					
Other:					

Kuptimi i identiteteve sociale

Si e perceptojmë veten në grupet sociale dhe si perceptohemi nga të tjerët?

Me cilat aspekte të identitetit tonë jemi më të rehatshëm për t'u ekspozuar në komunitetin tonë dhe cilat aspekte preferojmë t'i mbajmë private?


Ju lutemi, plotësoni pyetësonin.


Merrni parasysh se çfarë nënkupton identiteti social në nivelet e mëposhtme:


- Personale: Vlerat, Besimet, Ndjenjat;
- Ndërpersonale: Veprimet, Sjelljet, Gjuha;
- Institucionale: Rolet, Politikat, Procedurat;
- Kulturore: Bukuria, E vërteta, E drejta.

Cilat përmasa të diversitetit janë identifikuar në pyetësor? A ka përmasa të tjera që ju mendoni se janë të rëndësishme?

Paragjykimet në grup dhe jashtë grupit (Plenary)

 Nxemje: Ushtrimi Power Walk

 Bazuar në përgjigjet dhe mendimet ndaj identiteteve sociale të pjesëmarrësve, çështjet jashtë grupit mund të trajtohen Trajnuesi mund të ftoj pjesëmarrësit të mendojnë për identitete sociale të kundërta me të tyret. Rjedhimisht, trajnuesi duhet të ofrojë informacion mbi fenomenin në grup dhe jashtë grupit.

 Ata ftohen të reflektojnë për situatën e tyre si individë dhe si mësues.

Anshmëria në grup dhe jashtë grupit

Me ose pa ndërveprim midis grupeve mund të vëzhgohen veçoritë e mëposhtme:

- Identiteti në grup kundrejt etiketimi jashtë grupit;
- Favorizimi në grup kundrejt diskriminimi jashtë grupit;
- Ekzagjerimi dhe mbi-përgjithësimi i ndryshimeve midis anëtarëve të grupit dhe atyre jashtë grupit;
- Zvogëloni ndryshimet midis anëtarëve të grupit;
- Kujtoni informacion më shumë të detajuar dhe pozitiv për grupin dhe më shumë ndërveprim negativ për ata jashtë grupit.

Fenomeni mund të vihet re çdo ditë, p.sh. me fansat e futbollit.

Eksperimenti që tregon këto dinamika: Robbers Cave Experiment (Eksperimenti i shpellës së grabitësve).

Çfarë mund të bëni për të si një individ? Çfarë mund të bëni për të si një mësues?

Aktiviteti 1.3.2: Reflektim mbi ciklin e nënshtrimit.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Zhvillimi i një kuptimi më të mirë të proceseve që çojnë në përjashtim.
- Pranimi që mësuesit kanë fuqi institucionale që mund të lehtësojnë gjithëpërfshirjen ose të krijojnë barriera

Fokusi i Aktivitetit:

Cikli i zgjidhjes së problemit për të treguar proceset e përjashtimit

Stereotipet, paragjykimi, diskriminimi, shtypja, dhe brendësia e shtypjes (cikli i shtypjes)

Materialet dhe Metodatat:

Jo materiale shtesë

Zhvillim idesh dhe reflektim

Informacion /alternativa shtesë:

Cikli i nënshtrimit:

http://www.uas.alaska.edu/juneau/activities/safezone/docs/cycle_oppression.pdf Informacion shtesë ofrohet në site të ndryshme në internet

Informacion për trajnuesin:

Stereotipet, paragjykimet, diskriminimi, nënshtrimi dhe terminologjia e ngjashme me këto njihet në përgjithësi por rrallë janë të lidhura drejtpërdrejt me veprimet e mësuesit. Përdorimi i ciklit të zgjidhjes së problemit ndihmon në kuptimin e këtyre proceseve si pjesë e veprimeve të paragjykuara (të jashtme ose të brendshme) që krijojnë situata në të cilat nxënësit nwnshtrohen, përjashtohen, ose kufizohen në pjesëmarrje. Pjesëmarrësve u duhet dhënë mundësia të zhvillojnë ide dhe të reflektojnë në këto procese.

Shkollat kanë fuqinë institucionale sepse ato janë agjentët e ndryshimit. Në varësi të asaj sesi kjo fuqi institucionale përdoret, ato mund të ndihmojnë në krijimin dhe pasjen e mjediseve mundësuese që sigurojnë mësimin dhe pjesëmarrjen për të gjithë fëmijët ose mund të keqpërdoret për të përjashtuar fëmijët, duke mos vlerësuar nevojën për mësues mbështetës dhe duke mos kuptuar përgjegjësitë personale të gjithësecilit

Sekuena e aktivitetit

<p><i>Cikli i nënshtrimit (Plenare)</i></p> <p>Trajneri paraqet ciklin e nënshtrimit dhe e lidh me ciklin e veprimeve dhe atë se nga vjen paragjykimi.</p> <p>Diskutimet në grup mbi fuqinë institucionale të shkollave dhe sesi kontribuojnë në stereotipet, paragjykimet, diskriminimin, dhe nënshtrimin.</p>	<pre> graph TD A[Perceptimi i të tjerëve] --> B[Stereotipi] B --> C[Të menduarit për të tjerët / Paragjykimi] C --> D[Diskriminimi] D --> E[Marrja parasysht dhe planifikimi i veprimeve] E --> F[Shtypja / Veprimet e hapura dhe të mbyllura] F --> G[Efekt i mbi antarin jashtë grupit / Shtypja e përvetësuar] G --> A </pre>
<p>Stereotipet, paragjykimi, diskriminimi dhe shtypja</p> <p>Stereotipi është një përgjithësim për një grup njerëzish ku karakteristikat identike i përcaktohen virtualisht të gjithë anëtarëve të grupit, pavarësisht variacionit aktual midis anëtarëve. Gjithashtu, mund të jetë një besim i ekzagjeruar ose i shtrembëruar që refuzon të pranojë ndryshimet midis anëtarëve të një grupi.</p>	

Paragjykimi është një qëndrim negativ ose armiqësor kundrejt njerëzve në një grup të dallueshëm, i bazuar vetëm në anëtarësimin e tyre brenda grupit. Ai reflektohet në gjykime ose opinione të krijuara përpara se të njihen faktet. Nuk është i mësuar.

Diskriminimi është preferencë sistematike e grupit jashtë grupit me fuqinë për të vepruar mbi këto preferenca. Shtypja është një kombinim i paragjykimit, stereotipit dhe diskriminimit që përkrahet nga pushteti institucional.

Shtypja e përvetësuar është efekti që kjo ka mbi individët jashtë grupit.

Pushteti institucional është aftësia ose autoriteti zyrtar për të vendosur se çfarë është më e mire për të tjerët dhe shoqërohet me disponueshmërinë e burimeve dhe kapacitetit për të ushtruar kontrol mbi të tjerët.

Aktiviteti 1.3.3.: Reflektimi mbi pasojat e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Tregoni përgjegjësinë e shkollave për të krijuar mjedise që respektojnë të drejtat e njeriut.
- Reflektoni mbi veprimet e mësuesit që fuqizojnë fëmijët dhe familjet.
- Aplikimi i reflektimit sipas mjediseve shkollore të gjithsecilit.

Fokusi i Aktivitetit:

Të drejtat e njeriut dhe sesi zbatohen ato në sistemet arsimore Veprimet e mësuesit dhe sesi lidhen ato me proceset fuqizuese

Materialet dhe Metodadat:

“Flipchart” dhe stilolapsa Reflektim dhe diskutim

Informacion /alternativa shtesë:

Udhëzime politikash mbi arsimin gjithpërfshirës:

<http://unesdoc.unesco.org/images/0017/001778/177849e.pdf>

Qasja në të drejta për arsimin gjithpërfshirës:

http://www.inclusive-education.org/system/files/publications-documents/UNICEF_Right%20

[Children%20Disabilities_En_WebACCESS.pdf](http://www.inclusive-education.org/system/files/publications-documents/UNICEF_Right%20Children%20Disabilities_En_WebACCESS.pdf)

Informacion për trajnuesin:

Pjesa e aktiviteteve dhe slajdet ofrojnë një mënyrë të qasjes ndaj kësaj teme të gjerë. UNICEF-i ka zhvilluar “Child Rights Toolkit” nga ku mund të merren materiale për të pasuruar të mësuarin e pjesëmarrësve. Zbatimi i të drejtave të njeriut në arsim duhet të marrë parasysh të dyja, respektin e menjëhershëm për të drejtat e individëve dhe realizimin në mënyrë të vazhdueshme të të drejtave nëpërmjet krijimit të mjediseve mundësuese. Ky aktivitet fokusohet fillimisht në perspektivën e sistemit (krijimi i sistemeve të arsimit gjithpërfshirës) dhe pastaj në perspektivën e individit (fuqizimi i individëve). Mësuesit gjithpërfshirës duhet të jenë të vetëdijshëm për të dyja qasjet dhe duhet të kontribuojnë në të dyja: respektin e të drejtave individuale për arsimim dhe realizimin e tyre në mënyrë të vazhdueshme. Për më shumë informacion mbi legjislacionin dhe politikën për arsimin gjithpërfshirës shiko Publikimin 3 të Serisë së UNICEF-it *A Rights-Based Approach to Inclusive Education for Children with Disabilities*. Trajnuesi duhet të jetë i familjarizuar me çështjet dhe strategjitë për të siguruar se të

drejtat e njeriut respektohen në arsim. Ata mund të japin eksperiencat e tyre ose ti referohen literaturës për të dhënë shembuj dhe të ilustrojnë pikat e ngritura në slajdin prezantues. Trajnuesi mund të zgjedhë një qasje tjetër për të treguar të dyja perspektivat . Lidhjet duhen bërë me aktivitetin 1.1.2(qasja ndaj individëve dhe sistemit), produkteve të zhvilluara nga pjesëmarrësit mund të përdoren për të ilustruar dhe shpjeguar këto dy qasje për të zbatuar të drejtat e njeriut.(KDPAK dhe KDF a janë përmendur këtu por nuk janë shpjeguar në detaj). Pjesëmarrësit duhet të ftohen të reflektojnë mbi njohuritë e tyre dhe nëse kanë nevojë të mësojnë më shumë rreth këtyre konventave. Rezultatet dhe diskutimet e lidhura me ciklin e shtypjes (aktiviteti1.3.2) mund të përdoren për të menduar për veprime mundësuese në çdo hap që ndihmon për të krijuar ciklin e fuqizimit. Ushtrimi i ndihmon pjesëmarrësit të fokusohen në situatën e punës së tyre dhe në veprimet që nevojiten për të siguruar respektimin e të drejtave në mënyrë të vazhdueshme.

Sekuena e aktivitetit

Mungon

Tema 1.4:

Mbështetje për të Gjithë Nxënësit

Vështrim i përgjithshëm i Temës 1.4

Qëllimi:

- Konsideroni mënyrat tuaja për të menduar rreth mësimit dhe arritjeve
- Njohja e një modeli që ndihmon kuptimin e situatave të të mësuarit
- Konsideroni mësimin si rezultat i pjesëmarrjes (jo vetëm si arritje
- Kuptoni dhe organizoni mjedise të ndryshme
- Mendoni për mënyrat se si kjo njohuri mund të përshtatet në shkollat tuaja

Trajnuesi mund të mos paraqesë vetëm objektivat dhe synimet e temës, por edhe mund t'ju kërkojë pjesëmarrësve të shkruajnë pyetjet që ata kanë në lidhje me përmbajtjen dhe objektivat e temës. Këto pyetje mund të përdoren nga pjesëmarrësit për tu bërë kur këto çështje do të adresohen përgjatë trajnimit. Në fund të çdo teme, trajnuesi mund të pyesë nëse të gjitha pyetjet u adresuan.

VështrimAktivitetet

Aktiviteti 1.4.1: Mendoni më mirë për aktivitete sesa detyra

Aktiviteti 1.4.2: Zhvilloni një kuptim më të thellë të pjesëmarrjes

Aktiviteti 1.4.3: Zhvilloni një kuptim më të thellë të mjediseve mësimore

Aktiviteti 1.4.4: Reflektim i mbështetjes për të gjithë nxënësit në shkollat e pjesëmarrësve

Aktiviteti 1.4.1: Mendoni më mirë për aktivitete sesa detyra.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Prezantoni pjesëmarrësit me idenë e "situatave të të mësuarit"
- Eksploroni mënyrat në të cilat situatat mësimore mund të ndryshohen për të rritur eksperiencën e të mësuarit
- Praktikoni mendimin kreativ për të përshtatur situatat sipas nxënësve të ndryshëm

Fokusi i Aktivitetit:

Situata mësimore (më mirë sesa detyra të veçuara)

Mendimi juaj dhe sesi mund të shtrihet më tej

MaterialetdheMetodat:

"Flipcharts" dhe stilolapsa nëse diskutimet do të raportohen në sesion plenar

Informacion/alternativa shtesë:




Alternativa për të përdorur kartonin: përdorni slajdin mbi paragjykimin në "Projeksion në të ardhmen"(aktiviteti1.2.2) për të treguar rëndësinë e synimeve ose ndonjë shembull tjetër për të treguar këtë të fundit. (p.sh, në situatat me lidhje të dyfishtë).

Informacion për trajnuesin:

Ky aktivitet tregon një nga problemet që mësuesit hasin kur përpiqen të mësojnë grupe të ndryshme fëmijësh dhe sesi këto vështirësi mund të tejkalohen duke menduar në një mënyrë të ndryshme. Është më mirë mësuesit të fokusohen në situatat mësimore sesa në detyra të veçanta. Situatat mësimore konsistojnë në një set fleksibël detyrash që janë të lidhura me një qëllim të përbashkët. Trajnuesi duhet ti referohet publikimit prezantues për të kuptuar më mirë sesi kjo ndihmon në lidhjen e menjëhershme të veprimeve të të gjithë pjesëmarrësve në fusha të ndryshme të jetës (qasja e ciklit të jetës) dhe sesi kjo është e lidhur me aftësitë përkatëse të mësuesit (lëvizjet, rutina, abstraksionet). Mësuesit që mendojnë pa u bazuar në një model fiksdhe që e kanë të vështirë të bëjnë lidhjen midis të tashmes dhe të ardhmes së largët nuk janë në gjendje të krijojnë situata mësimi fleksible që ofrojnë mundësi për të mësuar për të gjithë fëmijët.

Mësuesit përgjithësisht e kanë të vështirë të mendojnë për situata jetësore që fëmijët mund të gjejnë vetë dhe për situatat mësimore që mund të krijohen nga vetë ata, një model ky që ofrohet dhe përdoret përgjatë të tre moduleve për të ndihmuar në analizën e situatave. Më shumë informacion dhe shpjegime për Modelin e Teorisë së Aktivitetit ofrohen në publikimin prezantues.

Sekuena e aktivitetit

<p><i>Prezantim i Modelit të Teorisë së Aktivitetit</i></p>  <p>Rezultatet nga diskutimet duhen përdorur për të paraqitur modelin. Përgjigjet mund të futen në kontekstin e modeleve për të ilustruar këtë lloj analize.</p>  <p>Pjesëmarrësit ftohen të tregojnë diferencat ndërmjet kësaj mënyre të menduarit dhe mënyrës që ju përqaasen kartonave.</p>	<p>Kuptimi i situatave të të nxënit — propozimi i një modeli</p>  <p>Ne do ta përdorim këtë model së bashku për të analizuar situatën e të nxënit që ju mendoni se është krijuar në karikaturë nga mësuesi.</p> <p>Ju do ta përdorni edhe vetë këtë model për të përshkruar situatën e të nxënit ku të gjitha kafshët marrin pjesë në një mënyrë domethënëse.</p>
	<p>Shpjegime për modelin e aktivitetit</p> <p>«Subjekti» i referohet personit ose personave që po kryen/kryejnë aktivitetin. Aktiviteti kuptohet dhe analizohet nga perspektiva e tij/Isaj (p.sh. mësuesi).</p> <p>«Objekti» i referohet çështjes kryesore të aktivitetit, ai përcakton se për ku është orientuar aktiviteti. Ky mund të jetë një tjetër person, problem, temë apo objekt. Objekti ndërtohet nga subjekti dhe përqendrohet në aspektet që janë të përshtatshme për kryerjen e aktivitetit (p.sh. matematika, sjellja e nxënësit).</p> <p>«Rezultati» i referohet të gjitha rezultateve ose ndikimeve të dëshiruara dhe të padëshiruara që janë krijuar si rezultat i kryerjes së aktivitetit (p.sh. arritja, zhgënjimi).</p> <p>«Mjetet dhe artikujt» janë mjete fizike dhe konjitive që përdoren për të kryer aktivitetin (p.sh. libri, strategjitë e të nxënit, gjuha).</p> <p>«Konteksti» i referohet karakteristikave të kuadrit dhe mjedisit social në të cilin kryhet aktiviteti. Kjo mund të referohet për vlera sociale, besime, norma ose rregulla, por edhe për klimën në klasë dhe mbështetjen e dhënë nga shokët.</p>

Aktiviteti 1.4.2: Zhvillimi i një kuptimi më të thellë të pjesëmarrjes.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Zhvillimi i kuptimit për pjesëmarrjen, si komponent i procesit të arsimit gjithëpërfshirës
- Aplikimi i Modelit të Teorisë së Aktivitetit për të parashikuar situata mësimore që promovojnë pjesëmarrjen
- Lejimi i pjesëmarrësve për të zhvilluar situata që mbështesin mësimin për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë.

Fokusi i Aktivitetit:

Pjesëmarrja e fëmijëve

Veprimet e mësuesit për të lejuar pjesëmarrjen

Katër perspektiva mbi kufizimet e pjesëmarrjes

Materialet, Metodat:

Materiale s'nevojiten


Informacion shtesë/alternativa:

Përcaktimi i pjesëmarrjes: referojuni Publikimit Prezantues dhe Agjencisë Evropiane (shiko më poshtë)

Informacion për trajnuesin:

Gjithëpërfshirja mund të përcaktohet si procesi për të siguruar pjesëmarrjen dhe mësimnxënien për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë. Prandaj është themelore për mësuesit dhe profesionistët e fushës të zhvillojnë një kuptim të asaj se çfarë është pjesëmarrja. Përcaktimi i pjesëmarrjes i përdorur në këtë modul (shiko publikimin prezantues) është marrë nga publikimi i Agjencive Evropiane



“Pjesëmarrja në arsimin gjithëpërfshirës. Një kuadër për zhvillimin e treguesve”Përcaktimi është bazuar në teorinë e vetë-përcaktimit me komponentët e nevojshëm për të ruajtur motivimin dhe për të qenë aktivë në jetë: Autonomi, Kompetenca, Ndërveprim. Në kontekstin e përfshirjes sociale, këto koncepte duhet të lidhen në atë se ku konkretisht fëmijët marrin pjesë. Prandaj këto janë blloqet e ndërtimit të përcaktimit të pjesëmarrjes. Përcaktimi mund të lidhet direkt me Modelin e Teorisë së Aktivitetit duke patur parasysh se mësuesit kanë mjete dhe mënyra për të analizuar dhe kuptuar situatën në të cilën fëmijët e gjejnë veten dhe për të identifikuar pengesa të mundshme për pjesëmarrjen e tyre:





- Me rutina tipike
- I përfshirë në aktivitete të cilat kanë në fokus synimet e duhura
- Në një ambient tipik/të zakonshëm

Megjithëse modeli i aktivitetit fokusohet në aktivitetet e individëve ose grupeve, kjo sjell në mjedis konceptin e “mjeteve dhe rutinës” dhe “mjedisit ose konteksteve”. Fushat e jetës duhen kuptuar si vende sociale ose si kontekste ku ndodh pjesëmarrja. Situata të ndryshme krijohen dhe varieteti pasuron jetët e fëmijëve dhe i bën ata më të aftë të marrin pjesë në situata në të ardhmen. Fushat e jetës të cituara në këtë ushtrim bëjnë lidhjen e parë me fushat e jetës që janë përdorur në “Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit” për të përshkruar pjesëmarrjen dhe kufizimet në pjesëmarrje që hasin fëmijët me aftësi të kufizuara. Fushat e jetës nuk janë specifike sipas aftësisë së kufizuar dhe reflektojnë përvojat universale njerëzore. Prandaj ato mund të përdoren për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë si edhe për të kuptuar situatat në jetë të mësuesve dhe profesionistëve të tjerë.

Sekuena e Aktivitetit

<p><i>Pjesëmarrësit duhen ftuar të japin shembuj sesi bëhet kjo në shkollat e tyre dhe klasa.</i></p>  <p>Trajnuesi tregon mënyrat sipas të cilave mësuesit mund të mbështesin ose përmirësojnë pjesëmarrjen:</p>  <ul style="list-style-type: none"> ▪ Struktura lehtëson bërjen e aktiviteteve ▪ Përfshirja lehtëson përkatësinë ▪ Autonomia mbështet agjencinë 	<p style="text-align: center;">Pjesëmarrja është parakusht për arritjen</p> <p>Pjesëmarrja, të angazhohesh me...»</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Angazhimi për sjelljen (drejtim pozitiv, përfshirja te të nxëniet dhe detyrat akademike, pjesëmarrja në aktivitete që kanë lidhje me shkollën); ▪ Angazhimi emocional (reagime emocionale si interesi, lumturia, identifikimi me mësuesit dhe shokët); ▪ Angazhimi konjktiv (vetë-kontroll, fleksibiliteti në zgjidhjen e problemit, përballja me strategjitë). <p>... «në rutina dhe mjedise tipike...»</p> <p>... «që orientohen drejt qëllimeve kuptimplota personale dhe / ose sociale.»</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Demonstroni dhe provoni kompetenca (p.sh. konjitive, komunikative, manuale, emocionale, etj.); ▪ Demonstroni dhe provoni përkatësi (p.sh. tregoni interes për të tjerët, jini të motivuar për të marr parasysht sugjerimet e të tjerëve, ndihuni të pranuar dhe të mirëpritur); ▪ Demonstroni dhe provoni autonomi (p.sh. vëmendje direkte, vetë-rregulloni sjelljen për të kryer veprime të ndërlikuara, marrja e vendimeve për jetën e dikujt).
	<p style="text-align: center;">Mënyra për të përmirësuar pjesëmarrjen si mësues</p> <p>1. Struktura</p> <p>Mësuesi jep orientime të qarta, jep një vështrim të përgjithshëm paraprak të një leksioni ose detyre të ardhshme, komunikon pritshmëritë e tij ose saj për të nxëniet ose performancën e të nxëniet, komunikon një standard përsosmërie për nxënësit, deklaron rregullat e klasës, administron pasojat në mënyrë konsistente dhe rastesore, jep reagime për nxënësit.</p> <p>2. Përfshirja</p> <p>Mësuesi kujdeset për mënyrën se si nxënësit i bëjnë projektet e tyre, u drejtohet nxënësve me emër, i pëlqen të kalojë kohë me nxënësit, flet me nxënësit para ose pas mësimit, jep ndihmë për probleme, u siguron burime nxënësve.</p> <p>3. Mbështetja e autonomisë</p> <p>Mësuesi u jep nxënësve një zgjedhje se çfarëdo të bëjnë, jep shpjegime të arsyeshme për aktivitetet e të nxëniet, reziston duke përdorur gjuhë detyruese dhe kontrolluese, nxit pyetjet dhe komentet, u kërkon sugjerime nxënësve, nxit iniciativën e nxënësve dhe pjesëmarrjen aktive.</p>

	<p style="text-align: center;">Aktiviteti i nxënësve</p>  <p>Pjesëmarrja ndodh në fusha të ndryshme të jetës: Të nxënësve, Lëvizshmëri, Komunikim, Marrëdhënie, Shkollë, Familje, Kohë e lirë.</p>
	<p style="text-align: center;">Perspektivat për të shpjeguar kufizimet e pjesëmarrjes</p>  <p>Mendoni për fëmijë të ndryshëm me vështirësi në të nxënë: cilat perspektiva janë të përshtatshme për të kuptuar kufizimet e pjesëmarrjes?</p>

Aktiviteti 1.4.3: Zhvillimi i një kuptimi më të thellë të mjediseve mësimore.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Zhvillimi i një kuptimi të përbashkët për krijimin e një sistemi mbështetës për të promovuar pjesëmarrjen.
- Zhvillimi i një kuptimi të përbashkët për krijimin e mjediseve mundësuese shkollore
- Vështrim mbi kompetencat e mësuesit, aftësitë dhe qëndrimet për mjedis mundësues mësimor.

Fokusi i Aktivitetit:

Modeli me tre nivele për të përshkruar intensitete të ndryshme të mbështetjes së personalizuar
Tre tipet e standardeve për të vlerësuar cilësinë e arsimit lidhur me kontributet, procesin, rezultatet
Pjesëmarrja e mësuesve

Materialet dhe Metodat:

Jo materiale shtesë
Diskutime në grup







Informacion shtesë/alternativa:

Më shumë informacion mbi modelin me tre nivele ose për qasjen “ndërrhyrja si përgjigje” mund të gjendet në: <http://www.rtineteork.org/learn/what/whatisrti>

Informacion për trajnuesin:

Krijimi i një mjedisi mundësues mësimor në shkolla është element thelbësor për arsimin gjithëpërfshirës. Theksi këtu është në sistemin dhe sesi sistemi mund të kuptohet dhe analizohet. Modeli i ndërhyrjes si përgjigje (modeli me tre nivele) përdoret për të qartësuar sistemet mbështetëse ekzistuese dhe sesi ato lidhin nevojat e nxënësve për mbështetje shitesë. Në modulën 1, pjesëmarrësit prezantohen me idenë e sistemeve mbështetëse dhe priten të reflektojnë bazuar në përvojat në të shkuarën dhe njohuritë. Strategjitë për të krijuar mjedise mundësuese do të ofrohen në modulën 2 dhe 3.

Sekuena e aktivitetit

<p><i>Prezantim me Modelin me Tre Nivele (plenare)</i></p> <p> Vështrim dhe prezantim mbi modelin me tre nivele.</p> <p>Pjesëmarrësit punojnë në çështjet në vijim (grupe të vogla ose në plenare):</p> <p> - Çfarë shërbime mbështetëse keni për çdo nivel? Cilat janë karakteristikat e fëmijëve që mbështeten në çdo nivel? Nëse ka fëmijë jashtë shkolle: pse nuk marrin pjesë dhe në cilin nivel duhen mbështetur?</p> <p> Nëse pjesëmarrësit punojnë në grupe të vogla rezultatet mund të shkëmbehen në plenare.</p>	<p style="text-align: center;">Sistemet e mbështetjes në arsim</p> <div style="text-align: center;">  </div>
<p><i>Lidhja e modelit me tre nivele me standardet (plenare)</i></p> <p> Një vështrim dhe prezantim i tre tipeve të standardeve.</p> <p> Diskutime në grup për çështjet në vijim (Sugjerim): A ka shkolla juaj kurrikulë dhe tekste mjaftueshëm fleksible që të përdoren për mësimin e gjithë nxënësve? A është shkolla dhe mjedisi mësimor i aksesueshëm dhe mundësues për të tërë nxënësit? A keni mjete dhe procedura për të marrë informacion të vlefshëm mbi arritjet e nxënësve.</p>	<p style="text-align: center;">Standardet për të siguruar të nxënësit për të gjithë</p> <p>Standardet e përmbajtjes së kurrikulës (Qëllimet dhe përmbajta e arsimit)</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Përcaktimi i njohurive, koncepteve dhe aftësive që nxënësit duhet të fitojnë në secilën klasë ose në fund të shkollimit të tyre. ■ Libra të përshtatshëm, materiale stimuluese të të nxënësit, dhe detyra të mirë-përcaktuara si mjete për të arritur kompetencën e parashikuar. <p>Mundësi për të mësuar standardet (Shërbim, shkolla dhe profesionistë)</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Përcaktimi i kushteve që promovojnë pjesëmarrjen dhe të nxënësit e nxënësve. ■ Shkolla të aksesueshme, përgatitje të të nxënësit, menaxhimi i klasës, grupim fleksibël, dhe bashkëpunim si mjete për të krijuar mjedise lehtësuese për të nxënësit. <p>Standardet e performancës së nxënësit (Fëmijë, të rinj dhe familjet e tyre)</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Përcaktimi i nivelit të ekspertizës, lloji i aftësive dhe kompetencave që nxënësit duhet të jenë të aftë t'i performojnë në secilën klasë ose në fund të shkollimit të tyre. ■ Vëzhgim, teste dhe procedura vlerësimesh të gatshme për të tërhequr njohuri dhe aftësi të përshtatshme si mjete për të vlerësuar performancën.

Lidhja e modelit me tre nivele me aktivitetin e mësuesit (plenare)




Trajnuesi duhet të mbështesë pjesëmarrësit të reflektojnë mbi atë se ku kanë nevojë të marrin pjesë. Çfarë duhet të sjellin mësuesit në punë (njohuri, aftësi, qëndrime)? Si duhet që përmbajtja e arsimit të prezantohet dhe të jetë e dobishme? Si duhen paraqitur objektivat e arsimit për të ndihmuar veprimet direkte të mësuesve? Cilat strategji duhen aplikuar? Për cilin nivel mbështetje apo ose mjedis mundësues keni nevojë?



Diskutime në grup për të tre komponentët e pjesëmarrjes por tani fokusi te mësuesi.

Aktiviteti i mësuesit



Ka tre elementë të njëjtë të pjesëmarrjes së mësuesve:

Kompetenca – Autonomia ose Pavarësia – Bashkësia ose Përkatësia

Aktiviteti 1.4.4: Reflektim i mbështetjes për të gjithë nxënësit në shkollat e pjesëmarrësve.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Reflektim mbi situatën e mbështetjes në mjediset e shkollave të pjesëmarrësve.
- Pjesëmarrësit sqarojnë kuptimin e tyre dhe u jepet një mundësi të bëjnë pyetje.

Fokusi i Aktivitetit:

Shkollat e tyre dhe situata në punë

Materiale dhe Metoda:

“Flipchart” dhe stilolapsa

Informacion shtesë/alternativa:

Informacion për trajnuesin:

Ky aktivitet është ideuar për mësuesit në institucionet arsimore. Nëse pjesëmarrësit në trajnim punojnë në institucione të tjera, ata është më mirë të shqyrtojnë mjedisin e tyre sesa të mendojnë se çfarë mësuesit dhe shkollat duhet të bëjnë. Këto udhëzime duhet të përshtaten sipas rastit. Ky aktivitet mbledh së bashku komponentët e ndryshëm të kësaj teme. Pyetjet janë të organizuara për komponentë të ndryshëm të Modelit të Teorisë së Aktivitetit.

Sekuena e Aktivitetit

Transferimi në mjedisin e shkollës tuaj

Si është situata në shkollën tuaj duke përsa i përket mbështetjes të të gjithë nxënësve? Çfarë mendon se do të ishte një tjetër hap i mirë për shkollën tuaj për t’i mbështetur më shumë nxënësit? Çfarë do t’i ndihmonte nxënësit, prindërit dhe komunitetin për të mbështetur të nxënit dhe pjesëmarrjen? Çfarë mendoni se është e rëndësishme për t’u transmetuar kolegëve tuaj në mënyrë që shkolla juaj të ndërmerë këto veprime?

- Çfarë qëllimesh keni? Çfarë doni të arrini?
- Cilat ide, teori dhe përmbajtje janë të rëndësishme dhe pse?
- Cilat metoda ose mjete do të donit të përdornit?
- Në cilat mjedise ose kontekste do të planifikonit aktivitete - dhe çfarë aktivitete do të planifikonit?

Tema 1.5:

Puna me të tjerët

Vështrim i përgjithshëm i Temës 1.5

Qëllimi i temës

- Konsideroni gjithëpërfshirjen e komunitetit dhe shkollës tuaj dhe përdoreni këtë informacion për të marrë veprime
- Ndërtoni një vizion të arsimit gjithëpërfshirës, kështu që mund të planifikoni veprimet me kolegët tuaj, nxënësit, prindërit, ose komunitetin.
- Rishikimi i përmbajtjes së modulit.
- Identifikoni nevojat për më shumë informacion ose sqarime.

Trajnuesi mund të mos paraqesë vetëm objektivat dhe synimet e temës, por edhe mund t'ju kërkojë pjesëmarrësve të shkruajnë pyetjet që ata kanë në lidhje me përmbajtjen dhe objektivat e temës. Këto pyetje mund të përdoren nga pjesëmarrësit kur këto çështje do të adresohen përgjatë trajnimit. Në fund të çdo teme, trajnuesi mund të pyesë nëse të gjitha pyetjet u adresuan.

Vështrim. Aktivitetet

Aktiviteti 1.5.1: Puna me familjet dhe komunitetin

Aktiviteti 1.5.2: Punojmë së bashku në shkolla

Aktiviteti 1.5.3: Krijimi i një vizioni të përbashkët për "Arsimin gjithëpërfshirës në shkollat tuaja"

Aktiviteti 1.5.1: Puna me familjet dhe komunitetin.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Sjellja e familjes dhe komunitetit në vëmendjen e pjesëmarrësve.
- Krijimi i lidhjeve midis aktivitetit të cikleve të përfshirjes dhe punës së pjesëmarrësve.
- Krijimi i një kuptimi të përbashkët të përgjegjësisë së shkollave përsa i përket komunitetit.

Fokusi i Aktivitetit:

Rezultatet nga Aktiviteti 1.1.3 "Ciklet e gjithëpërfshirjes"

Komuniteti dhe shoqëria (në nivel kombëtar dhe rajonal)

Materialet dhe Metodot:

"Flipcharts" dhe stilolapsat nëse grupet raportojnë në sesion plenar. Reflektim dhe diskutim

Informacion shtesë/alternativa:




Udhëzime mbi pjesëmarrjen e familjes dhe komunitetit, p.sh <http://www.seidl.org/ws/ws-fam-comm.pdf>

Informacion për trajnuesin:

Ky aktivitet trajton mendimet, diskutimet, rezultatet dhe produktet e zhvilluara në aktivitetin 1.1.3 “Ciklet e Gjithëpërfshirjes,” me fokus të veçantë mbi mendimet të lidhura me komunitetin e vetë pjesëmarrësve.

Pyetjet në slajd ndihmojnë pjesëmarrësit të adresojnë çështje të lidhura me komponentë të ndryshëm të Modelit të Sistemit të Aktivitetit. Kjo duhet të lehtësojë zhvillimin e strategjive koherente për të përmirësuar bashkëpunimin me prindërit në një fazë të mëvonshme. (moduli 2).

Sekuena e Aktivitetit

Prezantim me punën me familjet (plenare).	Puna me prindërit dhe familjet në komunitet
 <p>Ofrohet një vështrim dhe prezantim për detyrën për të shqyrtuar mjedisin social ose komunitetin në të cilin ndodhet shkolla. Po qe e mundur, grupet e vogla të organizohen në grupe nga e njëjta shkollë (komunitet ose vend). Grupet punojnë në çështjet e ofruara në slajd.</p>  <p>Trajnuesi duhet të përfshijë grupet e vogla në debat për të parë nëse konceptet e paraqitura në këtë modul janë kuptuar.</p>  <p>Trajnuesi duhet të vendosi nëse dhe si duhen raportuar rezultatet në sesion plenar.</p>	<p>Kthehuni te ushtrimi «Rrathët e gjithëpërfshirjes» dhe reflektoni mbi rezultatet duke marrë parasysh mbështetjen e gjithëpërfshirjes në shoqëri dhe komunitet: Cila është situata aktuale?</p> <p>Cili mendoni se do të ishte një tjetër hap i mire për ta përmirësuar këtë situatë?</p> <p>Çfarë mendoni se është e rëndësishme për t’ua transmetuar kolegëve tuaj në mënyrë që shkolla juaj të ndërmarrë këto veprime?</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Çfarë qëllimesh keni? Çfarë do të dëshironit të arrini? ■ Cilat ide, teori dhe përmbajtje janë të rëndësishme dhe pse? ■ Cilat metoda dhe mjete do të dëshironit të përdornit? ■ Në cilin mjedis ose kontekst do t’i planifikonit këto aktivitete — dhe çfarë aktivitete do të planifikonit?

Aktiviteti 1.5.2: Punojmë së bashku në shkolla.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Ndhmon pjesëmarrësit të fokusohen në marrëdhëniet me shkollën.
- Krijon lidhjet midis aktivitetit 1.1.4 (Përfshirja dhe përjashtimi në institucione) dhe punës së pjesëmarrësve.
- Krijimi i një kuptimi të përbashkët i përgjegjësisë në shkolla përsa i përket mundësimit të mjediseve ku mësohet.

Fokusi i Aktivitetit:

Klasat dhe shkolla e pjesëmarrësve (mundësitë edhe politikat)

Materialet dhe Metodat:

“Flipcharts” dhe stilolapsa nëse grupet raportojnë në plenare
Reflektim, dhe diskutim




Informacion shtesë/alternativa:

Informacion për trajnuesin:

Ky aktivitet trajton mendimet, diskutimet, rezultatet, dhe produktet e zhvilluara në aktivitetin 1.1.4 “Përfshirja dhe përjashtimi në institucione për të reflektuar situatën në shkolla” me fokus të veçantë në mendimet e lidhura me shkollat e vetë pjesëmarrësve.

Pyetjet në slajd duhet të ndihmojnë pjesëmarrësit të trajtojnë çështjet e lidhura me komponentë të ndryshëm të Modelit të Sistemit të Aktivitetit. Kjo duhet të lehtësojë zhvillimin e strategjive koherente për të përmirësuar bashkëpunimin me kolegët dhe autoritetet brenda sistemit arsimor. (shiko modulën 2).

Sekuena e aktivitetit

<i>Prezantim i aktivitetit (plenare)</i>	Puna me të tjerët në shkollë
 <p>Ofrohet një vështrim dhe prezantim për detyrën për të konsideruar shkollën si një sistem aktiviteti që mund të analizohet dhe zhvillohet duke u bërë më gjithëpërfshirëse.</p>  <p>Po qe e mundur, grupet e vogla të organizohen në grupe nga e njëjta shkollë (komunitet ose vend). Grupet punojnë në çështjet e ofruara në slajd. Trajnuesi duhet të përfshijë grupet e vogla në debat për të parë nëse konceptet e paraqitura në këtë modul janë kuptuar.</p>  <p>Trajneri duhet të vendos nëse rezultatet duhen raportuar në sesion plenar dhe nëse po, si. Pjesëmarrësve duhet t'u jepet një mundësi të bëjnë pyetje rreth përmbajtjes së temës.</p>	<p>Kthehuni te aktiviteti «Shkolla si një institucion» dhe reflektoni mbi rezultatet duke marrë parasysh të punuarit sëbashku: Cila është situata aktuale?</p> <p>Cili mendoni se do të ishte një tjetër hap i mirë për ta përmirësuar këtë situatë?</p> <p>Çfarë mendoni se është e rëndësishme për t'ua transmetuar kolegëve tuaj në mënyrë që shkolla juaj të ndër marrë këto veprime?</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Çfarë qëllimesh keni? Çfarë do të dëshironit të arrini? ■ Cilat ide, teori dhe përmbajtje janë të rëndësishme dhe pse? ■ Cilat metoda dhe mjete do të dëshironit të përdornit? ■ Në cilin mjedis ose kontekst do t'i planifikonit këto aktivitete — dhe çfarë aktivitete do të planifikonit?

Aktiviteti 1.5.3: Krijimi i një vizioni të përbashkët “Arsimi gjithëpërfshirës në shkollat tuaja”

Vështrim i Përgjithshëm

Qëllimi:

- Tu ofrojë pjesëmarrësve eksperiencën e krijimit të një vizioni të përbashkët për arsimin gjithëpërfshirës që mund të përdoret për të zhvilluar një vizion të tillë në shkollat e tyre.
- Të ndihmojnë pjesëmarrësit të bëjnë kalimin nga fokusimi te nxënësi te puna e tyre.
- Krijimi i mundësive kuptim plotë për të riparuar përmbajtjen e këtij moduli.

Fokusi i Aktivitetit:

Vizioni arsimi gjithëpërfshirës për individët (shikoni aktivitetin 1.1.1: Lumi i Jetës) të përditësohet në një përpjekje në grup. Konteksti i vizionit në modelin e sistemit të aktivitetit. Përmbajtjet e modulit dhe si ato mund të përdoren në mjedise shkollore.

Materialet dhe Metodat:

“Flipcharts” dhe stilolapsat nëse grupet raportojnë në sesion plenar.
Reflektim dhe diskutim.

Informacion / alternativa shpesh:

Indeksi për gjithëpërfshirjen

Informacion për trajnuesin:

Ka shumë qasje të larmishme për gjithëpërfshirjen dhe kuptime të ndryshme të asaj se çfarë është arsimi gjithëpërfshirës. Kyçi për të qenë në gjendje të punojmë së bashku drejt arsimi gjithëpërfshirës është zhvillimi i një vizioni të përbashkët. Ky aktivitet ndërtohet mbi produktin e “Lumit të Jetës”, ku fillimisht




vizioni i arsimit gjithëpërfshirës u zhvillua. Ky vizion i pastrukturuar po zhvillohet më tej. Ky proces është i rëndësishëm në eksperiencën e tyre të përditshme sepse do t'i lejoj pjesëmarrësit të organizojnë aktivitete të ngjashme në shkollat e tyre.

Një vizion i përbashkët do të thotë një synim i përbashkët, i kuptuar të përbashkëti çështjeve që kanë nevojë të adresohen, i njëjti këndvështrim për mjetete që duhen përdorur dhe mendim i përbashkët për atëqë duhet të ndryshohet në mjediset ose kontekstet sociale dhe fizike. Çështje të lidhura me Modelin e Teorisë së Aktivitetit udhëheqin diskutimet në grupe gjatë trajnimit por mund të përdoren nga pjesëmarrësit në mjediset e tyre shkollore për të diskutuar çështjet me kolegët e tyre. Ky model ndihmon për hartëzimin e mënyrës së të kuptuarit të arsimit gjithëpërfshirës, si dhe për zhvillimin e një bashkëpunimi me një vizion më koherent, me fokus çështjen e të drejtave njerëzore.

Rëndësia që i jepet këtij ushtrimi do të varet nga qëllimi i zhvillimit të trajnimit. Nëse trajnimi ofrohet në kontekstin e një projekti të madh për t'i bërë shkollat dhe komunitetet më gjithëpërfshirëse, apo nëse pjesëmarrësit kanë për detyrë të transferojnë njohurinë nga trajnimi në shkollat e tyre.

Ka shumë mjete dhe publikime që ofrojnë vizione të arsimit gjithëpërfshirës dhe ofrimi i udhëzimeve për shkollat që të bëhen më gjithëpërfshirëse. Një mjet i përdorur gjerësisht është indeksi për gjithëpërfshirje. Trajnuesi mund të prezantojë mjete të ndryshme që shkollat të bëhen më gjithëpërfshirëse.

Sekuena e aktivitetit

<p><i>Prezantim i transferimit të aktivitetit (plenare)</i></p>  <p>Një vështrim dhe prezantim ofrohet për detyrën për të konsideruar mejdiset shkollore të pjesëmarrësve.</p>  <p>Po qe e mundur, grupet e vogla të organizohen në grupe nga e njëjta shkollë (komunitet ose vend). Grupet punojnë në çështjet e ofruara në slajd. Trajnuesi duhet të përfshij grupet e vogla në debat për të parë nëse konceptet e paraqitura në këtë modul janë kuptuar</p>  <p>Trajnuesi duhet të vendosë nëse rezultatet duhen raportuar në sesion plenar dhe nëse po si do të ndodhë. Pjesëmarrësve duhet t'u jepet një mundësi të bëjnë pyetje rreth përmbajtjes së temës.</p>	<p>Një vizion i ndarë me të tjerët për shkollën gjithëpërfshirëse</p> <p>“Arsimi gjithëpërfshirës është një proces që synon të kapërcejë barrierat e të nxënit dhe pjesëmarrjes. Ai kërkon forcimin e kapaciteteve për të siguruar se sistemet e arsimit janë të gatshme për t’iu përgjigjur diversitetit dhe për të arritur rezultatet domethënëse të të nxënit për të gjithë fëmijët.” Ky është një nga përkufizimet e mundshme për arsimin gjithëpërfshirës, por nuk është një vizion. Krijoni vizionin tuaj për shkollën gjithëpërfshirëse duke marrë parasysh:</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Të ardhmen e dëshiruar për shkollën, aspiratat dhe qëllimet tuaja; ■ Vlerat dhe identitetin bazë të shkollës suaj, kush jeni dhe kush po përpiqeni të bëheni; ■ Strategjinë e shkollës suaj dhe mënyrën e të punuarit dhe bashkëpunimit; ■ Mjedisin e shkollës suaj dhe çfarë ju dëshironi të arrini sëbashku me komunitetin. <p>Mendoni për mënyra nëpërmjet të cilave ju mund të zhvilloni një vizion që orienton praktikën!</p>
---	--

Modulet ToT për arsimin gjithëpërfshirës

Moduli 2:

**Punojmë së bashku për të krijuar
shkolla gjithëpërfshirëse**

Hyrje

Deklaratë për qëllimin

Moduli 2 fokusohet në marrëdhëniet dhe në mënyrën se si ato mund të krijohen për të promovuar arsimin gjithëpërfshirës në shkolla dhe komunitete. Duke u fokusuar drejtpërdrejtë në atë se çfarë pjesëmarrësit bëjnë apo nuk bëjnë, është nga ana emocionale më sfiduesja nga të tre modulet. Pjesëmarrësit duhet të kenë dëshirë të reflektojnë mbi mënyrat e tyre të ndërveprimit, për shembull mbi mungesën e mundshme të marrëdhënieve të vërteta me kolegët dhe familjet si dhe pasojat e këtyre praktikave mbi të tjerët.

Fokusi i këtij moduli nuk është në konceptet e komunikimit dhe mënyrat e ndërveprimit dhe nuk ofron trajnim për komunikimin ose të mësojë aftësitë për marrëdhëniet. Koha e caktuar për modulet nuk është e mjaftueshme për ndërtimin e kapaciteteve ose zhvillimin e kompetencave. Moduli nënvizon nevojën për këto dhe ofron mundësitë për të reflektuar mbi aftësitë e pjesëmarrësve dhe njohuritë në këtë fushë. Duke përdorur mjetet që pjesëmarrësit mund të përdorin me të tjerët, ndihmon për të filluar proceset e nevojshme për ndryshim në shkolla dhe komunitete.

Vështrim i përgjithshëm

Moduli i 2-të ka të bëjë me pjesëmarrësit, kuptimin e rëndësisë së marrëdhënieve, punës së përbashkët dhe ndarjes së eksperiencave. Moduli synon t'i bëjë të dukshme marrëdhëniet aktuale profesionale për të lehtësuar reflektimin dhe shkëmbimin e praktikave aktuale të bashkëpunimit. Ai fillon me një veprimtari, "Më dëgjo mua" që ofron një përvojë të efektit të dikujt që nuk dëgjon atë që dikush tjetër i thotë. Ky ushtrim ndiqet nga rasti studimor i Siborës dhe familjes së saj për të ilustruar stilin e komunikimit të papërshtatshëm që mbizotëron akoma në shumë shkolla kur flasim me familjet që vijnë nga minoritetet. Për më shumë informacion midis profesionistëve dhe se si të përfshijnë prindërit dhe familjet për arsimin gjithëpërfshirës, shikoni Publikimin 12 dhe 13 të Serisë së UNICEF-it *A Rights-Based Approach to Inclusive Education for Children with Disabilities*.

Një nga aktivitetet më të rëndësishme në këtë modul është zhvillimi i një harte bashkëpunimi. Rrjeti i marrëdhënieve bashkëpunuese paraqitet vizualisht dhe dokumentohet për referenca të mëtejshme. Harta e bashkëpunimit është një mjet i rëndësishëm për të reflektuar mbi marrëdhëniet. Marrëdhëniet më të rëndësishme analizohen duke përdorur pyetje që na ndihmojnë ne në ciklin e zgjidhjes së problemit. Modeli i teorisë së aktivitetit dhe cikli i zgjidhjes së problemit janë mjete të rëndësishme për të analizuar natyrën dhe qëllimin e bashkëpunimit me të tjerët. Formate të të dyja modeleve ofrohen në faza të ndryshme në modul, për t'u përdorur nga pjesëmarrësit. Pritshmëria është që ata, më vonë, të jenë në gjendje të përdorin këto modele kur përballen me probleme dhe të analizojnë aktivitetet në mjediset e tyre të punës.

Nëse mësuesit dhe profesionistët e tjerë në shkolla duhet të punojnë së bashku për të promovuar pjesëmarrjen për të gjithë fëmijët, është e rëndësishme që ata të jenë në gjendje të zhvillojnë një kuptim të përbashkët të kufizimeve të pjesëmarrjes. Pjesëmarrësit në modul kalojnë nëpërmjet një sërë aktivitetesh për të analizuar fillimisht kufizimet në pjesëmarrje, the pastaj t'i eksplorojnë ato duke synuar të planifikojnë ndryshime që do

të lejojnë fëmijën të marrë pjesë. Tema 2 është mbase më sfiduesja, dhe trajnuesi mund të vendosë të bëjë disa ushtrime të shkurtra midis aktiviteteve për t'i ç'tendosur pjesëmarrësit (p.sh, gjimnastikë, këngë – dikush nga grupi mund të ketë ide të tjera). Kjo përfundon duke bërë bashkë rezultatet nga grupe të ndryshme, ku secili grup ka zhvilluar strategji për të promovuar pjesëmarrjen sipas perspektivave të zhvillimit, kurrikulës, shëndetit, dhe marrëdhënieve (të paraqitura në modulin e 1-rë).

Tema 3 prek një nga këto katër perspektiva (shëndetësore) dhe prezanton kornizë dhe gjuhë të përbashkët të përdorur nga prindërit, mësuesit, dhe profesionistët e tjerë me sfond mjekësor dhe social. Moduli përdor 3 raste të njerëzve me sindromën "Down" të cilët jetojnë në rrethana të ndryshme, kanë aftësi të ndryshme dhe si rrjedhojë mbështetja ka nevojë të eksplorojë nevojën e të menduarit të "aftësisë së kufizuar" nga një perspektivë e re. Perspektiva shëndetësore është zgjedhur sepse është përgjithësisht më e hasura në shkolla dhe ka më shumë nevojë për një ri-mendim. Për më shumë informacion mbi përdorimin e perspektivës së shëndetësore, shikoni Publikimin 2 të Serisë së UNICEF-it [*A Rights-Based Approach to Inclusive Education for Children with Disabilities*](#).

Ky modul përfundon me fokusin në marrëdhëniet bashkëpunuese, veçanërisht në termat e gjithëpërfshirjes dhe se cili mund të jetë qëllimi në shkolla. Pjesëmarrësit ftohen të reflektojnë mbi marrëdhëniet e tyre të tanishme dhe mbi atë se çfarë duhet të ndryshojë apo të zhvillohet që çdo përpjekje e përbashkët e të gjithë aktorëve të synojë drejt arsimit gjithëpërfshirës. Ky modul përfundon me ndarjen e ideve dhe vizionit sesi kjo mund të arrihet. Përsëri, Publikimet 12 dhe 13 të Serisë së UNICEF-it [*A Rights-Based Approach to Inclusive Education for Children with Disabilities*](#) janë veçanërisht të përshtatshme për lexime të mëtejshme mbi këtë temë.

Pjesëmarrësit

Trajnimiti do të jetë i suksesshëm vetëm nëse ja del të trajtojë njohuritë, përvojat dhe besimet që pjesëmarrësit sjellin në trajnim. Moduli duhet t'i lejojë pjesëmarrësit të bëhen agjentë për arsimin gjithëpërfshirës në punën e tyre. Kjo kërkon mundësi për të reflektuar mbi situatat e tyre dhe të krijojnë lidhje midis përmbajtjeve të modulit dhe hapave të tyre.

Trajnuesi duhet të dijë sa më shumë që të jetë e mundur rreth situatës së pjesëmarrësve përpara se të fillojnë modulin. Kjo do të bëjë ndryshim ku ata janë aktualisht në zhvillimin e tyre profesional: a janë ata nxënës-mësues, a janë mësues të rinj apo me përvojë? A janë ata mësues edukatorë apo mësues këshillues? Diversiteti në "formimin" e pjesëmarrësve mund të përdoret në mënyrë të përshtatshme duke mundësuar mësimin midis pjesëmarrësve dhe inkurajimin e tyre. Kjo krijon një mundësi për të zbatuar parimet e arsimit gjithëpërfshirës.

Mund të mendohet edhe për mënyrat sipas të cilave pjesëmarrësit mund të mbështeten në mësimin personal të tyre. Ka mjete të ndryshme që mund të përdoren për ta bërë mësimin të dukshëm (p.sh, të zhvillojë një portofol ose ditar për mësimet).

Mjedisi lejues

Situatat e krijuara gjatë trajnimit duhet të lehtësojnë shkëmbimin, diskutimet, dokumentimin e mendimeve, pritshmëritë, dhe idetë. Në vetvete duhet të promovojnë ide dhe parime të arsimit gjithëpërfshirës duke vlerësuar eksperiencat e ndryshme që pjesëmarrësit sjellin në trajnim duke mundësuar mësimin individual dhe duke krijuar një atmosferë bashkëpunuese.

Modulet janë të bazuara në aktivitete sepse ata kërkojnë të mbështesin trajnuesin në krijimin e mundësive për të mësuar. Pjesëmarrësit duhet të japin disa kontribute kështu që ata mund të mbështeten në njohuri për të marrë pjesë dhe për të bashkëpunuar. Mjedisi mësimor i krijuar nga trajnuesi duhet të mundësojë mësimin aktiv dhe jo thjesht të përcjellë informacion që gjendet kudo.

Që të mundësohet të nxënit, është e rëndësishme që, trajnuesi të sigurohet se të nxënit është bërë i dukshëm. Modulet ofrojnë sugjerime se si kjo mund të bëhet për aktivitete individuale, por trajnuesi duhet të japë disa mendime për të dokumentuar mësimin nga pjesëmarrësit, duke mbajtur shënime për rezultatet e rëndësishme që vijnë nga diskutimet ose puna individuale, dhe të lehtësojë transferimin në mjediset e punës së pjesëmarrësve.

Trajnuesi duhet të jetë më efektiv dhe të bëjë të mundur krijimin e lidhjeve midis situatave trajnuese dhe situatës së punës aktuale. Kjo mund të arrihet ose duke e përfshirë/inkorporuar modulën në projekt të plotë ose nëpërmjet aktivitetit që kërkon të promovojë arsimin gjithëpërfshirës në shkollë ose komunitet. Nëse modulet e trajnimit kombinohen me punë zhvillimore, praktika tregon që mund të rrisë përvetësimin e moduleve. Aktivitetet në këtë modul mund të shtrihen në punë praktike në shkollë.

Pjesëmarrësit do të jenë më të motivuar nëse pjesëmarrja në module i shërben qëllimeve të shumta. Për shembull, fakti nëse modulet janë të akredituara nga Ministria e Arsimit dhe kontributi drejt përbushjes së zhvillimit profesional ose kualifikimeve, do të jetë një faktor motivues për të plotësuar modulet.

Si t'i përqasemi modulit

Trajnuesit duhet të jenë në të njëjtën linjë me përmbajtjet dhe konceptet e këtij moduli. Kjo arrihet më mirë nëse do të ishin aktivisht të përfshirë si nxënës. Nëse trajnuesi nuk bie dakord për disa nga aktivitetet, ai/ajo mund të konsiderojë aktivitete alternative që i shërbejnë të njëjtit qëllim.

Konceptet e prezantuar në këtë modul nuk janë gjëra për t'u mësuar, por për t'u përdorur. Kuptimi konceptual do të thellohet nëpërmjet aplikimit të këtyre koncepteve në situata praktike. Konceptet duhen parë si mjete për të menduar dhe orientuar hapat, dhe jo si diçka për të mësuar një pjesë të izoluar të njohurive. Prandaj, prezantimi teorik i koncepteve duhet të ketë një hapësirë kohore të limituar, në mënyrë që të ketë mundësi të mjaftueshme për mendimin aktiv dhe zgjidhjen e problemeve.

Për t'i ndihmuar pjesëmarrësit të orientohen, është e rëndësishme të hidhet një vështrim i përgjithshëm mbi modulet dhe temat dhe më pas të krijohen mundësi për t'i rishikuar ato. Prandaj, koha duhet harxhuar për të prezantuar qëllimet dhe objektivat e temës. Megjithatë kjo nuk është parë si aktivitet, duhet të jetë fokusi në fillim të trajnimit. Qëllimet e listuara për çdo njësi duhen të ndahen me pjesëmarrësit. Ato mund të përdoren për të pasur një vështrim të përgjithshëm dhe për të riparë temat dhe modulet.

Produktet e zhvilluara nga pjesëmarrësit duhet të jenë kuptimplota, sepse mund të përdoren përsëri gjatë trajnimit. Megjithatë dobishmëria e këtyre produkteve do të varet nga cilësia e tyre, trajnuesi duhet të vendosë si t'i përdorë ato.

Tema 2.1: Përdorimi i komunikimit për të vendosur marrëdhënie pune.

Vështrim i përgjithshëm i Temës 2.1

Qëllimi i temës

- Reflektim mbi rëndësinë e komunikimit për marrëdhëniet njerëzore;
- Zhvillimi i një harte të marrëdhënieve aktuale profesionale;
- Kuptimi i komunikimit si një aktivitet i përbashkët;
- Fokusim mbi bashkëpunimin për pjesëmarrjen.

Trajnuesit mund të mos paraqesin vetëm objektivat dhe synimet e temës, por edhe mund t'ju kërkojnë pjesëmarrësve të shkruajnë pyetjet që ata kanë në lidhje me përmbajtjen dhe objektivat e temës. Këto pyetje mund të përdoren nga pjesëmarrësit të pyesin kur këto çështje do të adresohen në trajnim. Në fund të çdo teme, trajnuesi mund të pyesë nëse të gjitha pyetjet u adresuan.

Vështrim i Aktiviteteve

Aktiviteti 2.1.1: Ushtrimi “Më dëgjo mua”;

Aktiviteti 2.1.2: Rast studimor “Floriana dhe prindërit e saj”;

Aktiviteti 2.1.3: Harta e bashkëpunimit;

Aktiviteti 2.1.4: Analiza e marrëdhënieve;

Aktiviteti 2.1.5: Bashkëpunim për pjesëmarrje.

Aktiviteti 2.1.1: Ushtrimi “Më dëgjo mua”

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Informim mbi rëndësinë e komunikimit për marrëdhëniet njerëzore;
- Njohja e karakteristikave dhe të qenit dëgjues i mirë;
- Provo ndikimin e dëgjimit ose mos dëgjimit.

Fokusi i aktivitetit:

Eksperiencat pozitive të tejkalimit të vështirësive në punë (t'i shpjegohen partnerit);

Eksperiencia vetjake kur të tjerët nuk të dëgjojnë;

Kuptimi i komunikimit.

Materialet dhe Metodot:

- Udhëzime në slajd, “Flipchart” (për karakteristikat e dëgjuesit të mirë/keq);
- Introspeksion dhe diskutim.

Informacione / alternativa shtesë:

http://www.aucklandchamber.co.nz/media/88059/communication_exercise_listentome.pdf






Informacion për trajnuesin

Moduli fillon me një ushtrim që fokusohet në rëndësinë e komunikimit dhe lejon pjesëmarrësit të provojnë se si ndjehen kur personi tjetër nuk të dëgjon. Kjo është një përvojë që prindërit dhe fëmijët (veçanërisht kur fëmijët kanë vështirësi) kanë shpesh kur ndërveprojnë me mësuesit ose profesionistë të tjerë. Kjo kërkon që pjesëmarrësit të reflektojnë mbi përvojat dhe ndjenjat e tyre, që është një cilësi e rëndësishme për të bashkëpunuar efektivisht me të tjerët.

Ky aktivitet ofron një mundësi për tu fokusuar në përmbajtjet e modulit si edhe ndarjen e eksperiencës së punës me një person tjetër. Sidoqoftë, nuk ofron një rast për pjesëmarrësit që të njohin njëri-tjetrin. Nëse grupi është i ri apo nuk ka marrë pjesë në modulin 1, trajnuesi mund të konsiderojë një aktivitet që i ndihmon pjesëmarrësit të njohin njëri-tjetrin.

Lista e karakteristikave të një dëgjuesi të mirë dhe një dëgjuesi të keq, duhet t'i ofrohet pjesëmarrësve mbasi ata ta kenë hartuar së bashku. Se si bëhet, kjo varet nga metodat e zgjedhura për një dokumentim të plotë të trajnimit dhe produkteve të tij. Nëse pjesëmarrësit janë në gjendje të aksesojnë dosjet që janë online (me usb ose disk), shënimet e mbajtura nga trajnuesi duhet të fotografohen dhe të shtohen te lista e dokumenteve të mbledhur.

Sekuena e Aktivitetit

<p><i>Ushtrimi "Më dëgjo mua" (fillimisht seancë plenare, pastaj në grupe nga dy)</i></p>  <p>Thoni se pjesëmarrësit do të përfshihen në ushtrimin mbi rëndësinë e të qenit dëgjues i mirë. Ky është parakusht për komunikimin dhe komunikimi është përcaktues për marrëdhëniet.</p> <p>Ndiqni sekuencën e udhëzimeve të dhëna në slajd. Fillimisht pyesni për karakteristikat e dëgjuesve të mirë/keq. Shkruajini ato në dy kolona.</p>  <p>Jepni udhëzime për ushtrimin, kërko që pjesëmarrësit të ndahen në grupe nga dy. Nëse dikush ngelet vetëm, trajnuesi e bën ushtrimin me atë person.</p>  <p>Diskutoni rezultatet me pjesëmarrësit dhe konsideroni përvojat e tyre në komunikimin në punë, p.sh, me prindërit.</p>	<p>Rëndësia e të qenit dëgjues i mirë</p> <p>Ushtrimi „Më dëgjo mua».</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Cilat janë karakteristikat e një dëgjuesi të mirë kundrejt një dëgjuesi të keq? ■ Flisni me personin pranë jush për një përvojë pozitive që kapërcen vështirësitë në punën tuaj. Personi tjetër duhet të mbajë një qëndrim jo me interes, duke mos i'u dëgjuar me vëmendje. ■ Përsëriteni ushtrinin, këtë herë partneri duhet të përpiqet të tregojë interes dhe të dëgjojë me vëmendje. ■ Përsëriteni ushtrimin, ndërroni rolet. <p>Si u ndjetë kur po e dëgjonit me vëmendje partnerin tuaj? Si u ndjetë kur po ju dëgjonin me vëmendje? Si u ndjetë kur nuk po ju dëgjonin?</p>
<p><i>Rëndësia e komunikimit (seancë plenare)</i></p>  <p>Lexoni dhe jepni shembuj për secilën nga pikat e ngritura ose kërkonin nga pjesëmarrësit të japin shembuj.</p>  <p>Shembuj të mundshëm, shikoni shënimet në prezantim PPT.</p> <p>Diskutimet me pjesëmarrësit duhet të ndihmojnë të theksohet rëndësia e komunikimit. Komunikimi është parakusht për vendosur marrëdhënie.</p>	<p>Rëndësia e komunikimit</p> <p>Rëndësia komunikimit dhe bashkëpunimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Komunikimi është ai që na bën qenie njerezore, pa komunikim ne nuk mund të jetojmë; ■ Ne nuk mundemi të mos komunikojmë; ■ Keqkuptimet dhe pikëpamjet e e ndryshme janë normale; ■ Komunikimi i bazuar në respekt është çelësi për të luftuar diskriminimin; ■ Konfliktet zgjidhen nëpërmjet komunikimit; ■ Për të arritur diçka së bashku, ne duhet të komunikojmë. <p>Marrëdhëniet qëndrojnë në themel të gjithëpërfshirjes. Askush nuk mund ta krijojë gjithëpërfshirjen i vetëm.</p>

Aktiviteti 2.1.2: Rast studimor “Sibora dhe prindërit e saj”

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Reflektim mbi komunikimin e shkollave me prindërit;
- Reflektim mbi ndikimin që ka komunikimi mbi prindërit;
- Reflektim mbi praktikat personale të komunikimit me prindërit;
- Konsideroni praktika alternative dhe si ato mund të kontribuojnë në arsimin gjithëpërfshirës.

Fokusi i aktivitetit:

- Rast studimor që tregon praktikat e pamjaftueshme të komunikimit;
- Praktikrat e shkollave të tyre të lidhura me komunikimin me prindërit;
- Alternativat / efektive dhe komunikimi me respekt.

Materialet dhe Metodrat:

- Letër dhe laps për të punuar në rast studimor (opsionale: “flipchart” ose slajde për t’u prezantuar në plenare)
- Punë në grupe të vogla, diskutime në grup

Informacion / alternativa shesë:

Modeli i komunikimit katër-faqësh: http://en.wikipedia.org/wiki/Four-sides_model

Informacion për trajnuesin:

Puna në rastin studimor duhet të ndihmojë pjesëmarrësit të fokusohen si në atë se çfarë ndodh në incidentin e veçantë të përshkruar në rastin studimor dhe ashtu dhe në atë që ndodh në shkollat e tyre. Ky është një prezantim i parë dhe mundësi për të menduar për marrëdhëniet, reflektimin e praktikave vetjake, dhe konsiderimin e mënyrave për përmirësimin e këtyre praktikave.

Trajnuesi duhet të njohë bazat e teorisë së komunikimit për të qenë në gjendje të ndihmojë pjesëmarrësit të organizojnë përgjigjet e tyre; p.sh, trajnuesi mund të konsiderojë funksionet e komunikimit në vijim: (1) transmetimin e informacionit; (2) ushtrimin e fuqisë për të bindur të tjerët (3) shprehjen e ndjenjave; (4) ndërtimin e marrëdhënieve nëpërmjet motivimit/pritshmërive/përvojave të përbashkëta; (5) shpjegimin e saj që ndodh dhe se çfarë duhet të ndryshohet. Këto funksione reflektohen në “modelin me katër anë të komunikimit”.

Rezultati i pritshëm i këtij aktiviteti reflektohet kryesisht te pjesëmarrësit. Më shumë kohë mund të harxhohet në ndarjen e protokolleve të tanishëm të përdorur në shkolla për t’u lidhur me prindërit dhe për të përmirësuar këto protokolle duke marrë parasysh të gjitha funksionet dhe duke konsideruar situatën e prindërve.

Sekuena e Aktivitetit

Studim rasti

Prindërve të Floricas u është kërkuar të vijnë në shkollë nga drejtori, i cili mori nga mësuesi i saj mesazhin e mëposhtëm:

„Florica, ka gati gjysmë viti që tashme është në klasën e parë, por nuk është përshtatur akoma me kërkesat e klasës. Ajo është e pavëmendshme dhe nuk është e aftë të qëndrojë e qetë, të mbajë një stilolaps ose të përdorë gërshtë. Ndonjëherë, ajo vjen vonë në shkollë dhe nuk vishet në mënyrë të përshtatshme. Diçka nuk shkon mirë në shtëpinë e saj, ju lutem flisni me prindërit e saj; ata janë Romë.”

Drejtori u bën prindërve disa pyetje që lidhen me situatën e jetës së familjes, të ardhurat, punën, numrin e fëmijëve dhe për sëmundjet ose aftësi të kufizuara në familje. Më vonë, ai u jep udhëzime se çfarë të bëni.

Diskutoni qasjen për të komunikuar me prindërit për këtë studim rasti.

Si realizohen intervistat me familjet në shkollën tuaj?

Pjesëmarrja në shkolla Vëzhgime nga raporti i UNICEF-it

“Shkollat e përdorin pak komunikim e shkruar kështu që vendimmarrja dhe vendimet mund të jenë të vështira për t’u zbuluar. Ndonjëherë, prindërit marrin pjesë në aktivitete shkollore, dhe teknisht, fëmijët mund t’i shprehin pikëpamjet e tyre në shkollë. Por, në përgjithësi shkollat nuk kanë mekanizma që i nxitin prindërit dhe fëmijët t’i shprehin opinionet e tyre dhe të marrin pjesë në shkollë. Fëmijët nuk janë trajnuar me mënyra demokratike për shprehjen e opinionëve të tyre, dhe shpesh mësuesit i ndëshkojnë nxënësit që mendohen se kanë shprehur pikëpamje negative.” (2009)

Si është situata në vendin, komunitetin ose shkollën tuaj?

Pse është i rëndësishëm bashkëpunimi për arsimin gjithëpërfshirës?

Të shohim pas dhe përpara

Reflektimi mbi modulën e fundit.

- A janë përmendur «përmirësimi i marrëdhënies» ose «përmirësimi i bashkëpunimit» s’i rezultate që ju do të donit arninit në ushtrimin «Lumi i jetes»?
- Çfarë rëndësie ka bashkëpunimi për vizionin e arsimit gjithëpërfshirës:

Perspektivat mbi bashkëpunimin dhe komunikimin:

- Perspektiva personale: Krijimi i marrëdhënieve përmes ndërveprimit dhe komunikimit;
- Institucione dhe komunitete: Kontributi për shoqërinë përmes roleve profesionale dhe sociale të ndërlidhura.





Tabela e palexueshme ne word				



Aktiviteti 2.1.3: Harta e bashkëpunimit

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Vështrim i të gjitha marrëdhënieve që janë të rëndësishme për punën e pjesëmarrësve;
- Reflektim mbi natyrën e marrëdhënieve dhe rëndësinë e tyre për praktikën e pjesëmarrësve;
- Prezantim vizual i marrëdhënieve dhe rëndësia e tyre.

Fokusi i Aktivitetit:

- Marrëdhëniet profesionale personale;
- Proceset në shoqëri dhe institucione që kontribuojnë në gjithëpërfshirjen dhe përjashtimin

Materialet dhe Metodat:

- Letër dhe laps, letra ngjitëse, “flipchart”, stilolapsa.
- Zhvillim idesh individualisht ose në grupe të vogla (shiko informacionin për trajnuesin).

Informacion / alternativa shtesë:

Qasje për t’i bërë marrëdhëniet e punës të dukshme ose hartëzimi i bashkëpunimeve që mund të zgjidhen.





Informacion për trajnuesin:


Pjesëmarrësit mund të punojnë në grupe nëse ata punojnë në të njëjtën shkollë ose mjedise të tjera sepse në këtë rast ata do të ndajnë të njëjtat marrëdhënie profesionale. Nëse pjesëmarrësit vijnë nga shkolla të ndryshme puna duhet bërë individualisht.

Zhvillimi i një paraqitjeje grafike është hapi i parë i nevojshëm për të menduar rreth marrëdhënieve në punë mbi qëllimin e tyre, cilësinë, dhe ndikimin në praktikat vetjake. Hartëzimi i marrëdhënieve profesionale të dikujt i bën burimet njerëzore të dukshme tek të tjerët. Pjesëmarrësit bëhen të vetëdijshëm se kë ata perceptojnë si “margjinal” dhe kanë mundësinë të reflektojnë mbi praktikat e tyre. Pjesëmarrësve u jepet mundësia të konsiderojnë rëndësinë e marrëdhënieve të tyre dhe të ri-shqyrtojnë pikëpamjet e tyre bazuar në atë se çfarë thonë të tjerët dhe kjo njihet të jetë një praktikë e mirë në kontekstin e arsimit gjithëpërfshirës. Dhënia e një mundësie për pjesëmarrësit për të reflektuar mbi praktikat e tyre është themelore për zhvillimin e mjeteve logjike që mësuesit duhet të krijojnë për mjediset mundësuese për të gjithë nxënësit. Krijimi i hartave të bashkëpunimit është një aktivitet që ata mund ta bëjnë me kolegët e tyre si bazë për të diskutuar ndryshimet e nevojshme.

Produktet ose rezultatet nga ky aktivitet do të përdoren përsëri në temat 3 dhe 4. Sa më i mirë të jetë dokumentimi i rezultateve, aq më efektive do të jetë. Produktet e këtij aktiviteti do t'i japin trajnuesit disa tregues se ku janë pjesëmarrësit me mendimet e tyre dhe se sa janë në gjendje të përfaqësojnë marrëdhëniet me të cilat punojnë.

Sekuena e aktivitetit

<p><i>“Harta e bashkëpunimit” (seancë plenare)</i></p>  <p>Trajnuesi bën një prezantim të shkurtër për të shpjeguar aktivitetin. Tregojuni pjesëmarrësve se produkti i këtij ushtrimi do të përdoret përsëri: cilësia e punës që bëjnë do të ndikojë pjesëmarrjen në aktivitetet në të ardhmen. Shembujt e ofruar në slajdet në vijim duhet të ndihmojnë pjesëmarrësit të krijojnë një vizion dhe të imagjinojnë sesi produkti i tyre do të duket. Trajnuesi mund të dojë të japë shembujt e tij.</p>  <p>Pjesëmarrësit zhvillojnë ide vetëm ose në grupe të vogla duke shkruar çfarë u vjen ndërmend. Rrjedhimisht, ata vendosin letrat në flipchart dhe vizatojnë vija për të bërë rrjetin.</p>  <p>Pjesëmarrësit ua paraqesin hartat e tyre të bashkëpunimit grupeve të tjera.</p>	<p style="text-align: center;">Harta e bashkëpunimit</p> <p>Krijoni një hartë për të gjitha marrëdhëniet tuaja profesionale!</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Me kë ndërveproni dhe bashkëpunoni në punën tuaj? 2. Shkruani emrin e secilit person së bashku me rolin ose pozicionin profesional (p.sh.: punonjës social, nxënës, drejtor, inspektor). Përdorni shënime me ngjites ose karta të vogla. 3. Krahasoni emrat me koleget tuaj nga e njëjta shkollë: Kush është përmendur nga të gjithë dhe kush është përmendur nga disa? A keni harruar që të gjithë ndonjë person? 4. Rregulloni emrat (duke përfshirë edhe ndonjë që është shtuar gjatë diskutimeve) në një flipchart në mënyrën e duhur për të përfaqësuar një hartë të marrëdhënieve profesionale në shkollën tuaj. Përgatituni për t’ua pezantuar flipchartin të gjitha grupeve.
<p>Shembuj se si mund të bëhen hartat e bashkëpunimit.</p>	<p style="text-align: center;">Shembull hartash për frymëzim</p> 



Aktiviteti 2.1.4: Analiza e marrëdhënieve

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Reflektim mbi rëndësinë e marrëdhënieve të ndryshme në hartat e bashkëpunimit;
- Njohja e strategjisë ose metodës për të analizuar marrëdhëniet;
- Përdorimi i modelit të teorisë së aktivitetit për të konsideruar, qëllimin, fokusin, metodën, dhe kontekstin të marra së bashku;
- Përdorimi i ciklit të zgjidhjes së problemit për të reflektuar mbi qëllimin e bashkëpunimit aktual

Fokusi i Aktivitetit:

- Marrëdhëniet bashkëpunuese të konsideruara si më të rëndësishmet;
- Aktiviteti i bashkëpunimit;
- Qëllimi i bashkëpunimit në ciklin e zgjidhjes së problemit.

Materialet dhe Metodatat:

- "Flipcharte", stilolapsa, forma bosh me ciklin e zgjidhjes së problemit dhe modelin e aktivitetit.
- Reflektim dhe introspeksion, diskutim.

Informacion / alternativa shesë:

Për informacion mbi modelin e teorisë së aktivitetit dhe ciklin e zgjidhjes së problemit shikoni publikimin prezantues dhe modulën 1.

Informacion për trajnuesin:

Aktiviteti i mësipërm lidhur me marrëdhëniet bashkëpunuese (harta e bashkëpunimit), u jep mundësinë pjesëmarrësve për të reflektuar mbi natyrën e marrëdhënieve të përzgjedhura. Duke e bërë këtë, ata njihen me një metode që mund ta përdorin vetë për të analizuar marrëdhëniet, ose mund ta përdorin në bashkëpunim me kolegët për të qartësuar pritshëmëritë dhe bashkërisht të përcaktojnë se për çfarë duhet bashkëpunimi. Kjo metodë funksionon në klasë – me përshtatjet e nevojshme për ta bërë kuptimplotë për fëmijët.

Modeli i teorisë së aktivitetit i prezantuar në modulën 1 (shikoni publikimin prezantues) ndihmon për të reflektuar mbi natyrën e marrëdhënieve bashkëpunuese. Përfaqësimi grafik lehtëson diskutimet dhe sugjerimet që dalin për të bërë përmirësime. Përsëri, kjo metodë mund të përdoret në shkolla me kolegët




për të përmirësuar bashkëpunimin dhe për ta bërë kuptimplotë dhe efektiv.


Cikli i zgjidhjes së problemit prezantohet këtu si ndihmë për të marrë një pamje të plotë të asaj se si marrëdhëniet kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve. Për këtë qëllim, duhet të parashikohet një proces konkret për zgjidhjen e problemeve. Me fokus në arsimin gjithëpërfshirës, u përzgjedh procesi për "mësimin e personalizuar". Për t'i ndihmuar pjesëmarrësit të kuptojnë çfarë nënkuptohet nga termat e shtuar në slajdin përkatës, duhen bërë pyetjet në vijim:

- Si ndikon bashkëpunimi për të njohur problemet sa më herët? Identifikimi do të thotë njohja e problemit ose e situatës që ka nevojë të kuptohet më mirë;
- Si ndikon bashkëpunimi për të marrë informacion nga burime të ndryshme? Vlerësimi përfshin matjet dhe mbledhjen, por edhe kuptimin dhe analizimin e problemit;
- Si ndikon bashkëpunimi për të lehtësuar procesin e planifikimit mësimor? Planifikimi mësimor ka të bëjë me eksplorimin e zgjidhjeve të ndryshme të problemit, sqarimin e synimeve dhe vendimmarrjen;
- Si ndikon bashkëpunimi për të zgjidhur problemet në klasë? Udhëzimi dhe ndërveprimi ka të bëjë me bërjen e gjërave bashkërisht, duke bashkëpunuar për të adresuar problemin në klasë;
- Si ndikon bashkëpunimi për të reflektuar praktikën dhe monitoruar rezultatet. Reflektimi dhe vlerësimi ka të bëjë me mbajtjen e shënimeve rreth asaj që është bërë dhe asaj që është arritur.

Bashkëpunimi përgjatë ciklit të zgjidhjes së problemit për planet edukative të personalizuar duhet të preken përsëri në aktivitetin tjetër, kështu që kjo mund të kuptohet si organizues i avancuar për të lehtësuar aktivitetin tjetër. Cikli i zgjidhjes së problemit do të preket përsëri në modulën 3. Nëse trajnuesi do ta bëjë të ditur këtë lidhje, përfaqësimi mund të fotografohet dhe trajnuesi mund të hartojë rezultatet nga aktiviteti 2.1.5.

Sekuena e Aktivitetit

<i>"Analizimi marrëdhënies" (Individue dhe grupe të vogla)</i>	Analiza e marrëdhënies
<p> Trajnuesi shpjegon udhëzimet. Çështjet mund të paraqiten të tilla ose mund të bëhen lidhjet me Modelin e Teorisë së Aktivitetit (përdorur në modulën 1.)</p> <p> Punoni në grupe të vogla nëse pjesëmarrësit vijnë nga e njëjta shkollë dhe kanë shkëmbyer marrëdhënie, përndryshe ushtrimi duhet bërë individualisht. Rezultatet nuk duhen raportuar në grup por duhen dokumentuar. Grupet mund të përdorin formën për të reflektuar mbi aktivitetin e përbashkët.</p> <p> "Analiza e marrëdhënies për pjesëmarrjen e fëmijëve dhe familjeve" (Diskutim në grup). Pjesa e dytë e këtij aktiviteti fokusohet në bashkëpunimet për të siguruar pjesëmarrjen e fëmijëve dhe familjeve. Pyesni nëse fëmijët dhe familjet ishin të listuara në pyetjen 2 (qëllimi) ose pyetjen 3 (tema).</p>	<p>Zgjidhni dy ose tre nga marrëdhëniet më bashkëpunuese dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Cili bashkëpunon me kë? (psh. mësuesi me prindin) 2. Përse bashkëpunoni ose cili është qëllimi i bashkëpunimit? (psh. ndarje informacioni përgatitja e mësimit, monitorim). 3. Çfarë është tema kryesore e këtij bashkëpunimi, me fjalë të tjera rreth çfarë bëhet ky bashkëpunim? (psh, sjellja e fëmijës, organizimi i kohës, menaxhimi i klasës). 4. Si bashkëpunoni çfarë mjetesh ose metodash përdorni? (psh, vizita, telefonata, formularë, mbledhje javore, platforma online). 5. Ku dhe në çfarë konteksti social bashkëpunoni? (psh, klasë, sallën e mbledhjeve, qendra komunitare).



Aktiviteti 2.1.5: Bashkëpunimi për pjesëmarrjen (çon te Tema2)

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Identifikimi i fëmijëve dhe familjeve që janë në rrezik për t’u përjashtuar ose që nuk marrin pjesë plotësisht;
- Zhvillimi i përcaktimeve dhe përshkrimeve për t’i bërë besimet, vlerat dhe njohuritë vetjake të dukshme;
- Grupimi i fëmijëve sipas karakteristikave të përcaktuara për ta bërë kategorinë e fshehur të dukshme;
- Reflektimi mbi mënyrën se si pjesëmarrësit karakterizojnë fëmijët dhe familjet e tyre
- Reflektimi mbi përgjegjësitë për fëmijët dhe familjet e tyre.

Fokusi i Aktivitetit:

- Perceptimi dhe përshkrimi i pjesëmarrësve në lidhje me fëmijët dhe familjet me kufizimet e pjesëmarrjes;
- Perceptimi i përgjegjësive për fëmijët dhe familjet e tyre

Materialet dhe Metodadat:

“Flipcharte”, stilolapsa, forma bosh me ciklin e zgjidhjes së problemit. Reflektim, diskutim.

Informacion / alternativa sheshtë:

Informacion për trajnuesin:

Ky aktivitet fokusohet te fëmijët dhe familjet e tyre që vuajnë kufizimet në pjesëmarrje ose përjashtimin. Pjesëmarrësit emërtojnë grupe fëmijësh dhe karakteristikat e tyre. Kjo do të ndihmojë trajnuesin të ketë një kuptim më të mirë të asaj se si pjesëmarrësit “kategorizojnë fëmijët”. A tregon gjuha e përdorur respekt apo tregon shenja të një gjuhe paragjyquese ose diskriminuese? Trajnuesi duhet të vendosë nëse të tilla çështje do të adresohen në këtë pikë dhe deri në çfarë shkalle.

Ky aktivitet është një përgatitje e rëndësishme për temën 2, ku kufizimet në pjesëmarrje do të përdoren përsëri duke u dhënë pjesëmarrësve mundësinë të organizojnë më mirë këtë informacion, dhe të zhvillojnë një kuptim më të thellë. Kjo punë është e rëndësishme sepse e bën mendimin e pjesëmarrësve dhe praktikën të dukshme. Kjo është një pikë e domosdoshme fillestare për çdo ndryshim në praktikë.

Sekuena e Aktivitetit

Bahkëbisedojmë për pjesëmarrje

Cilët fëmijë dhe familje nuk marrin pjesë si duhet në arsim dhe në jetën shkollore?

- Diskutoni me kolegët tuaj dhe shkruani të gjitha karakteristikat;
- Organizojni karakteristikat e ndryshme në lloje dhe grupe;
- A keni harruar diçka?
- Përdorni, një flichart dhe shkruani grupet e ndryshme të fëmijëve.

Kush përfshihet në sigurimin e pjesëmarrjes së këtyre grupeve të ndryshme të fëmijëve në secilën fazë të ciklit të zgjidhjes së problemit?

(Identifikimi, Vlerësimi, Planifikimi, Ndërhyrja, Vlerësimi)

- kontrolloni hartën tuaj për të identifikuar personat më shumë të përfshirë.
- A ka një vazhdimësi të përfshirjes përgjatë ciklit?

Tema 2.2:

Kuptimi i kufizimeve të pjesëmarrjes

Vështrim i përgjithshëm i Temës 2.2

Qëllimi i temës

- Zhvillimi i një kuptimi më të thellë për kufizimet e pjesëmarrjes;
- Përdorimi i perspektivave të ndryshme për të analizuar kufizimet në pjesëmarrje;
- Zhvillimi i strategjive që mund të përdoren për të shqyrtuar kufizimet e pjesëmarrjes;
- Njohja e modelit për analiza të thella të kufizimeve në pjesëmarrje në kontekstin e shëndetit dhe mirëqenies.

Trajnuesit mund të mos paraqesin vetëm objektivat dhe synimet e temës, por edhe mund t'ju kërkojnë pjesëmarrësve të shkruajnë pyetjet që ata kanë në lidhje me përmbajtjen dhe objektivat e temës. Këto pyetje mund të përdoren përsëri kur këto çështje do të adresohen në trajnim. Në fund të çdo teme, trajnuesi mund të pyesë nëse të gjitha pyetjet u adresuan.

Vështrim i përgjithshëm, Aktivitetet

Aktiviteti 2.2.1: Analizoni kufizimet në pjesëmarrje;

Aktiviteti 2.2.2: Shqyrtimi i analizës së të tjerëve;

Aktiviteti 2.2.3: Ndani njohurinë dhe mësoni nga njëri tjetri.

Aktiviteti 2.2.1: Analizoni kufizimet e pjesëmarrjes.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Eksploroni të kuptuarit, premiset dhe besimet e lidhura me grupet e ndryshme të fëmijëve;
- Bëni të qarta ose të dukshme pikëpamjet e pjesëmarrësve lidhur me shkaqet e kufizimit të pjesëmarrjes, përgjegjësitë dhe nevojat e nivelit të mbështetjes të ngarkuara për një grup të caktuar fëmijësh;
- Identifikoni grupet e fëmijëve të cilët nuk janë përmendur deri më tani, por që janë gjithashtu në rrezik përjashtimi.

Fokusi i aktivitetit:

- Perspektivat për kufizimet e pjesëmarrjes (shikoni gjithashtu broshurën prezantuese dhe Modulin 1);
- Përgjegjësitë për të zgjidhur kufizimet e pjesëmarrjes;
- Niveli i nevojave të mbështetjes (Modeli me Tre Hallka).

Materialet dhe Metodrat:

- Fletë pune me temë "Analizoni kufizimet e pjesëmarrjes", laps ose stilolaps për të plotësuar fletën e punës, përfundimet nga tema 1;
- Reflektim, diskutim.




Informacion / alternativa shtesë

Informacion për trajnuesit:

Tema 2 vazhdon mendimet e zhvilluara në temën 1 dhe kërkon të sqarojë premiset e pjesëmarrësve lidhur me origjinën e kufizimeve të pjesëmarrjes, për përgjegjësitë dhe për nivelin e mbështetjes së nevojshme për grupe specifike fëmijësh. Është e rëndësishme që këto lidhje të bëhen të qarta në mënyrë që pjesëmarrësit të reflektojnë me kompetencën e tyre duke marrë parasysh arsimin gjithëpërfshirës. Pjesëmarrësve duhet t'iu jepet mundësia të analizojnë situatën aktuale dhe situatën e fëmijëve me nevoja dhe formim të ndryshëm në mënyrë që të ndryshojnë praktikën e tyre dhe të krijojnë mjedise që janë më gjithëpërfshirëse. Gjithashtu ky aktivitet paraqet modele dhe informacion që ishte paraqitur në modulën 1. Këto modele tashmë po përdoren si mjete për të ndihmuar pjesëmarrësit që të analizojnë situatën e fëmijëve në rrezik përjashtimi.

Fusha të ndryshme pjesëmarrjeje janë paraqitur këtu si një parim organizues në mënyrë që të kuptohet më mirë dhe të eksplorohej kufizimet e pjesëmarrjes. Kjo shërben për të theksuar faktin se fëmijët mund të përjetojnë kufizime të pjesëmarrjes në disa fusha të jetës së tyre, por jo në të tjerat. Fushat janë nga "Klasifikimi Ndërkombëtar i Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit" (ICF), i zhvilluar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë për të analizuar kufizimet e pjesëmarrjes në kontekstin e shëndetit (një nga katër perspektivat e paraqitura këtu). Fushat janë universale dhe mund të përdoren për të katërta perspektivat.

Sekuena e Aktivitetit

<p><i>Kuptueshmëria e Kufizimeve të Pjesëmarrjes</i></p> <p> Seancë plenare: Trajnuesi bën një prezantim të aktivitetit duke thënë se pjesëmarrësit tani do të analizojnë kufizimet specifike, nevojat e mbështetjes dhe përgjegjësitë për këta fëmijë. Kjo duhet t'iu ndihmojë pjesëmarrësit të zhvillojnë një kuptim më të gjerë të kufizimeve të pjesëmarrjes.</p> <p>Së pari, bëhet pajisja me informacionin e nevojshëm dhe pjesëmarrësit reflektojnë mbi atë që se u diskutua në modulën 1.</p> <p> Trajnuesi udhëheq nëpër këto tre slajde dhe iu bën pyetje pjesëmarrësve në mënyrë që të sigurohet për kuptueshmërinë e tyre. Katër perspektiva: Ilustrimi me shembuj ndihmon kuptueshmërinë.</p>	<p>Analizimi i kufizimeve të pjesëmarrjes</p>  <p>Pse fëmijët nuk marrin pjesë si duhet? Merrni shënimet tuaja dhe përpiquni t'iu përcaktoni karakteristika perspektivave të prezantuara në modulën 1.</p>
<p><i>Fushat e Pjesëmarrjes:</i> Jepni shembuj që të bëni të qartë:</p> <p>Të nxënimit dhe zbatimi i njohurive: të mësosh të lexosh, të luash një vegël muzikore;</p> <p>Detyra dhe Kërkesa të Përgjithshme: merrni pjesë në aktivitetet e zakonshme të shkollës, menaxhoni kërkesat e jetës së përditshme;</p> <p>Komunikimi: flisni me bashkëmoshatarët, iu shkruani shokëve.</p> <p>Lëvizja: Të shkruarit në shkollë me të tjerët, përdorni një biçikletë, ose ngjisni një makinë;</p>	<p>Fushat e pjesëmarrjes</p> <p>Të nxënimit & Aplikimi i njohurive; Detyra dhe kërkesa të përgjithshme; Komunikimi; Lëvizshmëria; Vete-përkujdesja; Jeta familjare; Ndërveprimet dhe marrëdhëniet personale; Fushat madhore të jetës: Arsimi, Puna dhe Punësimi, Jeta ekonomike komuniteti, Jeta sociale & qytetare.</p> <p>Në cilat fusha i përjetojnë këta fëmijë kufizimet e pjesëmarrjes?</p>

Kujdesi për veten: vishuni, hani dhe pini, shkoni në tualet.

Jeta shtëpiake: të përgatiturit e vakteve, punët e shtëpisë;

Ndërpersonale: marrëdhëniet me bashkëmoshatarët, prindërit etj.;

Arsimi: shkoni në shkollë, mësoni, ndërveproni, luani;


Komuniteti: bëhuni pjesë e një komuniteti;

Nevojat për mbështetje (Modeli me Tre Hallka):

Ku bëjnë pjesë në model grupet e identifikuar nga pjesëmarrësit? Pse janë caktuar në një hallkë dhe jo në tjetrën. Për çfarë lloj mbështetje kanë nevojë? Përse? Pjesni pjesëmarrësit për shembuj nga shkolla e tyre në mënyrë që të siguroheni se e kanë kuptuar modelin me tre hallka.



Analizoni nevojat për mbështetje



(Cilat janë nevojat për mbështetje të këtyre fëmijëve? Përpiquni t'i klasifikoni fëmijët në një nga hallkat e "Modelit me Tre Hallka", të prezantuar në modul 1.

Fletë pune "analizoni...": Shpjegimi i detyrës (Seancë plenare)



Seancë plenare: Trajnuesi shpërndan fletën e punës (kopje të shumta për çdo person) dhe e shtjellon në mënyrë që të sigurohet se të gjithë e kuptojnë detyrën.



Pjesëmarrësit plotësojnë fletën e punës. Sigurohuni që për çdo grup të përdoret një fletë pune e re. Në fund të aktivitetit, fletët e punës mbledhen veçmas sipas perspektivës. Kjo gjë mund të arrihet duke kërkuar në fillim fletët e punës ku shënohet "perspektiva e marrëdhënieve" dhe pasi i keni mbledhur, kaloni tek perspektiva tjetër. Përndryshe, trajnuesi duhet t'i ndajë ato në grupe pasi i ka mbledhur.

Fleta e punës "Analizoni..."

Ju lutemi, përdoreni fletën e punës individualisht ose në grupe të vogla. Përdorni një fletë pune për grup fëmijësh që keni përshkruar në temën 1.

Përshkruani karakteristikat ose llojin e grupit.

Kush është përfshirë në sigurimin e pjesëmarrjes (rezultatet tuaja nga tema 1)?

Në cilën perspektivë përshtaten ato?

Cili është niveli i nevojës për mbështetje (Modeli me Tre Hallka)?

Plotësojeni fletën e punës në mënyrë që të tjerët të mund ta përdorin këtë informacion për aktivitetin tjetër.

Aktiviteti 2.2.2: Eksplorimi i kufizimeve të pjesëmarrjes.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Reflektoni mbi njohuritë dhe besimet e pjesëmarrësve duke përdorur fletën e punës "Të kuptuarit e kufizimeve të pjesëmarrjes";
- Përmbledhni njohuri të ndryshme për të theksuar kontradiktat;
- Siguroni një mundësi për të zhvilluar një kuptim më të madh të pjesëmarrjes;
- Paraqisni metoda që mund t'i përdorin shkollat për të eksploruar kufizimet e pjesëmarrjes në shkollat e tyre.

Fokusi i aktivitetit:

- Mendimet dhe të kuptuarit nga ana e pjesëmarrësve për kufizimet e pjesëmarrjes;
- Fletë pune dhe bërja e pyetjeve për tu përqendruar tek aktiviteti;
- Çdo person për grup të paraqesë perspektivën e tij për kufizimet e pjesëmarrjes.

Materialet dhe Metodot:

- Fletë pune “Eksploroni kufizimet e pjesëmarrjes”, Flipchart, stilolapsa dhe të kuptuarit e dokumenteve.
- Fletë pune të plotësuara “Analizoni kufizimet e pjesëmarrjes”, të ndara sipas perspektivës.
- Analiza e përgjigjeve, reflektimit, diskutimit.

Informacion / alternativa shtesë**Informacion për trajnuesit:**



Ky aktivitet iu jep mundësinë pjesëmarrësve që të mësojnë më shumë për pikëpamjet e pjesëmarrësve të tjerë në lidhje me të menduarit e tyre për “grupet” dhe “llojet” e identifikuar në temën 2. Pjesëmarrësve iu kërkohet që të analizojnë në mënyrë kritike ndarjet në grupe, caktimin e perspektivave, nivelin e mbështetjes dhe përgjegjësitë në lidhje me çfarë kanë mësuar deri më tani për arsimin gjithëpërfshirës. Aftësia për të reflektuar në mënyrë kritike për mënyrën se si mendojnë vetë dhe si mendojnë të tjerët është thelbësore për arsimin gjithëpërfshirës. Mësuesit duhet të jenë të aftë që të distancohen nga besimet dhe pikëpamjet e tyre; ky aktivitet i ndihmon pjesëmarrësit që të zhvillojnë këtë kompetencë.

Ky aktivitet përdor ciklin e zgjidhjes së problemeve nga moduli 1 dhe siguron një mundësi për ta zbatuar si një mjet për reflektim. Sekuenca e ciklit të zgjidhjes së problemeve tashmë është përdorur në fletën e punës “Analiza e Pjesëmarrjes”. Kjo shërben për t’i pajisur pjesëmarrësit me mundësi që t’i përdorin si modele dhe jo vetëm sa të mësojnë për to. Me praktikë ato do të bëhen edhe më të lehta për tu përdorur. Nëse shkollat duan të bëhen organizata mësimi, mësuesit dhe profesionistët e tjerë duhet të jenë të aftë të përdorin modele të tilla mendore (shiko Broshurën Hyrëse). Të përdorësh të njëjtat modele si mjete për të menduar dhe zgjidhur probleme është thelbësore për një bashkëpunim dhe komunikim efikas.

Gjithashtu aktiviteti mund të përdoret në shkollat të cilat duan të reflektojnë mbi popullatën e nxënësve të tyre, sistemet e mbështetjes dhe përgjegjësitë. Prandaj ky aktivitet siguron një mundësi për të zbatuar këto modele dhe për të arritur një kuptim më të mirë të përdorimit të tyre në mënyrë që më vonë të përdoren në situatat e jetës së përditshme.

Trajnuesi duhet t’i këshillojë pjesëmarrësit që të sigurohen që të plotësojnë fletoret e punës në mënyrë që të kenë dokumentacionin e nevojshëm për aktivitetin tjetër. Nëse hapësira e siguruar nuk është e mjaftueshme, pjesëmarrësit duhet të përdorin copa boshe letre duke përdorur numërimin për t’u orientuar. Zgjidhjet kryesore dhe reflektimet (kritike) duhet të dokumentohen në një flipchart.

Sekuenca e aktivitetit

<p><i>Eksplorimi i Kufizimeve të pjesëmarrjes (Seancë plenare)</i></p>  <p>Seancë plenare: Trajnuesi bën një prezantim të aktivitetit duke thënë se pjesëmarrësit tani do të eksplorojnë të gjitha përgjigjet nga të gjithë pjesëmarrësit të cilat ishin identifikuar të binin në një perspektivë.</p>  <p>Grupet e mëparshme tashmë janë përzierë, kjo mund të bëhet duke i lënë njerëzit në të katërt cepat e dhomës dhe duke i lejuar të zgjedhin perspektiven me të cilën duan të punojnë. Secilit grup i jepen fletët e punës përkatëse “Kuptoj”. Nga aktiviteti i mëparshëm.</p>	<p>Fleta e punës „Eksploroni...“</p> <p>Fletët e punës „Kuptoni...“ janë mbledhur dhe ndarë nga perspektiva (e marrëdhënies, zhvillimore, kurrikulare, shëndetësore) dhe u janë shpërndarë katër grupeve përgjegjëse për një nga këto perspektivat. Çdo grup përqendrohet te një perspektivë:</p> <p>Kontrolloni përshkrirret: A janë ato konsistente? Bëni një përmbledhje të karakteristikave.</p> <p>A i janë përcaktuar këta grupe një hallke në, mënyrë konsistente?</p> <p>Kush është listuar si përgjegjës për këta fëmijë?</p> <p>Reflektioni rezultatet duke përdorur njohuritë tuaja mbi arsimin gjithëpërfshirës.</p> <p>Kontrolloni karakteristikat kundrejt përkufizimit të pjesëmarrjes të shtjelluar në modulin 1 (shikoni fletën e punës „Eksploroni...“).</p>
--	---



Trajnuesi siguron fletë pune boshe “Eksploroni” për këtë aktivitet dhe shpërndan grumbullin e fletëve të punës “Analizoni” sipas “perspektivës” së secilit grup dhe shpjegon detyrën.

Ata duhet të organizohen nëse duan ta ndajnë punën apo duan ta bëjnë gjithçka bashkë. Kujtoni grupet të shënojnë përfundimet dhe zgjidhjet pesë minuta para përfundimit të aktivitetit. Sigurohuni se fletët e plotësuara të punës nga grupet të mund të përdoren për aktivitetin tjetër.

Plotësojeni fletën e punës në mënyrë që ju ose të tjerët të mund ta përdorin informacionin! Shkruajini përfundimet dhe pikëpamjet tuaja, p.sh. në një letër flipchart.

Aktiviteti 2.2.3: Ndarja e njohurive dhe të mësuarit nga njeri-tjetri

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Të përjetoni një metodë që kombinon rezultatet nga njerëz të ndryshëm;
- Përfshirja në procesin e “të nxënimit të zgjeruar”;
- Të nxirrni në pah njohuritë e pjesëmarrësve në lidhje me praktikën gjithëpërfshirëse në shkollë;
- Të arrini një kuptim të madh se si të menaxhoni kufizimet e pjesëmarrjes.

Fokusi i aktivitetit:

- Gjuha e përdorur nga pjesëmarrësit për të përshkruar fëmijë që vuajnë nga kufizimet e pjesëmarrjes;
- Strategji për të përmirësuar pjesëmarrjen;
- Praktikën aktuale në shkollë.

Materialet dhe Metodatat:

- Flipcharte, stilolapsa, fletë pune “Eksploroni” nga aktiviteti i mëparshëm, shabllone “Zgjidhje-problemesh”;
- Analizë e përgjigjeve në fletët e punëve, diskutim, brainstorming, reflektim.

Informacion / alternativa shtesë

Informacion për trajnuesit:





Ky aktivitet kërkon që pjesëmarrësit të parashtrojnë të gjitha opinionet që kanë paraqitur të gjithë së bashku dhe ky aktivitet bën edhe zhvendosjen nga “eksplorimi” drejt “planifikimit”. Në mënyrë që të bëhet kjo zhvendosje, është vendimtare që planifikimi mësimor të bëhet me të tjerët; kjo është kryesore për arsimin gjithëpërfshirës. Arsimi gjithëpërfshirës nuk mund të arrihet në izolim. Pjesëmarrësit punojnë në këtë aktivitet bashkë me të tjerët dhe përpunojnë zgjidhje bashkërisht. Kjo mund të jetë një përvojë e re për shumë pjesëmarrës, madje edhe për trajnuesit, por është thelbësore që pjesëmarrësit kanë mundësi të përjetojnë bashkë këto mënyra si për mendimin ashtu edhe zgjidhjen e problemeve. Është në dorën e trajnuesit për të vendosur nëse kjo duhet të bëhet e qartë ose nëse pjesëmarrësit duhet thjesht të merren me aktivitetin.

Ajo çfarë trajnuesi duhet të bëjë është të përpiqet të arrijë rezultatet e mëposhtme nga pjesëmarrësit (ndani për secilën nga katër perspektivat mbi pjesëmarrjen, të dokumentuara në flipchart):

- Ide për përshkrimin jodiskriminues të fëmijëve (informacioni burimor: llojet origjinale dhe grupet e rikonsideruara/riorganizuara të fëmijëve);
- Ide mbi strategjitë për të përmirësuar pjesëmarrjen (informacioni burimor: mendimet e tyre deri më tani dhe praktikën e mira në shkollat e tyre);
- Praktika aktuale në shkollë dhe komunitete (Informacioni burimor: vetë përvoja e tyre);

Përfundimet do të përpilohen në një flipchart për secilën nga katër perspektivat (zhvillimi, kurrikulë, marrëdhënie, shëndetësore). Këto janë katër “copat e formueses” që pjesëmarrësit tashmë mund t’i përdorin për të eksploruar strategjitë për të përmirësuar praktikën në lidhje me katër perspektivat mbi kufizimin e pjesëmarrjes.

Sekuena e aktivitetit

<p><i>Shpjegimi i punës në grup për të ndarë njohuritë (Seancë plenare)</i></p> <p> Seancë plenare: Trajnuesi bën një prezantim të aktivitetit duke thënë se pjesëmarrësit tani do të eksplorojnë të gjitha përgjigjet nga të gjithë pjesëmarrësit të cilat ishin identifikuar të binin në një perspektivë.</p> <p> Grupet e mëparshme tashmë janë përzierë, kjo mund të bëhet duke i lënë njerëzit në të katërt cepat e dhomës dhe duke i lejuar të zgjedhin perspektivën me të cilën duan të punojnë. Secilit grup i jepen fletët e punës përkatëse “Kuptoj”. Nga aktiviteti i mëparshëm.</p> <p> Trajnuesi siguron fletë pune boshe “Eksploroni” për këtë aktivitet dhe shpërndan grumbullin e fletëve të punës “Analizoni” sipas “perspektivës” së secilit grup dhe shpjegon detyrën.</p> <p>Ata duhet të organizohen nëse duan ta ndajnë punën apo duan ta bëjnë gjithçka bashkë. Kujtoni grupet të shënojnë përfundimet dhe zgjidhjet pesë minuta para përfundimit të aktivitetit. Sigurohuni se fletët e plotësuara të punës nga grupet të mund të përdoren për aktivitetin tjetër.</p>	<p>Puna në grup për ndarjen e njohurive</p> <p>Për këtë aktivitet, grupet mund të mbeten të njëjta si në aktivitetin paraardhës, ose mund të grumbullohen sërish (për të rritur efektin e te nxënësit). Produkti i kësaj pune në grup do të ndahet me të gjithë pjesëmarrësit. Ai përfaqëson njohuritë, përvojat dhe praktikatat e çdokujt në lidhje me:</p> <p>Si t’i përshkruajmë grupet pa përdorur një gjuhë diskriminuese;</p> <p>Strategjitë për të përmirësuar pjesëmarrjen;</p> <p>Praktikat e fundit në shkolla dhe komunitete.</p> <p>Rezultatet do të dokumentohen në një flipchart ose slajde, dhe do të ndahen me të gjithë pjesëmarrësit. Kjo do të ndihmojë në planifikimin e modulit të fundit ku keto tema do të shfaqen sërish.</p>
<p><i>Raportimi në Seancë plenare (Seancë plenare)</i></p> <p> Trajnuesi redukton prezantimin e punës në grup dhe e bën atë që t’i përshtatet katër perspektivave:</p> <div data-bbox="215 1523 646 1780" data-label="Diagram"> <pre> graph TD A[Prespektiva zhvillimore] --- B[Pjesëmarrja] C[Prespektiva kurrikulare] --- B D[Prespektiva shëndetësore] --- B E[Prespektiva e marrëdhënieve] --- B </pre> </div> <p>Pjesëmarrësit kanë krijuar një produkt ku kanë marrë pjesë bashkë dhe që i udhëzon në mënyrë që të nxisin pjesëmarrjen. Tema 2 i ka udhëhequr ata nëpër procesin e analizimit, eksplorimit dhe planifikimit.</p> <p>Trajnuesit duhet ta bëjnë këtë lidhje dhe grupet duhet të reflektojnë për procesin (shiko gjithashtu Temën 3, Moduli 1 Diversiteti i Nxënësve)</p>	<p>Raportimi në seancë plenare</p> <p>Çdo grup i përmbledh rezultatet në një flipchart: Katër flipchart janë katër jigsaw (bashkime figurash) të ndara, të nevojshme për kuptimin e duhur të kufizimeve të pjesëmarrjes dhe nuk i diskriminojnë gabimisht fëmijët duke mos i njohur të gjithë faktorët kontribues. Grupet prezantojnë rezultatet dhe u përgjigjen pyetjeve:</p> <div data-bbox="790 1624 1364 2004" data-label="Image"> </div> <p>Përdorimi i metodës jigsaw (bashkim figurash) në klasë: https://www.jigsaw.org/</p>

Tema 2.3:

Bashkëpunimi për të kapërcyer kufizimet në pjesëmarrje

Vështrim i përgjithshëm i Temës 2.3

Qëllimi i Temës

- Të njohim “Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit” ICF-në si një kornizë të përbashkët për bashkëpunim (konteksti i shëndetit dhe mirëqenies);
- Të zhvillojmë strategji për të bashkëpunuar përgjatë ciklit të zgjidhjes së problemeve;
- Të njohim dhe të zhvillojmë mjetet që na ndihmojnë të vëmë në zbatim këtë strategji.

Trajnuesit jo vetëm që mund të prezantojnë qëllimet dhe synimet e Temës, por gjithashtu mund të pyesin pjesëmarrësit që të shënojnë pyetjet që mund të kenë në lidhje me përmbajtjen dhe qëllimet e kësaj Teme. Këto pyetje mund të përdoren përsëri kur t’i drejtohem problemit në trajnim. Në fund të secilës Temë, trajnuesi mund të pyesë nëse u shqyrtuan të gjitha pyetjet.

Vështrim i përgjithshëm i aktiviteteve

Aktiviteti 2.3.1: Përshkruani diversitetin në kontekstin e shëndetit;

Aktiviteti 2.3.2: Të njohim ICF-në si një kornizë të përbashkët;

Aktiviteti 2.3.3.: Zgjidh problemin tim, të lutem!

Aktiviteti 2.3.1: Përshkruani diversitetin në kontekstin e shëndetit

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Eksploroni më në detaj një nga katër perspektivat (perspektivën e shëndetit);
- Reflektoni mbi gjuhën, konceptimet dhe premisat tuaja rreth aftësive të kufizuara;
- Mësoni të zbatoni ciklin e zgjidhjes së problemeve në mënyrë që të përvetësoni organizimin e punës në bashkëpunim.

Fokusi i aktivitetit:

- Të kuptuarit e pjesëmarrësve rreth aftësive të kufizuara;
- Të përjetuarit e kufizimeve të pjesëmarrjes nga tre persona me sindromën Down.

Materialet dhe Metodat:

- Flipchart, stilolapsa; opsionale: shënimet për “grupet dhe llojet e fëmijëve” (Aktiviteti 2.1.5 dhe Tema 2);
- Reflektimi dhe përvoja personale.

Informacion / alternativa shtesë



Informacion për trajnuesit:

“Perspektiva shëndetësore” është ajo që ka traditën më të vjetër në sistemin arsimor. Edhe sot, ajo mbetet perspektiva më e rëndësishme e zgjedhur për të kuptuar kufizimet e pjesëmarrjes dhe zakonisht e vetmja për të cilën sigurohet mbështetje shtesë. Prandaj është e rëndësishme që t’i dedikojmë kohë shtesë për ta eksploruar dhe për të prezantuar një rrugë për të kuptuar aftësinë e kufizuar bazuar në të drejtat e njeriut. **Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara** (KDPAF) kërkon që të gjitha shtetet nënshkruese të vendosin në zbatim arsimin gjithëpërfshirës dhe të sigurojnë mbështetje të përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (ICF) bashkë me versionin e përftuar nga ajo për Fëmijët dhe Adoleshenca (ICF-CY) janë korniza që ndodhen në themel të KDPAF.

Edhe pse këtu nuk mund të jepet një prezantim i plotë i ICF-së, pjesëmarrësit duhet të jenë të njohur me fushat e aktiviteteve dhe pjesëmarrjes dhe faktorët e mjedisit rrethues. Këto fusha përfaqësojnë fushat ku pjesëmarrja duhet të garantohet nga KDPAF. Faktorët e mjedisit rrethues ju ndihmojnë të reflektoni për kufizimet dhe si të ndërtoni mjedise rrethuese të përshtatshme. Trajnuesit duhet të theksojnë faktin se ICF-ja përdoret vetëm për të përshkruar diversitetin në kontekstin e shëndetit. Fushat e aktivitetit dhe pjesëmarrjes ndihmojnë të ndërtoni ura që lidhin me perspektivat e tjera (zhvillimi, marrëdhëniet, kurrikula). Kjo është një kornizë e cila ndihmon në zhvillimin e një gjuhe të përbashkët e cila mund të përdoret për bashkëpunim, kooperim dhe komunikim ndërmjet profesionistëve dhe sistemeve (p.sh. Shëndetësia, Mbrojtja Sociale, Arsimi).

Broshura 2 (dhe webinarin e saj shoqëruar) e serive të UNICEF *Një Përfaqëse bazuar në të Drejtat e Njeriut për Arsimin Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara*, “Përkufizimi dhe Klasifikimi i Aftësive të Kufizuara” siguron informacion shtesë për ICF-në. Trajnuesi mund ta përdorë Webinarin në përgatitje për këtë temë. Tre simulimet për Erën, Arbën dhe Ditmirin janë nga Webinarin. Informacion shtesë për Erën: Ajo lindi me zhurmë në zemër, por fizikisht është e shëndetshme. Ajo është ndikuar rëndë nga problemet e saj të shumta shëndetësore dhe ka një sjellje të vonuar, pjesërisht nga fakti se ishte e izoluar në marrëdhëniet shoqërore. Historia e Arbës (në jetën reale Kareen) është e bazuar në një raport (duke përfshirë edhe material filmik) të ABC News i cili gjendet në internet. Ajo u adoptua vetëm pak muaj para se të transferohej në një institucion për të rriturit me probleme të shëndetit mendor. Simulimi i fundit i referohet Ditmirin, një mësuesi spanjoll, aktor dhe aktivist. Ai luan në filmin “Me too” (Yo tambien).

Sekuena e aktivitetit

<p><i>Diversiteti në kontekstin e shëndetit (Seancë plenare)</i></p>  <p>Trajnuesi prezanton Erën, Arbën dhe Ditmirin aftësitë dhe situatat e jetës së tyre. Ky prezantim mund të jetë i shkurtër ose mund të pasurohet me material filmik ose fotografi.</p> <p>Duke përdorur tre simulimet, trajnuesi shpjegon dhe i lë pjesëmarrësit të eksplorojnë deklaratat në këtë slajd.</p>  <p>Pjesëmarrësve iu jepen pak çaste që të diskutojnë në grupe të vogla informale. Trajnuesi duhet të theksojë se ata mund t’i kthehen diskutimit në Temën 2.</p> <p>Grupet e vogla japin opinionet e tyre, trajnuesi Shënon rezultatet në flipchart.</p>	<p>Përshkruani diversitetin në shëndetësi</p> <p>Personat me diagnozën e sindromës Down, etiketohen si „të paaftë intelektualë“</p> <ul style="list-style-type: none"> Anna, shtatë vjeç, i kaloi tre vitet e para të saj në një jetimore në Ukrainë përpara se të adobtohej nga një familje amerikane. Sara, tre muaj më e vogël, lindi me sindromën „fetal alcohool“ (sindromë e lindur që lidhet me konsumin e alkoolit nga ana e nënës gjatë shtatzanisë dhe karakterizohet nga vonesa në zhvillimin mendor dhe fizik, veçanërisht kafka dhe fytyra) dhe u braktis nga nëna që në lindje. Pablo, i lindur në vitin 1974, ishte vetëm shtatë vjeç kur u diagnostikua me sindromën Down. Tashmë, ai është aktor dhe mësues.
--	---



Këto çështje duhet të trajtohen në përfundim:

- Të njihni diagnozën është e rëndësishme kur kjo iu ndihmon të identifikoni “ilaçin” por nuk ka ilaç për sindromën Down.
- Të njihni dëmet është e rëndësishme kur kjo iu ndihmon të eliminoni kufizimet në pjesëmarrje, por jo kur ato përdoren thjesht për të etiketuar fëmijën.

Tani trajnuesi njofton se pjesëmarrësit do të njihen me një model dhe një kornizë e cila ndihmon në zhvillimin e një gjuhe jodiskriminuese.

Një ç’rregullim ose paaftësi nuk parashikon situatën jetësore të një femije.

Një ç’rregullim ose paaftësi nuk parashikon kufizimet e pjesëmarrjes.

Një ç’rregullim ose paaftësi nuk parashikon kërkesat për mbështetje.

Si ta përshkruani diversitetin duke respektuar shëndetin, mirëqenien dhe aftësinë e kufizuar pa diskriminim?

Aktiviteti 2.3.2: Të njohim ICF-në si kornizë të përbashkët

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Të njohim modelin e ICF-së si një mjet për të menduar rreth aftësive të kufizuara;
- Të sigurojmë një zbulim të parë të fushave të aktivitetit dhe pjesëmarrjes së ICF-së;
- Të zbatojmë modelin e ICF-Së dhe fushat e aktivitetit dhe pjesëmarrjes;
- Të reflektojmë në përdorimet e ICF-së dhe se si mund të ndryshojë të menduarit e pjesëmarrësve.

Fokusi i aktivitetit:

- Modeli i ICF-së me përbërësit e funksionimit dhe aftësisë së kufizuar, faktorët e mjedisit rrethues;
- Zbatimi i ICF-së në shkolla në mënyrën se si mendojmë vetë.

Materialet dhe Metodadat:

- Nuk nevojiten materiale shtesë;
- Brainstorming dhe reflektim.

Informacion / alternativa shtesë

Informacion për ICF-në: shihni Broshurën Hyrëse, Broshurën 2 (dhe webinarin e saj shoqëruar) të serive të UNICEF *Një Përfaqje bazuar në të Drejtat e Njeriut për Arsimin Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara*, “Përkufizimi dhe Klasifikimi i Aftësive të Kufizuara”; Informacion i siguruar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë: <http://www.who.int/classifications/icf/en/>

Informacion për trajnuesit:

Ky aktivitet bën një prezantim të shkurtër të ICF-së. Këshillohet që para se të filloni këtë aktivitet, trajnuesi shikon Webinarin dhe lexon Broshurën teknike 2 të serive të UNICEF *Një Përfaqje bazuar në të Drejtat e Njeriut për Arsimin Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara*, “Përkufizimi dhe Klasifikimi i Aftësive të Kufizuara”. Ky aktivitet është më efikas nëse përdor diskutimet dhe çështjet e shqyrtuara në aktivitetin e mëparshëm për të ndihmuar pjesëmarrësit që të lidhin të menduarit e tyre me modelin. Në mënyrë që t’i referoheni më lehtë, përkufizimet e përbërësve të ndryshëm janë listuar këtu; ato duhet që t’i sigurohen pjesëmarrësit kur shpjegohet modeli:

Përbërësit e trupit:

- Funksionet e trupit janë funksionet fiziologjike të sistemit të trupit (duke përfshirë edhe funksionet psikologjike);
- Strukturat e trupit janë pjesët anatomike të trupit si organet, gjymtyrët dhe përbërësit e tyre;
- Dëmtimet janë probleme në funksionimin ose strukturën e trupit si p.sh një devijim ose humbje e konsiderueshme.

Përbërësit e aktiviteteve dhe pjesëmarrjes (fushat janë prezantuar më parë në Temën 2!):






- Aktiviteti është kryerja e një detyre ose një veprimi nga një individ;
- Pjesëmarrja është përfshirja në situatat e jetës;
- Kufizimet e aktivitetit janë vështirësi që një individ mund të ketë kur kryen një aktivitet;
- Kufizimet e pjesëmarrjes janë problemet që një individ mund të përjetojë kur përfshihet në situatat e jetës.

Faktorët kontekstualë

- Faktorët e mjedisit rrethues përbëjnë mjedisin fizik, social dhe të mënyrës së sjelljes se si njerëzit jetojnë dhe drejtojnë jetën e tyre.
- Faktorët personalë janë gjithashtu një përbërës i faktorëve kontekstualë por ato nuk klasifikohen në ICF për shkak të shumëllojshmërisë së gjerë sociale dhe kulturore.

Trajnuesi duhet të sigurohet që pjesëmarrësit të kuptojnë ndërveprimin ndërmjet mjedisit rrethues dhe pjesëmarrjes. Në këtë rast historia e Anës na ndihmon, pasi dy trajektorët e ndryshme të zhvillimit (nëse ajo do të kishte shkuar në një institucion për të rriturit me probleme të shëndetit mendor apo të rritej në një familje të dashur) mund të eksplorohej lehtë në lidhje me ndikimin e dy mjediseve rrethuese në situatat e jetës së saj dhe gjithashtu në zhvillimin që ajo do të pësonte.

Sekuena e aktivitetit

<p><i>ICF-ja si një kornizë e përbashkët (Seancë plenare)</i></p>  <p>Trajnuesi bën një prezantim të modelit të ICF-së duke përdorur simulimet e tre çështjeve. Pjesëmarrësit ftohen që të japin shembuj për secilën nga përbërësit e modelit, trajnuesi jep përkufizimet.</p>  <p>Derisa trajnuesi të sigurohet se modeli është kuptua do të ketë diskutime në grup, pyetje dhe përgjigje.</p>	<p>ICF si një kuadër i përbashkët</p> <p>Çdo grup i përmbledh rezultatet në një flipchart: Katër flipchartet janë katër jigsaw (bashkime figurash) të ndara, të nevojshme për kuptimin e duhur të kufizimeve të pjesëmarrjes dhe nuk i diskriminojnë gabimisht fëmijët duke mos i njohur të gjithë faktorët kontribues. Grupet prezantojnë rezultatet dhe u përgjigjen pyetjeve:</p>  <p>Për më shumë informacion: http://www.who.int/classifications/icf/en/</p>
<p><i>Informacion për përbërësit (Seancë plenare)</i></p>  <p>Ky slajd përqendrohet në përbërësit të cilët janë të rëndësishëm për mësuesit dhe profesionistët të cilët punojnë në arsim: aktivitetet dhe pjesëmarrja gjithashtu edhe faktorët e mjedisit rrethues. Gjithashtu duhet të përmenden edhe faktorët personalë pasi ata përshkruajnë situatat personale (përvojat e mëparshme të pasqyruara te personi).</p>  <p>Derisa trajnuesi të sigurohet se modeli është kuptuar do të ketë diskutime në grup, pyetje dhe përgjigje.</p>	<p>Elementet e rëndësishëm për mësuesin</p> <p>Fushat e aktiviteteve dhe pjesëmarrja (shikoni temën 2). Faktorët mjedisorë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Produktet dhe teknologjia; 2. Mjedi natyral dhe ndryshimet e bëra nga njeriu në mjedis; 3. Mbështetja dhe marrëdhëniet; 4. Qëndrimet; 5. Shërbimet, sistemet dhe politikat. <p>Faktorët personalë mund të përfshijnë gjininë, moshën, formimin social, përvojat e shkuara dhe të tashme, formimin etnik dhe profesionin. Ata konsiderohen si formim i veçantë i situatës jetësore të një individi në lidhje me funksionimin.</p>

ICF për arsimin gjithëpërfshirës (Seancë plenare)

Trajnuesi tregon rrugët se si ICF-ja mund të përdoret për arsimin gjithëpërfshirës. Informacioni bazë për këtë deklarata mund të gjendet në webinar dhe broshurën teknike.



Zhvillimi i ideve të para se si mund të përdoret ICF-ja. Diskutime të vogla në grup për aplikimin e ICF-së në qytetin, komunitetin ose shkollën e pjesëmarrësve. Reflektim për punën e tyre të mëparshme për "grupet dhe llojet" e fëmijëve.



Raportimi nuk është i detyrueshëm, por nëse është e mundur trajnuesi duhet të bëjë të mundur shkëmbime në zbatimin aktual të ICF-së.

ICF për Arsim gjithëpërfshirës

Kuadri dhe gjuha e përbashkët midis profesionistëve të ndryshëm që punojnë në sektorët e arsimit, shëndetësisë dhe politikave sociale.

Një mjet për të përshkruar situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe probleme shëndetësore kronike me fokus pjesëmarrjen.

Një mjet për të nënvizuar dallimet në perceptimin, kuptueshmërinë dhe pritjet (p.sh. përcaktimi i qëllimit) ndërmjet palëve të ndryshme të interesit.

Kuadri për të planifikuar, siguruar dhe monitoruar përfshirjen dhe pjesëmarrjen në kornizën e konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (CRPD).

A përdoret ICF në vendin tuaj, komunitetin apo shkollën? Kthehuni te aktivitetet në njësinë 1 dhe 2: A ofron ICF një gjuhë më të përshtatshme për të folur për grupe të caktuara të fëmijëve?

Aktiviteti 2.3.3: Zgjidh problemin tim, të lutem!**Vështrim i përgjithshëm****Qëllimi:**

- Praktikoni të shkruani përshkrime të mira të problemeve;
- Praktikoni zgjidhje problemesh duke bashkëpunuar;
- Jepni opinionet për zgjidhjet që ka gjetur dikush tjetër.

Fokusi i aktivitetit:

- Problemet e pazgjidhura të pjesëmarrësve;
- Praktikant në bashkëpunim të pjesëmarrësve;
- Zgjidhjet e pjesëmarrësve;

Materialet dhe Metodadat:

- Fletë dhe lapsa;
- Punë grupi e vogël, reflektim, diskutim.

Informacion / alternativa shtesë

Direktivat e politikës për arsimin gjithëpërfshirës:

<http://unesdoc.unesco.org/images/0017/001778/177849e.pdf>

Përfaqja në bazë të të drejtave të njeriut për arsimin gjithëpërfshirës: E drejta për Arsim e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara: Bazuar në të Drejtat e tyre *Përfaqja për Arsimin Gjithëpërfshirës*.






Informacion për trajnuesit:

Ky ushtrim iu jep pjesëmarrësve një mundësi për të folur me të tjerët për një problem që ata nuk kanë qenë të aftë ta zgjidhin dhe të marrin ide se si ta zgjidhin atë. Grupet e vogla përqendrohen në problemet aktuale, në problemet e punës së përditshme të pjesëmarrësve. Grupeve iu kërkohet që të përdorin strukturat e Modelit Teorik të Aktivitetit dhe Ciklin e Zgjidhjes së Problemeve të prezantuar më parë, por kjo gjë duhet të jetë opsionale. Megjithëse ushtrimi duhet të përfundojë me shpirtin e partneritetit dhe argëtimit, ai duhet që të sigurojë edhe një mundësi për të praktikuar zgjidhjen e problemeve në bashkëpunim me të tjerët.

Natyra e problemit mbetet e hapur, por trajnuesi mund të zgjedhë që ta kufizojë sferën e problemit, duke thënë p.sh. se problemi do të jetë për përjetimin e kufizimit të pjesëmarrjes nga një fëmijë. Nëse kjo

gjë është e dobishme ose jo, do të varet nga konteksti. Një përqendrim i fortë tek pjesëmarrja mund të mbështesë të nxënit të pjesëmarrësve rreth kësaj teme por nga ana tjetër mund të perceptohet si shumë kufizuese nëse pjesëmarrësit do të dëshironin që të flisnin edhe për probleme të tjera.

Sekuena e Aktivitetit

<p><i>Zgjidh problemin tim, të lutem (Prezantim i seancës plenare)</i></p>  <p>Trajnuesi shpjegon ushtrimin: grupe të vogla lejojnë grupe të tjera të vogla që të zgjidhin problemet e tyre. Trajnuesi ndan grupet në grupe të vogla dhe jep udhëzimet (shiko slajdin).</p>  <p>Grupet e vogla bëjnë përshkrime të problemeve dhe jua dorëzojnë grupit tjetër.</p>  <p>Grupet vogla zgjidhin problemet që ia dha grupi tjetër.</p>	<p>Zgjidhe problemin tim, të lutem!</p> <p>Grupet e vogla shkruajnë një problem që ata e ndeshin në punën e tyre dhe kanë qenë të paaftë për t'i zgjidhur vetë. Ofroni sa më shumë informacion që të jetë e nevojshme, në mënyrë që një tjetër grup të jetë i aftë ta kuptojë plotësisht se cili është problemi juaj. Vendosni emrat tuaj në letër. Më pas, problemi shkëmbehet ndërmjet dy grupeve: secili grup ngarkohet me zgjidhjen e problemit të grupit tjetër. Ofrohen shabllone me modelin e aktivitetit dhe ciklin e zgjidhjes së problemit (përdorimi është opsional). Të dyja grupet mblidhen bashkë dhe ndajnë me të tjerët zgjidhjet e tyre. Ata i japin njëri-tjetrit reagime mbi dobishmërinë dhe aplikueshmërinë e zgjidhjeve të tyre. Përgatituni për të kontribuar në diskutimin e seancës plenare që do vijojë!</p>
<p><i>Opinione në Seancë plenare:</i></p>  <p>Përshkrime të mira të problemeve? Zgjidhje të dobishme? Ide të reja? Komete dhe përfundime.</p> <p>Ky slajd tregon ciklin e zgjidhjes së problemeve të cilin grupet e vogla mund ta përdorin për të gjetur zgjidhje duke bashkëpunuar. Pjesëmarrësit kanë një strukturë që mund ta përdorin për të hartuar zgjidhje. Struktura të Modelit Teorik të Aktivitetit mund të përdoren për të arritur një kuptim më të mirë të problemit dhe për të gjetur zgjidhje. Përdorimi i strukturave është opsional.</p>	<p>Bashkimi i provojave dhe ideve</p>  <pre> graph TD A(situa, problemi) --> B(matja, mbledhja) B --> C(analizimi, kuptimi) C --> D(planifikimi, vendimmarrja) D --> E(veprimi, zbatimi) E --> F(kontrolli, vlerësimi) F --> A </pre>

Tema 2.4:

Ndërtimi i skuadrave dhe koalicioneve për gjithëpërfshirje

Vështrim i përgjithshëm i Temës 2.4

Qëllimi i Temës

- Të arrish të kuptosh qëllimet dhe aktivitetet e një skuadre gjithëpërfshirëse;
- Rishqyrto çfarë ke mësuar deri më tani dhe si të ndihmon kjo gjë për ndërtimin e një skuadre gjithëpërfshirëse;
- Zhvillo strategji për të ndërtuar koalicione për gjithëpërfshirje në komunitetin tuaj;
- Mendo për gjërat që ende do të donit të mësonit.

Trajnuesit mund që jo vetëm të prezantojnë qëllimet dhe synimet e Temës, por gjithashtu mund të pyesin pjesëmarrësit që të shënojnë ndonjë pyetje që mund të kenë në lidhje me qëllimet dhe synimet e kësaj teme. Këto pyetje mund të përdoren përsëri kur ky problem të trajtohet në trajnim. Në fund të secilës temë, trajnuesi mund të pyesë nëse të gjitha pyetjet u shqyrtuan.

Këshillohet se para që të fillohet me këtë Teme, trajnuesi shikon Webinarin dhe lexon Broshurën teknike 13 të serive të UNICEF *Një Përfaqëse bazuar në të Drejtat e Njeriut për Arsimin Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara*, "Prindërit, Familja dhe përfshirja në komunitet".

Vështrim i përgjithshëm i aktiviteteve

Aktiviteti 2.4.1: Zgjidhja e problemeve të mëdha bashkërisht;

Aktiviteti 2.4.2: Reflektim për rolet dhe detyrat për një skuadër gjithëpërfshirëse;

Aktiviteti 2.4.3: Reflektim për marrëdhëniet duke përdorur hartën e bashkëpunimit;

Aktiviteti 2.4.4: Idetë dhe vizionet për të përmirësuar marrëdhëniet për gjithëpërfshirje.

Aktiviteti 2.4.1: Së bashku zgjidhim probleme më të mëdha

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Angazhoni të gjithë pjesëmarrësit në zgjidhje problemesh duke bashkëpunuar;
- Gjeni ide për të përmirësuar pjesëmarrjen në nivelin e komunitetit;
- Gjeni vizione dhe strategji për të arritur këto vizione.

Fokusi i aktivitetit:

- Situata e familjeve Rome në një komunitet (përdorni një grup social të përfshirë në komunitetin e Pjesëmarrësve);
- Kufizimet e pjesëmarrjes në të gjitha fushat e jetës.
- Vizionet dhe strategjitë për të përmirësuar pjesëmarrjen.

Materialet dhe Metodot:

- Karta të ndryshme identiteti, letra dhe laps, 7 flipcharte me fushat e jetës, shirit ngjitës për të ngjitur letrat në flipchart, pika ngjitëse jeshile dhe të kuqe, struktura e modelit teorik të aktivitetit
- Brainstorming, ndërtimi i vizionit dhe strategjive

Informacion / alternativa shitesë**Informacion për trajnuesin**

Ky aktivitet angazhon pjesëmarrësit në një aktivitet në grup për të përjetuar një proces të mundshëm i cili mund të përdoret për të filluar një projekt në nivelin e shkollës ose të komunitetit. Pjesëmarrësve iu kërkohet të marrin rolin e një personi (grup personash) në këtë komunitet. Duke i menduar problemet si ai person i caktuar, atyre iu kërkohet që të nxjerrin ide se çfarë mund të bëhet për të përmirësuar pjesëmarrjen e Romëve. Nëse modulet mësohen në një vend ose zonë pa popullsi Rome, trajnuesit do t'i duhet ta përshtatë këtë aktivitet me situatën lokale. Duke marrë në konsideratë situatën lokale, trajnuesit iu duhet të përgatisë "karta identiteti" për secilin nga pjesëmarrësit. Këto identitete duhet të jenë të ndjeshëm ndaj kulturës dhe mund të përfshijnë: Drejtor shkolle fillore, drejtor shkolle të mesme, mësuese kopshti me prejardhje rome, doktor familje, punonjës social, baba me prejardhje rome, adoleshent që e ka lënë shkollën, ndërmjetës kulturor, terapist gjuhe, përfaqësues i ministrisë së arsimit etj.

Idetë duhet të fokusohen në përmirësimin e pjesëmarrjes sidomos për fëmijët Romë, por pjesëmarrësit gjithashtu mund të zhvillojnë ide të tjera. Trajnuesi duhet të përgatisë flipcharte në mure, secila e titulluar me një nga fushat e mëposhtme të aktivitetit dhe pjesëmarrjes: "Mësimi dhe aplikimi i njohurive", "Komunikimi", "Lëvizshmëria", "Ndërveprimet ndërpersonale dhe marrëdhëniet", "Jeta shtëpiake", "Arsimi Shkollor", dhe "Jeta në komunitet". Një flipchart bosh mund të sigurohet për ndonjë ide tjetër.

Në fazën e dytë të këtij aktiviteti, të gjitha idetë duhet të projektohen dhe të analizohen: A janë këto ide me qëllime kontradiktore në të njëjtën fushë pjesëmarrjeje? Cilat ide janë të ngjashme? Cilat ide janë veçanërisht të mira dhe cilat duhet të zgjerohen më tej? Pjesëmarrësve duhet t'iu jepet mundësia për të ecur rreth dhomës dhe të diskutojnë me njeri tjetrin.

Më vonë pjesëmarrësit mund të pyeten që të vlerësojnë idetë, p.sh duke ngjitur pesë pika jeshile (për pesë idetë më të mira) pranë copave të letrës. Pjesëmarrësit mund të hezitohen të vlerësojnë idetë e kolegëve të tyre. Por në mënyrë që bashkëpunimi të jetë efikas, duhet që t'iu jepet prioritet ideve të mira. Trajnuesit duhet të bëjnë një foto të letrave në flipchart në mënyrë që idetë të jenë të disponueshme për të gjithë pjesëmarrësit. Nga të gjitha idetë e nxjerra, duhet të jenë disa ku "skuadrat e gjithëpërfshirjes në shkollë" luajnë një rol të rëndësishëm. Këto ide mund të merren në konsideratë më vonë në Temë.

Sekuena e aktivitetit

*Së bashku zgjidhim probleme më të mëdha
(Aktivitet në grup)*



Trajnuesi bën një prezantim të shkurtër për të shpjeguar aktivitetin në grup. Ai iu cakton pjesëmarrësve identitete të ndryshme duke dorëzuar kartat sipas rastit. Pjesëmarrësve iu kërkohet të nxjerrin ide se si mund të përmirësohet pjesëmarrja e Romëve.






Pjesëmarrësit shënojnë idetë (me shkronja të mëdha) duke përdorur një letër për çdo ide.

Së bashku zgjidhim "problemet e mëdha"

Në fshatin tuaj, shumë prej familjeve Rome nuk janë integruar si duhet në jetën e komunitetit. Fëmijet e tyre konsiderohen si persona që sjellin telashe dhe shpesh nuk ndjekin shkollën. Kjo nuk është e gjitha, pasi fëmijët e tjerë nuk i lejojnë të hipin në autobus. Disa fëmijë Romë marrin përfitime për aftësi të kufizuara dhe para që i përdorin për të blerë ushqim. Sa herë që diçka shkon keq, janë fëmijët Romë ata që fajësohen.

Tani, shkollat në fshat duan të fillojnë një projekt komunitar për të promovuar gjithëpërfshirjen sociale dhe arsimore. Ato organizojnë një eveniment, ku çdokush është i ftuar për të ndarë idetë etij/saj se çfarë mund të bëhet.

 <p>Të gjithë pjesëmarrësit përpiqen t'i caktojnë idetë e tyre fushës së jetës dhe ngjisin idetë e tyre në flipchart. Pasi kjo gjë përfundon, pjesëmarrësit thirren që të lexojnë idetë e tyre, pavarësisht nëse janë të ngjashme ose shumë të ndryshme. Pjesëmarrësit mund t'i vlerësojnë sa të duan idetë duke përdorur pikat jeshile ose një shenjë "e pëlqej".</p>	<p>Ju është dhënë një kartë me një identitet. Duke u nisur nga pikëpamja e këtij personi: Jepni ide se çfarë mund të bëhet për të promovuar pjesëmarrjen. Përdorni një copë letre për secilën ide Shkruajeni atë me shkronja të mëdha në mënyrë që të lexohet nga një distancë prej dy metrash.</p>
 <p>Trajnuesit duhet t'i përfshijnë të gjithë pjesëmarrësit në një diskutim informal dhe të bëjnë një fotografi të të gjitha flipcharteve sapo vlerësimi të ketë përfunduar.</p>  <p>Marrja në pyetje (Seancë plenare) Ky ushtrim mund të mos jetë shumë i lehtë për të gjithë pjesëmarrësit, prandaj bëni plan për një marrje në pyetje. Kjo mund të jetë më e gjatë ose më e shkurtër në varësi të situatës.</p> <p>Trajnuesi merr me radhë të gjitha pyetjet në një seancë plenare dhe pjesëmarrësit japin opinione dhe informacione.</p>	<p style="text-align: center;">Marrja në pyetje</p> <p>A keni komente për ushtrimin ose se u ndjetë kur po bënit ushtrimin?</p> <p>Ishte e vështirë t'i shihnit idetë tuaja të diskutoheshin dhe të vlerësoheshin?</p> <p>A mund t'i shndërroni disa nga këto aktivitete në një projekt ose iniciativë?</p> <p>A mund të hartoni strategji se si të bëni një projekt të tillë?</p> <p>A mund ta imagjinoni që të bëni diçka si kjo në komunitetin tuaj?</p> <p>A mund të raportoni për projekte të ngjashme që dini ose që keni marrë pjesë?</p>

Aktiviteti 2.4.2: Reflektimi i roleve dhe detyrave të një ekipi gjithëpërfshirës

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Siguroni një mundësi për një eksplorim të parë "të ekipit gjithëpërfshirës";
- Reflektoni për qëllimet që mund të arrihen në një "ekip gjithëpërfshirës";
- Reflektoni për bashkëpunimet aktuale dhe si mund të përmirësohen.

Fokusi i aktivitetit:

- Të kuptuarit e pjesëmarrësve për një ekip gjithëpërfshirës;
- Qëllimi i krijimit të një skuadre gjithëpërfshirëse;
- Bashkëpunimet aktuale siç paraqiten në hartën e bashkëpunimit.

Materialet dhe Metodot:

Nuk nevojitet material, struktura e modelit teorik të aktivitetit (opsionale).

Informacion / alternativa shtesë

Informacion për trajnuesit:

Tashmë trajnuesi do të ketë arritur të kuptojë se si pjesëmarrësit i shikojnë kolegët e tyre dhe nivelin e tyre të bashkëpunimit për të zgjidhur situata të vështira në shkollë. Trajnuesi gjithashtu duhet të konsiderojë punën e bërë deri më tani nga pjesëmarrësit dhe të jetë i aftë të vërë në dukje fuqitë dhe dobësitë e tyre, gjithashtu mundësitë dhe rreziqet (SWOT-Analysis) e krijimit të ekipeve në shkollë që mbështesin realizimin progresiv të gjithëpërfshirjes dhe që mund të shërbejnë si "shumëfishues" dhe "promovues".







Në mënyrë që të kuptohen më mirë rolet e ekipeve gjithëpërfshirëse dhe për të eksploruar se cilat role janë të mundshme duke pasur parasysh rrethanat, pjesëmarrësit duhet të eksplorojnë se në cilat përgjegjësi ose role dhe në cilat detyra ose aktivitete duhet të përfshihen skuadrat gjithëpërfshirëse.

Dhënia e shembujve në këtë moment është shumë e dobishme. Shembujt mund të jepen nga vetë trajnuesi, ose pjesëmarrësit të cilët kanë përvojë pune në ekipe, mund të ndajnë nga eksperiencën e tyre me grupin.

Për të zhvilluar këtë aktivitet mund të gjendet material filmik në YouTube ose në burime të tjera. Kjo mund të përdoret si një hyrje e këtij aktiviteti. Forma e prezantuar në modulin 1 mund të ndihmojë që të vendosni praktika të ndryshme: duke dhënë mësim si ekip në klasë, duke lehtësuar bashkëpunimin prind-shkollë, duke krijuar një këshill studentor, duke drejtuar proceset e zhvillimit të shkollave, etj., për të përmendur disa.

Në pjesën e dytë të aktivitetit, trajnuesi duhet të zgjedhë disa nga qëllimet më premtuese ose më të rëndësishme të përmendura nga pjesëmarrësit për tu eksploruar më në detaj. Kjo do t'i ndihmojë pjesëmarrësit të zhvillojnë sistemin e tyre të menduarit dhe të konsiderojnë kontradikta të mundshme ose probleme që mund të hasen gjatë një praktike të tillë. Për shembull, skuadra mund të ketë një vizion të përbashkët dhe madje mund të përfshihen bashkërisht për të njëjtin qëllim. Por “ku” mund të mos jetë i favorshëm për praktika të tilla (vendimet nga ministria, mungesa e kohës në dispozicion) dhe mund të mos ketë mjete të përbashkëta (strategji pune të përbashkëta, forma për planifikimin arsimor individual, aftësi bashkëpunimi) për të punuar bashkërisht drejt vizionit ose qëllimit. Pjesëmarrësit duhet të kenë mundësi për të zgjidhur aktivitetet të tilla bashkë me të tjerët, me ose pa udhëzimin e trajnuesit.

Sekuena e aktivitetit

<p><i>Qëllimi i ekipeve gjithëpërfshirëse (Seancë plenare)</i></p>  <p>Trajnuesi bën një prezantim të qëllimit e të pasurit skuadra gjithëpërfshirëse në shkolla në cilat nga detyrat e aktiviteteve mund të përfshihen skuadrat gjithëpërfshirëse. Pjesëmarrësit duhet të kujtohen se këtë fushë e diskutuan në Modulin 1 dhe janë marrë nga “Profili i Mësuesve Gjithëpërfshirës”. Duhet të paraqiten shembuj (p.sh. video, histori personale, çështje studimore) për të ilustruar disa role dhe detyra për të ndihmuar diskutimin.</p>  <p>Diskutimet në grup rreth këtyre tre fushave, paraqitja e përvojave të pjesëmarrësve dhe qëllimet që ata përfaqësojnë për një skuadër shkolle. Trajnuesi mund ta lidhë këtë me formën në modulin 1. Prezantimi i rezultateve në seancë plenare (nëse diskutimet kryhen në grupe më të vogla)</p>	<p>Një skuadër gjithëpërfshirëse — për çfarë?</p> <p>Qëllimi i përgjithshëm për “Skuadrën gjithëpërfshirëse” është të punojmë së bashku për:</p> <p>Vlerësimin e diversitetit të nxënësit —kërkon komunikimin, jo diskriminim dhe përdorim të arsyetuar të pushtetit/fuqisë “Jo fëmijë të lënë mënjane”</p> <p>Mbështetjen e të gjithë nxënësve — kërkon konsiderimin e nxënësve si partnere aktive të mësimdhënies dhe të të nxënësve, dhe jo si objektiva pasive «Jo hinke Nurembergu».</p> <p>Zhvillimin profesional personal — kërkon partneritetet ndërmjet të gjithë profesionisteve për të nxënësit “Jo izolim të mësuesit”</p> <p>Çfarë mendoni se duhet të bëjë një skuadër gjithëpërfshirëse për shkollën — duke marrë parasysh këto tre fusha të kompetencave mësuesve gjithëpërfshirës?</p> <p>Në cilën fushë do të mirëprisnit mbështetje nga profesionistët e tjerë?</p>
<p><i>Sinteza e ideve (Seancë plenare)</i></p>  <p>Modeli teorik i aktivitetit mund të përdoret për të bërë një analizë në tërësi të disa prej qëllimeve të përmendura nga grupi. Kjo mund të bëhet në dërrasë, në flipcharte ose me kompjuter. Të paktën tre prej qëllimeve të aktivitetit duhet të eksplorohe bashkërisht.</p>  <p>Nëse trajnuesi mendon se kjo do të ishte e dobishme, mund të krijohen grupe të vogla për të eksploruar qëllimet shtesë dhe kushtet e nevojshme për t'i arritur ato (shabllone mund të sigurohen nëse është e nevojshme).</p>  <p>Diskutimi përfundimtar (mundësisht një prezantim i modeleve të aktivitetit) duhet të vijojë për të përfunduar aktivitetin.</p>	<p>Bashkimi i ideve</p>  <p>Cili është qëllimi i të punuarit së bashku? (Qëllimi)</p> <p>Çfarë bën skuadra e gjithëpërfshirjes shkollore? (Objekti)</p> <p>Kush përfshihet dhe çfarë bëjnë? (Subjekti)</p> <p>Si punojnë ata së bashku? (Mjete dhe artikulj)</p>

Aktiviteti 2.4.3: Reflektim mbi marrëdhëniet duke përdorur hartën e bashkëpunimit.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Të reflektoni për bashkëpunimet aktuale në lidhje me përmbajtjen e këtij moduli;
- Të angazhoheni në diskutime rreth bashkëpunimit;
- Të zhvilloni ide se si marrëdhëniet në lidhje me gjithëpërfshirjen mund të përmirësohen.

Fokusi i aktivitetit:

Harta e bashkëpunimit e zhvilluar në temën 1 të modulit 2;

Natyra e marrëdhënieve profesionale;

Përmirësimi i marrëdhënieve për të lehtësuar gjithëpërfshirjen.

Materialet dhe Metodadat:

Flipcharte, stilolapsa (opsionale) për raportim; reflektim, diskutim, shkëmbim idesh.




Informacion / alternativa shtesë

Informacion për trajnuesit:

Ky aktivitet i kthen pjesëmarrësit në punën e tyre fillestare dhe në kontributin e parë të tyre në këtë modul dhe u bën disa pyetje të vështira rreth premisave që ndodhen në themel të marrëdhënieve të caktuara, të shpërndarjes së fuqisë dhe të paragjyqimeve që njerëzit kanë. Këto paragjyqime mund të pengojnë partnerët me të cilët bashkëpunojmë që të kontribuojnë në një mënyrë kuptimplotë. Mënyra se si marrëdhëniet përjetohen mund të kontribuojë në përjashtim dhe nëse një shkollë dëshiron të promovojë gjithëpërfshirje, atëherë natyra e këtyre marrëdhënieve duhet të ndryshohet.

Për shembull, një shkollë mund të angazhohet në praktika ku ato ftojnë në shkollë prindërit e nxënësve që nuk kanë mundur të kalojnë klasën kanë ngelur dhe t'i marrin në interviste (e cila është më shumë një marrje në pyetje). Trajnuesi mund t'i referohet çështjes studimore që ishte përdorur në Temën 2 (Aktiviteti 2.1.2). qëllimi i marrjes së informacioni mund të jetë i vlefshëm, por shkollat duhet të reflektojnë në mënyrat se si do të angazhojnë prindërit. Duke eksploruar më tej çështjen studimore, trajnuesi mund të zhvillojë ide se si mund të arrihet që kjo gjë të ndihmojë pjesëmarrësit me këtë aktivitet.

Sekuencë e aktivitetit

<p><i>Reflektim mbi hartën e bashkëpunimit (Seancë plenare)</i></p>  <p>Trajnuesi bën një prezantim të këtij aktiviteti dhe shpjegon se çfarë duhet të bëhet. Trajnuesi mund t'i kthehet çështjes studimore të Florica dhe prindërve të saj, duke i kujtuar pjesëmarrësit se çfarë ishte thënë, duke e përdorur këtë gjë për të shpjeguar pyetjet.</p>  <p>Pjesëmarrësit punojnë në mënyrë individuale ose në grup në varësi se si ishte zhvilluar harta e bashkëpunimit. Kjo është gjithashtu një rishqyrtim i përmbajtjes në lidhje me atë që ishte në modulën 1 dhe 2.</p>  <p>Trajnuesi duhet të sigurohet se 10 minuta par se të mbarojë koha, të gjithë individët/grupet të shënojnë idetë e tyre për të përmirësuar marrëdhëniet.</p>	<h4>Marrëdhëniet në skuadrat gjithëpërfshirëse</h4> <p>Kthehuni te harta e bashkëpunimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Mendoni për identitetet sociale të të gjithë personave në hartën tuaj (referojuni temës 3 në modulën 1). ▪ Vlerat, besimet dhe ndjenjat e kujt edominojnë bashkëpunimin? ▪ Kush po i dominon marrëdhëniet? ▪ Kush ka më shumë fuqi institucionale? ▪ Kush është marxhinalizuar dhe pse? ▪ ka anshmëri brenda dhe jashtë grupit? <p>Shkruajini mendimet tuaja. Diskutojini mendimet tuaja me koleget. Lidheni diskutimin me temën 2 të modulit 1 - kompetencat për diversitet. Idetë për përmirësimin që ju doni t'i ndani me të tjerët.</p>
---	---

Aktiviteti 2.4.4: Idetë dhe vizionet për të përmirësuar marrëdhëniet për gjithëpërfshirje.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Ndarja e ideve për përmirësimin e marrëdhënieve në lidhje me gjithëpërfshirjen;
- Mblidhni idetë më të mira të zhvilluara nga pjesëmarrësit;

Fokusi i aktivitetit:

Idetë tuaja dhe të tjerëve se si të përmirësoni marrëdhëniet.

Materialet dhe Metodot:

Flipchart dhe stilolaps (për trajnuesin që të dokumentojë idetë më të mira);
Ndërveprim, reflektim, diskutim.

Informacion / alternativa shtesë



Informacion për trajnuesin:

Ky aktivitet inkurajon pjesëmarrësit të ndajnë idetë e tyre me të tjerët dhe të marrin opinione se si ata mund t'i përmirësojnë idetë. Ky është gjithashtu një "proces vlerësimi" informal ky pjesëmarrësit marrin opinione nga kolegët e tyre. Ky duhet të jetë gjithashtu një moment ku festohet përparimi i bërë nga pjesëmarrësit, procesi i tyre i të nxënimit dhe rezultatet që ata kanë arritur.

Si gjithmonë, cilësia e produktit varet nga situata. Trajnuesi mund ta lehtësojë procesin duke krijuar një mjedis plot besim dhe të përshtatshëm dhe duke i motivuar pjesëmarrësit që t'i ndajnë me të vërtetë idetë e tyre dhe të mos kenë frike nga kritikën ose mosinteresi i të tjerëve. Aftësia dhe gatishmëria për të mësuar nga të tjerët është më e rëndësishmja për arsimin gjithëpërfshirës.

Trajnuesi duhet të sigurohet që idetë për përmirësim të paraqitura në seancë plenare të jenë regjistruar në mënyrë të rregullt dhe të jenë të disponueshme për të gjithë pjesëmarrësit.

Sekuena e aktivitetit

<i>Ndarja e ideve për përmirësim (Seancë plenare)</i>	Ndarja e ideve për përmirësimin
 <p>Trajnuesi jep udhëzimet për të ndihmuar këtë sekuencë shkëmbimesh ndërmjet individëve ose grupe të vogla.</p>  <p>Individët ose grupet e vogla-pasi kanë dëgjuar opinionet nga të tjerët dhe pasi kanë marrë idetë se si të përmirësojnë ato të tyre, ndajnë idetë më të mira në seancë plenare.</p> <p>Trajnuesi duhet të sigurohet që këto ide të dokumentohen dhe të jenë të disponueshme për të gjithë.</p>	<p>Le t'i bashkojmë idetë!</p> <p>Merrni idetë tuaja dhe shikoni për dikë me të cilin nuk keni punuar ose shkëmbyer përvoja. Me radhë, tregojini personit tjetër idetë tuaja se si mund të përmirësohen skuadrat gjithëpërfshirëse për shkollën.</p> <p>Pas shkëmbimit dhe një eksplorimi se si ideja mund të përmirësohet, shkoni te një person tjetër dhe përsëriteni të njëjtën procedurë.</p> <p>Idetë më të mira duhet të prezantohen në seancën plenare dhe të dokumentohen për të gjithë pjesëmarrësit!</p>

Modulet ToT për arsimin gjithëpërfshirës

Moduli 3:

**Krijimi i mjediseve për të nxënit
e personalizuar**

Hyrje

Prezantim i plotë i qëllimit

Moduli 3 përqendrohet në mjediset e të nxënimit për të nxënimit e personalizuar. Premisa bazë e të nxënimit të personalizuar është se shkolla ekziston për fëmijët dhe jo e kundërta, prandaj shkollat duhet të përshtaten për të mundësuar të nxënimit e nxënësve sa më shumë të jetë e mundur. Por, shkollat duhet të përmbushin gjithashtu edhe funksione të tjera; për shembull, të rikrijojë rendin social të shoqërisë, që përfshin një proces përzgjedhjeje (ndërsa të gjithë kryejnë një funksion, jo të gjithë mund të bëhet ministër, avokat ose mjek). Këto dinamika sociale dhe mënyra se si ato ndikojnë në funksionimin e shkollave nuk duhet harruar gjithashtu dhe mësuesit duhet të ndërtojë njohësit për bisedat/ligjëratat që bëhen nga shumë njerëz në lidhje me faktin se çfarë e bën një mësues të mirë: Një mësues që investon te nxënësit e shkëlqyer? Një mësues që shpenzon shumë kohë për të mbështetur nxënësit e që kanë rezultate jo të larta? Një mësues që kap vlerësimet më të larta në provimet kombëtare të nxënësve? Për më tepër, të gjitha shkollat kanë burime të kufizuara dhe mësime tradicionale mund të duket si një metodë e efektshme për të adresuar klasat e mëdha që mësojnë në hapësira minimale dhe pa materiale për të nxënimit e personalizuar. Realiteti i kushteve të punës të pjesëmarrësve nuk duhet nënvlerësuar ndërsa jeni duke punuar me këtë modul.

Të nxënimit e personalizuar nënkupton që çdo fëmijë pranohet si person me talente dhe aftësi, me një formim të caktuar familjar, identitet social dhe përvoja të mëparshme të të nxënimit. Çdo fëmijë është i/e aftë të mësojë; të nxënimit është një pjesë thelbësore e natyrës njerëzore. Çdo fëmijë dëshiron të jetë pjesë e komunitetit. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, është që çdo fëmijë ka aspirata, ëndrra, shpresa dhe dëshirë për të qenë i pavarur; një agjent i të drejtës së tij ose saj. Përvoja e kompetencës, përkatësisë dhe pavarësisë është thelbësore për të nxënimit, sepse vetëm fëmijët që marrin pjesë në një aktivitet mund të mësojnë nga ai (shikoni Broshurën Prezantuese). Moduli 3 kërkon të ilustron mënyrën se si mësuesit mund t'u përgjigjen këtyre nevojave në klasë. Për të mësuar më shumë rreth mësuesve, mësime dhe të nxënimit, dhe pedagogjisë me në qendër nxënësin, ju lutemi shikoni Broshurën 12 të Serive të UNICEF-it A Rights-Based Approach to Inclusive Education for Children with Disabilities.

Tradicionalisht, vëmendja e mësuesve është më shumë te grupi sesa te individët fëmijë dhe kur përgatiten për të dhënë mësim ata marrin parasysh interesat dhe përvojat e mëparshme të të nxënimit të grupit. Meqenëse fëmijët klasifikohen në grupe homogjene sipas moshës, mësuesit presin homogjenitet edhe përsa i përket njohurive, interesave, stileve të të nxënimit, stileve të ndërveprimit, etj. Nëse të gjithë fëmijët janë të njëjtë dhe duan të mësojnë të njëjtat gjëra në të njëjtën kohë, mësimi në grup është mënyra më efektive dhe e efektshme. Por rrallë ndodh që të jetë kështu; prandaj disa fëmijë, në përgjithësi, mbeten prapa, që në shumë sisteme shkollash konsiderohet si diçka normale. Arsimi gjithëpërfshirës e sfidon këtë ide dhe thekson të drejtën e çdo fëmije për të mësuar. Për vetë faktin që besimet dhe premiset e mësuesve për të nxënimit kanë një ndikim të rëndësishëm te fëmijët, ata duhet të trajtohen dhe të jenë më të qartë. Moduli i adreson këto përmes shembujve dhe studimeve të rastit që i theksojnë këto besime/ide – pa i vënë në siklet pjesëmarrësit. Për faktin që shumë nga ajo çfarë mbulohet në këtë modul supozon se trajnuesi ka një besim të thellë se fëmijët janë agjentët e ndryshimit dhe të aftë për të krijuar (dhe përçarur) dëshirat e tyre, është e rëndësishme që ai/ajo të familjarizohet me punën e Save the Children UK, në lidhje me pjesëmarrjen e fëmijëve. Ju lutemi, shikoni: <http://www.inclusive-education.org/publications/see-me-hear-me-guide-using-un-convention-rights-persons-disabilities-promote-rights>.

Tradicionalisht, vëmendja e mësuesit është më shumë te detyrat se sa te situatat, dhe më shumë te përmbajtja e kurrikulës sesa te kompetencat e nxënësit. Nëse nxënësit i përmbushin detyrat dhe përmbajtja e kurrikulës mësohet deri në fund të vitit shkollor, çdo gjë duket sikur është në rregull. Por, a mësuan nxënësit vërtetë diçka domethënëse për ta përdorur në jetën e përditshme? Evidencat e përdorura në Modulin 1 dhe rezultatet nga programet ndërkombëtare për vlerësimin e nxënësit kanë treguar se metodat e mësimdhënies tradicionale nuk janë efektive, veçanërisht në klasat me diverzitet. Kalimi i vëmendjes nga detyrat te situatat dhe nga përmbajtja te kompetencat nuk është diçka që arrihet në pak ditë. Qasja bazuar në situatë për mësimdhënien dhe të nxënët përshkon të tre modulet (modeli i teorisë së aktivitetit) dhe aplikohet sërish në modulin 3. Moduli 3 thekson rëndësinë e përcaktimit të qëllimit si një veprim i parashikimit të kompetencave të nxënësit në të ardhmen drejt mësimdhënies. Pjesëmarrësve u jepet mundësia për të praktikuar përcaktimin e qëllimit si një nga pjesët më të rëndësishme të planifikimit të mësimdhënies së personalizuar. Përpara fillimit të këtij moduli është e rëndësishme që trajnuesi të familjarizohet plotësisht me përmbajtjen e Broshurës/Webinarit 11 - Aksesit në Mjedisin e të Nxënët II, Projektim Universal për të Nxënët – në Seritë e UNICEF-it A Rights-Based Approach to Inclusive Education for Children with Disabilities, si edhe Broshurën/Webinarin 12 - Mësuesit, Mësimdhënia dhe Pedagogjia Gjithëpërfshirëse dhe me në Qendër Nxënësin – në të njëjtat seri.

Vështrim i përgjithshëm

Moduli 3 ka të bëjë me krijimin e mjediseve për të nxënët e personalizuar. Tema 1 përqendrohet në situatën e të nxënët të fëmijëve dhe të rinjve, dhe se si ndërgjegjësimi i mësuesve dhe nxënësve për situatën i çon ata në veprim. Për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit të mësuesve për situatën, shumë mundësi të nxënët nuk vihen re dhe barrierat për të nxënët mbeten të padukshme për mësuesit. Fëmijët reagojnë ndaj informacionit kontekstual; kjo ndikon në qasjen e tyre për zgjidhjen e problemit dhe në përfundimet e të nxënët. Shembuj të ndryshëm jepen dhe punohet mbi ta për t'i ndihmuar pjesëmarrësit të kuptojnë ndikimet kontekstuale në sjelljen njerëzore. Për ta plotësuar temën e parë, përdoret Modeli i Teorisë së Aktivitetit për të reflektuar përbërësit e ndryshëm që ndikojnë në mënyrën se si dikush vepron në një situatë të dhënë.

Tema 2 përqendrohet në hapin tjetër të ciklit të zgjidhjes së problemit: sapo një person e ka kuptuar mirë një situatë (analiza/kuptimi), ai ose ajo fillon të imagjinojë, mënyra të mundshme për të ecur përpara. Disa njerëz kanë metoda procedurale shumë intuitive për zgjidhjen e problemit (le ta fillojmë që këtu dhe të shohim se çfarë ndodh), të tjerët i vendosin vetes qëllime të qarta, përcaktojnë rezultatet e pritshme dhe vazhdojnë më tej të mendojnë për strategjinë. Përcaktimi i qëllimit eksplorohet fillimisht në jetën e përditshme për të çuar më pas në eksperiencat e pjesëmarrësve dhe reflektohet brenda qasjes së ciklit të jetës. Pjesëmarrësit udhëzohen përmes një serie ushtrimesh për të diferencuar qëllimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata midis tyre se si orientohen drejt performancës, arritjes dhe aftësive. Vëmendja e tyre tërhiqet nga fakti se sa shpesh ata përballen me qëllime konfliktuese në jetën e tyre profesionale. Ajo se çfarë konsiderohet më e mirë për fëmijën, të promovojë aftësitë e tij ose saj, nuk është domosdoshmërisht në interes të shkollave ose mësuesve.

Tema 3 i kushtohet personalizimit të situatave të të nxënët dhe përpiqet të theksojë faktin se kjo nuk do të thotë të zhvillosh një program individual për secilin nxënës (ose për nxënësit "e veçantë") dhe në këtë mënyrë i izolon fëmijët nga njëri-tjetri. Vëmendja e pjesëmarrësve tërhiqet fillimisht për faktin se, në ndonjë situatë të dhënë, ka shumë gjëra të ndryshme për të mësuar. Sërish, varet nga ndërgjegjësimi i mësuesve për situatën nëse ai ose ajo është i, e vetëdijshëm për këto mundësi. Duke përdorur studimin e rastit të prezantuar në temën 1, pjesëmarrësit ftohen për të menduar për sa më shumë mundësi të nxënët që të jetë e mundur – bazuar në sekuencën e parë (tregimi i fabulës "Qengji dhe ujku"). Më pas, pjesëmarrësit zhvillojnë qëllime të ndryshme që mund të arrihen duke dhënë e mundësi të ndryshme për të nxënët. Mundësitë e të nxënët hapen pa bërë ndonjë përshtatje në klasë, sepse ato janë mundësi të reja në mendjen e mësuesit. Përshtatja e mjediseve të të nxënët është pika e fundit e bërë në këtë temë sepse pjesëmarrësit fillimisht ftohen për të reflektuar mbi kompetencat e tyre personale në lidhje me të qenit një mësues gjithëpërfshirës.

Tema 4 kërkon të sjellë së bashku çdo gjë që është trajtuar në tre modulet. Pjesëmarrësit kanë mundësinë të diskutojnë me njëri-tjetrin për atë çfarë duan dhe se çfarë duhet prezantuar ose ndryshuar në shkollën e tyre për të promovuar arsimin gjithëpërfshirës. Pas kësaj, grupet zgjedhin idetë më të mira dhe i

konkretizojnë ato, në mënyrë që të mund të përdoren në mjedisin e tyre dhe të ndahen me pjesëmarrësit e tjerë. Një aktivitet i fundit do të ketë nevojë të zhvillohet nga trajnuesi, pasi do të përmbushë kërkesat lokale.

Pjesëmarrësit

Trajnimi është i suksesshëm vetëm kur ia del që të prekë njohuritë, përvojat dhe besimet që pjesëmarrësit sjellin në trajnim. Ky modul duhet t'i aftësojë pjesëmarrësit të jenë agjentë ndryshimi për arsimin gjithëpërfshirës në punën e tyre. Për tu bërë agjentë ndryshimi pjesëmarrësit duhet të reflektojnë mbi situatën aktuale dhe veprimet e tyre dhe të krijojnë lidhje me përmbajtjet e modulit. .

Është me rëndësi që trajnuesi para dhënies së trajnimit të marrë sa më shumë informacion mbi backgroundin e pjesëmarrësve. Me rëndësi të veçantë është që të kemi informacion të hollësishëm mbi interesat dhe zhvillimin profesional të pjesëmarrësve.: a janë ata kandidat për mësues, a janë ata mësues të rinj apo mësues me përvojë? A janë ata edukatorë apo mësues mentorë? Diversiteti në formimin e pjesëmarrësve mund të përdoret në mënyrë konstruktive duke mundësuar të nxënit midis pjesëmarrësve. Kjo krijon një mundësi për të aplikuar parimet e arsimit gjithëpërfshirës.

Duhet menduar edhe për mënyrat sipas të cilave pjesëmarrësit do të mbështeten në të nxënit e tyre personal. Ka mjete të ndryshme që mund të përdoren për ta bërë të nxënit të dukshëm (siç është krijimi i një portofoli ose mbajtja e ditarëve të të nxënit).

Krijimi i mjedisit

Situata e krijuar gjatë trajnimit duhet të lehtësojë shkëmbimin, diskutimin dhe dokumentimin e mendimeve, pritshmërive dhe ideve. Duhet të promovohen idetë dhe parimet e arsimit gjithëpërfshirës duke vlerësuar përvojat e ndryshme që pjesëmarrësit sjellin në trajnim, duke mundësuar të nxënit individual dhe duke krijuar një atmosferë bashkëpunuese.

Modulet janë të bazuara në aktivitete sepse kërkojnë të mbështesin trajnuesin në krijimin e mundësive për të nxënë. Gjithashtu, pjesëmarrësit kanë nevojë për disa të dhëna, në mënyrë që ata mund t'i besojnë një organizimi për ndarjen e njohurive që të marrin pjesë dhe të bashkëpunojnë. Mjedisi i të nxënit i krijuar nga trajnuesi duhet të lehtësojë të nxënit aktiv dhe jo të përçojë informacionin që gjendet diku tjetër.

Një pjesë e rëndësishme e të qenit mundësues i të nxënit është që trajnuesi të sigurojë se të nxënit është i dukshëm. Moduli ofron sugjerime se si një gjë e tillë mund të bëhet për aktivitetet individuale. Gjithashtu trajnuesi do të japë disa mendime për dokumentimin e të nxënit të pjesëmarrësve, mbajtjen e shënimeve për rezultatet e rëndësishme nga diskutimet dhe puna individuale, dhe lehtësimin e zhvendosjes në mjedisin e punës së pjesëmarrësve.

Trajnimi do të jetë më efektiv nëse krijohen lidhje midis situatës së trajnimit dhe asaj të punës aktuale. Kjo mund të arrihet përmes integritit të modulit në një projekt ose aktivitet gjithëpërfshirës që kërkon të promovojë arsimin gjithëpërfshirës në shkollë dhe komunitet. Nëse modulet e trajnimit kombinohen me punën zhvillimore, praktika mund të përmirësojë të nxënit e moduleve. Aktivitetet e ofruara në këtë modul mund të zgjerohen në punë praktike në shkolla.

Si t'i qasemi modulit

Trajnuesit duhet të ndihen rehat me përmbajtjet dhe konceptet e këtij moduli dhe kjo arrihet, nëse ata janë përfshirë më parë aktivisht si nxënës. Nëse trajnuesi nuk ndihet rehat me disa nga aktivitetet, ai ose ajo mund të marrë parasysh krijimin e aktiviteteve alternative që i shërbejnë qëllimeve të njëjta ose të ngjashme.

Konceptet e prezantuara në këtë modul nuk janë gjëra që duhen mësuar, por gjëra që duhen përdorur. Kuptueshmëria konceptuale do të thellohet përmes aplikimit të këtyre koncepteve në problemet e përditshme praktike. Konceptet duhet të shihen si mjete për të menduar dhe për të orientuar veprimin dhe jo si diçka për ta mësuar si një pjesë të izoluar të njohurisë. Prandaj, prezantimi teorik i koncepteve duhet të jetë në minimum, për të siguruar mundësi të përshtatshme për të menduarit aktiv dhe zgjidhjen e problemit.

Për t'i ndihmuar pjesëmarrësit të orientohen, është e rëndësishme të ofrohet një vështrim i përgjithshëm i temave të moduleve dhe të jepen mundësi për rishikim. Prandaj, koha duhet shpenzuar për të prezantuar synimin dhe qëllimet e temës. Edhe pse kjo nuk është përcaktuar si një aktivitet, duhet të jetë pika e parë kyçe e trajnimit. Kjo do t'i lejojë pjesëmarrësit të orientohen, gjë që është e nevojshme për një nxënës aktiv. Synimet e listuara për çdo temë duhet të ndahen me pjesëmarrësit dhe të përdoren për të krijuar një vështrim të përgjithshëm si dhe për të rishikuar temat dhe modulet.

Produktet e krijuara nga pjesëmarrësit duhet të jenë aq domethënëse sa të mund të përdoren sërish gjatë trajnimit. Përderisa dobishmëria e këtyre produkteve do të varet nga cilësia e tyre, trajnuesi duhet të marrë parasysh se si do t'i përdorë ato .

Tema 3.1:

Analizimi i situatës të të nxënit për fëmijët dhe të rinjtë

Vështrim i përgjithshëm i Temës 3.1

Qëllimi i temës

- Aplikoni çfarë keni mësuar deri tani për analizimin e situatave të të nxënit;
- Mësoni të analizoni një situatë nisur nga perspektiva e mësuesit dhe nxënësit;
- Praktikoni të përqendroheni në situata më shumë sesa në karakteristikat e nxënësit.

Trajnuesit nuk duhet që thjesht të prezantojnë qëllimet dhe synimet e temës, por duhet t'u kërkojnë pjesëmarrësve të shkruajnë ndonjë pyetje që ata kanë në lidhje me përmbajtjet dhe qëllimet e kësaj teme. Këto pyetje mund të përdoren sërish kur çështja trajtohet në trajnim. Në fund të çdo teme, trajnuesi mund të pyesë nëse janë trajtuar të gjitha pyetjet.

Vështrim i përgjithshëm i Aktiviteteve

Aktiviteti 3.1.1: Nxemja: Ndërgjegjësimi për situatën;

Aktiviteti 3.1.2: Studim rasti "Qengji dhe ujku";

Aktiviteti 3.1.3: Kuptimi i ndërgjegjësimit për situatën te fëmijët;

Aktiviteti 3.1.4: Testi Marshmalloë Test i rivizituar;

Aktiviteti 3.1.5: Aplikimi i modelit të Sarës dhe kolegëve e saj.

Aktiviteti 3.1.1: Nxemja: Ndërgjegjësimi për situatën.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Jini në kontakt me rëndësinë e ndërgjegjësimit për situatën;
- Reflektoni mbi ndikimin e ndërgjegjësimit për situatën në vendimmarrje;
- Nxemja për të kryer punë mbi studimin e rastit "Qengji dhe ujku".

Fokusi i aktivitetit:

- Dy situata që krijojnë lidhje të dyfishtë;
- Ndërgjegjësim personal për situatën;
- Ndikimi i ndërgjegjësimit për situatën në vendimmarrje.

Materiale dhe Metoda:

- Udhëzime në slajd, letër dhe laps (opsionale);
- Ekzaminim i ndjenjave dhe mendimeve personale dhe diskutim.





Informacion/alternativa shpesh:

Informacion për trajnuesin

Të ndërgjegjësohesh për situatën do të thotë të dish se çfarë po ndodh në mjedisin aktual në atë kontekst, vend dhe në atë kohë. Por, nuk përfundon këtu. Ndërgjegjësimi për situatën formohet nga kuptimi se çfarë ka ndodhur më parë (gjërat që çuan në mjedisin aktual që po përjetoni) dhe të jesh i aftë të parashikosh ngjarjet e ardhshme përpara sesa ato të shpalosen (këto gjëra që nuk kanë ndodhur akoma por që parashikohen të ndodhin – rezultatet e veprimeve ose mos veprimeve tuaja). Shikoni: <http://www.samatters.com/using-simulation-environment-to-improve-situational-awareness/>. Ndërgjegjësimi për situatën është i rëndësishëm për arsimin gjithëpërfshirës sepse perceptimi dhe interpretimi i një situatë ka ndikim të madh në veprimet e mësuesve. Duke qënë se mësuesit janë partneri më i fuqishëm në mjedisin e klasës, ndërgjegjësimi i tyre do të ketë një ndikim të madh në motivimin e nxënësve, në kuptimin e vetes, dhe aftësinë për të mësuar. Ndërgjegjësimi për situatën është “angazhimi meta-konjitiv” i nevojshëm për të orientuar veprimet e dikujt nga një moment në tjetrin (“lëvizjet”, shikoni Broshurën Prezantuese). Kjo do të eksplorohej me pjesëmarrësit me më shumë detaje, më vonë në këtë modul.

Një lidhje e dyfishtë është një dilemë në komunikim, ku individët ose grupet marrin dy mesazhe konfliktues në një situatë ku ky konflikt (me sa duket) nuk mund të trajtohet. Për shembull: Një i ri është refuzuar (jo verbalisht) kur ai i shpreh dashurinë nënës së tij. Me shumë gjasa, ky është një tipar ndërveprimi që mund të kontribuojë në një ç'rregullim skizofrenik. Në kundërshtim të drejtë, një mësues Zen dëshiron t'i mësojë nxënësit të tij/saj të mendojë jashtë kornizës dhe të lirohet nga manipulimet. Nxënësi Zen mëson se ka mijëra mënyra për të reaguar ndaj një situatë, në vend që të ngecësh në një të pamundur. Ky ndryshim në të menduar është ajo çfarë mësuesit duhet të mësojnë kur përballen me situata ku ndihen si të mbërthyer – midis interesave të nxënësve dhe interesave të tyre.

Sekuena e aktivitetit

<p><i>Ushtrimi “Ndërgjegjësimi për situatën” (seanca e parë plenare, më pas grupet e vogla)</i></p>  <p>Trajnuesi bën një prezantim të ushtrimit duke pyetur pjesëmarrësit nëse kanë dëgjuar për “ndërgjegjësimin për situatën”. Trajnuesi prezanton dy situata dhe fton pjesëmarrësit të diskutojnë mbi pyetjet.</p>  <p>Pjesëmarrësve u jepet pak kohë për të reflektuar mbi pyetjet dhe për t'u përgjigjur. Dhjetë minuta janë të mjaftueshme për të analizuar situatën dhe për të imagjinuar mënyra sipas të cilave i riu dhe nxënësi reagon.</p>  <p>Diskutojini përgjigjet dhe hipotezat në seancën plenare.</p>	<p>Ndërgjegjësimi për situatën</p> <p>Një i ri sapo shëruar nga një episod skizofrenie u vizitua nga e ëma e tij. Ai ishte i lumtur që e pa dhe në mënyrë impulsive i hodhi krahun mbi shpatulla, dhe pas kësaj ajo ngriu. Ai e tërhoqi krahun dhe ajo e pyeti „Nuk më do më?” Ai u skuq dhe ajo i tha „I dashur, nuk duhet të vihesh kaq lehtë në siklet dhe të jesh i frikësuar për ndjenjat e tua.”</p> <p>Një master Zen merr një shkop dhe e mban mbi kokën e nxënësit dhe thotë: Nëse thua se ky shkop është i vërtetë, nuk do të të godas me të. Dhe, nëse thua se nuk është i vërtetë, do të të godas me të. A është ky një shkop i vërtetë?</p> <p>Çfarë po ndodh këtu? Përshkruani kuptimin tuaj për situatat.</p> <p>Çfarë duhet të bëjnë më tej i riu dhe nxënësi?</p>
<p><i>Çfarë është ndërgjegjësimi për situatën? (seancë plenare)</i></p>  <p>Trajnuesi eksploron formulimet në këtë slajd së bashku me pjesëmarrësit, duke përdorur komentet dhe zgjidhjet e dhëna në sekuencën e fundit.</p> <p>Trajnuesi dhe pjesëmarrësit mund të japin shembuj shtesë që theksojnë rëndësinë e ndërgjegjësimi për situatën.</p> <p>Për shembull, piloti Chesley Sullenberge, që në viti 2009, zbarkoi Airbus A320 në lumin Hudson pa u lënduar njeri; ose qytetarët që lexojnë shenjat e sjelljes së çuditshme dhe ndihmojnë në parandalimin e sulmit terrorist.</p>	<p>Çfarë është ndërgjegjësimi për situatën?</p> <p>Informacioni pa kontekst ka pak vlerë. Vendimmarrësi duhet ta kuptojë mjedisin operacional dhe kjo kërkon të dhëna dhe sugjerime për shqyrtim dhe për t'u dhënë kuptim atyre që janë vëzhguar dhe dëgjuar.</p> <p>Ndërgjegjësimi për situatën është:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Krijimi i një vendimmarrjeje të mirë; ▪ Formuar nga vëzhgimi dhe kuptimi i asaj çfarë po ndodh në mjedisin tuaj. <p>Ky “kuptim” përdoret më vonë për të bërë parashikime për ngjarje të ardhshme. Këto parashikime orientojnë vendimmarrjen dhe veprimet.</p>

Aktiviteti 3.1.2: Studim rasti “Qengji dhe ujku”

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Reflektoni për ndërgjegjësimin e mësuesve dhe nxënësve për situatën ;
- Analizoni pjesëmarrjen e fëmijëve në situata;
- Reflektoni mbi ndikimin e mësuesve për situatën e të nxëniet të fëmijët.

Fokusi i aktivitetit:

- Studim rasti që thekson se si mësuesi mund të bëhet barrierë për të nxëniet;
- Situata nisur nga perspektiva e mësuesit dhe nxënësit;
- Ndikimi i paditurisë së mësuesit për situatën në lidhje motivimin e nxënësit.

Materiale dhe Metoda:

- Letër dhe laps për të punuar mbi studimin e rastit (opsionale: flipchart ose slajd për të prezantuar në seancë plenare);
- Puna në grupe të vogla, diskutim në grup.

Informacion / alternativa shpresë

Modeli katër-faqësh i komunikimit: http://en.wikipedia.org/wiki/Four-sides_model

Informacion për trajnuesin:



Studimi i rastit është një shembull i mësuesit që ka ndërgjegjësim të pakët për situatën, që i mungojnë shumë mundësi për të nxëniet dhe krijon një atmosferë ku të nxëniet real nuk nxitet. Mësuesi krijon situata që çojnë në kufizime të pjesëmarrjes për shkak të kompetencës (Sara nuk është e aftë të dëgjojë plotësisht), përkatësisë (Dea përjashtohet nga të kuptuarit; Genti humbet interesin) dhe autonomisë (Deni nuk respektohet nga mësuesi).




Mësuesit prirën të përqendrohen paraprakisht në detyrën që kanë për të kryer dhe në përmbajtjen që ata duan të “përçojnë” te nxënësit. Ndërsa ajo lexon historinë, nxënësit janë shumë të vëmendshëm dhe të motivuar, dukshëm kjo histori do të thotë diçka për ta. Por, ajo është përqendruar kaq shumë te historia dhe detyrat që do u japë studentëve për t’i kryer më vonë sa që nuk i kushton vëmendjen e duhur përgjigjeve të nxënësve. Përgjigjet reflektojnë kuptimin e thellë dhe kjo duhej të ishte eksploruar për të theksuar natyrën e fabulave dhe se përse ato përdoren ende edhe sot. Kuptimi i përfituar nga nxënësit shkatërrohet kur mësuesja vazhdon të japë detyra të tjera, në vend që të përdorë situatën për ta eksploruar më tej.

Në fakt, mësuesja krijon një lidhje të dyfishtë: Ajo u jep fëmijëve një mjet për të analizuar situatën e tyre (mësuesi është ujku, fëmijët janë qengjat): fëmijët mund të thonë çfarë të duan, nuk përbën aspak ndryshim, dhe mësuesja bën pikërisht atë çfarë ajo donte të bënte që nga fillimi. Ajo i përjashton fëmijët nga përdorimi këtij mjeti për të zgjeruar kuptueshmërinë e tyre. Fëmijët që janë pjesë e kësaj përvoje, shumë shpesh e humbin interesin për të nxëniet dhe fillojnë ta përbuzin mësuesin, shkollën dhe të nxëniet në përgjithësi.

Studimi i rastit përqendrohet sërish në çështjet e pjesëmarrjes dhe komunikimit, duke përfshirë çështjet e fuqisë/pushtetit dhe origjinat e përjashtimit. Trajnuesi duhet t’i bëjë të dukshme këto lidhje për t’i ndihmuar pjesëmarrësit me lidhjen se çfarë ata kanë mësuar tashmë dhe se me çfarë do të angazhohen në këtë modul.

Sekuena e aktivitetit

<p>Prezantimi me studimin e rastit (Seancë plenare)</p> <p> Trajnuesi njofton se ky është një studim rasti për ndërgjegjësimin për situatën e një mësueseje dhe katër prej nxënësve të saj. Ai përqendrohet në dy sekuenca të një mësimi, dhe pas sekuencës së dytë nxënësit punojnë individualisht për pyetjet e përgatitura nga mësuesja.</p> <p>Trajnuesi i pyet pjesëmarrësit nëse e dinë fabulën e Ezopit, një rrëfimtari grek që jetoi në vitet 620-564 para Krishtit. Nëse historia është e njohur, trajnuesi mund të kalojë shumë shpejt në slajdin tjetër, në të kundërt historia duhet të tregohet.</p>	<p style="text-align: center;">Studim rasti “Qengji dhe ujku”</p> 
	<p style="text-align: center;">Fabula „Qengji dhe ujku”</p> <p>Njëherë e një kohë, një ujku po zvarritej në një burim në një kodër, kur ngre kokën, çfarë të shohë, një qengj po pinte ujë pak më poshtë „Ja ku është darka ime,” mendoi ai, „vetëm nëse do të mund të gjej ndonjë justifikim për ta kapur.” Ai i tha qengjit, „Si guxon ta turbullosh ujin nga ku unë po pi?” „Jo, mjeshtër, jo,” tha qengji; “nëse uji është i turbullt aty, nuk jam unë shkak, sepse ai që nga ju po rrjedh drejt meje.” „Mirë, atëherë,” tha ujku, „pse vjet në këtë kohë më ke thirrur me emra të pakëndshëm?” „Kjo nuk është e vërtetë,” tha qengji; „Unë jam veçse gjashtë muajsh.” „Nuk më bëhet vonë,” hungëroi ujku; „nëse nuk ishit ju, ka qenë babai juaj;” dhe pas kësaj vrapoi drejt të shkretit qiengj të vogël dhe e përpiu.</p>
<p>Më pas, Trajnuesi i prezanton katër fëmijët të pranishëm në klasë midis gjithë nxënësve të tjerë. Pjesëmarrësit do t’i kushtojnë vëmendje të veçantë reagimit të këtyre katër fëmijëve.</p> <p>Pas kësaj, Trajnuesi i orienton pjesëmarrësit përmes dy slajdeve që ofrojnë një imazh të dy sekuencave.</p> <p>Pjesëmarrësve do t’u duhet të kthehen te këto slajde për të diskutuar mbi pyetjet (shikoni sekuencën tjetër).</p>	<p>Sara mezi dëgjohej. Ajo ka vështirësi me dëgjimin, veçanërisht në situata grupi dhe ka ndrojtje të flasë për shkak të problemeve me shqiptimin e fjalëve.</p> <p>Genti është diagnostikuar me deficiet të vëmendjes dhe hiperaktivitet. Ai është impulsiv, gjë që i krijon vështirësi për të ndjekur atë çfarë thotë mësuesi për periudha të gjata kohore. Ai ka probleme me mbajtjen parasysh të udhëzimeve.</p> <p>Ina nuk e flet gjuhën në të cilën zhvillohet mësimdhënia. Detyrat e shpjeguara nga mësuesi nuk kuptohen gjithmonë. Informacionet e shkruara nuk janë të kuptueshme për të.</p> <p>Deni është shumë krenar dhe i pavarur. Ai nuk e duron dot qasjen e mësuesit për ta trajtuar atë si vajzë dhe ndihet sikur nuk respektohet për nevojën e tij për pavarësi.</p>
	<p style="text-align: center;">Sekuena 1: Mësuesja lexon historinë</p> <p>Mësuesja lajmëron se do t’i lexojë klasës së katërt një fabul. Dejan edhe pse nuk është pyetur vë në dukje se nxënësit janë të rritur për përralla. Mësuesja nuk e merr parasysh dhe fillon të lexojë.</p> <p>Ndërsa mësuesja lexon, nxënësit dëgjojnë me vëmendje, janë të magjepsur nga historia dhe paksa të prekur nga mesazhi i saj. Ivana duket paksa e hutuar, por Tobias është çuditërisht i vëmendshëm.</p>

	<p style="text-align: center;">Sekuena 2: Pyetjet dhe përgjigjet</p> <p>Pas leximit të historisë, mësuesja pyet nëse ata kanë ndonjë pyetje ose vërejtje për të shtuar. Sarah thotë „Ujku nuk mund ta durojë dot faktin që qengji është i pafajshëm”, një tjetër fëmijë komenton „Ujku po kërkonte një justifikim për ta ngrënë qengjin” dhe më pas një tjetër fëmijë shton „Ai nuk dëgjoji se çfarë tha qengji, ai donte vetëm që ta hante atë.” Mësuesja përgjigjet duke thënë “Po” ose “Mirë” dhe kalon nga njëri fëmijë te tjetri. Sapo, klasa bie në qetësi Dejan fillon të godasë me grusht vajzën pranë tij, mësuesja e qorton. Gjatë kësaj ore mësimi, Tobias luan me stilolapsin e tij duke u përpjekur që ta balancojë atë mbi një gisht; kjo gjë nuk vihet re nga mësuesja, Sarah dhe Ivana duken të hutuara, por janë të qeta dhe të përqendruara te mësuesja. Mësuesja e përfundon këtë ore mësimi pasi fëmijët japin përgjigjet e tyre. Magjepsja e nxënësve që më përpara ishte e dukshme, tashmë është zhdukur plotësisht. Mësuesja shpjegon punën që duhet berë.</p>
<p><i>Diskutimi i studimit të rastit (Seancë plenare)</i></p>  <p>Trajnuesi shkon përmes pyetjeve për t’u siguruar se pjesëmarrësit i kuptojnë ato. Ai i fton pjesëmarrësit të diskutojnë pyetjet në grupe të vogla dhe t’i shkruajnë përfundimet e tyre për t’i ndarë me të tjerët.</p>  <p>Pjesëmarrësit i diskutojnë pyetjet individualisht ose në grupe të vogla.</p>  <p>Pjesëmarrësit raportojnë. Trajnuesi shton reflektimet e tij ose saj (shikoni gjithashtu “Informacion për Trajnuesin” për këtë aktivitet).</p>	<p style="text-align: center;">Ju lutemi, diskutojini këto pyetje!</p> <p>Çfarë po ndodh në këto dy sekuenca të mësimi? Përshkruajeni situatën nisur nga perspektiva e mësueses. Cili është kuptimi i mësueses për situatën? Përshkruajeni situatën duke u nisur nga perspektiva e Sarah, Tobias, Yvana dhe Dejan. Cili është kuptimi i tyre për situatën? Identifikoni vendimet e rëndësishme që mësuesja merr dhe mendoni për alternativat që mund të kishin promovuar pjesëmarrjen e katër nxënësve.</p> <p>Cilët janë përfundimet tuaja? Shkruajini ato dhe ndajini me të tjerët.</p>

Aktiviteti 3.1.3: Kuptimi i ndërgjegjësimit për situatën te fëmijët.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Zhvilloni një kuptueshmëri që situatat ndikojnë mbi sjelljen;
- Mësoni të shikoni situata përmes syve të fëmijëve;
- Aplikoni Modelin e Teorisë së Aktivitetit për të analizuar situata.

Fokusi i aktivitetit:

- Ndikimi i kontekstit për ndërgjegjësimin e fëmijëve për situatën;
- Modeli i Teorisë së Aktivitetit për të vizualizuar ndryshimet në ndërgjegjësimin për situatën.

Materiale dhe Metoda:

- Letër dhe lapsa, flipchart, stilolapsa;
- Brainstorming individual ose grupe të vogla (shikoni Informacion për Trajnuesin).

Informacion / alternativa shpresë

Mund të përzgjidhen qasje të tjera për t’i bërë marrëdhëniet e punës të dukshme ose për të hartëzuar bashkëpunimet.

Informacion për trajnuesin:

Mësuesit mund t'i mbështesin fëmijët për të nxënit vetëm nëse ata zhvillojnë një kuptueshmëri për situatën nisur nga perspektiva e fëmijës. Fokusi i këtij aktiviteti është theksimi i rëndësisë për kontekstin në të cilin kryhet aktiviteti. Shembulli i përdorur në këtë aktivitet është marrë nga një studim që është raportuar nga Cooper dhe Harries, në vitin 2002 (Cooper, B., Harries, T., 2002, Educational Studies in Mathematics. 49, 1-23). Studimi "Përgjigjet e Fëmijëve Krahasuar me Problemet 'Reale' të Matematikës: Sa të gatshëm janë fëmijët që të jenë realistë?" ilustron se konteksti ka një ndikim në mënyrën se si i qasemi detyrës. Pjesa e mëposhtme është një fragment nga studimi: "Rezultatet e tyre prezantohen në dy mënyra përgjigjeje përsa i përket 120 gramëve letër. Studentët mund ta shfaqin rezultatit duke u konsultuar me tabelën në mënyrën realiste që pritet në një zyrë postare. Nxënësit, në mënyrë alternative, mund të përdorin një strategji që përfshin llogaritjen e normës së tarifës postare, për shembull duke shtuar normën e rrafshët/tabuluar 20 gramë te norma për 100 gramë për të prodhuar një normë prej 120 gramë. Säljö dhe Wyndhamn zbuluan se nga 57.4% e nxënësve që ndërmorën detyrën e izoluar për 120 gramët në një orë matematike dhe u angazhuan në llogaritje për të nxjerrë përgjigjen, vetëm 29.3% e nxënësve që u morën me 'të njëjtin problem' në një orë për studimet sociale bën këtë. Kjo sugjeron një efekt të qartë të kontekstit për përgjigjen."

Mësuesit prirën të përqendrohen në detyra dhe nuk reflektojnë mjaftueshëm për kontekstin në të cilin kryhen detyrat. Në mënyrë që të përshtatim situatat e të nxënit me nevojat e nxënësve, mësuesit duhet të jenë të vetëdijshëm për faktorët kontekstualë dhe se si mënyra që ata e prezantojnë një pyetje, situatë ose problem ndikon në qasjen e tyre. Ky shembull thekson këtë pikë, në përgjithësi, dhe e lidh atë me përvojat e pjesëmarrësve – pa trajtuar ndryshimet midis fëmijëve individualë.

Sekuena e aktivitetit

"Ndërgjegjësimi për situatën te fëmijët"
(seancë plenare).



Trajnuesi bën një prezantim të shkurtër për këtë "detyrë" dhe i fton pjesëmarrësit të parashikojnë përgjigjet e nxënësit. Trajnuesi zgjedh dy mjedise të ndryshme (mësim i Matematikës vs. Shkencës sociale).



Trajnuesi duhet t'i pyesë nxënësit e tij për premisat e tyre fillimisht dhe më pas t'u japë evidenca për kërkimin.

Dokumentimi ose mos-dokumentimi i pikave kryesore të diskutimit është opsional.



Trajnuesi u kujton pjesëmarrësve për Modelin e Teorisë së Aktivitetit të përdorur tashmë në Modulin 1 dhe 2. Modeli mund të përdoret këtu për të theksuar ndryshimin në ndërgjegjësimin për situatën.

Trajnuesi mund të ofrojë dy slajde dhe t'i ftojë pjesëmarrësit të shtojnë mendimet e tyre ose trajnuesi mund të prezantojë fillimisht një shabllon të modelit dhe t'i ftojë pjesëmarrësit të eksplorojnë. Trajnuesi duhet të sigurohet se pjesëmarrësit e kuptojnë ndikimin e kontekstit këtu.

Ndërgjegjësimi për situatën te fëmijët

Pyetje: Sa kushton për të dërguar një letër që peshon 120 gramë në Suedi?

Nxënësve u është vënë në dispozicion kjo tabelë:


LETTERS Donwstic

Regular letters (and picture postcards)

Maximum weight grams	Postage SEK
20	2,10
100	4,00
250	7,50
500	11,50
1000	14,50

Trajtimi i problemit me mësimin e matematikës vs. shkencës sociale ka një ndikim mbi rezultatet— cili është ndikimi dhe pse?


Përdorimi i modelit të teorisë së aktivitetit



Për këtë qëllim, mund të jepen shembuj lidhur me jetën e përditshme të pjesëmarrësve.

- Nëse jemi në një dyqan me muzikë dhe aromë të mirë, ka më shumë gjasa që të blejmë diçka.
- Si fillim, më mirë të rikujtojmë informacionin e situatës në të cilën e mësuam. Të jesh në një vend të veçantë aktivizon kujtesën për këtë vend. Prandaj: Nëse përgatiteni për një test, më mirë bëjeni në një mjedis që është i ngjashëm me mjedisin e testit!
- Kur Desdemona, gruaja e Otellos bërtet se po vdes, asnjë nuk thërret doktorin, sepse konteksti (Opera) sugjeronte ajo vetëm po aktron.

Përdorimi i modelit të teorisë së aktivitetit



Aktiviteti 3.1.4: Testi Marshmallow i rivizituar.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Kuptoni se si sjellja e mësuesit ndikon mbi sjelljen e nxënësit;
- Reflektoni mbi ndikimin e mjediseve jo të besueshme për impulsivitetin e fëmijëve;
- Tregoni se kërkimi mund të të jetë i rëndësishëm për mësuesit.

Fokusi i aktivitetit:

- Testi Marshmallow;
- Ndikimi i testuesit jo të besueshëm mbi sjelljen pritëse të fëmijës.

Materiale dhe Metoda:

- Nuk nevojitet material;
- Reflektim dhe Diskutim

Informacion / alternativa shtesë

Informacion për trajnuesin:

Ky aktivitet është në thelb një prezantim i studimit të mposhtëm: Kidd, C., Palmeri, H., Aslin, R.N. (2013)

Shpërndarja racionale: Vendimmarrja e fëmijëve të vegjël në detyrën marshmallow ndikohet nga idetë për besueshmërinë mjedisore. Aftësia njohëse, 126(1), 109-114. Ka edhe një video nga Universiteti Rochester që është i disponueshëm online dhe shpjegon test origjinal Marshmallow, si edhe ndërtimin dhe rezultatet e studimit. Studimi thekson se çfarë mendohet për të qenë një tipar personaliteti (impulsiviteti) mund të ndikohet nga faktorët mjedisorë. Mësuesit priren të besojnë se ata nuk mund të ndikojnë mbi impulsivitetin (p.sh. Genti) dhe e perceptojnë atë më shumë si një tipar fiks sesa si një gjendje, dhe bëjnë shumë pak përpjekje për të reflektuar mbi mënyrën se si mund krijojnë mjedise lehtësuese.

Sekuena e aktivitetit

Testi Marshmallow i rivizituar (seancë plenare).



Trajnuesi i pyet pjesëmarrësit nëse kanë dëgjuar për Testin Marshmallow. Ai u krye fillimisht nga Walter Mischel dhe kolegët e tij në vitet 1960 dhe 1970.

Impulsiviteti është normal te fëmijët e vegjël (p.sh. shpërthim temperamenti i çastit të një fëmijë tre vjeç që nuk merr atë që ai ose ajo do), por duke filluar nga mosha katër-vjeçare fëmijët duhet të jenë të aftë të vonojnë kënaqësinë. Siç duket, kjo është diçka që fëmijët duhet ta mësojnë, por impulsiviteti është një tendencë në disa personalitete ("Natyrë dhe Edukim"). Të jesh i aftë të vonosh kënaqësinë është një parashikues i fortë i suksesit në shkollë dhe jetës profesionale.


Trajnuesi shpjegon testin; ai gjendet edhe në YouTube, nëse Trajnuesi dëshiron të fitojë kohë për ta parë. Nëse audiencia nuk është familjarizuar me konceptin, videoja është shumë e dobishme.

Testi është rivizituar nga studiues që donin të dinin nëse konteksti social përbën një ndryshim përsa i përket kohës se sa shumë pritën fëmijët. Trajnuesi mund të shpjegojë ndërtimin e eksperimentit duke përdorur këto slajde.

Më shumë detaje gjenden në video dhe në studim (për referencë shikoni më poshtë).



Rezultatet mund të diskutohen me pjesëmarrësit. Çfarë përfundimesh nxjerrin ata nga ky eksperiment? Për çfarë kanë nevojë fëmijët impulsivë si Geni? A kanë ata fëmijë impulsivë në klasat e tyre? A i kanë marrë ata parasysh të katër perspektivat kur përpiqen të shpjegojnë kufizimet e pjesëmarrjes së tyre?



Ky studim thekson perspektivën e marrëdhënies, por gjithashtu mund të eksplorohej edhe katër perspektivat.

A ekziston mundësia për të vonuar kënaqësinë e «Vetë-kontrollit»?

Fëmijët e kanë të vështirë ta vonojnë kënaqësinë për të arritur më vonë shpërblime më të mëdha dhe disa e kanë më të vështirë se të tjerët përsa i përket pritjes.

Ndryshimet individuale për aftësinë për të pritur i janë atribuar vetë-kontrollit, pjesërisht për shkak të evidencave se vonuesit e mëdhenj janë më të suksesshëm për jetën e mëvonshme.



Por, konteksti përbën një ndryshim: Testi Marshmallow i rivizituar

A ka konteksti social një ndikim mbi vetë-kontrollin te fëmijët? Krijimi i situatës përpara testit aktual Marshmallow:

Fëmijës i është thënë se testuesi (këtu Holly Palmeri) ka shkumësa me ngjyrë më të bukur dhe do të shkojë t'i marrë ata.

<http://www.youtube.com/watch?v=JsQMdEC0FnUQ>



Dy grupe eksperimentuese: Mjedis i besueshëm kundrejt mjedisit të pabesueshëm

Testuesi kthehet me shumësata e premtuar.

Testuesi kthehet duke thënë se e kishte gabim, nuk ka shumësata të tjerë.



Rezultatet dhe përfundimet

Fëmijët në grupin e besueshëm pritën mesatarisht 12 minuta përpara se të hanin Marshmallow — krahasuar me 4 minuta në grupin që ishte i ekspozuar ndaj sjelljes jo të besueshme.

Sjellja pritëse e testit Marshmallow ndikohet nga përvojat e para-eksperimentit.

Përvoja e mosbesueshmërisë së partnerit ndërveprues lidhet me kompetencën e vetë-kontrollit.

A nxirri ndonjë përfundim nga ky eksperiment? Për çfarë kanë nevojë fëmijët impulsivë, si Tobias?

Aktiviteti 3.1.5: Aplikimi i modelit të Sarah dhe kolegët e saj

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Thelloni kuptimin e situatave duke praktikuar analizën e situatave;
- Përdorni analizën e situatave për të eksploruar kontekstet e të nxënësve;
- Eksploroni mënyrën se si veprimet e mësuesit mund të krijojnë pamundësi për mjediset e të nxënësve;
- Reflektoni mbi mënyra se si mësuesit mund të ndikojnë pozitivisht mbi situatat.

Fokusi i aktivitetit:

- Kufizimet e pjesëmarrjes së Sarës, Gentit, Inës dhe Denit;
- Analiza e modelit të aktivitetit për kufizimet e pjesëmarrjes;
- Ndikimi i mësuesve mbi mjediset e të nxënësve.

Materiale dhe Metoda:

- Flipcharte, stilolapsa (opsional për raportimin, shabllone të modelit të aktivitetit);
- Reflektim dhe ekzaminim i ndjenjave dhe mendimeve personale, diskutim.

Informacion / alternativa shtesë

Për më shumë informacion mbi modelin e Teorisë së Aktivitetit, shikoni broshurën prezantuese, Moduli 1 dhe Moduli 2.

Nëse është e mundur, nxitini pjesëmarrësit të shohin Webinarin 11 - Aksesin në Mjedisin e të Nxënësve II, Projektimi Universal për të Nxënësve – në Serinë e UNICEF-it A Rights-Based Approach to Inclusive Education for Children with Disabilities përpara fillimit të këtij aktiviteti.

Informacion për trajnuesin:

Ky aktivitet e çon analizën e situatës një hap më përpara. Në aktivitetin 3.1.2 (Qengji dhe ujku), pjesëmarrësve u është kërkuar të eksplorojnë “ndërgjegjësimin për situatën” nga ana e mësuesve dhe nxënësve – duke theksuar faktin se njerëzit mund të përjetojnë të njëjtën situatë në mënyra të ndryshme dhe se si mesazhet kontradiktore nga mësuesi mund të krijojnë situata të dyfishta. Barrierat e krijuara nga mësuesi u eksploran në përgjithësi, por jo në veçanti për secilin fëmijë. Fokusi ishte në të qenit i vetëdijshëm (perceptimi, shikoni modulën 1) për situatën e plotë e krijuar nga mësuesi, dhe se si situatat mund të motivojnë ose demotivojnë fëmijët dhe ndikojnë mbi pjesëmarrjen e tyre gjatë mësimit.

Në këtë aktivitet, pjesëmarrësve u është kërkuar ta përdorin vetë modelin e teorisë së aktivitetit, për të analizuar situatën e fëmijëve në pika kyçe gjatë mësimit. Duhet të zgjidhet një moment, kur pjesëmarrja e katër fëmijëve rrezikohet, për shembull:

- **Sara:** Mësuesi tregon historinë (Mësuesi krijon një situatë ku Sara nuk mund ta përdorë dëgjimin për të kuptuar historinë. Zgjidhja: një ndryshim në mjet: mjete ndihmëse për dëgjimin, piktura për të mbështetur kuptueshmërinë; ose një ndryshim në kontekst: uleni atë në rreshtin e parë);
- **Genti:** Mësuesi përgjigjet me po/jo (Genti e humbet interesin dhe motivimin, dhe angazhohet në sjellje që nuk orientohet më nga qëllimi / nuk ka më qëllim. Zgjidhja: mësuesi ndryshon kontekstin ose i tërheq vëmendjen);
- **Ina:** Mësuesi tregon historinë (Ina nuk mund ta ndjekë historinë, ajo nuk mund ta përdorë gjuhën e mësimit si një mjet për të kuptuar historinë. Zgjidhja: jepjani Inës tekstin në shtëpi, përpara mësimit në gjuhën që ajo flet);
- **Deni:** Ai godet me grusht një vajzë, mësuesi e qorton (Deni e humb interesin dhe motivimin, e përqendron vëmendjen e tij te vajza, me shumë mundësi për të kërkuar vëmendjen e mësuesit. Zgjidhja: Mësuesi mund ta orientonte atë, për shembull ti jepte një vërejtje apo mendim për “përrallën” për ta bërë situatën më kuptimplotë për të).

Përgjigjet nga pjesëmarrësit mund t'i japin trajnuesit idenë se sa pjesëmarrësit janë të aftë të analizojnë situata nisur nga perspektiva e fëmijës. Kur diskutimi kalon te mjedisi, duhet theksuar se ndryshimet mjedisore mund të ndikojnë çdo përbërës të aktivitetit të një fëmije. Mësuesi mund ta "ndryshojë" fëmijën (Kush?) duke e motivuar nëpërmjet të qenit i sigurt se situata ka lidhje me identitetin dhe përvojat e tij ose saj. Mësuesi mund të ndikojë mbi strategjitë që një fëmijë aplikon (Si?), duke ofruar mjete që mbështesin kryerjen e aktivitetit (shkrimi i një historie nga Sara dhe përkthimi nga Ina). Mësuesi mund të ndikojë mbi kontekstin social (Ku?) duke krijuar një klimë pozitive dhe përkrahëse në klasë dhe duke ushqyer marrëdhënie pozitive. Mësuesi mund t'i ndihmojë fëmijët ta përqendrojnë vëmendjen e tyre te objekti i synuar (Çfarë?) duke bërë parashikime dhe duke bërë prezantime frymëzuese të historisë. Mësuesi mund të përmirësojë rezultatet e të nxëniet (Qëllimi) duke i pohuar dhe duke i motivuar fëmijët që të arrijnë rezultate kuptimplota.

Sekuena e aktivitetit

"Aplikoni modelin te Sara dhe kolegët e saj"
(Punë individuale ose në grupe të vogla)



Trajnuesi shpjegon udhëzimet. Deri tani, pjesëmarrësit kanë pasur shumë mundësi për të përdorur modelin e teorisë së aktivitetit. Mësuesi mund të vendosë nëse mund të punohet akoma me pjesëmarrësit përmes një shembulli.



Punoni individualisht ose në grupe të vogla. Trajnuesi duhet të vendosë nëse rezultatet duhen raportuar në seancë plenare apo jo.




Raportimi në seancë plenare (opsional).

Aplikojeni modelin te Sarah dhe kolegët e saj!

Kthehuni te mësimi i qengjit dhe ujkut dhe bëni një vizatim të ngjashëm për fëmijët që janë aty. Përzgjidhni momentin kur pjesëmarrja e tyre është kufizuar dhe kur mësuesit mund ta interpretojnë sjelljen e tyre si "përçarëse", "të pavëmendshme" ose "jo kompetente".

Vizatoni modelin: Çfarë mund të ndryshojë mjedisi?



Tema 3.2: Zhvillimi i qëllimeve efektive.

Vështrim i përgjithshëm i Temës 3.2

Qëllimi i Temës

- Aplikoni qasjen e ciklit jetësor për përcaktimin e qëllimit;
- Forconi kapacitetet për të zhvilluar qëllime efektive afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata;
- Përdorni formulimet e qëllimeve ose synimeve për të pasur reagime kuptimplota.

Trajnuesit nuk duhet që thjesht t'i prezantojnë qëllimet ose synimet e temës, por duhet që edhe t'u kërkojnë pjesëmarrësve të shkruajnë ndonjë pyetje që mund të kenë në lidhje me përmbajtjet dhe qëllimet e kësaj teme. Këto pyetje mund të përdoren sërish kur çështja të trajtohet në trajnim. Në fund të çdo teme, trajnuesi mund të pyesë nëse janë trajtuar të gjitha çështjet.

Vështrim i përgjithshëm i aktiviteteve

Aktiviteti 3.2.1: Arritja e qëllimit të vetë-përcaktuar;

Aktiviteti 3.2.2: Qasja e ciklit jetësor dhe përcaktimi i qëllimit;

Aktiviteti 3.2.3: Qëllimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata;

Aktiviteti 3.2.4: Përdorimi i formulimeve të qëllimit për reagim; Aktiviteti 3.2.5: Qëllimet konfliktuese.

Aktiviteti 3.2.1: Arritja e qëllimit të vetë-përcaktuar.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Eksploroni natyrën e përcaktimit të qëllimit duke filluar me përvojat e pjesëmarrësve;
- Reflektoni mbi atë se çfarë e bën një qëllim efektiv dhe si mund të përkrahët ndjekja e një qëllimi;
- Fitoni një kuptueshmëri fillestare për atë se çfarë është e rëndësishme në formulimin e qëllimit.

Fokusi i aktivitetit:

- Përvojat e pjesëmarrësve me arritjen e qëllimit të vetë-përcaktuar;
- Kushtet që lehtësojnë (ose pengojnë) ndjekjen dhe realizimin e qëllimeve.

Materiale dhe Metoda:

- Shabllone me modelin e teorisë së aktivitetit;
- Reflektim, Diskutim.

Informacion / alternativa shitesë




Informacion për trajnuesin:

Tema 2 provon t'i orientojë pjesëmarrësit drejt një kuptueshmërie të thellë të qëllimeve dhe se si formulimi i qëllimit ndikon në efektivitetin e tyre. Qëllimet duhet të bëhen vizione, përfaqësime të brendshme të një arritjeje ose rezultatit, dhe të gatshëm për ta orientuar një person në situatë kritike drejt një qëllimi sa më larg tij. Aktiviteti i parë përqendrohet te përvojat personale të pjesëmarrësve me arritjen e qëllimit të vetë-përcaktuar. Fillimisht, atyre u kërkohet të eksplorojnë çështje rreth përcaktimit të qëllimit, duke përdorur qoftë një shembull që ka pasur një rezultat të qartë dhe të paracaktuar (shkrimi i një libri), ose një qëllim i orientuar në proces ku qëllimi është të jesh në gjendje të bësh diçka (të lundrosh rreth botës).

Sapo pjesëmarrësve u rikujtohet qëllimi i tyre i vetë-përcaktuar që kërkon planifikim afatgjatë, trajnuesi mund të përdorë shembujt e tyre për të theksuar natyrën e qëllimit si përfaqësime konjitive që mbajnë emocione, dhe orientojnë motivimin (= zhvillon motive) dhe vullnetin (= vë në përdorim motivet). Qëllimet janë ide për të ardhmen, dhe vetëm nëse njerëzit i zhvillojnë këto ide mund të orientoohen më mirë prej tyre sesa kur i orientojnë ngjarjet e ditës nga vullneti i të tjerëve. Formulimi në slajdin përkatës ka nevojë të ilustruhet duke dhënë sa më shumë shembuj. Për ta udhëhequr këtë proces, mund të përdoren si shembuj dy qëllimet e prezantuar në slajdin e parë.

Për të ndjekur qëllimet afatgjatë, personi duhet të sigurohet se qëllimi mbahet mend dhe se motivimi dhe vullneti mbahen "gjallë". Prandaj, është e rëndësishme të reflektohet mbi kushtet që ndihmojnë në realizimin e qëllimeve. Kushtet që lehtësojnë ndjekjen e qëllimit prezantohen në këtë aktivitet. Për të zhvilluar qëllime efektive, këto kushte mund të përfshihen në procesin e përcaktimit të qëllimeve; kjo duhet kuptuar si një pjesë integrale e përcaktimit të qëllimit. Disa shembuj jepen më poshtë, por duhet bërë pak më shumë në këtë grup. Gjithashtu, trajnuesi mund të përdorë përshkrimin e Sarës, Gentit, Inës dhe Denit si shembuj për zhvillimin e qëllimit.

Sekuena e aktivitetit

Arritja e qëllimeve të vetë-përcaktuara (seancë plenare).	Arritja e qëllimit të vetë-përcaktuar
 <p>Seancë plenare: Trajnuesi bën një prezantim të aktivitetit duke thënë se pjesëmarrësit ftohen për të menduar për një qëllim afatgjatë, që e kanë vendosur vetë ata dhe që kishin sukses në ndjekjen e tij (p.sh. shkrimi i një libri, lundrimi rreth botës).</p>  <p>Nëse trajnuesi jep një shembull, do ishte shumë e dobishme për ta.</p> <p>Pjesëmarrësve u lihet pak kohë në dispozicion për të diskutuar në grupe të vogla.</p>  <p>Sillini të gjitha bashkë, mbajtja e shënimeve për të transferuar atë çka është thënë këtu në situatën e fëmijëve.</p>	<p>A keni pasur sukses në ndjekjen e një qëllimi të vetë-përcaktuar që kërkonte shumë kohë, përpjekje dhe qëndrueshmëri?</p> <p>Plotësimi i një projekti afatgjatë, si shkrimi i një libri?</p> <p>Përgatitja por dhe përmbushja e ëndrrës prej kohësh për të lundruar përreth botës.</p> <p>Çfarë ju ndihmoi t'i përmbaheshit qëllimit, kur e humbët motivimin ose kur hasët vështirësi?</p> <p>Reflektoni për të gjitha fazat e arritjes së qëllimit të vetë-përcaktuar dhe shkruani se çfarë ju ndihmoi për ta arritur atë?</p>

Qëllimet si ide për të ardhmen (seancë plenare).



Trajnuesi i shpjegon këto pohime duke përdorur atë çka është thënë deri tani dhe nxjerr shembuj nga pjesëmarrësit:

- **Abstrakte:** Lundrimi rreth botës dhe të jesh i lumtur;
- **Konkrete:** Shkrimi i një libri dhe botimi i tij.
- **Shkrimi i një libri përfshin informacion e mposhtëm procedural:** Bëni kërkime në bibliotekë; përdorimin e një skicë për ta organizuar librin; blerjen e një kompjuteri të ri, komunikimet me partnerin për fragmente; biseda me botuesin.
- **Shkrimi i një libri ju jep një pozitë më të mirë në universitet, ju bën të fitoni më shumë para, ju bën të famshëm, etj.**
- **Kushtet:** Të shkruarit gjatë pushimeve në Maldive vs. në një tavoline në zyrë do të aktivizojë imazhe, ndjenja dhe shoqërimi të brendshme të ndryshme.

Trajnuesi eksploron kushtet për realizimin e qëllimeve me pjesëmarrësit. Sërish, duhet të jepen shembuj për të shpjeguar:

- **Informacion për realizimin:** shikoni më sipër
- **Aktivizim (për shembull, libër):** Mjedise ku ka libra, ku vlerësohen librat, etj., njerëzit që kanë shkruar libra dhe kanë qenë të suksesshëm.
- **Të duash atë që të ndihmon për të arritur qëllimin:** Ulu në zyrë, shpenzo kohë në librari, etj.
- **Stimul i dykuptimtë:** miratim i marrë nga bashkëmoshatarët, edhe pse ata mund ta kenë me dy kuptime.
- **Ndrydhja e njohurive:** vetmia e partnerit, kostot e larta, shpresa e pakët për të pasur përfitime

Duhet dhënë shumë shembuj dhe duhen shkruar pika të rëndësishme (opsional).

Paraqitje e duhur e qëllimeve (seancë plenare).



Slajdi i fundit i këtij aktiviteti lidh atë çka është thënë në modelin e teorisë së aktivitetit. Sërish, shembujt tashmë të përmendur duhen përdorur për të shpjeguar përdorimin e modelit të formulimeve për qëllimin që mund të orientojnë veprimet.



Pjesëmarrësve u kërkohet të përdorin modelin dhe të plotësojnë shabllonet për qëllime të ndryshme. Qëllimet e listuara mund të kuptohen si synim (qëllimi final):

Qëllimet janë ide për të ardhmen

- Qëllimet janë përfaqësime konjitive të një gjendjeje përfundimtare të dëshirueshme. Kjo ide mund të jetë konkrete, ose abstrakte;
- Gjithashtu, qëllimet përfshijnë informacion procedural. Cila sjellje, plan, objekt, etj., ju ndihmon për ta arritur këtë gjendje përfundimtare?
- Të gjitha gjendjet përfundimtare mund të konsiderohen si mjete për të arritur një gjendje përfundimtare të një rendi të lartë. Gjithashtu, qëllimet nënkuptojnë arritjen e qëllimeve të reja:
- Qëllimet janë aktivizuar sipas kushteve specifike për të orientuar veprimin. Sa më të dendura dhe më shumë aspekte të kenë këto përfaqësime, ndjenja ose shoqërimi aq më shumë gjasa ka që qëllimet të aktivizohen.

Kushtet për realizimin e qëllimeve

Qëllimet kuptimplota përmbajnë gjithashtu informacion për realizimin e tyre.


Aktivizimi i qëllimeve përmes mjediseve dhe personave. Që i rikujton personit për qëllimin.

Nëse njerëzit e ndjekin një qëllim, ata gjithashtu duan atë çka i ndihmon për të arritur qëllimin e tyre dhe nuk duan atë çka i shpërqendron prej tij.

Një qëllim duhet të "bëhet personal"; personi duhet ta marrë në zotërim atë.


- Ndikon mbi vëmendjen dhe interpretimin e stimulit të dykuptimtë;
- Shtyp/ndrydh njohuritë dhe përvojat që kanë lidhje ose shoqërohen me arritjen e qëllimit.

Përfaqësim i duhur i qëllimeve



Aplikoni modelin e teorisë së aktivitetit për përcaktimin e qëllimit! Përzgjidhni qëllime të ndryshme dhe vizatoni modelin sipas rastit:

- Mësoni të lexoni
- Humbni peshë
- Jini një mësues gjithëpërfshirës



Aktiviteti 3.2.2: Qasja e ciklit jetësor dhe përcaktimi i qëllimit.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Zhblokoni të menduarit e pjesëmarrësve sipas ciklit jetësor për nxënësit e tyre;
- Reflektoni mbi qëllimet afatgjata për fëmijët dhe mbi çfarë arsimit gjithëpërfshirës kërkon që të arrihet;
- Përpiquni të njihni mënyra sipas të cilave fëmijët mbështeten për të arritur përpjekje e tyre.

Fokusi i aktivitetit:

- Jeta e fëmijëve dhe mënyra se si kontribuon arsimit në të nxënit afatgjata;
- Çfarë kërkojnë të arrijnë shkollat;
- Çfarë duhet të bëjnë mësuesit për të siguruar arritje.

Materiale dhe Metoda:

- Nuk nevojiten materiale (opsionale: flipcharte dhe stilolapsa, nëse raportohet diskutimi në grupe të vogla);
- Reflektim dhe diskutim, aplikim.

Informacion / alternativa shtesë

Informacion për trajnuesin:







Slajdi i fundit i aktivitetit të mëparshëm jep një prezantim të qasjes së ciklit jetësor. Kjo mund të merret sërish këtu. Fëmijët mund të bëhen nxënës aktivë vetëm nëse e dinë se përse janë duke bërë diçka dhe se ku i çon ajo. Megjithatë jeta prej të rrituri është shumë abstrakte për t'u parashikuar për shumë fëmijë,

është e rëndësishme që të krijohet një perspektivë më e gjerë për ta dhe t'i ndihmoni ata të kuptojnë se përse është e rëndësishme që të fitojnë aftësi, të jenë kompetentë dhe të kenë arritje. Veçanërisht për fëmijët e vegjël, është detyra e mësuesit të reflektojë mbi mënyrën se si përfshirja aktuale e fëmijës në kryerjen e aktiviteteve ose plotësimin e detyrave kontribuon në pjesëmarrjen e tyre në të ardhmen. Kjo ndihmon për të lidhur qëllimet afatshkurtra me qëllimet afatmesme (pjesëmarrja në situatat e jetës). Fushat e aktivitetit dhe pjesëmarrjes të prezantuara në modulën 2 mund të përdoren për këtë qëllim (p.sh. të nxënit dhe aplikimi i njohurive, komunikimi, ndërveprimet dhe marrëdhëniet ndërpersonale, etj.).

Qëllimet përqendrohen në arritje, rezultate dhe në atë se çka do të fitohet duke kryer një aktivitet. Në këtë pikë, trajnuesit mund t'u kujtojnë pjesëmarrësve se çfarë është diskutuar në modulën 1 (Aksesi, pjesëmarrja, arritja). Gjithashtu, ata mund të sjellin qasjen e bazuar te të drejtat e njeriut dhe fëmijës për një të ardhme të hapur. Mënyra se si mësuesit i interpretojnë kufizimet e pjesëmarrjes (moduli 2) përbën një ndryshim, sepse pa reflektuar dhe analizuar profesionalisht mbi kufizimet e pjesëmarrjes, ka shumë gjasa që ata të orientohen nga besimet dhe qëndrimet e tyre. Kjo mund t'i vendosë fëmijët në një trajektore të caktuar që nuk i ndihmon ata për të zhvilluar plotësisht potencialin dhe talentet e tyre.

Përveç përdorimit të shembujve që janë diskutuar në aktivitetin e mëparshëm 3.2.1, trajnuesi mund t'i referohet Sarës, Gentit, Inës dhe Denit për të ilustruar trajektorët e ndryshme që mësuesin mund të parashikojnë për këta katër fëmijë dhe zhvillimi i premisave alternative. Premisat më pozitive do të ndikojnë për përcaktimin e qëllimit, dhe për pasojë edhe ata se çfarë mund të arrijnë fëmijët. Këto diskutime duhet të përdoren për të theksuar rëndësinë e pritshmërive të mësuesit. Përcaktimi i qëllimit do të thotë bërja e këtyre pritshmërive të dukshme.

Sekuena e aktivitetit

<p><i>Qasja e ciklit jetësor dhe përcaktimi i qëllimit (seancë plenare).</i></p>  <p>Trajnuesi bën një prezantim duke e lidhur këtë aktivitet me të mëparshmin dhe duke shpjeguar qasjen e ciklit jetësor (shikoni broshurën prezantuese). Pjesëmarrësit duhet të përfshihen në diskutim për pikat e nxjerra këtu. Do të nevojiten shumë shembuj për t'i qartësuar këto pika.</p>  <p>Më pas, pjesëmarrësit ftohen të mendojnë për pritshmëritë pozitive dhe negative që fëmijët sjellin në shkollë dhe se si mund të ndikohen. Duhet ngritur çështja se pritshmëritë e mësuesve janë të rëndësishme.</p>	<p>Qasja e ciklit jetësor për përcaktimin e qëllimit</p> <p>Arsimimi është një projekt për jetën. Qëllimi afatgjatë i shkollave gjithëpërfshirëse është promovimi i të nxënit afatgjatë. Pse mësojnë njerëzit? Çfarë duhet nxitur te fëmijët për të qënë të interesuar te të nxënit?</p> <p>Pritshmëritë pozitive të rezultateve—suksesi është i mundur.</p> <p>Ajo çfarë pritët është e vlefshme—suksesi ia vlen.</p> <p>Pritshmëritë dhe vierat ndërveprojnë për të parashikuar rezultate të rëndësishme, siç është angazhimi, vazhdimësia e interesit, dhe arritja akademike.</p> <p>Çfarë pritshmëri dhe vlerash sjellin fëmijët në shkollë?</p>
<p><i>Arsimi si një projekt afatgjatë (seancë plenare).</i></p>  <p>Trajnuesi shpjegon se si pjesëmarrja në detyra sot i ndihmon fëmijët të marrin pjesë në situata të ndryshme jetësore dhe se si kjo kontribuon në pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri.</p>  <p>Pjesëmarrësit duhet të ftohen për të zhvilluar shembuj duke përdorur studimet e rastit të prezantuara në modulën 2 (Floriana) dhe temën 1 të modulit 3.</p>  <p>Trajnuesi duhet të vendosë nëse kjo bëhet në seancë plenare ose në grupe të vogla. Nëse puna bëhet në grupe të vogla, duhen raportuar disa shembuj në seancën plenare.</p>	<p>Arsimi si një projekt afatgjatë</p> 

Arritja në shkollat gjithëpërfshirëse (seancë plenare).



Trajnuesi diskuton kushtet që lehtësojnë arritjen e qëllimit. Ky slajd lidhet me aktivitetin 3.2.1 dhe kjo duhet theksuar.



Sërish, shembujt e Sarës, Gentit, Inës dhe Denit mund të përdoren për të treguar mënyra për të mbështetur fëmijët në arritjen e qëllimeve.

Duhet theksuar se një element i rëndësishëm i të qenit mësues, nuk ka të bëjë vetëm me dhënien e mësimit/përmbajtjes, por ka të bëjë me lehtësimin e pjesëmarrjes (mbështetja për të provuar përvojën, përkatësinë, autonominë/pavarësinë).

Arritja në shkollat gjithëpërfshirëse

Çfarë mund të bëjnë mësuesit për të siguruar arritjen për të gjithë fëmijët?

- Ndihmojini fëmijët të shohin se si aktivitetet te “këtu dhe tani” përshtaten me atë që mund të arrijnë në jetët e tyre;
- Ndihmojini fëmijët të vizualizojnë rezultatet pozitive dhe mënyrat për ti arritur ato;
- Sigurohuni që fëmijët ta përjetojnë të nxënit si një përpjekje të vlefshme, jo si një ushtrim të pavlerë;
- Ofroni mbështetje dhe përkujdesje për fëmijët që kanë humbur shpresën ose kanë frikë nga dështimi;
- Mbështesni pavarësinë e fëmijës duke i lënë t’i ndjekin qëllimet e tyre.

Aktiviteti 3.2.3: Qëllimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Mësoni të bëni dallimet midis qëllimeve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata;
- Vlerësoni faktin se qëllimet afatshkurtra duhet të lidhen me qëllimet afatmesme për t’i bërë më kuptimplotë;
- Fitoni një kuptueshmëri më të madhe se si qëllimet afatshkurtra janë mjete për të arritur qëllime afatmesme.

Fokusi i aktivitetit:

- Qëllimet në arsim në kontekstin e qasjes së ciklit jetësor;
- Qëllimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata;
- Qëllimet si mjete për të arritur qëllime të tjera.

Materiale dhe Metoda:

- Nuk nevojiten materiale;
- Reflektim, Analiza e qëllimeve, diskutim.

Informacion / alternativa shtesë


Informacion për trajnuesin:

Përcaktimi i qëllimeve është rëndësishëm për arsimin e personalizuar për zhvillimin e planeve zhvillimore, edukatedhe për zbatimin dhe vlerësimin e tyre. Fatkeqësisht, studimi tregon se përcaktimi i qëllimit është në përgjithësi pika më e dobët në “Planet Edukative Individuale” (PEI). Qëllimet prirën të jenë shumë të gjëra ose të ngushta, shumë të përgjithshme ose specifike, dhe mund të përmbajnë pak informacion për mjediset ose situatat ku ata mund të ndiqen. Së bashku me mungesën e ndërëgjegjësimi për situatën – që i lejon mësuesit t’i njohin më mirë mundësitë e të nxënit – mungesa e parashikimit të qëllimeve i lë mësuesit pa orientim për edukimin e personalizuar.

Në përgjithësi, mësuesit formulojnë qëllime pa reflektuar për një lidhje midis qëllimeve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Qëllimet afatshkurtra duhen kuptuar si mjete për të arritur qëllimet afatmesme, dhe qëllimet afatmesme kontribuojnë për arritjen e qëllimeve afatgjata. Qëllimet afatgjata të arsimit përcaktohen në kurrikul, por në shumë shtete, kurrikula ofron më shumë përmbajtje për t’u dhënë se sa kompetenca për t’u arritur.

Sekuena e aktivitetit


Qëllimet në arsim (seancë plenare).




Trajnuesi e përdor këtë slajd për të shpjeguar mënyrën se si përcaktimi i qëllimit duhet lidhur me ciklin jetësor. Qëllimet afatshkurtra përqendrohen te performanca, qëllimet afatmesme te arritjet dhe qëllimet afatgjata te aftësitë (shikoni qasjen e bazuar te të drejtat e njeriut në broshurën prezantuese).

Duhet të jepen shembuj për t'i bërë këto tre perspektiva qëllimesh të qarta:


- Karikatura e përdorur në aktivitetin 1.4.1: Përqendrohet më shumë në arritjen e përgatitjeve të të gjitha kafshëve për operacionin e shpëtimit gjatë përmbajtjeve sesa në plotësimin e detyrës.
- Qengji dhe ujku (Aktiviteti 3.1.2): Më shumë ndihmon fëmijët të vlerësojnë natyrën e fabulës sesa përgatitata për të kryer punë individuale.



Përcaktimi i llojeve të ndryshme të qëllimeve (seancë plenare).



Trajnuesi jep përkufizime që kanë lidhje me slajdet e mëparshme.



Mund të përdoren shembuj nga aktiviteti 3.2.1 (qëllimet afatgjata të vetë-përcaktuara nga pjesëmarrësit).


Përcaktimi i llojeve të ndryshme të qëllimeve

Plotësoni detyrat dhe kryeni aktivitete në mjedisin aktual.
 Perspektiva e gjetjes së zgjidhjeve konkrete për sfidat e ardhshme të punës konkrete: "Të qenit i aftë për zgjidhjen e problemeve në një situatë specifike" ➔ „Performanca“

Jini kompetentë për situatat jetësore tipike ose përmbyshjen e sfidave.
 Perspektiva e përmbyshjes, së kërkesave të jetes së përditshme, të qenit kompetentë në situata jetësore tipike: „Të jeni kompetentë dhe të keni aftësi të përshtatshme për një fushë jetësore“ ➔ „Arritia dhe përmbyshja“


Realizoni potencialin dhe talentet tuaja në shoqëri
 Perspektiva e të bërit një jetë të mirë, të qenit i aftë për të jetuar në mënyrë të pavarur dhe të qenit i përfshirë në jetën sociale: „Formësimi i jetës së dikujt“ ➔ „Aftësitë“

Ushtrim për llojet e ndryshme të qëllimeve (seancë plenare).




Trajnuesi bën një prezantim të shkurtër për të shpjeguar ushtrimin.: "Këta janë qëllime të ndryshme që janë shkruar gjatë një takimi planifikues me prindërit. Ju lutemi, aplikoni gjithçka që ne kemi thënë deri tani për qëllimet dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

- A janë këta qëllime afatshkurtra, afatmesme apo afatgjata?
- A janë formuluar mirë këta qëllime, nëse jo, si mund të përmirësohen?



Pjesëmarrësit duhet ta kryejnë këtë ushtrim në grupe të vogla ose individualisht.




Diskutimet në grup duhet t'i përgjigjen pyetjeve dhe duhen dhënë shembuj të qëllimeve të përmirësuara. Duhet përmendur se pjesë nga përmbajtja e listuar këtu nuk përfaqëson qëllime (p.sh. vazhdimi i terapisë së fjalës).

Përcaktimi i llojeve të ndryshme të qëllimeve

Vazhdimësia e terapisë së fjalës	Rolandi mëson të shprehë gjendjen shpirtërore	
Punon individualisht	Benjamini krijon një portofol	Stefani i pranon dobësitë e tij
Përmirësimi i përqendrimit duke bërë pushime	Të qenit i motivuar dhe vullneti për të mësuar	Rolandi mund të shprehet si duhet në grup
Diferencimi i tingujve (b-d, f-s)	Përdorimi i një stili ndërveprues të përshtatshëm me shokët	Lexoni dhe kuptoni tekstin e thjeshtë
Thomasi mund të zhvillohet pa mbështetje në klasë.	Rritni shpejtësinë e leximit	
	Një herë në javë mësuesi kontrollon nëse të gjitha fletët e punës janë dokumentuar si duhet	

Qëllimet si mjete për qëllime të tjera (seancë plenare).




Në fund të këtij aktiviteti, trajnuesit duhet ta bëjnë të qartë lidhjen midis qëllimeve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Ky grafik thekson çështjen se qëllimet afatshkurtra janë "mjete," "strategji" ose "mënyra" për të arritur qëllime afatgjata.

Sërish, mund të përdoren shembuj të të nxëniet për t'u lexuar:

- Të mësosh shkronjat për të lexuar fjalë;
- Të mësosh të lexosh një tekst për të fituar njohuri;
- Të fitosh njohuri përmes të lexuarit për të mësuar një histori (etj.).

Pjesëmarrësve u duhet përmendur se lidhja e qëllimeve në këtë mënyrë është shumë e rëndësishme për ta orientuar dikë në aktivitetin e tij në klasë dhe për të mundësuar mjedise për të nxëniet (shikoni temën tjetër).

Qëllimet janë mjete për qëllime të tjera



Aktiviteti 3.2.4: Përdorimi i formulimeve të qëllimit për reagim.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Kuptoni lidhjen midis formulimeve të qëllimit dhe reagimit kuptimplotë;
- Diferenconi reagimin konstruktiv nga ai destruktiv;
- Reflektoni mbi praktikën personale të reagimit.

Fokusi i aktivitetit:

- Karakteristikat e reagimit efektiv;
- Idetë e John Hattie për "reagimin e fuqishëm";
- Praktika personale që kanë lidhje me ofrimin e reagimit.

Materiale dhe Metoda:

- Kopje të shabllonit të Modelit të Teorisë së Aktivitetit (opsionale), letër dhe laps;
- Diskutim, reflektim, pyetje për nxitjen e reagimeve.

Informacion / alternativa shtesë


John Hattie: Të nxëniet e dukshëm (libër, website), Prezantim PowerPoint i "Fuqisë së Reagimit" në: https://www.eduweb.vic.gov.au/edulibrary/public/publ/research/publ/john_hattie_making_learning_visible_feedback.pdf; YouTube: <https://www.youtube.com/watch?v=S770g-LULFY>

Shikoni gjithashtu: <http://assessment.tki.org.nz/> (Vlerësimi për praktikën e të nxëniet; reagimi efektiv) dhe <http://assessment.tki.org.nz/Assessment-in-the-classroom/Assessment-for-learning-in-practice/Effective-feedback>

Informacion për trajnuesin:




Reagimi mund të inkurajojë ose dekurajojë fëmijët nga arritja e qëllimeve. Por, reagimi është diçka që mësuesit e bëjnë/japin çdo ditë, në çdo mësim. Lloji i reagimit që mësuesit bëjnë lidhet ngushtë me ndërgjegjësimin e tyre për situatën, kuptimin e tyre për situatën e fëmijës dhe qëllimin që duhet arritur duke kryer një aktivitet. Shpesh, mësuesit reagojnë në "nivel personal", pra duke i vlerësuar fëmijët, por thuajse nuk i trajton fare nivelet e tjera (nivelet e detyrës, procesit, vetë-rregullimit). Përsa i përket përcaktimit të qëllimit, të gjitha këto përmasa janë eksploruar në aktivitetet e mëparshme të kësaj teme.

Mësuesi i Sarës, Gentit, Inës dhe Denit reagon duke thënë “Po” ose “Mirë”, dhe në këtë mënyrë humb mundësitë e mëdha për të reaguar mbi trajtimin e pyetjeve të prezantuara nga Hattie për të përmirësuar të nxënësit - “Ku po shkoj?” – për të thelluar kuptimin e qëllimit të dëshiruar - “Si po eci?” – për të marrë të dhëna se ku janë në lidhje me qëllimin, dhe për të marrë orientime sesi të ecin përpara drejt qëllimeve të dëshiruara - “Po tani, ku?” Reagimi për këto pyetje mund të trajtohet në nivele të ndryshme. Nivelet e cituara nga Hattie mund të përkthehen në Modelin e Teorisë së Aktivitetit për t’i ndihmuar pjesëmarrësit t’i lidhin formulimet e qëllimit të tyre me mënyrat sipas të cilave ata mund të marrin reagime.



Trajnuesi duhet të punojë nëpërmjet Prezantimit PowerPoint nga John Hattie ku ai shpjegon në detaje të gjitha nivelet. Në të kundërt, trajnuesi mund të vendosë të tregojë vetëm slajdin e parë dhe të tretë dhe thjeshtë të përdorë Modelin e Teorisë së Aktivitetit pa e lidhur me terminologjinë e përdorur nga Hattie.

Sekuena e aktivitetit

<p><i>John Hattie për reagimin (seancë plenare).</i></p>  <p>Trajnuesi jep shpjegime për reagimin efektiv që i ndihmon nxënësit të orientojnë të nxënësit e tyre. Trajnuesi mund të dojë të përdorë studimin e rastit “Qengji dhe ujku” për të nxjerrë në pah praktikatat e reagimit të mësuesit dhe për të dhënë shembuj se si mund të jetë një reagim më i mirë. Nëse pjesëmarrësit janë anglisht folës, mund të shihen një video në YouTube ku jepen shpjegime.</p>  <p>Trajnuesi i lë pjesëmarrësit të bëjnë pyetje shtesë që lidhen me qëllimet që ata kanë përcaktuar ose për të cilat është diskutuar.</p>	<p>John Hattie për reagimin¹</p> <p>Në mënyrë që reagimi të jetë efektiv, nxënësit kanë nevojë për:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ një kuptim të qëllimit të dëshiruar; ▪ evidencë për atë që ka lidhje me qëllimin; ▪ orientim se si të plotësoni një boshllëk. <p>Ku po shkoj? Si po eci? Për ku?</p> <p>Fuqia e reagimit shpjegohet në YouTube: https://www.youtube.com/watch?v=S770g-LULFY</p>				
<p><i>Modeli i “Fuqisë së reagimit” (seancë plenare).</i></p>  <p>Varet nga trajnuesi të vendosë nëse ky slajd duhet paraqitur ose nëse ai vetëm sa e ndërlikon nxënësin mund të gjeni material alternativ, (ju lutemi, referojuni pjesës më sipër: “Informacion për trajnuesin”).</p>	<p>Përdorimi formulimeve të qëllimit për reagim (John Hattie: “Fuqia e reagimit”)</p> <p>Qëllimi i reagimit Të reduktojë mospërputhjet ndërmjet kuptimeve/performancave aktuale dhe qëllimit të dëshiruar.</p> <p>Mospërputhja reduktohet nëpërmjet Rritjes së përpjekjeve dhe punësimit të nxënësve në strategji më efektive. Mësuesve që ofrojnë qëllime sfiduese dhe specifike dhe mbështetja e i nxënësve për t’i arritur ato.</p> <p>Reagimi efektiv i përgjigjet tre pyetjeve Ku po shkoj? Si po eci? Për ku?</p> <p>Çdo pyetje për reagim funksionon në katër nivele:</p> <table border="0"> <tr> <td>Niveli i detyrës Sa mirë janë kryer/kuptuar detyrat</td> <td>Niveli i procesit Procesi kryesor i nevojshëm për të kuptuar/kryer detyrën</td> <td>Niveli i vetë-rregullimit Vetë-monitorimi. Orientimi dhe rregullimi i veprimevedetyrat</td> <td>Niveli vetjak Vlerësimi personal dhe efekti për nxënësin</td> </tr> </table>	Niveli i detyrës Sa mirë janë kryer/kuptuar detyrat	Niveli i procesit Procesi kryesor i nevojshëm për të kuptuar/kryer detyrën	Niveli i vetë-rregullimit Vetë-monitorimi. Orientimi dhe rregullimi i veprimevedetyrat	Niveli vetjak Vlerësimi personal dhe efekti për nxënësin
Niveli i detyrës Sa mirë janë kryer/kuptuar detyrat	Niveli i procesit Procesi kryesor i nevojshëm për të kuptuar/kryer detyrën	Niveli i vetë-rregullimit Vetë-monitorimi. Orientimi dhe rregullimi i veprimevedetyrat	Niveli vetjak Vlerësimi personal dhe efekti për nxënësin		

1 Në gjuhën angleze termi që këtu është përkthyer si reagim është feedback (on line mund të gjeni John Hattie “The power of feedback”)

Të flasësh me fëmijët për të nxënit e tyre (seancë plenare).



Pjesëmarrësve u duhet rikujtuar se modelin e teorisë së aktivitetit e kanë përdorur më parë për të përshkruar situatën e fëmijëve. Përcaktimi i qëllimit ka të bëjë me parashikimin e situatave të ardhshme, reagimi ka të bëjë me reflektimin për situatat në të shkuarën. Përdorimi i të njëjtit model do t'i ndihmojë pjesëmarrësit ta kthejnë përcaktimin e qëllimit të tyre në pyetje për reagim.




Pjesëmarrësve u duhet dhënë mundësia të kthehen pas në formulimet e qëllimit të tyre dhe analizën për situatën për të bërë pyetje për reagim që trajtojnë elemente të ndryshëm të modelit. Pjesëmarrësit duhet t'i shkruajnë pyetjet.



Diskutim dhe përgjigje ndaj pyetjeve në seancë plenare, prezantim i disa pyetjeve të bëra nga pjesëmarrësit.

Të folurit me fëmijët për të nxënit e tyre

Ku po shkoj? Si po eci? Për ku?



Çfarë lloji reagimi jepni kryesisht?

Mendon pyetje për secilin element të modelit!

Aktiviteti 3.2.5: Qëllimet konfliktuese.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Reflektoni mbi ndërlidhjet e arritjes së qëllimeve;
- Nënvizoni faktin se zbatimi i të drejtave të njeriut dhe qasjes së ciklit jetësor mund të krijojë konflikte me të tjera qëllime nga ato që kanë mësuesit dhe shkollat;
- Diskutoni mbi mënyra për të kapërcyer qëllimet konfliktuese sesa të pengoni të drejtat e fëmijës.

Fokusi i aktivitetit:

- Qëllimet konfliktuese - çfarë duan mësuesit dhe për çfarë kanë nevojë fëmijët;
- Duhet dëgjuar zëri i fëmijëve dhe respektuar e drejta e tyre;
- Mënyra për t'u marrë me qëllimet konfliktuese.

Materiale dhe Metoda:

- Flipcharte, stilolapsa; fletë pune "Eksploroni" të plotësuara nga aktiviteti i mëparshëm, shablloni "Zgjidhje problemesh";
- Analiza e përgjigjeve në fletët e punës, diskutim, brainstorming, reflektim.

Informacion / alternativa shtesë

Informacion për trajnuesin:

Ky aktivitet tërheq vëmendjen për faktin se mbështetja e fëmijëve në arritjen e synimeve të tyre mund të jetë në kundërshtim me qëllimet dhe pritshmëritë e mësuesve dhe shkollave. Rasti i Martha Payne, një nxënëse nga Skocia, përdoret këtu për të theksuar tensionet ndërmjet qëllimeve dhe synimeve, por trajnuesi mund të zgjedhë një tjetër shembull më afër skenës vendore të pjesëmarrësve. Një shembull tjetër do të ishte historia e Malala Yousafzai, fitues i Çmimit Nobel për Paqen, në vitin 2014, qëllimet dhe vizionet e të cilit ishin në kontrast të plotë me synimet dhe vlerat sociale të talebanëve.

Ushtrimi synon lehtësimin e diskutimit për qëllimet konfliktuese dhe se si një situatë e tillë mund të zgjidhet në mënyrën më të mirë të mundshme. Çështje të mundshme për diskutim mund të jenë:

- Përmasa e të drejtave të njeriut: Të drejtat e fëmijëve duhen dëgjuar, t'u jepet zë dhe se si kjo gjë mund të merret parasysh në shkolla që përballen me "shumë zëra" në komunitetin e tyre. Si mund

t'u jepet zë të gjithë fëmijëve duke mbajtur një klasë të organizuar dhe duke pasur "një komunitet të nxëni"?

- Përgjegjësia e mësuesit: Mësuesit janë përgjegjës për të nxënit e nxënësve të tyre; ata nuk mund t'i lënë nxënësit e tyre të bëjnë çfarë të duan. Si mund të koordinohet në gjë e tillë?
- Kontrolli i mësuesit: Mësuesit përdoren për t'i mbajtur nxënësit në kontroll duke bërë që të gjithë të njëjtën gjë, në të njëjtën kohë. Siç duket, kjo nuk është fryma për arsimin gjithëpërfshirës. Por, cilat janë alternativat për ta humbur kontrollin sapo fëmijëve u lejohej të flasin më shumë për atë që mësojnë?
- Duket mirë nga jashtë dhe në retrospektivë - nuk duket aq mirë kur je pjesë e saj: Historitë si kjo janë të mrekullueshme për t'u lexuar si një i jashtëm që i di tashmë rezultatet pozitive. Kur je pjesë e kësaj situate, gjërat duken më pak tërheqëse dhe rezultatet nuk janë të sigurta. Çfarë mund të bëjnë mësuesit për të parashikuar rezultate pozitive dhe për t'i sjellë ato?

Pjesëmarrësit duhen ftuar për të folur rreth përvojave të tyre personale kur ata janë përballur me qëllime konfliktuese. Diskutimi duhet t'i nxisë mësuesit të identifikojnë situata të tilla dhe të kërkojnë zgjidhje për dilemën që përjetojnë. Kjo ka të bëjë gjithashtu edhe me ndërgjegjësimin për situatën: duke i pranuar qëllimet konfliktuese, pjesëmarrësit mund të kërkojnë të fitojnë një kuptim të ri që hap mënyra të reja veprimi për ta. Trajnuesi mund të zgjedhë t'i nxjerrë në pah këto çështje duke u kthyer pas në përmbajtjen përkatëse të këtij moduli në temën 1.

Gjithashtu, ky aktivitet i përgatit pjesëmarrësit për temën 3 ku ata përqendrohen mbi situatat e të nxënit që janë përshtatur sipas pikëpamjes së synimeve dhe qëllimeve të mësuesve. Përcaktimi i qëllimit i nxjerr në pah synimet. Synimet orientohen nga besimet, vlerat dhe qëndrimet, por, mund të ndikohen edhe nga ndërgjegjësimi i mësuesve për situatën. Qëllimet ndihmojnë për të krijuar pamjen/skenën dhe japin orientime për detyra dhe aktivitete për të siguruar përmbushjen e arritjeve të synuara. Qëllime të ndryshme mund të përdoren për të njëjtën situatë të nxëni dhe kjo është ajo që mësuesit duhet ta kuptojnë në mënyrë që të jenë të aftë ta personalizojnë edukimin.

Sekuena e aktivitetit

Diskutim për qëllimet konfliktuese (seancë plenare).



Trajnuesi i përdor këto slajde për të treguar historinë e Martha Payne. Historia fillon kur ajo vendos se projekti që ajo kishte për të bërë në shkollë do të ishte për vaktet e saj në shkollë.

I ati e ndihmoi për të krijuar blogun, dhe duke filluar nga prilli i vitit 2012, ajo filloi t'i bënte fotografi drekës së saj çdo ditë, dhe e vlerësoi sipas kriterëve të vendosura nga vetë ajo. Titulli i blogut lë të kuptohet se vaktet në shkollë nuk ishin as të shëndetshëm dhe as të shijshëm. Për shkak të rritjes së popullaritetit të tij, këshilli i shkollës e bllokoi/mbylli blogun, gjë që shkaktoi protestë.

Martha e përdori popullaritetin për të mbledhur para për vaktet e Mary, një bamirësi që ofron vakte në shkollë në shtete të varfra, që fëmijët që ndjekin shkollën përfitojnë të paktën një vakt në ditë. Në kohën që u shkrua ky modul, ishin mbledhur më shumë se £130.000. Blogu është ende online dhe gjendet me adresën treguar në slajdin e dytë, shikoni gjithashtu edhe në hyrjen Wikipedia. Ju lutemi, referojuni këtyre websiteve për informacion më të detajuar.

**Qëllimet konfliktuese:
Rasti i Martha Payne**





Trajnuesi duhet të ketë parasysh disa çështje dhe duhet t'i ftojë pjesëmarrësit të kontribuojnë me mendimet dhe përvojat e tyre. Këto çështje, të treguara nën titullin "Informacion për trajnuesin," mund të përdoren për të orientuar diskutimin.

Duhen diskutuar çështjet e mëposhtme:

- Qëllimet konfliktuese: Qëllimet e Martha, qëllimet e këshillit të shkollës?
- Sa "zë" dhe vetë-vendosmëri u duhet dhënë fëmijëve?
- Qëllimet e shfaqura: E ardhmja është e pasigurt, por duhet të hapet për fëmijët, dhe jo të mbyllet.
- Cilat mjedise të nxëni i lejojnë fëmijët të zhvillojnë pavarësinë dhe të ndjekin qëllimet e tyre personale?
- Rëndësia e të qenit i mbështetur dhe i përkrahur kur aspiron qëllime afatgjata. Ky nuk është "mashtim" (sepse Martha nuk e bëri gjithçka vetë), ky është bashkëpunim - diçka shumë e rëndësishme që duhet mësuar.
- Përvoja personale e pjesëmarrësve që ka lidhje me çështje e ngritura këtu.

Best Food Blog 2012



Donation summary

	*Online donations
	Offline donations
	Text donations
	547,730.79 €
	4,326.96 €
	75.61 €

Scottish 9-year-old Martha Payne's ban on food blogging lifted by local council

44 Comments · 1 Share · 0 Tweets · 0 Stalks · 0 Email



©BBC (AP) Martha Payne, a 9-year-old blogger from Scotland who set off a brief international online video furore last autumn because her food blog contained images of her school's meals, has won her blog back.

A 9-year-old's blog caused school diets changing food



Total raised
162,133.35 €
GIR Aid
24,954.61 €

* Charities pay a small fee for our service. Find out donor.mouth.ie and what.org.uk/2012/7

Martha Payne në neverseconds.blogspot.com

Vlerësimet e saj për këtë vakt:
Vlerësimi i ushqimit 7/10
Kafshata - ngrënia: numërimi dhe bisedimi me shokët është i vështirë!
Vaktet – kryesore/ëmbëlsira
Vlerësimi i shëndetit 2/10
Çmimi - £2
Fije floku-0!



Sa tolerante duhet të jenë shkollat dhe autoritetet lokale?



News • UK & World • Big Brother

By Dailyrecord.co.uk | 15 Jun 2012 10:48

Council ban school dinners blogger Martha Payne from taking pictures.. then do a U-turn after outcry

A COUNCIL banned a nine-year-old girl from taking pictures of her school dinners.. then performed a U-turn hours later after an uproar on the internet.

Barnirësia e Martha's për Mary's Meals

Welcome to Mary's Meals
Willkommen bei Mary's Meals
Benvenuti a Mary's Meals
Dobrodošli na Mary's Meals

Our vision is that every child receives a daily meal in a place of education

Mary's Meals is an international movement that sets up school feeding projects in communities where poverty and hunger prevent children from gaining an education. Mary's Meals is a unique idea that works - by providing a daily meal in a place of education, chronically poor children are attracted to the classroom where they can gain a better education that prevents an end cycle of poverty. Over 100,000 children receive Mary's Meals every school day. The average cost to feed a child for a whole school year is €10.75 / £12.40 / \$16.90.

Tema 3.3: Përshtatja e situatave për kërkesat e nxënësit.

Vështrim i përgjithshëm i Temës 3.3

Qëllimi i temës

- Mësoni t'i lidhni qëllimet me situatat e të nxënësit;
- Përpquni të gjeni mënyra për të përmirësuar pjesëmarrjen në klasë;
- Aplikoni ato që keni mësuar deri tani për të hartuar plane për të nxënësit e personalizuar.

Trajnuesit nuk duhet që thjesht t'i prezantojnë qëllimet ose synimet e temës, por duhet gjithashtu që t'u kërkojnë pjesëmarrësve të shkruajnë ndonjë pyetje që ata mund të kenë në lidhje me përmbajtjen dhe qëllimet e kësaj teme. Pyetjet mund të përdoren sërish kur çështja të trajtohet në trajnim. Në fund të çdo teme, trajnuesi mund të pyesë nëse janë trajtuar të gjitha pyetjet.

Vështrim i përgjithshëm i aktiviteteve

Aktiviteti 3.3.1: Një histori, shumë mësim për t'u nxënë;
 Aktiviteti 3.3.2: Krijoni mundësi për të nxënë!
 Aktiviteti 3.3.3: Harmonizoni qëllimet me mundësitë!
 Aktiviteti 3.3.4: Përshtatni mjediset për të nxënë!
 Aktiviteti 3.3.5: Kompetencat për gjithëpërfshirjen;
 Aktiviteti 3.3.6: Reflektim personal.

Aktiviteti 3.3.1: Një histori, shumë mësim për t'u nxënë.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Rikujtojini pjesëmarrësve studimin e rastit për fabulën e Ezopit;
- Lidheni atë që do të kryhet me konceptet e aksesit, pjesëmarrjes dhe arritjes;
- Përgatituni për të kryer punë mbi mundësitë e të nxënësit, lidhjen e qëllimeve dhe përshtatjen e mjediseve të të nxënësit.

Fokusi i aktivitetit:

- Fabula "Qengji dhe ujku" si një pikënisje për ushtrimet pasardhëse;
- Arsimi gjithëpërfshirës dhe me çfarë ka të bëjë.

Materiale dhe Metoda:

- Nuk nevojiten materiale;
- Kujtesë dhe rishikim.


Informacion / alternativa shtesë

Informacion për Trajnuesin:

Aktiviteti i parë i shkurtër synon ta ri-përqendrojë vëmendjen e pjesëmarrësve mbi atë se çfarë është arsimi gjithëpërfshirës. Ai thekson sërish konceptet e “aksesit”, “pjesëmarrjes” dhe “arritjes” që janë diskutuar në modulin 1, me një theks të veçantë mbi pjesëmarrjen dhe barrierat e pjesëmarrjes (moduli 2). Trajnuesi duhet t’i eksplorojë këto tre aspekte të personalizimit të edukimit dhe t’i lajmërojë pjesëmarrësit se ata do të angazhohen në aktivitete për të bërë pikërisht këtë gjë.

Mesazhi kryesor këtu është se këto tre hapa janë të nevojshëm për të personalizuar edukimin – duke përdorur një situatë të thjeshtë që mund të rikrijohet në çdo klasë dhe nuk ka nevojë për pajisje të sofistikuara; në parim, gjithçka që duhet është dikush që të lexojë historinë “Qengji dhe ujku” dhe më pas varet nga vetë mësuesi nëse do të krijojë situata të domethënëse të të nxënit për të gjithë nxënësit.

Sekuena e aktivitetit

<p><i>Një histori, shumë mësim për t’u nxënë (seancë plenare).</i></p>  <p>Trajnuesi u rikujton pjesëmarrësve mësimin që është përdorur si një studim rasti në temën e parë të këtij moduli. Mësuesi nuk ishte i aftë ta shfrytëzonte mundësinë për të lehtësuar të nxënit, edhe pse kishte shumë mundësi për ta bërë këtë.</p> <p>Trajnuesi u rikujton pjesëmarrësve vizionin e arsimit gjithëpërfshirës dhe se aksesit, pjesëmarrja dhe arritja duhet të sigurohen për të gjithë fëmijët.</p> <p>Më pas, trajnuesi u jep një “organizues të avancuar” dhe deklaron se këto janë hapa që duhen ndërmarrë nga një mësues gjithëpërfshirës.</p>	<p>Një histori, shumë mësim për t’u nxënë</p> <p>Arsimi gjithëpërfshirës ka të bëjë me krijimin e situatave kuptimplota të të nxënit për të gjithë fëmijët — aksesit, pjesëmarrja, arritja.</p> <p>Si mund ta arrijë një mësues këtë?</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Duke qenë i ndërgjegjshëm për mundësitë e të nxënit; ▪ Duke lidhur mundësitë e të nxënit me qëllimet; ▪ Duke përshtatur mjediset e të nxënit me situatën e nxënësve. <p>Tema 3 përqendrohet te këto tre aspekte të arsimit të personalizuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Krijimi i mundësive të të nxënit për të gjithë nxënësit; ▪ Lidhja e qëllimeve me mundësitë për të gjithë nxënësit; ▪ Përshtatja e mjediseve të të nxënit për të gjithë nxënësit.
---	--

Aktiviteti 3.3.2: Krijoni mundësi për të nxënë!

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Kuptojeni se mësuesi është agjenti më i rëndësishëm për të krijuar mundësi të të nxënit;
- Kaloni përmes procesit brainstorming për të identifikuar mundësi të të nxënit;
- Paraqitni një vështrim të përgjithshëm të organizuar të mundësive të të nxënit që mund të përdoren për përcaktimin e qëllimit.

Fokusi i aktivitetit:

- Mundësi të nxëni për tregimin e fabulës nga Ezopi;
- Vizualizimi i të menduarit personal për mundësitë e të nxënit.

Materiale dhe Metoda:

- Letër dhe lapsa, Flipchart dhe stilolapsa (për prezantim);
- Brainstorming dhe reflektim.

Informacion / alternativa shtesë

Për më shumë informacion mbi brainstorming, hartën e mendjes dhe hartën e konceptit, ju lutemi shikoni për burime në internet (metoda të nxëni për të rriturit)

Informacion për trajnuesin:




Ky aktivitet përpiqet t'u ilustrojë pjesëmarrësve se një histori mund të jetë pikënisja e shumë mundësive të ndryshme të të nxënit. Kjo lidhet me ndërgjegjësimin e mësuesve për situatën dhe përdorimin e imagjinatës, njohurive dhe krijimtarisë për të krijuar mundësi të të nxënit. Është e rëndësishme që pjesëmarrësit të mos krijojnë përshtypjen se, fillimisht do t'u nevojiten më shumë burime, përpara se t'i përdorin sa më mirë materialet e ndryshme/shtesë.

Trajnuesi mund të dojë të fillojë së bashku me pjesëmarrësit me ushtrimin brainstorming për t'u dhënë atyre disa ide se çfarë mund të mësohet nga dëgjimi i kësaj historie. Disa ide për të frymëzuar trajnuesin, listohen më poshtë:

- Ezopi dhe jeta e tij;
- Përvoja e pavarësisë dhe kontrollit vs. pafuqisë dhe mungesës së ndihmës;
- Metaforat, imazhet në gjuhë, kuptimi letrar dhe figurativ;
- Përvoja e të qenit pjesë e një audience dhe të dëgjuarit me vëmendje (për kënaqësi, informacion, kënaqësinë e të bërit shoqëri të tjerëve, etj., të gjitha aspektet se përse njerëzit shkojnë në leksione ose teatër);
- Njohuritë që lidhen me formën letrare të një "fabule";
- Të jesh pjesë e një komuniteti kulturor me një trashëgimi specifike.

Rezultatet duhen organizuar në një hartë mendjeje ose hartë koncepti. Nëse këto mjete janë të panjohura për pjesëmarrësit, bëjini një prezantim të shkurtër.

Sekuena e aktivitetit

<p><i>Krijoni mundësi për të nxënë! (seancë plenare).</i></p>  <p>Trajnuesi bën një prezantim dhe shpjegon detyrën (shikoni informacionin më sipër).</p>  <p>Pjesëmarrësit do të punojnë në grupe të vogla, fillimisht me brainstorming dhe më pas me krijimin e hartës së mendjes. Kjo mund të bëhet në letër. Nëse prezantimi është planifikuar në seancë plenare, hartat e mendjes duhet të transferohen në flipcharte ose slajde PPT.</p>  <p>Diskutim në grup, shtim dhe pasurim i mundësive të të nxënit të krijuara nga pjesëmarrësit.</p>	<p>Krijimi i mundësive të të nxënit!</p> <p>Krijimi i mundësive të të nxënit nuk ka të bëjë me rregullimet e ndërlikuara të mësimdhënies, librat e shtrënjtë edhe kompjuterat rinj.</p> <p>Ka të bëjë me aftësinë e mësuesit për të qënë i vetëdijshëm për mundësitë e të nxënit.</p> <p>Pa imagjinatë, njohuri dhe krijimtari, burimet materiale nuk do të transformoheshin në mundësi të nxënit.</p> <p>A jeni familjarizuar me metodën „Brainstorming“ ose „Hartëzimi i koncepteve“? A keni dëgjuar për „Hartën e mendjes“ ose „Hartën e konceptit“?</p> <p>Ju lutemi, vizatoni një hartë mendje ose hartë koncepti për të prezantuar gjithçka që mund të mësohet pas dëgjimit të fabulës „Qengji dhe ujku“! Nëse doni mund të përdorni shembuj të tjerë.</p>
--	---

Aktiviteti 3.3.3: Harmonizimi i qëllimeve me mundësitë!

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Mësoni t'i harmonizoni qëllimet me mundësitë e të nxënit;
- Përjetoni faktin se ka shumë qëllime – disa nuk mund të arrihen lehtësisht;
- Merrni reagime për qëllimet nga pjesëmarrësit e tjerë dhe trajnuesi.

Fokusi i aktivitetit:

- Mundësi të të nxënit të paraqitura në letër dhe flipchart;
- Qëllime që mund të harmonizohen me mundësitë e të nxënit;
- Reagime për qëllimet dhe përmirësimet.

Materiale dhe Metoda:




- Letër dhe lapsa, flipchart dhe stilolapsa (për prezantim);
- Punë në grupe të vogla, reflektim dhe diskutim.

Informacion / alternativa shtesë**Informacion për trajnuesin:**

Ky ushtrim duhet t'u ilustrojë pjesëmarrësve se çdo mundësi të nxëni vjen me një set qëllimesh. Me pak imagjinatë, thjesht duke lexuar një histori, mund të ndiqen shumë qëllime! Çdo qëllim duhet formuluar për të reflektuar informacionin mbi mirë-përcaktimin e qëllimit të prezantuar në temën e fundit. Pjesëmarrësit duhen ftuar gjithashtu për të pasur parasysh tre aspektet e pjesëmarrjes (pavarësi/autonomi, përkatësi/përfshirje, kompetencë) të prezantuara në modulin 2. Për më tepër, dhe veçanërisht nëse pjesëmarrësit kanë kohë tepër, ata mund të hartojnë qëllime afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata duke i harmonizuar qëllimet e ndryshme që ata kanë formuluar.

Në fund të këtij ushtrimi, secili grup duhet të ketë një hartë mendjeje me mundësitë e të nxënit si degë të ndryshme, dhe të shtojë qëllime të shumta te secila degë ("gjethe" në degë). Lidhjet midis qëllimeve duhen theksuar me shigjeta ose duke zgjedhur ngjyra të ndryshme. Më pas, flipcharte mund të varen në klasë, në mënyrë që të gjitha grupet të krijojnë një ide për diversitetin e mundësive të të nxënit dhe qëllimet që mund të pasojnë leximin e një historie.

Sekuena e aktivitetit

<p><i>Lidhni qëllimet me mundësitë (Prezantim i seancës plenare).</i></p>  <p>Trajnuesi shpjegon ushtrimin: grupe të vogla i lënë grupet e tjera të vogla të zgjidhin problemet e tyre. Trajneri i ndan grupet në grupe të vogla dhe jep udhëzime (shikoni slajdin).</p>  <p>Grupet e vogla (e njëjtë si për ushtrimin e fundit) zgjerojnë hartat e tyre të mendjes duke shtuar qëllime për secilën nga mundësitë e të nxënit.</p>  <p>Reagimet në seancë plenare: A janë këto qëllime efektive? Jepuni pjesëmarrësve një mundësi për të përmirësuar qëllimet bazuar në reagimet në seancën plenare.</p>	<p>Lidhja e qëllimeve me mundësitë!</p> <p>Harta juaj e mendjes ose e konceptit tashmë përmban të paktën gjashtë mundësi të ndryshme për të mësuar, Nëse jeni frymëzuar nga prezantimi i të tjerëve, ju lutemi shtoni!</p> <p>Merrni të paktën tre nga këto mundësi potenciale të nxëni që ju mund ti ndiqni në klasën tuaj dhe përcaktoni qëllime që mund t'i arrini duke krijuar këto mundësi të nxëni.</p> <p>Zgjeroni hartën tuaj të mendjes ose konceptit duke shtuar qëllime të mundshme për secilën mundësi të nxëni. Kthehuni te tema 2 dhe aplikoni çfarë keni mësuar për të zhvilluar qëllime efektive!</p>
---	--

Aktiviteti 3.3.4: Përshtatni mjediset për të nxënit**Vështrim i përgjithshëm****Qëllimi:**

- Praktikoni të lidhni mundësitë e të nxënit me qëllimet për kërkesat e nxënësit, duke ndryshuar mjedisin;
- Reflektoni mbi ndërveprimin midis mundësive të të nxënit, qëllimeve dhe situatës së nxënësve;
- Përshtatni situatën e të nxënit për të siguruar pjesëmarrjen.

Fokusi i aktivitetit:

- Harta e mendjes me mundësi të të nxënit dhe qëllimeve si baza për të krijuar mjedise të të nxënit;
- Situata e nxënësve dhe përshtatjet që lehtësojnë pjesëmarrjen e tyre;

- Mbështetja e mësuesit për të lehtësuar pjesëmarrjen (strukturë, mbështetje e autonomisë, përfshirja).

Materiale dhe Metoda:






- Letër dhe lapsa, flipchart me rezultatet e ushtrimeve të mëparshme;
- Punë në grupe të vogla, reflektim dhe diskutim.

Informacion / alternativa shitesë

Informacion për trajnuesin:

Ky ushtrim i çon pjesëmarrësit një hap përpara. Tani që ata kanë një vështrim të përgjithshëm të mundësive të të nxëniet dhe se cilat qëllime mund të arrihen, ata konsiderojnë mjediset e të nxëniet që nevojiten për të krijuar mundësi të tilla të të nxëniet, dhe për të arritur qëllimet e parashikuara. Është hartuar një listë e përmasave që mund të përshtaten me kërkesat specifike. Sigurisht, ka shumë për të thënë në lidhje me çdo përmasë të listuar dhe se trajnuesi mund të zgjedhë për t'i dhënë shembujt së bashku me avantazhet dhe disavantazhet. Ka shumë për t'u bërë me krijimin e Mjedisëve Universale të të Nxëniet dhe trajnuesi mund të japë informacion mbi Projektimin Universal të të Nxëniet. Duke iu dhënë koha e mjaftueshme, trajnuesi mund ta fillojë aktivitetin duke treguar Webinarin 11 në seritë e UNIUCEF-it: [A Rights-Based Approach to Inclusive Education for Children with Disabilities](#).

Sekuena e aktivitetit

<p><i>Përshtatni mjediset e të nxëniet (Prezantim i seancës plenare).</i></p>  <p>Trajnuesi shpjegon përmasat e diferencimit ose personalizimit duke dhënë shembuj kur është e nevojshme. Është e rëndësishme të theksohet se disa mundësi të të nxëniet kërkojnë mjediset të caktuar të të nxëniet, ose të paktën janë lehtësuar nga ta (e ngjashme me qëllimet – dhe sigurisht, me nxënësit). Por, çështja e përshtatjes së nevojave të nxënësit duhet të ngrihet e fundit për të shmangur “përrjashtimin” e parakohshëm duke i zhvilluar mjediset e ndryshme, qëllimet, etj., nga fillimi!</p>  <p>Pjesëmarrësit duhet të kontribuojnë duke dhënë shembuj, dhe duke i lidhur me hartat e mendjes që kanë hartuar.</p>	<p>Përshtatja e mjedisëve të të nxëniet!</p> <p>Me shumë mundësi, jo të gjitha qëllimet që ju përcaktoni do të ndiqen pikërisht në mjedis të njëjtë. Merrni parasysh përmasat e mëposhtme për të krijuar mjediset mundësuese për t'i përshtatur qëllimeve tuaja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përmbajtja; ▪ Mësimdhënia ose strategjitë udhëzuese; ▪ Grupimi i nxënësve; ▪ Menaxhimi i klasës dhe sjelljes; ▪ Koha; ▪ Materialet dhe burimet; ▪ Produktet; ▪ Tjetër?
<p><i>Përshtatni kërkesat e nxënësit (seancë plenare).</i></p>  <p>Pjesëmarrësit prezantohen me këtë detyrë dhe u bëhen pyetje. Disa nga slajdet e mëposhtme mund të prezantohen, por ato nuk duhen prezantuar. Ato e zgjerojnë përmbajtjen e modulit 2 dhe nxjerrin në pah mënyrat nëpërmjet të cilave mësuesit mund të ofrojnë strukturë (Genti, Ina dhe Sara), mbështetje të pavarësisë (Deni) dhe përfshirje (të katër). Nëse është e nevojshme mund të jepen shembuj, ose pjesëmarrësit mund të eksplorojnë vetë.</p>  <p>Grupe të vogla për të marrë parasysh përmasat e diferencimit dhe se cila duhet përdorur për të katër nxënësit duke u nisur nga mundësitë e të nxëniet dhe qëllimet që ata kanë zgjedhur.</p>  <p>Reagime në seancë plenare, për të pyetur nëse ata ndihen sikur mund të fillojnë të planifikojnë krijimin e situatave të të nxëniet gjithëpërfshirës dhe të shumëllojshëm.</p>	<p>Për kërkesën e nxënësit</p> <p>Bazuar në kuptimin tuaj për situatën specifike të një fëmije nisur nga pjesëmarrja dhe kufizimet e saj, ju mund të krijoni kombinime kuptimplota për mundësitë e të nxëniet, qëllimet dhe mjedisin e të nxëniet.</p> <p>Përdorni shënimet, hartat dhe listat tuaja të krijuara deri tani në këtë temë dhe krijoni situata të nxëniet pjesëmarrëse që janë personalizuar për Sarah, Tobias, Yvana dhe Dejan.</p> <p>Merrni parasysh rolin tuaj në ofrimin e strukturës, mbështetjes për autonomi dhe përfshirjes mundësuese. Përdorni slajdet ose listat e mëposhtme!</p>

Aktiviteti 3.3.5: Kompetencat për gjithëpërfshirjen.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Reflektoni mbi atë çfarë është thënë bazuar në kompetencat personale të mësimeve;
- Prezantimi se si kompetenca e mësuesit lidhet me të qenit i aftë për të arritur qëllime afatgjata;
- Reflektoni mbi pjesëmarrjen në lidhje me zhvillimin profesional personal.

Fokusi i aktivitetit:

- Lëvizje, Veçori dhe Abstraksione dhe si ato lidhen me qëllimin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë;
- Kompetenca për arsimin gjithëpërfshirës – shkollat (si organizata të të nxënësve) dhe mësuesit;
- Kompetenca personale që lidhen me profilin e një mësuesi gjithëpërfshirës.

Materiale dhe Metoda:

- Letër dhe lapsa, Profil i mësuesve gjithëpërfshirës (opsionale);
- Punë individuale dhe reflektim;



Informacion / alternativa shpresë

Informacion për trajnuesin:

Ky aktivitet përmbyllet me temën 3 dhe i fton pjesëmarrësit të reflektojnë për situatën e tyre. Nuk janë vetëm fëmijët ata që duhet të performojnë, të kenë arritje dhe të bëhen të aftë për ta jetuar plotësisht jetën; kjo aplikohet edhe për mësuesit. Koncepti i "lëvizjeve", "veçorive" dhe "abstraksioneve" për këtë qëllim prezantohet këtu dhe lidh perspektivat e qëllimeve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.


Në këtë moment, pjesëmarrësit ftohen për të rishikuar përmbajtjen e modulit dhe reflektojnë për kompetencat e tyre për të krijuar shkolla dhe klasa gjithëpërfshirëse. Ushtrimi synon që secilin pjesëmarrës t'i ndajë njohuritë e tij me dikë tjetër, qoftë trajnuesi apo një koleg i besuar. Një rishikim më formal mund të kryhet nëse pjesëmarrësit duan të marrin një certifikatë. Kjo do të varet nga ofruesi i trajnimit.

Sekuena e aktivitetit

Kompetencat për gjithëpërfshirjen (Prezantim i seancës plenare).		Kompetencat për gjithëpërfshirje		
		Lëvizjet	Veçoritë	Abstraksionet
	Trajnuesi shpjegon këtë grafik, dhe nëse është e mundur i referohet direkt librit (shikoni broshurën prezantuese). Koncepti i "lëvizjeve", "veçorive" dhe "abstraksioneve" nënvizon faktin se vetëm menaxhimi i një klase nuk mjafton, dhe se ka edhe një perspektivë mësimeve, motivuese dhe kurrikulare dhe se veçoritë mund të përcaktohen vetëm përgjatë kohës dhe hapësirës. Abstraksionet – të gjitha të lidhura me qëllimet e edukimit dhe se si të arrihet atje – janë të nevojshme për ta personalizuar edukimin pa humbur linjën e qëllimeve mësimore.	Vëmendja Momenti Disiplina	Hapësira Koha Rutina	
		Qartësia Parimet e të nxënësve	Modelet e mësimeve	
		Pritshmëritë Forcimi i marrëdhënies personale	Klima në klasë	
	Diskutimi i kësaj matrice në seancë plenare.			Projektimi i kurrikulës Objektivat Planifikimi Përvojat e të nxënësve Vlerësimi Objektivat gjithëpërfshirës

Performanca, arritje dhe aftësisë (Prezantim i seancës plenare).

Me këtë grafik, lidhjet midis slajdit të mëparshëm dhe ushtrimit për përcaktimin e qëllimit në temën 2 bëhen më të dukshme. Trajnuesi duhet të japë shembuj se si lëvizjet mund të kontribuojnë për veçoritë, etj.

Performanca, arritjet dhe aftësitë e shkollave dhe mësuesve*Reflektim personal (Prezantim i seancës plenare).*

Një prezantim i shkurtër mund të jepet për t'u siguruar se pjesëmarrësit e kuptojnë detyrën.

Pjesëmarrësit reflektojnë mbi këto çështje duke kaluar përmes moduleve. Duhet ofruar një kopje e versionit/ listës së shkurtër të kontrollit "Profili i një mësuesi gjithëpërfshirës" për të lehtësuar detyrën. Pjesëmarrësit, mund të shkruajnë edhe pyetje.



Rishikimi i reflektimeve duhet bërë me një person tjetër (trajnuesi ose një pjesëmarrës tjetër).

Reflektimi personal

Tre modulet për arsimin gjithëpërfshirës nxjerrin në pah katër fushat e kompetencave:

- Vlerësimi i diversitetit të nxënësit;
- Puna me të tjerët;
- Mbështetja e të gjithë nxënësve;
- Zhvillimi profesional personal.

Ju lutemi, merrni kohë për të reflektuar mbi kompetencat tuaja dhe ku mendoni se keni nevojë për të fituar aftësi në mënyrë që të jeni një mësues gjithëpërfshirës që punon në një shkollë gjithëpërfshirëse. Ndajini mendimet tuaja ose me trajnuesin ose me kolegët tuaj.

Tema 3.4:

Zhvillimi i praktikave për t'i mbështetur të gjithë nxënësit.

Vështrim i përgjithshëm i Temës 3.4

Qëllimi i temës

- Hartoni strategji bashkëpunim për ta zbatuar në shkollën tuaj;
- Zhvilloni mjete dhe metoda hartimi që mund t'i zbatoni në shkollën tuaj;
- Hartoni strategji për të ecur përpara në arritjen e arsimit gjithëpërfshirës.

Trajnuesit jo vetëm që mund t'i prezantojnë qëllimet dhe synimet e temës, por mund t'u kërkojnë pjesëmarrësve që të shkruajnë ndonjë pyetje që ata mund të kenë në lidhje me përmbajtjen dhe qëllimet e kësaj teme. Këto pyetje mund të përdoren sërish kur çështja trajtohet në trajnim. Në fund të çdo teme, trajnuesi mund të pyesë nëse janë trajtuar të gjitha pyetjet.

Vështrim i përgjithshëm i aktiviteteve

Aktiviteti 3.4.1: Sillini të gjitha bashkë - World Café;

Aktiviteti 3.4.2: Proveni një ide!

Aktiviteti 3.4.3: Rishikimi dhe planifikimi për të ardhmen.

Aktiviteti 3.4.1: Sillini të gjitha bashkë - World Café.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Angazhojini të gjithë pjesëmarrësit në zgjidhjen e problemit në mënyrë bashkëpunuese;
- Jepni ide për të promovuar gjithëpërfshirjen në klasë, shkolla dhe komunitet;
- Aplikoni atë që keni mësuar deri tani;
- Proveni një metodë që gjithashtu mund të përdoret në shkolla.

Fokusi i aktivitetit:

- Koha, ngjarjet dhe proceset për të promovuar gjithëpërfshirjen;
- Hapësirat dhe krijimi i mjediseve;
- Njerëzit dhe marrëdhëniet e tyre.

Materiale dhe Metoda:

- Fleta me informacione për pritësit (lehtësuesit), letër e madhe për të mbuluar tavolinat dhe lapsa, flipchart për lehtësuesin;
- Brainstorming, diskutim, reflektim.

Informacion/alternativa shtesë

[http://en.wikipedia.org/wiki/World_Café_\(conversational_process\);](http://en.wikipedia.org/wiki/World_Café_(conversational_process);)

<http://www.kstoolkit.org/The+World+Cafe>


Informacion për trajnuesin:


Ky aktivitet i angazhon pjesëmarrësit në një veprimtari në grup për ndarjen e përvojave, planifikimi dhe zgjidhjen e problemit. Gjithashtu, nënkuptohet edhe bashkimi i të gjitha atyre që janë mësuar më parë dhe aplikimi i tyre. World Café është një metodë ndërveprimi në grup e mirë-ndërtuar për të lehtësuar dialogun bashkëpunues, ndarjen e njohurive, zgjidhjen e problemit dhe brainstorming; grupet punojnë mbi tre sete pyetjesh që kanë lidhje me zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës. Kjo metodë mund të përdoret edhe në shkolla si një hap i parë në një proces zhvillimi për shkollën drejt arsimit gjithëpërfshirës, ajo sjell së bashku njohuri, përvoja dhe perspektiva të ndryshme për të krijuar ide dhe strategji bashkëpunuese. Gjithsej janë tre raunde, kështu që çdo pjesëmarrës ka mundësinë të diskutojë mbi të gjitha pyetjet. Udhëzimet e detajuara mund të gjenden edhe në fletën e informacionit – e cila është për trajnuesit, por edhe për pritësit që mirëpresin pjesëmarrësit në tavolinat e tyre, mbajnë shënime për çështjet më të rëndësishme dhe informojnë grupet pasuese për diskutimet dhe idetë që tashmë janë diskutuar. Më shumë informacion për metodën mund të gjendet në internet.

Tre pyetjet për të cilat pjesëmarrësit do të diskutojnë përqendrohen te: “Koha, Ngjarjet dhe Proceset”, “Hapësirat dhe Mjediset”, dhe “Njerëzit dhe Marrëdhëniet e tyre”. Ka tre përmasa planifikimi që duhen pasur parasysh për realizimin e arsimit gjithëpërfshirës. Pjesëmarrësit ftohen për të reflektuar se çfarë nevojitet për secilën përmasë për t’i mbështetur të gjithë nxënësit, për të vlerësuar diversitetin e nxënësit, për të punuar me të tjerë dhe për zhvillimin profesional – pra, duke lidhur ushtrimin me fushat e kompetencës për arsimin gjithëpërfshirës.

Trajnuesit do t’i duhet të identifikojë “pritësin” (lehtësuesin) për secilën tabelë dhe të shpjegojë se çfarë pritët prej tyre. Fleta e informacionit është kryesisht për lehtësuesin. Çdo pyetje jepet si detyrë për një tavolinë, në varësi të numrit të pjesëmarrësve.; trajnuesit mund të planifikojnë për tre ose gjashtë tavolina (çdo pyetje në dy tavolinë, dy grupe të ndara me rotacion në të njëjtën klasë). Pirja e kafes dhe e pijeve që ndodhen aty mund t’i shtohen kësaj atmosfere, por mund të jetë paksa problematike duke pasur parasysh hapësirën dhe pjesëmarrësit që lëvizin midis tavolinave.

Sekuena e aktivitetit

<p><i>Zgjidhja e problemeve të mëdha së bashku (Aktivitet në grup).</i></p>  <p>Trajnuesi shpjegon qëllimin dhe synimin e kryerjes së World Café.</p> <p>Përpara se të fillojë aktiviteti, trajnuesi duhet të përgatisë tabelat dhe të identifikojë dhe marrë në pyetje “pritësit” (lehtësuesit).</p>	<p style="text-align: center;">Bashkimi i tyre</p> <p>World Café — qëllime për t’u arritur:</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Tre pyetje diskutohen në grupet e përziera; ■ Pjesëmarrësit shkëmbejnë mendimet dhe përvojat e tyre; ■ Kuptueshmëria dhe kuptimi i pozicionit dhe perspektivave të tjerëve thellohet; ■ “Niveli më i lartë (state-of-the-art)” përmbledhësi diskutimit nxirret në pah, konsolidimi dhe specifikimet e problemeve bëhen të dukshme; ■ Çështjet më të rëndësishme të diskutimeve mbahen shënim.
--	--

 <p>Për procesin ofrohet një vështrim i përgjithshëm dhe tre pyetje. Trajnuesi duhet të sigurohet nëse pyetjet janë kuptuar dhe nëse fokusi i pyetjes është i qartë (si të krijojmë një arsim gjithëpërfshirës).</p>	<p style="text-align: center;">Sekuenca e World Café</p> <p>Kohëzgjatja e World Café është afërsisht 90 minuta:</p> <p>0.00 - 0.10: Prezantimi dhe ftesë për World Café.</p> <p>0.10: Tre pyetje trajtohen dhe diskutohen në tre raunde — secila në tavolina të ndryshme.</p> <p>0.50: Pas dy raunde pyetjesh ka një pushim të shkurtër. Si është situata e diskutimit?</p> <p>1.00: Raundi final i diskutimeve, puna mbi pyetjen e fundit duke marrë parasysh çka është thënë gjatë pushimit.</p> <p>1.20: Flipcharte dhe produkte të tjera vihen në dispozicion të çdokujt.</p> <p>1.20— 1.30: Sinteza e rezultateve nga pritësit (lehtësuesit).</p> <p>Diskutim i gjetjeve dhe pikëpamjeve.</p>
<p style="text-align: center;">Café - Hapësirat dhe krijimi mjediseve</p> <p>Pyetja 1: Koha, ngjarjet dhe proceset</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Çfarë duhet të ndodhë gjatë vitit shkollor? (p.sh. ngjarje, takime, procese planifikuese) ▪ për të mbështetur të gjithë nxënësit? ▪ për të vlerësuar diversitetin e nxënësit? ▪ për të punuar me të tjerët? ▪ për zhvillimin profesional? 	<p style="text-align: center;">World Café - Hapësirat dhe krijimi mjediseve</p> <p>Pyetja 2: Hapësirat dhe krijimi i mjediseve</p> <p>Çfarë hapësirash ose mjedise duhen krijuar? (p.sh. mjediset e të nxënës, ndërtesa dhe terrene shkollore, hapësira në komunitete)</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ për të mbështetur të gjithë nxënësit? ▪ për të vlerësuar diversitetin të nxënësit? ▪ për të punuar me të tjerët? ▪ për zhvillimin profesional?
<p style="text-align: center;">World Café - Njerëzit dhe marrëdhëniet</p> <p>Pyetja 3: Njerëzit dhe marrëdhëniet e tyre</p> <p>Kush duhet fuqizuar dhe cilat marrëdhënie duhen promovuar? (p.sh. nxënësit, prindërit, mësuesit drejtorët, autoritetet e shkollës, të tjerë)</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ për të mbështetur të gjithë nxënësit? ▪ për të vlerësuar diversitetin e nxënësit? ▪ për të punuar me të tjerët? ▪ për zhvillimin profesional? 	

Aktiviteti 3.4.2: Provoni një ide!

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Ofroni një mundësi për të punuar mbi diçka konkrete që mund të përdoret në punën personale;
- Konsolidoni disa ide të nxjerra gjatë World Café;
- Ndhimojini pjesëmarrësit me transferimin e atyre çfarë ata kanë mësuar në mjedisin e tyre të punës.

Fokusi i aktivitetit:

- Idetë e nxjerra nga World Café;
- Punë personale dhe çfarë nevojitet për ta përmirësuar atë;
- Mjete ose dokumente pune që mund të përdoren në mjedisin personal të punës.

Materiale dhe Metoda:

- Grupe të ndryshme do të kenë nevojë për materiale, informacione, literaturë të ndryshme, etj.
- Punë zhvillimore bashkëpunuese.

Informacion / alternativa shtesë

Informacion për trajnuesin:

Ky aktivitet ndahet tre pjesë: identifikimi i idesë se pjesëmarrësit duan të pasojnë me veprime; puna me idetë në grupe të vogla, dhe prezantimi i ideve. Pjesa e parë e aktivitetit do të ishte ideale të kryhej në fund të ditës së punës. Kjo do t'i jepte trajnuesit mundësinë për t'u ofruar pak ndihmë ekipeve duke u projektuar të gjithë punën e planifikuar për t'u bërë, dhe t'u caktojë grupeve materialin ekzistues që mund të jetë i dobishëm për ta.

Mënyra se si është organizuar, niveli i mbështetjes së nevojshme, cilësia e pritshme e produkteve, etj., do të varen nga pjesëmarrësit. Deri tani, trajnuesi do të ketë fituar përvojë dhe aftësi të mjaftueshme për të qenë i aftë ta përshtatë këtë ushtrim me nevojat dhe aftësitë e grupit. Ai ose ajo mund të vendosë që të përqendrohet vetëm në disa mjete të pakta për t'u zhvilluar, bazuar në materialin ekzistues. Nëse modulet janë pjesë e një projekti zhvillimi më të madh, ushtrimi duhet të përqendrohet mbi qëllimet e përgjithshme të projektit.

Sekuena e aktivitetit

<p><i>Prezantim (seancë plenare).</i></p>  <p>Trajnuesi bën një prezantim të shkurtër të këtij aktiviteti që u kërkon fillimisht pjesëmarrësve të zgjedhin dhe më pas të punojnë mbi një ide për ta bërë atë të realizueshme më mjedisin e tyre të shkollës.</p>  <p>Njerëzit që janë të interesuar për të njëjtën ide ose që punojnë në të njëjtin mjedis duhet të mblidhen së bashku dhe të përpiqen të trajtojnë çështje specifike duke përdorur rezultatet nga World Café.</p> <p>Idetë dhe ajo se çfarë mund të nxjerrësh nga ato duhen shkruar në një flipchart, në mënyrë që të organizohet puna.</p>  <p>Flipcharte mund të vendosen në mure, duke krijuar një atmosferë tregu, ku grupet mund të shesin ide, të mblidhen së bashku për të punuar mbi të njëjtën ide, të ndihmojnë në përmirësimin e ideve të tjerëve duke shtuar informacion në flipchart, etj.</p> <p>Kjo seancë duhet të mbyllet duke identifikuar se për çfarë do punojë secili grup dhe cili do jetë produkti i punës së tyre.</p>	<p>Një ide për ndjekjen e veprimit!</p> <p>Shumë ide krijohen nga ju gjatë World Café. A ju ka mbetur ndonjë ide në mendje si shumë interesante? A ka ndonjë ide mbi të cilën ju doni të punoni — në mënyrë që ju të mund ta përdorni në komunitetin, shkollën ose klasën tuaj?</p> <p>Ju lutemi, shkruajeni idenë tuaj në flipchart ose slajd dhe përmendni se çfarë doni të zhvilloni. Shpjegoni se si kjo do të jetë e dobishme për të promovuar arsimin gjithëpërfshirës.</p> <p>Të gjitha idetë do të ndahen me të tjerët për të shmangur përsëritjet dhe për ta përmirësuar idenë tuaj përpara se të punoni me të!</p>
<p><i>Prezantimi i produkteve (seancë plenare).</i></p>  <p>Ashtu siç tregohet më sipër, mënyra e punës dhe se si do të prezantohen produktet në seancë plenare varet nga pjesëmarrësit dhe mjedisi ku punohen modulet. Trajnuesi duhet t'i japë aktivitetit një strukturë shtesë duke e bërë atë më kuptimplotë për grupin.</p>  <p>Prezantimet dhe shkëmbimi i produkteve duhet të organizohet në një mjedis informal dhe motivues, p.sh. duke zgjedhur një ide të një tregu ku njerëzit takohen, “bli dhe shit”, shkëmbim mallrash.</p>	<p>Prezantimi i produktit tuaj</p> <p>Prisni ta prezantoni produktin tuaj ose sa keni përparuar drejt krijimit tij.</p> <p>Se si e bëni këto, do të varet nga produkti juaj, por mendoni për një mënyrë interesante dhe krijuese për ta bërë!</p> <p>Jepni llogari se si do ta përdorni këtë produkt në shkollën tuaj dhe çfarë shpresoni të arrini.</p> <p>Nëse keni nevojë për ndihmë, ju lutemi kërkojeni!</p>

Aktiviteti 3.4.3: Rishikimi dhe planifikimi për të ardhmen.

Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi:

- Reflektoni mbi atë se çfarë është mësuar, diskutuar dhe zhvilluar;
- Reflektoni mbi mënyrat për të transferuar njohuritë në mjedisin personal;
- Hartoni strategji dhe ndani ide se si ta bëni këtë.

Fokusi i aktivitetit:

- Aktivitete dhe produkte të tre moduleve;
- Mjedis pune personal dhe çfarë nevojitet;
- Hapat e tjerë personal kur "të shkoni në shtëpi".

Materiale dhe Metoda:

- Përcaktohen nga trajneri;
- Reflektim, vlerësim, diskutim.

Informacion / alternativa shtesë**Informacion për trajnuesin:**

Është e rëndësishme që pjesëmarrësve t'iu jepet mundësia për të rishikuar modulet, për të reflektuar mbi atë se çfarë kanë mësuar dhe se si ajo mund të përdoret në mjedisin e tyre personal të punës. Se si do të bëhet kjo, dhe nëse do të ketë një vlerësim formal për atë se çfarë është mësuar, një detyrë për të reflektuar mbi një temë, ose produkte të tjera që pjesëmarrësit mund të krijojnë për të vlerësuar punën e tyre, mbetet për t'u vendosur nga trajnuesi. Prandaj, këtu nuk mund të propozohet asnjë aktivitet specifik dhe trajnuesit do t'i duhet të zhvillojë aktivitetin e tij ose saj.

